



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 15 NËNTOR 2012**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 15. NOVEMBRA 2012. GODINE**

**NËNTOR - NOVEMBAR
2012**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013.

Dnevni red

1. Vreme za izjašnjavanje izvan dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Prvo razmatranje Nacrta zakona o budžetu Republike Kosova, za 2013. godinu.

Seancën e drejtoi kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë dhe ministra,
I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës, sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Fillojmë me pikë e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për diskutime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta.
Diskutimi në emër të grupeve parlamentare, 5 minuta. Në emër të deputetit, 3 minuta.
Replika, siç e dini, nuk ka.

Fjalën e ka kërkuar deputetja Xhevahire Izmaaku.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit kryetar!

I nderuar nënkryetar,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Fjala ime sot ka të bëjë lidhur me festat e 100-vjetorit, pra të shënimit të 100-vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë.

28 Nëntori 1912 është datë që e mbajti gjallë shpresën e lirisë dhe të demokracisë në trevat tona tash e 100 vjet. Këtë jubile shekullor, edhe pse ende larg ëndrrës së rilindësve tanë, e festojmë me të arritura historike për kombin tonë.

Shteti shqiptar, brenda kufijve të përcaktuar nga Konferenca e Londrës, tashmë ka hyrë në rrugën e pakthyeshme të zhvillimit, përparimit dhe integritetit euroatlantik.

Kosova e ka hequr përfundimisht zgjedhën serbe, duke e shpallur pavarësinë e saj, të njohur tashmë nga mbi 90 vende të globit. Shqiptarët në viset tjera etnike, brenda kufijve të shteteve fqinje, po i vazhdojnë përpjekjet për t'i fituar të drejtat e tyre legjitime.

Në këto rrethana, kremtja e 100-vjetorit të krijimit të shtetit shqiptar mendoj se do të ishte e varfër nëse nuk do të shënohej edhe nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Prandaj, në kuadër të festimeve gjithëkombëtare, propozoj organizimin e një seance solemne të Kuvendit të Kosovës kushtuar kësaj ngjarjeje madhore për kombin tonë, në të cilën do të ftoheshin figurat eminente të jetës publike e institucionale nga të gjitha viset shqiptare dhe diaspora, e pse jo edhe përfaqësues ndërkombëtarë.

Nëse eventualisht nuk do të ketë një shënim të tillë, e shfrytëzoj rastin, duke filluar nga ju, kryetar i Kuvendit, dhe gjithë kolegët e mi deputetë, të ju uroj për 100-vjetorin e pavarësisë së shtetit shqiptar. Faleminderit!

KRYETARI: Kryesia nuk merr vendim mbi bazë të deklarimeve jashtë rendit të ditës. Fjalën e ka deputetja Vjosa Osmani.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Ditëve të fundit kemi qenë dëshmitarë të spoteve të ndryshme promovuese të Radio-Televizionit të Kosovës, në të cilat promovohen emisione dhe programe të këtij mediumi me rastin e 100-vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë.

Por, çka bie në sy në secilin nga këto spote është mungesa e presidentit historik doktor Ibrahim Rugova, përderisa pareshtur shfaqen figura të tjera historike që kanë kontribuar gjatë qindvjeçarit të kaluar. Kjo politikë editoriale e selektive nuk është e papritur nga ky medium publik, i cili vazhdon ta bëjë zëdhënësin e kryeministrit të Qeverisë dhe të PDK-së, duke e anashkaluar çdo figurë tjetër që nuk është e ndërlidhur me kryeministrin, PDK-në dhe Qeverinë.

Përderisa vepra dhe roli i presidentit Rugova në vënien e themeleve të shtetit të pavarur të Kosovës dhe si kontribuues i paqes, demokracisë, lirisë dhe vlerave perëndimore, jo vetëm në hapësirat mbarëshqiptare, por edhe më tej, është theksuar dhe përshëndetur nga figurat më emblematike ndërkombëtare, madje edhe në këtë Kuvend, si presidenti Bill Klinton, ish-kryeministri Toni Bler, sekretarja Klinton e të tjerë, kontributin e tij fatkeqësisht nuk e vlerëson, por përkundrazi po e injoron RTK-ja.

Ne i bëjmë thirrje edhe një herë mediumit publik që të mos ndikohet politikisht gjatë hartimit të politikave editoriale dhe urgjentisht t'i korrigjojë spotet politike, duke e përfshirë edhe kontributin e presidentit Rugova.

Përkundër këtyre tendencave, askush nuk do të mund ta rrënojë veprën e presidentit Rugova në historinë e shekullit tonë. Askush nuk do të mund ta rrënojë krenarinë që ndien çdo qytetar i Kosovës, meqë jetuam në shekullin e Ibrahim Rugovës. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Visar Ymeri e ka kërkuar fjalën, në emër të Grupit.

VISAR YMERI: Faleminderit kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Skandali i fundit i zhdukjes së 1,4 milion eurove nga Buxheti i Republikës së Kosovës nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme shpërfaq dy gjëra për këtë Qeveri, por edhe për Prokurorinë e vendit.

Nën një - korrupsioni tashmë është bërë normë e funksionimit të Qeverisë. 10%-shi është etabluar si pjesë e pandashme e koston e kontratës për cilindo prokurim të Qeverisë. Kur kjo bëhet edhe në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministria pra që e menaxhon Policinë e Republikës së Kosovës, atëherë kjo e shpërfaq qartë edhe arsyen pse nuk e kemi një polici të suksesshme në ndjekjen e krimit, dhe aq brutale në shkeljen e qytetarëve.

Dhe, nën dy, ndërhyrjet e politikës në Gjyqësor. Deri tash, të gjithë qytetarët kanë pasur dyshime për nivelin e lartë të korrupsionit në Gjyqësor, por disa qytetarë e kanë pasur një fije shprese se EULEX-i do ta përmirësojë këtë situatë të pashpresë. Rasti i 1,4 milion eurove të pasaportave e dëshmon qartë se EULEX-i nuk do të jetë zgjidhja e problemit, por një pjesë e rëndësishme e problemit. Kjo për shkak të politikës së EULEX-it dhe të lidhjeve të tij me politikën e Qeverisë, e cila e ka vendosur veten në funksion të negociatave dhe kompromisit me Serbinë.

1,4 milion euro janë 10% e kontratës prej 14 milionë eurove, të cilën e ka fituar kompania austriake OESD për shtypjen e pasaportave të Kosovës. Nga Qeveria na premtohej se këto pasaporta do të jenë bileta jonë drejt udhëtimit pa viza, ndërkohë që realiteti po tregon se këto paskan qenë bileta e lotarisë që i pasuron zyrtarët e lartë qeveritarë.

Njëra prej protagonisteve të publikuara deri tash nëpër media për këtë aferë, gjermania Natalie Velijaj, e cila është arrestuar, ka ofruar dëshmi të dokumentuara për këtë aferë. Ajo kishte deklaruar se dihet shumë mirë se në llogari të kujt kanë shkuar 1,4 milionët e avulluar. Ajo e di këtë me të vërtetë, pasi ka qenë ajo që i ka bartur këto mjete në këto llogari. Mirëpo, sipas avokatit të saj, as prokurori vendor, e as ai i EULEX-it nuk kanë pranuar që ta lejojnë të flasë për këtë gjë. Paramendoni se çfarë intervenimi brutal në procedurat, por edhe në frymën e funksionimit të një Gjyqësori të pavarur po e provojmë në këtë rast.

E arrestuara për korrupsion insiston që të prezantojë fakte për aferën, e prokurorët nuk e lejojnë një gjë të tillë. Zakonisht i arrestuari është ai i cili do t'i fshehë faktet, e prokurori bën çmos që t'i zbardhë ato. Në këtë rast, është e kundërta, prokurorët vendorë e ndërkombëtarë po duan t'i fshehin ato, duke e përdorur pozitën e tyre zyrtare për ta penguar zbardhjen e këtyre fakteve.

Këtij rasti duhet shkuar deri në fund. I bëjmë thirrje Prokurorisë që të mos e pengojë zbardhjen e rastit dhe dënimin e fajtorëve. Pra, mos iu frikësoni të korruptuarve dhe mos i ndihmoni ata!

Sa i përket Bajram Rexhepit, mua po më çudit fakti se si ai është ende këtu. Skandal pas skandali, dhe i ashtuquajtur i kryeministër vazhdon ta mbajë atë në Qeveri. Kjo dëshmon se implikimi në këtë rast, por edhe në raste tjera, shkon shumë më lart dhe shumë më thellë.

Pra, i bëjmë thirrje Qeverisë, po ashtu, që të mos ndërhyjë në Gjyqësor dhe ta lejojë atë që pavarësisht t'i ndjekë rastet e korrupsionit dhe rastet tjera që lidhen me krimin e organizuar. Për t'u thënë mos vidhni, po më duket pak e tepërt, për shkak se këta tash e kanë bërë zakon vjedhjen. Por të paktën, kur zihen, le ta pranojnë dhe le të shkojnë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Aurora Bakalli.

AURORA BAKALLI: Faleminderit, kryetar!

Diskutimi im bartet nga java e kaluar, por nuk kam pasur mundësi ta marr fjalën. Ky diskutim ka të bëjë me një çështje që i ka shqetësuar mjaft shumë qytetarët e Gjakovës, e kjo për faktin dhe iniciativën që është ndërmarrë për ndërrimin e kalldrëmit në Çarshinë e Madhe të këtij qyteti.

Qytetarët e Gjakovës shquhen për vetinë që ta ruajnë traditën e tyre. Vetë Çarshia e Madhe e Gjakovës ishte shkatërruar tërësisht gjatë luftës së fundit, ndërsa gjatë renovimit të saj u tentua që t'i qëndrohet sa më besnik pamjes së përparme të Çarshisë. Projekti për renovimin e Çarshisë së Madhe është projekt pre 1 milion euro i Komunës së Gjakovës, por mbetet shumë e paqartë se pse me këtë projekt parashihen veprime, të cilat do t'ia ndërrojnë autenticitetin kësaj çarshie, e cila përndryshe është pjesë e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme.

Është shumë e paqartë se pse duhet ndërruar kalldrëmin dhe zëvendësuar atë me rrasë gurës të Gllarevës, të cilët do t'ia ndërrojnë shumë pamjen origjinale Çarshisë, ndërkaq edhe vetë cilësia dhe qëndrueshmëria e këtij materiali, krahasuar me aktualin, është shumë e dyshimtë.

Sipas definimit, trashëgimia kulturore e paraqet pasurinë kulturore që trashëgohet nga gjeneratat e kaluara, mirëmbahet me të tashmen, dhe u dhurohet gjeneratave të ardhshme. Këtë obligim e kemi edhe ne, ta ruajmë trashëgiminë tonë kulturore që t'ua dhurojmë gjeneratave të ardhshme, e në asnjë mënyrë ta bastardojmë atë.

Me këtë rast dua ta përshëndes vendimin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, sipas të cilit është kërkuar ndalimi i menjëhershëm i punimeve. Tani shpresojmë se punimet nuk do të zvarriten dhe ta lënë të shëmtuar këtë pjesë të qytetit të Gjakovës dhe, mbi të gjitha, shpresojmë se pamja e Çarshisë do të mbetet autentike, se përndryshe do të humbë një pjesë shumë e rëndësishme e identitetit të qytetit të Gjakovës.

Të nderuar deputetë,

Ne si Lëvizje për Bashkim i kundërshtojmë veprimet e fundit në Çarshinë e Madhe dhe fuqishëm kërkojmë ruajtjen e trashëgimisë kulturore shqiptare, pasi si shoqëri jemi treguar shumë të përkushtuar për ruajtjen e trashëgimisë së pakicave, ndërsa mjaft indiferentë, siç po tregon edhe ky rast ndaj vlerave tona. Si duket, qenka dashur që edhe trashëgimia kulturore shqiptare të futet në pakon e Ahtisarit, ndoshta do të përkujdeseshim më shumë për të. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Goran Marinković.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala predsjedniče!

Poštovani poslanici,

Na prethodnim sednicama mi kao poslanici koristili smo skupštinsku govornicu kako bi na neki način iskazali svoje nezadovoljstvo, ali ima i reči hvale za neke procese i događaje koji su se desili u prethodnom periodu na Kosovu.

Pokušali smo da pokažemo realnu sliku u kome živi moj narod, i nikad nismo nikoga prozvali, jer za to ne postoje konkretni dokazi, da se to zaista nije desilo. Za procese koji su bili za pohvalu, ja i moje kolege javno i bez imalo stezanje smo pozdravljali, i kao takvi javno pohvaljivali.

Bili smo i ostali najpouzdaniji partner vladajućoj koaliciji, i kao takvi radili smo svesno i donosili neke odluke u korist svoje štete, samo za to da ne bi smo mi bili taj jazičak na vagi koji bi usporio procese, koji je započeti mnogo ranije, a koji su završavali sada. Takvim svojim radom mislimo da na najbolji mogući način štitimo interes svoje zajednice. Ali izgleda da smo samo mi koji poštujemo dogovore, jer problemi mog naroda, iako smo deo vladajuće koalicije, ne smanjuju se, naprotiv mislimo da se povećavaju, a kao takvi nama koji smo dobili glasove iz tog naroda postavlja se, moram da kažem, opravdano pitanje - šta mi to tamo radimo?

Da ovo sve što sada kažem ima zaledinu i da nije samo priča iz nečije probleme, koji su se desili za Srpsku zajednicu zadnjih mesec dana. 13.10. - Đurakovac: krađa traktora koji su koristili povratnici, koji je bio iz donacije IEM; 15.10. - Srbina maltretirale Albanci, šutirali i tražili novac, probušili mu gume na kola; 18.10. - u selu Svinjare, iz povratničke kuće ukradeni prozori i garažna vrata; 23.10. - kamenovana je kuća Srbina u selu Tučeš; 27.10. - na groblju u Đakovici ukradena metalna vrata; 28.10. - oskrnavljen grob u selu Suvo Grlo; 25.10. - u selu Zakač, dok je obrađivao Srbina Maksića, napali Albanci koji su mu uzurpirali zemlju; 24.10. - u selu Zupče uhvaćeno je 7 Albanaca kako seku šumu koja je u vlasništvu Srba; 1.11. 2012. - memorijalna ploča postavljena u avgustu na putu između Orahovca i Zočišta na dvojezičnom jeziku, koje je predstavljao obaveštenje i apel da se pronađu dva novinara, koji su nestali 1998. godine na tom putu, nestalo je. 9.11. - u Suvom Lukovcu pucano je na Srbina Momira Pantića, koji je tada ranjen.

Posle ovakvih dešavanja, šta reći više nego da su opravdane kritike upućene nama srpskim poslanicima, koji sada sedimo u Parlamentu Kosova. Ali kritike su upućene i vama gospodo poslanici iz većinske zajednice, jer za ovakvo stanje odgovorni ste i vi, a odgovorni ste što ćutite i javno ne osudite bilo koji vid nasilja, ma ko da ga je počinio.

Završiću rečima...

KRYETARI: Paraqituni kur ta merrni fjalën në emër të Grupit, që t'i keni 5 minuta! Mirë, vazhdoje edhe 2 minuta.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala! Imam samo još jednu rečenicu. Završiću rečima Alberta Ajnštajna, koji je rekao: "Sveti opasno mesto, ne zbog onih koji čine zlo, već zbog onih koji to mirno gledaju i ne čine ništa da to spreče". Hvala!

KRYETARI: Vazhdojmë. Deputeti Halit Krasniqi e ka fjalën.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!
Të nderuara deputete dhe deputetë,

Unë e kam bartur fjalën nga mbledhja e kaluar, një ditë pas zgjedhjeve në SHBA.

Mesazhi për Kosovën nga SHBA-të:

Mos shpifni për njëri-tjetrin! Lëreni logjikën e deritashme në këto momente të rëndësishme për vendin tuaj. Besim bashkëpunëtorit, besim në zgjedhësit, besim në qytetarët, respekt për oponencën, besim në bashkëpunimin e përbashkët për të mirën e vendit tuaj, theksim i veçantë i rëndësisë së bashkëpunimit të alternativave, besim në rendin kushtetues!

Ky mesazh vjen nga zgjedhjet e fundit në SHBA. Në këto zgjedhje, fjala e Romnit, në momentin e pranimit të humbjes, është leksion për epokën tonë, të cilin e kishin preferuar 50 milionë zgjedhës. Megjithatë, ai lutej për shëndetin e presidentit dhe për vendin e tij, që e kishte zgjedhur liderin e vërtetë.

Gjithashtu, edhe fjala e presidentit Obama ishte leksion i dytë për epokën tonë. Edhe ky i shquante vlerat e Romnit dhe premtonte bashkëpunim. Krijimi i idesë se pasuri e parë dhe e vërtetë janë vlerat njerëzore dhe rendi kushtetues, e jo resurset natyrore dhe në atë nëntokësore të një vendi.

Dhe, derisa i marr këto mesazhe nga këto zgjedhje, më ngacmojnë shumë ide, shumë konceptione e shumë teori dhe më shtrëngojnë nga një mori ndjenjash, por dy nga ato më përshkojnë njëherësh, që mund t'i akceptoj. respekti për vlerat amerikane dhe zilia për to.

Ky fërkim ndjenjash më nxit meditimin për analizat e historisë, të alternativave dhe diveristeteve të jetës amerikane, duke i krahasuar ato me realitetin tonë. Ne jetojmë në një diversitet besimesh fetare me qindra vjet dhe asnjëherë, asnjë përplasje nuk e kemi pasur ndërmjet popullit tonë, as në festat islame, as në evenimentet katolike, as në ceremonitë ortodokse, të cilat gjithnjë janë zhvilluar edhe në ambiente të afërta dhe në hapësira të ngushta, pa as më të voglin incident në gjithë etninë tonë, as nga zëri i hoxhës në minaret e xhamive, as nga ushtima e kambanave të kishave që kanë zgjuar dhe zgjojnë artikulum të ndryshëm mbi oborret e njëri-tjetrit, dhe shumë hollësi tjera që i përkasin jetës sonë të përditshme.

Por, kjo tolerancë dhe kjo kulturë u mungon zhvillimeve politike. Madje është jetësuar një marrëdhënie e stërkequr deri në shpërftyrim të kulturës sonë tradicionale. I lutem Zotit që t'i ndryshojë këto marrëdhënie ndërmjet nesh.

Sikur ta sjellim rastin e Al Gorit para nesh në kujtesën tonë tash pas këtyre zgjedhjeve, në zgjedhjet e mëparshme, dhe të kujtojmë se ai i kishte 500 mijë votues afërsisht më shumë sesa kundërshtari i tij që në votën popullore humbi, por sistemi i tyre e kishte nxjerrë kundërshtarin e tij politik që kishte më pak se 500 mijë votues dhe natyrisht se qytetarët, por edhe Al Gori iu bind sistemit dhe natyrisht se ky është një shembull plotësisht...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Deputeti Afrim Kasolli e ka fjalën.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit kryetar,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që sot për diskutim të ngre një çështje të ndjeshme për shoqërinë tonë. Kriza e përgjithshme, e cila e ka përfshirë sferën e arsimit në Republikën e Kosovës, pa dyshim se shkakun themelor të saj e ka te logjika partiake e menaxhimit të kësaj sfere.

Me këtë rast, pranimi i punëtorëve arsimorë në shkollat e mesme dhe fillore gjithandej Kosovës, ekskluzivisht mbi baza partiake dhe familjare, ka bërë që nepotizmi e zhbërja e mundësive kualitative të jenë bërë esenca e kësaj fushe. Në këtë kontekst, kryesisht pushtetarë komunalë thuajse nëpër gjithë Kosovën po i përdorin drejtoritë e arsimit për realizimin e interesave të jashtëligjshme, me motive personale e partiake.

Përgjithësisht, logjika e punësimit të militantëve partiakë, në njërin anë, dhe ajo e persekutimit politik, në anën tjetër, të gjithë atyre punonjësve të arsimit në nivelin fillor dhe të mesëm, vetëm pse nuk i takojnë partisë në pushtet, si me largim nga vendet e tyre të punës pa asnjë bazë ligjore, ka filluar të marrë përmasa galopante.

Ndërkohë, për ta ilustruar këtë gjendje të tmerrshme të arsimit në nivel të përgjithshëm do të fokusohem në rajonin e Prizrenit. Në këtë mënyrë, mund ta pasqyroj këtë logjikë abuzive të Departamentit Komunal të Arsimit në këtë komunë, me një rast skandaloz të kësaj natyre, megjithëse ka edhe dhjetëra raste të tjera.

Kështu, ky departament, duke e shpërfillur çdo normë juridike, ka filluar persekutimin politik të jomilitantëve të partisë në pushtet me largim nga vendet e tyre të punës pa asnjë paralajmërim dhe në kundërshtim, si me Ligjin e punës, ashtu edhe atë të arsimit në Republikën e Kosovës. Madje, ajo që është më tronditëse qëndron në faktin se Gjykata komunale në Prizren ka konstatuar në formën e procedurës së prerë dhe përmbarimore se mosvazhdimi i kontratës së punës, për shembull mësimdhënësit Sahit Rrakaj, nga Drejtoria Komunale e Arsimit, është bërë në kundërshtim me ligjet në fuqi. Kështu, fillimisht Inspektorati i Punës, e më pastaj gjykata e obligon Drejtorinë Komunale të Arsimit në Prizren që paditësin ta rikthejë në vendin e punës urgjentisht. Për më tepër, Gjykata Komunale konstaton se veprimet e Departamentit Komunal të Arsimit në këtë komunë janë në kundërshtim flagrant edhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, më saktësisht me garantimin e të drejtës themelore për punë.

Unë këtu kam me vete, si vendimin e Gjykatës, ashtu edhe të Inspektoratit të Punës, që e verifikojnë dhe e japin këtë konstatim. Mirëpo, fatkeqësisht, që nga koha e ekzekutimit të këtij gjykimi nga kjo gjykatë, e cila ka karakter të procedurës përmbarimore, Departamenti i Arsimit ka vazhduar ta injorojë këtë përfundim juridik, pa asnjë arsyetim racional dhe të shëndoshë.

Kështu, ky fakt e tregon shkallën ekstreme të politizimit të sferës së arsimit, sepse në këtë komunë ka edhe dhjetëra raste të tjera, e me këtë rast këtu nga Kuvendi i Kosovës u bëj apel gjykatave që sa më shpejt t'i përfundojnë këto procedura dhe të mos i zvarritin vendimet.

Përfundimisht, kjo logjikë e shpërfilljes së vendimeve juridike për t'i mbrojtur interesat e ngushta politike përcakton sot tiparet...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Mursel Haljilji e ka fjalën.

MURSELJ HALJILJI: Hvala predsedniče Skupštine,

Potpredsedniče,

Članovi Vlade,

Kolege i koleginice, ministri i poslanici,

Ja se javljam vezano za događaj koji se desio pre dva dana u selu Globočica opština Dragaš, kada je u akciji policije uhapšeno 3 mladića. Ne ulazeći u slučaj i pozdravljajući akciju policije, ja sam hteo samo da ukažem na to da se u medijima provlači informacija da se radi o pripadnicima goranske zajednice. To nije istina. Želim da kažem da se radi o pripadnicima neke druge zajednice, a na organima i na medijima je da obrate malo više pažnju na taj detalj i sve je proverljivo, mogu u statističkom zavodu Kosova da proveru takvu informaciju.

Znači ne ulazeći u slučaj i pozdravljajući akciju policije, želeo sam samo da ukažem na to da se ne radi o pripadnicima goranske zajednice, kako je to naznačeno. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Bekim Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot dua ta ngre një shqetësim të qytetarëve të fshatit Kuçicë, të një pjese të fshatit Klinë e Epërme, të Radishevës, të Kopiliqit, të Açarevës, të Krasmirovcit, por edhe të shumë qytetarëve të tjerë të Republikës së Kosovës, te të cilët nuk po arrijnë të depërtojnë valët e Radio-Televizionit të Kosovës.

Banorët e këtyre fshatrave, te disa pjesërisht e te disa tërësisht, nuk arrijnë të depërtojnë frekuencat tokësore të RTK-së, me çka ata janë të privuar për ta përcjellë programin e këtij radiotelevizioni. Për shkak të pozitës gjeografike në të cilën shtrihen këto fshatra, por edhe në fshatra të tjera në Kosovë, banorët e këtyre fshatrave nuk kanë mundësi ta përcjellin Televizionin Publik të Kosovës, në mungesë të valëve të frekuencave tokësore. Ndërsa sistemi kabllor nuk është i arritshëm për këta banorë të këtyre fshatrave.

Të gjithë këta qytetarë janë tatimpagues dhe banorë të Kosovës dhe në bazë të Ligjit për RTK-në do të duhej t'u ofrohej të paktën mundësia valore që ta përcjellin programin e RTK-së.

Derisa një pjesë e qytetarëve të Kosovës nuk po kanë mundësi ta përcjellin këtë program të RTK-së në sistemin analog, prej qershorit të vitit 2015 të gjithë qytetarët e Kosovës mund të mbeten pa transmetimin televiziv tokësor, pasi deri atëherë duhet të përfundojë procesi i digjitalizimit, të përfundojë kalimi nga sistemi analog në atë digjital, e puna për këtë ende nuk ka filluar.

Kosova, si edhe vendet tjera të rajonit, ka afat deri kah gjysma e vitit 2015 që ta përfundojë kalimin nga sistemi analog i transmetimit në sistemin digjital. Disa vende të rajonit e kanë filluar këtë proces, e disa e kanë përfunduar, derisa ne ende po kemi probleme, me gjithë përfshirjen në sistemin analog.

Kërkoj që këto shqetësime të qytetarëve të zgjidhen dhe sa më parë të fillojë puna për kalimin nga sistemi analog në atë digjital dhe gjithëpërfshirja të jetë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Duke e pasur në këtë seancë në lexim të parë Projektbuxhetin e Kosovës për vitin 2015, kërkoj që të ndahen mjete për këtë qëllim që programi i RTK-së të arrijë të depërtojë në shtëpitë e të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka Fadil Demaku.

FADIL DEMA KU: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Ministra, kolegë deputetë,

Papërgjegjësia e të shprehurit para publikut e degradon fjalën dhe mendimin e lirë, e këtë vazhdimisht janë duke e bërë deputetët e “Vetëvendosjes”. Gënjejnë dhe paragjykojnë hapur pa asnjë turp dhe përgjegjësi për fjalën e thënë. Rasti më i freskët është ai i ditëve më parë, në seancën ku pika e rendit ishte informimi i Kuvendit nga kryeministri Thaçi për takimin e zhvilluar në Bruksel.

Në foltoren e Kuvendit, zoti Kurti para takimit shprehej kështu: “Flamuri i BE-së ishte prapa Thaçit, nuk ishte flamuri i Kosovës, ndërkaq te Daçiqi ishte flamuri i Serbisë”. Pa fije turpi gënjente dhe qeshej derisa shkonte të ulej në vend. Të gjithë e kemi parë foton e të gjitha medieve të jashtme dhe vendore dhe ne askund nuk e pamë atë flamur.

Kjo është tendencë që ta mashtrojë opinionin. Kjo formë spekuluese e të vepruarit është fyerje edhe për elektoratin e tij. Kjo tregon se as ata nuk i çmojnë e vlerësojnë, por duan të manipulojnë me vetëdije të plotë me naivitetin e tyre. Reaguan ndaj Radio-Televizionit të Kosovës pse ka bërë intervistë me njërin nga themeluesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Nuk u pati penguar intervista me Bllacën, e dhënë me 28 nëntor, në Ditën e Flamurit, në kohën më të shikuar. Nuk patën reaguar në atë rast. Japin leksione se kush dhe si duhet të hyjë në Partinë Demokratike të Kosovës. Vendosin a po

bën politikë të mirë a të keqe Lidhja Demokratike e Kosovës dhe si po e bën opozitën. As AAK-në nuk e lënë anash duke e kritikuar për qasjen ndaj problemeve politike.

Por, nuk duhet t'u mbetet hatri kolegëve deputetë, se këta e mësojnë dhe kritikojnë Bashkimin Evropian dhe SHBA-në. Baronesha Eshton dhe sekretarja Klinton kanë bërë "gabim historik" që gjatë vizitës së tyre ditë më parë në Kosovë nuk e kanë takuar "Vetëvendosjen". Këta do t'u mbanin leksion Brukselit dhe Uashingtonit për politikën e jashtme, për marrëdhëniet ndërkombëtare dhe integritet, dhe do t'i bindnin se këta me qasjen e tyre politike, agjendën për Kosovën mund ta çojnë deri në Kukës.

Sipas tyre, ne të gjithë qenkemi tradhtarë, sikur Serbia të na ketë sjellë këtu. Vetëm këta e nderojnë, e duan, e mbrojnë dhe e çmojnë Kosovën. Këtë e bëjnë fuqishëm në kohë paqeje, e luftën e Ushtrisë Çlirimtare nuk e mbajnë në mend shumë.

Këta mbajnë leksione për ligje, por Kushtetutën e flamurin nuk i njohin. Ulëset në Parlament i duan se këtu i kanë edhe pagat, edhe trimërinë e shfaqin të vendosur, e sulmojnë Policinë tonë, ua thyjnë xhamat institucioneve, i kapërcejnë muret. Një ditë e patën bllokuar edhe kufirin, por nata ishte bërë e ftohtë, i tradhtoi dhe i bëri të heqin dorë. Këta e mësojnë SHBA-në se kë duhet emëruar ambasador në Kosovë. Së fundi kanë ardhur në përfundim se SHBA-ja gjithmonë ka mbështetur struktura kriminale. Këta nuk më befasojnë më për asgjë. Le të thuan çfarë të duan. Faleminderit!

KRYETARI: Tash janë deklaratimet e Qeverisë. Ministër Rexhepi, e ke fjalën.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Faleminderit!

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar ministra,

E ndiej si obligim të bëj disa sqarime në lidhje me një çështje që e ngriti deputeti Ymeri.

Kjo kontratë, prej fillimit ka filluar në mënyrën më të mirë dhe më të pastër. Problemet kanë lindur në momentin kur në bazë të ligjeve tona kjo kompani është dashur ta ketë një përfaqësues të vet zyrtar në Kosovë. Këtë përfaqësues e ka zgjedhur vetë kompania për t'i bërë shërbimet që duhen karshi institucioneve tona.

Në momentin që nëpërmjet ambasadorit austriak e kam pasur informatën se një pjesë e mjeteve nuk kanë shkuar në destinimin final, por kanë shkuar nëpërmjet përfaqësueses së tyre, e kam thirrur krejt stafin që ka qenë i autorizuar me prokurim, me drejtorët, me ata të financave dhe e kemi zbardhur rastin se kah kanë shkuar mjetet.

Në praninë e të gjithë atyre, unë i pari, para dy muajsh, kam kërkuar hetime dhe i kemi thelluar hetimet që të zbulohet kushdo qoftë që është i kyçur në këtë mungesë të transferimit të parave drejt "Osterreichische Staatdruckerei".

Në momentin kur janë avancuar hetimet, kryeprokurori i Shtetit, në bazë të ligjeve tona, na e ka ndaluar, duke thënë se për kompanitë e jashtme duhet ta ketë kërkesën kompania

e jashtme ose lejen, dhe unë kam insistuar në kontakte edhe me drejtorin e kompanisë që sa më shpejt ta bëjnë këtë kërkesë dhe ta zbardhim rastin. Këtë e kanë bërë, por e kanë dorëzuar në EULEX. Dhe, në kontakt me udhëheqësin e EULEX-it, zotin De Marnak, kam kërkuar që sa më shpejt, qoftë EULEX-i ndaras, qoftë ekip i përbashkët, qoftë vetëm hetuesit tanë, ta zbardhin rastin sa më shpejt.

Kanë filluar këto, janë në fazën e hetimeve dhe kam insistuar që kushdo qoftë që është i përzier në këtë të dalë para ligjit dhe ta marrë dënimin e merituar.

Natyrisht se kjo në opinion mund të dalë si çështje e aferave, që mua fort nuk më brengos në atë kuptim, për arsye se jam i përkushtuar që të luftohet hajnia dhe krimi kudo qoftë. Edhe së pari në oborrin tënd, ose në shtëpinë tënde, dhe çdoherë që ka pasur dyshim, unë i kam iniciuar hetimet, fillimisht në Ministrinë time, që të pastrohet dhe të vazhdojë edhe nëpër tjerat.

Kjo duket pak si patetike, por nëse të gjithë veprojmë në këtë mënyrë, t'i bëjmë këto hetime, atëherë mund të krijohet një perspektivë, ndërsa nëse unë i mbroj këto çfarëdo hetimesh, i mbroj ata, që kushtimisht them hajna, atëherë ka vend për të menduar për dorëheqje, por për deri sa ta luftoj këtë, nuk mendoj për atë. Dhe, pajtohem me zotin Ymeri vetëm në një fjalë që thotë, edhe publikisht them dhe kam kërkuar që këto hetime pa kurrfarë ndikimi, këdo qoftë që e prekin, duhet të zbardhen sa më shpejt dhe kushdo qoftë që është i involvuar, do të përgjigjet para drejtësisë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Visar Ymeri e ka fjalën!

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Meqenëse m'u përmend emri, natyrisht po e marr fjalën që t'i bëj edhe unë disa sqarime. Ministri tha se e ka iniciuar vetë rastin e hetimit. Problemet që kanë dalë nëpër media për këtë aferë janë shumë të mëdha. Natyrisht, unë nuk arrita për 5 minuta t'i përmbledh të gjitha, për shkak se do të duhej shumë më shumë të flasim për to.

Së pari, kur është nënshkruar kontrata ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe kompanisë, e cila e ka marrë përsipër shtypjen e pasaportave, atëherë a nuk është specifikuar në atë kontratë se në cilën llogari duhet të shkojnë paratë - pagesat. Dhe, cila llogari ka qenë e specifikuar aty, për shkak se nuk është kësti i vetëm që i është paguar kësaj kompanie 1,4 milion euro. Ka edhe këste tjera. Pse ato nuk u avulluan, e u avullua vetëm një. Domethënë, edhe pse bash 1,4 milion euro?

E dyta, mbrojtësi i të arrestuarës ka deklaruar publikisht që ajo ka thënë, por prokurori nuk ka dashur të dëgjojë, se kompania austriake e ka fituar këtë tender për shkak se ka pranuar ta japë 10-përqindëshin. A është i njoftuar për këtë ministri dhe çfarë ka bërë në këtë drejtim? Pra, a është i njoftuar që 10-përqindëshi ka qenë kusht për marrjen e kontratës.

Dhe, e treta, a e di ministri arsyen, meqenëse paska qenë duke e përcjellë këtë rast shumë për së afërmi, pse prokurori vendor dhe i EULEX-it nuk po duan ta dëgjojnë të

arrestuarën për faktet që ajo po thotë që i ka të dokumentuara. Pra, pse nuk është i interesuar ministri ta dijë cilat llogari janë ato që kanë përfituar nga ky 1,4 milion euro?

KRYETARI: Urdhëro ministër, e ke fjalën!

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Fillimisht, kontrata është fituar në bazë të preferencës më të mirë dhe nuk ka pasur kurrfarë përqindjeje. Them tek pas një viti, kur e kanë bërë përfaqësimin dhe transferi i parave, aty kanë lindur problemet. Pra, këtu s'e ka pas atë 10-përqindësh të kontratës.

Të lutem, unë të dëgjova! Pse kanë shkuar të tjerat, duhet pyetur zonjën. Ajo i di dhe na i kemi nga NLB-ja në çfarë drejtimesh i ka çuar paratë dhe është çështje e hetuesisë, e ne nuk mund të përzihemi në gjyq. As nuk kemi të drejtë, as nuk përzihemi, por edhe një herë insistoj që ajo zonja duhet t'i tregojë adresat ku i ka çuar dhe çfarë ka bërë. Në këtë pikë, pajtohem të dytë, përndryshe kontrata është fituar absolutisht në bazë të ofertës më të mirë dhe nuk ka pas kurrfarë përqindjeje aty.

KRYETARI: Vazhdojmë me pikën e dytë:

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Ganimete Musliu, pyetje për ministrin Agim Çeku.

GANIMETE MUSLIU: I nderuari kryetar i Parlamentit,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

I nderuari ministër, zotëri Çeku,

Duke pasur parasysh se në të gjitha segmentet e sigurisë në Kosovë, por edhe në ato ndërkombëtare ka femra me gradën gjeneral, pyetja ime që ju drejtohet ju është: Pse në Forcën e Sigurisë së Kosovës ende nuk e kemi një të tillë, duke pasur parasysh se femrat në Kosovë e kanë dhënë një kontribut shumë të madh edhe gjatë luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dhe po kontribuojnë shumë ndershëm dhe me krenari edhe në Forcën e Sigurisë?

KRYETARI: Ministër, sqaroje pak!

MINISTRI AGIM ÇEKU: Faleminderit!

I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

E nderuara deputete,

Po e filloj këtë përgjigje, vërtet është ashtu, se femrat e kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në luftë, në UÇK, në TMK, po tash edhe në FSK.

Dhe, është një segment, me të cilin ne mburremi si ministri, po edhe si FSK, sepse Ministria jonë rëndësi të veçantë i kushton barazisë gjinore. Mu për këtë kemi ngritur

infrastrukturën ligjore, e cila garanton një përfshirje të barabartë, një mundësi të barabartë, pozitë të barabartë mes femrave dhe meshkujve.

Sot, në FSK ne i kemi 188 femra në uniformë, që përbëjnë 8.23 të gjithë pjesëtarëve të FSK-së. Kemi me këto grada.

- Me gradën kolonel, që është vetëm një gradë më pak se gjeneral, e kemi një femër,
- Me gradën nënkolonel, një femër,
- Me gradën major, katër femra,
- Kapitene, 4,
- I kemi 5 togere,
- I kemi 4 nëntogere,
- I kemi 28 nënoficere,
- 141 nga këta janë vetë ushtarë, dhe
- Kemi një kadete, që është duke u përgatitur për oficerë.

Kështu që, është një numër i madh. Numri i gjeneralëve në FSK është i përcaktuar me ligj. Ligji e përcakton, po edhe struktura e FSK-së dhe janë të përcaktuara procedurat e avancimit në gradë. Në rast se lirohet ndonjë vend i paraparë për gradën gjeneral, atëherë formohet bordi për avancime, bordi formon një komision për filtrim të kandidatëve dhe të gjithë kolonelët, përfshirë edhe kolonelin që e kemi këtu, është kandidate e barabartë me mundësi të barabarta, për t'u avancuar në gradën gjeneral, në qoftë se bordi e vlerëson se i plotëson kushtet.

Nuk do të jetë vetëm përkatësia gjinore kriter a të jetë apo të mos jetë, por mundësitë tjera dhe rezultatet e punës, që t'i kenë treguar. Për shembull, kolonelja Ylfete Spahiu, që e kemi është zëvendës komandante, domethënë, është në pozitë komanduese. Nënkolonelja tjetër është komandante e Kompanisë së Mjekësisë. Domethënë, kemi femra jo vetëm në pozita të drejtorëve apo administratorëve, por janë në pozita komanduese, që nga niveli më i lartë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Deputete, a ke pyetje shtesë?

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit shumë, zoti ministër, për sqarimet që na i dhatë për gradat që i kanë femrat në FSK. Unë isha në njohuri, pikërisht se e kisha këtë informacion shumë të qartë dhe e kam parë që nuk kemi një femër gjenerale dhe ua kam drejtuar pyetjen. Por, megjithatë shumë faleminderit për përgjigjen shumë të sinqertë, që na e dhatë dhe, shpresoj shumë që në gradimin e radhës për gjeneralë, do të jetë një femër por jo vetëm pse është femër, por për arsyen se i plotëson të gjitha kriteret.

Dhe, unë jam e bindur që në FSK, në radhë të FSK-së, ka femra të tilla. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Ganimete Musliu, pyetje për ministrin Nenad Rashiq.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar ministër Rashiq,

Duke pasur parasysh që Ligji për aftësim dhe riaftësim të personave me aftësi të veçanta është në fuqi, dua të dëgjoj nga ju dhe të gjithë qytetarët dëshirojnë të marrin një opinion prej jush, se sa po gjen zbatim ky ligj tek institucionet tona, për punësimin e këtyre kategorive.

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Hvala gospodine predsjedniče!

Dame i Gospodo narodni poslanici.

Ja pitanje, da budem iskren nisam dobio, sad ka čujem od vas. Ali mislim da ono što sigurno jeste značajno kod nas, da jedan od najbitnijih zakona je taj koji ste vi sami pomenuli za profesionalnu prekvalifikaciju i kao što znate mi imamo 9 centara za obuku ili kvalifikaciju ili samo prekvalifikaciju. Zakon se implementira u potpunosti, koliko sam u ovom momentu upoznat. Naravno, ne bih ulazio u detalje zbog toga što, opet ponavljam, nisam dobio pitanje pre seance, prema tome mogu da vas pozovem da budete, da nas posetite u ministarstvu i da vam objasnim sve u detaljima, pogotovo što se tiče svake tačke zakona.

A za ono što ja, u ovom momentu znam, zakon se absolutno primenjuje, kao i svaki zakon koji smo dosada imali prilike da usvojimo. Još jednom, naravno vas pozivam da dodete u prostorijama ministarstva da možda u deteljnije malo budem precizniji i da vam bolje objasnim. Hvala!

KRYETARI: Deputete, a ke pyetje shtesë?

GANIMETE MUSLIU: Zoti ministër,

Mua më vjen keq që juve nuk ju ka ardhur kjo pyetje parlamentare, sepse është bartur të njëjtën ditë kur unë pyetjen ua kam drejtuar edhe ministrit, zotit Çeku, më 6.11.2012, në orën 13:45 minuta. Kështu që, mua më vjen keq, sepse është kohë e gjatë që unë e kam drejtuar këtë pyetje dhe kjo pyetje nuk ka arritur deri tek ju, kështu që besoj se administrata e Kuvendit do të na e sqarojë më vonë këtë çështje.

Ndërsa, ftesës suaj për të ardhur dhe për t'u konsultuar në ministri, unë të falënderoj për këtë ftesë, por megjithatë pyetjen parlamentare e bëra, që të kenë mundësinë jo vetëm unë të informohem si deputete, por të informohen të gjitha ato kategori, të cilat preken në këtë ligj dhe të cilave iu cenohen të drejtat e tyre herë pas here.

Në këtë rast, unë do të kisha kërkuar ndoshta edhe prej ministrit Ramë Buja, që të na jap disa sqarime shtesë në këtë pyetje, pasi që është në të njëjtën pozitë sikur ju, nuk e keni marrë pyetjen, ndoshta do të kishte mundur t' ju plotësojë si pjesë e Kabinetit. Por, megjithatë mua më vjen keq, që ju s'e keni marrë pyetjen me kohë.

KRYETARI: Jo, unë mund të ju njoftoj që pyetjet kanë shkuar në Qeveri. Administrata e Kuvendit komunikon me administratën e kryeministrit dhe është çështje e administratës së Qeverisë. Deputetja Time Kadrijaj, pyetje për ministrin Agim Çeku.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar ministër,

Kohë më parë është formuar Komisioni për verifikimin e numrit të veteranëve të UÇK-së.

Ajo çka ne jemi të njoftuar është se do të fillojë verifikimi dhe regjistrimi i serishëm i veteranëve, për këtë është caktuar edhe periudha kohore prej tre muajsh.

Cilat janë kriteret për verifikim të saktë të numrit të veteranëve, në mënyrë që të mos përsëritet e kaluara dhe sa ekziston mundësia që veteranët e vërtetë të mbesin jashtë listave, ndërsa të përfshihen në lista ata që nuk janë veteranë të luftës?

(Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Zoti Çeku, e keni fjalën.

MINISTRI AGIM ÇEKU: Faleminderit, deputete për këtë pyetje. Dhe, është pyetje me kohë, që pikërisht sot, më 15 nëntor, ka filluar procesi i aplikimit të gjithë veteranëve, familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Mund të them që Komisioni Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të këtyre kategorive i ka bërë të gjitha përgatitjet dhe procesi ka filluar mbarë dhe unë jam i nderuar, që jam një ndër të parët, së bashku me kryeministrin që sot i dorëzuam edhe aplikacionet për të na u njohur edhe neve statusi i veteranit, pranë Shoqatës së Veteranëve, këtu në Prishtinë.

Ne, si bazë, si komision, e kemi Ligjin për statusin e veteranëve, familjeve të dëshmorëve, invalidëve të luftës, viktimave civile dhe e kemi Rregulloren e punës të komisionit përkatës në krye të cilit jam. Dhe, këto janë, kriteret për të qenë veteran janë të përcaktuara me ligj, që është aprovuar në Parlament, vitin e kaluar e që është në fuqi që nga ky vit, domethënë, Ligji 04/L-054, ku thotë se veteran i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës është çdo shtetas i Republikës së Kosovës dhe shtetas i jashtëm, i cili iu ka bashkuar radhëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe është evidentuar si pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nga zinxhiri komandues, brenda njësive në të cilat ka shërbyer në periudhën 1997 - 1999. Ky është definim, kriter me të cilin ne si komision punojmë.

Mandej pas, kur të përcaktohet numri i vërtetë i veteranëve, atëherë besoj që do të nxirret ligji i veçantë për veteranët, ku do t'i kategorizojmë, varësisht nga kohëzgjatja e kontributi i tyre brenda UÇK-së.

Ne i kemi bërë të gjitha mundësitë, që askujt mos t'i hyjmë në hak, që çdonjëri që ka dhënë kontribut, ka qenë në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, t'i njihet ai kontribut dhe t'i njihet statusi i veteranit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Kësaj radhe e kanë pasur shumë njerëz të zgjidhur këtë, shumë veteranë, shumë ish luftëtarë, të zgjidhur, por kjo është zgjidhur nga shoqatat e tyre. Kjo është, për herë të parë, që kanë një njohje qeveritare institucionale, që do t'u njihet statusi dhe ata do t'i gëzojnë benificionet e tyre, ashtu siç i përcakton ligji.

Asnjë veteran nuk do të mbetet jashtë në qoftë se aplikon. Mund të mbetet jashtë vetëm me vullnetin e tij, në qoftë se nuk vjen dhe nuk aplikon, nuk e dorëzon aplikacionin. Veteranët nuk do të kenë nevojë që të vrapojnë mbas komandantëve të tyre, mjafton vetëm t'i cekim emrat dhe njësitë dhe emrat e atyre komandantëve të tyre, nga niveli i skuadrës deri te niveli i zonës operative apo Shtabit të Përgjithshëm dhe ne, si komision, ne do të shkojmë dhe do t'i kontaktojmë komandantët e tyre, që ta vërtetojmë saktësinë e të dhënave, të qenit apo të mos qenit pjesëtar i UÇK-së.

Kështu që i kemi vendosur disa mekanizma, që garantojnë se çdonjëri që ka qenë, vërtet t'i njihet kontributi, por ka edhe mekanizma, që dikush që pretendon se ka qenë dhe në qoftë se, vërtet s'ka qenë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Berisha-Shala pyetje për ministrin Ramë Buja.

(Ndërhyrje: Pyetje shtesë.)

Pyetje shtesë? Më falni zonja Sala. E ka fjalën zonja Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Ministër, a ka mundësi që procesi i verifikimit të bëhet shumë transparent, sepse është rasti të korrigjohet një gabim shumë serioz, që është bërë pas lufte. Atyre që janë parashutuar në këto lista duhet t'u vijë turp, po turp duhet të kenë edhe ata që ua kanë mundësuar që të futen në listat e veteranëve.

KRYESUESI: E ka fjalën ministri Agim Çeku.

MINISTRI AGIM ÇEKU: Procesi sigurisht se do të jetë transparent. Detyrë e komisionit, në bazë të Rregullores së punës është që në fund të procesit t'i bëjë publike listat e veteranëve. Dhe, i ftojme të gjithë qytetarët, që në qoftë se kanë dëshmi, kur ta shohin një person që është në listë e iu ka njohur statusi që të deponojnë dëshmi që e kundërshton një gjë të tillë. Dhe, ne brenda komisionit kemi mekanizma, në bazë të Rregullores krijojmë komisione të veçanta, grupe të veçanta, që i shqyrtojnë, qoftë ankesat e qytetarëve, qoftë ankesat e vet veteranëve, apo të njerëzve që nuk iu ka njohur statusi.

Kështu që procesi do të jetë transparent. E shfrytëzoj këtë foltore që t'i ftoj qytetarët që ta përcjellin këtë proces, që të dëshmojnë të kundërtën, në qoftë se mendojnë për një kandidat apo veteran, por i ftoj edhe të gjithë veteranët, që të mos hezitojnë dhe të aplikojnë, që ta dimë numrin e tyre dhe ta njohim kontributin e tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Sala Berisha-Shala, pyetje për ministrin Ramë Buja.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje Kabinet Qeveritar.

Zoti ministër Buja,

Unë sot kam shtruar një çështje që ka të bëjë me arsimin në Kosovë.

Dihet se në Kosovë është eksperimentuar me sistemin arsimor në kohërat e kaluara dhe pasojat i kemi bartur të gjithë.

Sot, Kosova ka me qindra inxhinierë të sistemeve të para Bolonjës me studime pesëvjeçare të fushave të ndryshme teknike si: gjeologji, xehetari, teknologji, metalurgji, elektroteknikë, e kështu me radhë, të cilët studentë kanë shpenzuar dhe shpenzojnë kohë dhe para, tani për t'ju përshtatur sistemit të Bolonjës, për të fituar tituj master, që i bie dyfishim apo përsëritje e asaj që veç e kanë përfunduar.

Të gjitha shtetet e rajonit dhe shtetet që kanë dalë nga ish Jugosllavia, e kanë bërë barasvlerësimin e këtyre sistemeve me sistemin e Bolonjës dhe studentët tanë detyrohen që të shkojnë në shtetet përreth, të shpenzojnë para, të shpenzojnë kohë, të derdhin para jashtë nëpër shtete tjera, në vend se një problem i tillë të zgjidhet në Kosovë.

Pyetja ime është, zoti ministër, a ka ndërmarrë Qeveria e Kosovës, përkatësisht Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, diçka në këtë drejtim?

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër e keni fjalën.

MINISTRI RAMË BUJA: I nderuar zoti kryesues,

Kabinet Qeveritar,

Të nderuar deputetë,

E nderuara deputete Shala,

Faleminderit shumë për pyetjen e bërë, sepse ka pasur nevojë që kjo gjë të sqarohet dhe unë besoj se sot do të jetë e sqaruar. Unë kam informuar për atë që kam mundur, këta studentë, faktikisht këta njerëz që kanë mbaruar këtë nivel të shkollimit, por megjithatë, sot bëhet publikisht dhe përmes kësaj foltoreje të Kuvendit, që Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ka përgatitur Udhëzimin Administrativ 20/2, krahasueshmëria dhe barasvlera e diplomave dhe e programeve studimore para sistemit të Bolonjës dhe të sistemit të Bolonjës, i cili është aprovuar, në fakt është nënshkruar nga ministri, më 22 tetor 2012.

Neni 5 i këtij udhëzimi administrativ thotë, se diplomat e studimeve universitare pesëvjeçare, që kanë përfunduar me mbrojtje publike të temës, në fushat teknike të sistemit para Bolonjës, barasvlerësohen me 300 kredi, ose 300 ectsh, siç thuhet. Kurse, neni 6 thotë, se në studime të doktoratës mund të regjistrohen të gjithë të diplomuarit, të cilët në studimet e niveleve paraprake kanë fituar të paktën 300 kredi dhe i plotësojnë kriteret e kërkuara nga institucioni i arsimit të lartë në Kosovë.

Është shumë e vërtetë ajo që thoni, se vërtet këta njerëz që kanë përfunduar këtë nivel shkollor të pesëvjetëshit kanë shkuar nëpër vende të rajonit, për të marrë dëshmi se ata veç janë me derë të hapur për të shkuar në doktoratë, ndërsa tash nuk kanë nevojë ta bëjnë këtë, sepse në fakt është realizuar edhe tek ne e njëjta gjë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë? Zonja Berisha – Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Nuk kam pyetje shtesë, veç ta përsërishtes për këtë hap të qëlluar që e ka marrë ministri dhe Ministria e Arsimit dhe është një lajm i mirë për të gjithë ata inxhinierë, të cilët nuk kanë pasur mundësi dhe nuk kanë pasur para që të shkojnë ta bëjnë një gjë të tillë në shtetet e rajonit.

Faleminderit edhe njëherë, ministër!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk kemi pyetje tjera për Qeverinë.

Pika e tretë e rendit të ditës:

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 8 nëntor 2012

(Ndërprerje nga regjia)

Pasi nuk kemi forum, vazhdojmë me pikën e katërt. Dhe, është e çuditshme se si në sallë janë vetëm 48 deputetë, kur duhet të diskutohet projektbuxheti, që është pika më e rëndësishme për të gjitha seancat e këtij viti.

Faleminderit! Në sallë tani janë 63 deputetë. Në radhë është miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare të mbajtur më 8 nëntor 2012. Nuk e di nëse ka dikush vërejtje në procesverbal? Nuk ka.

Konstatoj që Kuvendi e miratoi procesverbalin e mbledhjes plenare, të mbajtur më 8 nëntor 2012.

Pika e katërt e rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbështetje të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit e ka shqyrtuar projektbuxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013 dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

E ftoj ministrin, zotin Hamza, që ta arsyetojë projektbuxhetin.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

I nderuar nënkryetar i Kuvendit,

Kabinet Qeveritar,

Deputetë të nderuar,

Ndjehem i nderuar që sot kam mundësi të paraqes Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012.

Ky buxhet është hartuar duke respektuar kuadrin ligjor, konkretisht Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, nenin 21 dhe 22 të këtij ligji.

Procesi buxhetor ka filluar në fillim të vitit 2012, me nxjerrjen e indikatorëve të hershëm makroekonomik, nxjerrjen e deklaratës së prioriteteve nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Qarkorja e parë buxhetore është lëshuar në prill të vitit 2012, kanë vazhduar më pas me qarkoret deri në përfundimin e këtij buxheti.

Gjatë këtij procesi ne kemi pasur takime të rregullta me të gjitha organizatat buxhetore, i kemi diskutuar projektet në nivel të programeve, i kemi diskutuar edhe projektet specifike, gjithmonë duke pasur në konsideratë resurset e mundshme për financim.

Gjithsesi, gjatë punës sonë kemi marrë në konsideratë ecuritë në eurozonë. Ekonomia e Kosovës, si një ekonomi e re, me fuqi të kufizuar nuk mund të jetë e pandikuar nga ecuritë në eurozonë. Edhe përkundër masave të cilat janë marrë nga ana e Bankës Qendrore Evropiane, Fondit Monetar Ndërkombëtar, Bankës Botërore, prapëseprapë zhvillimet ekonomike në eurozonë nuk janë që na bëjnë të jemi optimistë, se kjo krizë do të tejkalohet edhe gjatë vitit 2012 dhe shumë vende brenda eurozonës do të kalojnë nga faza e recesionit.

Ne i kemi marrë masat dhe fatbardhësisht, deri më tash ekonomia e Kosovës ka qenë në masë të vogël e ndikuar nga kjo krizë. Masat të cilat janë ndërmarrë, kanë të bëjnë edhe me ruajtjen e stabilitetit financiar në sektorin bankar, me krijimin e rezervës emergjente të likuiditetit dhe ruajtja e nivelit të arsyeshëm të bilancit bankar.

Më lejoni, deputetë të nderuar, të ju informoj se ky buxhet është diskutuar në detale, në tri misione të fondit monetar ndërkombëtar. Është diskutuar gjatë misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar, në qershor, është diskutuar në shtator dhe përfundimisht, është diskutuar dhe është në harmoni të plotë me Fondin Monetar Ndërkombëtar, në muajin tetor.

Siç jeni të informuar, deputetë të nderuar, Republika e Kosovës ka një marrëveshje stand by me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Deri më tani, të gjitha kriteret kuantitative dhe të performancës janë përmbushur. Rishikimi i parë i kësaj marrëveshjeje ka qenë pozitiv, si rezultat i rishikimit pozitiv, deri në këtë kohë, Kosova ka përfituar rreth 53 milionë euro nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, 37 milionë euro grande, para falas, nga Banka Botërore, të cilat janë derdhë në Buxhetin e Kosovës dhe me këtë është përmbushur premtimi i Bankës Botërore për 62 milionë. 25 milionë janë derdhur në fund të vitit të kaluar dhe ne presim që rreth datës 21 dhjetor të mbahet Bordi i FMN-së, ku vlerësimet janë se edhe rishikimi i dytë i kësaj marrëveshjeje do të jetë pozitiv dhe do të kemi derdhje të mjeteve në Buxhetin e Kosovës edhe rreth 41 milionë euro tjera.

Dhe, si rezultat i përmbushjes së këtyre kritereve, ne kemi bërë kërkesë te ky institucion, që marrëveshja aktuale stand by të ngrihet në nivel më të lartë, që është një marrëveshje e kujdesit paraprak.

Të nderuar deputetë, projektbuxheti për vitin 2013 nuk duhet të shikohet si një projektbuxhet i shkëputur vetëm për një vit, por duhet të shikohet si një projekt i cili ka të bëjë për një periudhë të ardhshme makrofiskale.

Ne kemi pasur në konsideratë prioritetet e Qeverisë, ne e kemi respektuar një nga top-prioritetet e Qeverisë, që është rritja ekonomike.

Rritja ekonomike në Kosovë, për vitin 2013 vlerësohet që të jetë 4.5%, duke i marrë ecuritë, të cilat janë të pranishme në euro-zonë, kjo rritje ekonomike është rritja më e madhe në rajon. Presim që edhe në vitin 2013 edhe në vitet në vijim, ekonomia e Kosovës të vazhdojë me ritmet e saja pozitive.

Në të vërtetë, presim që në vitin 2013 kjo rritje të jetë 4,5%. Indikatorët kryesorë apo kontribuues kryesor në këtë rritje ekonomike është konsumi agregat për vitin 2013 dhe dy vjetët në vijim pritet të ketë një rritje mesatare prej 6.2%, ndërsa, vetëm konsumi privat pritet të ketë një rritje më të lartë mesatare prej 6.9%, në vitin 2013, 5,2%. Investimet private, si një komponentë shumë e rëndësishme e rritjes ekonomike, pritet që gjatë tre vjetëve të ardhshme të rriten me një normë mesatare prej 7,8%, në vitin 2013 9,1%.

Eksportet totale, në vitin 2013, pritet të kenë një rritje prej rreth 11.5%, ndërsa vetëm eksportet e mallrave, vlerësohet se do të kenë një rritje mbi 18%. Kjo normë relativisht e lartë e përqindjes së rritjeve të eksporteve, së bashku me një normë më të ulët të rritjes së importeve, që vlerësohet se do të jetë 5,8%, pritet që ta përmirësojë bilancin tregtar negativ, që vazhdon të jetë i lartë dhe paraqet një sfidë të madhe për neve.

Duke ditur se ekonomia jonë është e hapur dhe ajo ndikohet nga lëvizjet në tregjet rajonale, evropiane dhe më gjerë, e siguria e çmimeve në vend, në masë të madhe do të varet nga ecuria e çmimeve në tregjet globale.

Për vitin e ardhshëm projeksionet tona, që marrin parasysh edhe pritjet për ecurinë e çmimeve të importit, tregojnë se do të kemi një ngritje modeste të çmimeve, që vlerësohet se inflacioni për vitin 2013 do të jetë në nivel 1,5%.

Dërgesat e qytetarëve, si një element i rëndësishëm i financimit të konsumit të investimeve, pritet që të kenë trend stabil.

Tani po i kthehem Buxhetit dhe komponentëve të tij. Veçori kryesore e këtij buxheti është se vazhdon trendi i rritjes nga viti në vit edhe në pjesën e të hyrave dhe në pjesën e shpenzimeve.

Nëse shikojmë pjesën e të hyrave, shihet se të hyrat në vitin 2013, në krahasim me vitin aktual në total planifikohet të ketë një rritje prej 3%. Mirëpo, nëse hyjmë në strukturën e

të hyrave dhe e shohim se në vitin 2013 nuk do të kemi grant nga Banka Botërore, që këtë vit ka qenë 37 milionë euro, nëse shohim dallimin në mes dividendës, i cili në këtë vit do të jetë 45 milionë euro, ndërsa vitin e ardhshëm 30 milionë euro, atëherë del se rritja në pjesën e të hyrave rritja reale e të hyrave të rrjedhshme në Buxhetin e Kosovës, do të jetë 7%.

Të hyrat vendore nga tatimet, taksat, doganat, do të kenë një rritje prej 5%, ndërsa rritjen më të madhe do ta kenë të hyrat vetjake të nivelit qendror dhe lokal, që do të kenë një rritje prej 22%.

Sa i përket pjesës së shpenzimeve, buxheti do të jetë më i lartë për 4%, do të jetë në lartësi 1 miliard e 586 milionë. Të gjitha kategoritë e shpenzimeve kanë një rritje. Ka rritje kategoria e shpenzimeve për paga dhe mëditje. Kjo rritje vjen si rezultat i ndarjes së kostos për mbulimin e reformave në administratën publike, që do të reflektojë edhe me rritjen e pagesave për kategori të caktuara të shërbyesve civilë. Kemi punësim të ri në institucione të caktuara, kryesisht që kanë të bëjnë me implementimin e Ligjit për shëndetësi, në sektorin e shëndetësisë dhe plotësimin e kapaciteteve të disa institucioneve të reja.

Kemi rritje edhe te pozicioni i mallrave dhe shërbimeve, që kjo rritje është 10% në krahasim me vitin aktual, vjen si rezultat i rritjes së numrit të projekteve kapitale, të cilat kanë nevojë për mirëmbajtje dhe vjen si rezultat i rritjes së mallrave dhe shërbimeve në nivel komunal.

Gjithashtu, ka rritje edhe te subvencionet, transferet. Kemi zvogëlim të subvencioneve për ndërmarrjet publike, ndërsa në total kemi rritje të këtij pozicioni, si rezultat i ndarjes së kostos për mbulimin e kostos së vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për rritjen e pensioneve të pensionistëve kontribut-pagues, që vendimi i Qeverisë është 40% për këtë kategori dhe 33% për kategoritë tjera, që gjithsej nga ky vendim përfitojnë 164 mijë pensionistë.

Dhe, mbi të gjitha, vazhdon trendi i investimeve kapitale. Me këtë projektbuxhet sigurohen mjete të mjaftueshme për përfundimin e projektit, Autostradës së Kombit “Ibrahim Rugova” sipas kontratës dhe fillimin e autostradës së re prej Prishtinës në Shkup....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Regjia, edhe pak vazhdojani.

MINISTRI BEDRI HAMZA: ...mundësohet vazhdimi i punimeve në rrugën Prishtinë-Pejë, Prishtinë-Mitrovicë dhe shumë rrugëve tjera me karakter lokal dhe rajonal, po e theksoj në gjithë territorin e Kosovës, mundësohet përfundimi i dhjetëra objekteve shkollore dhe fillimi i dhjetëra të rejave, mundësohet përfundimi i shumë palestrave sportive dhe fillimi i të rejave, ndahen mjete për subvencione në bujqësi, mjete për mbulimin e kostos së reformës së shëndetësisë dhe përkrahet sektori i sigurisë.

Në vazhdim, më lejoni që t'ju informoj në lidhje me një projekt që ka filluar në janar të këtij viti dhe është emetimi i letrave me vlerë. Është projekt i suksesshëm dhe presim që edhe vitin e ardhshëm të vazhdojmë me emetimin e këtyre instrumenteve.

Kostoja e këtij burimi të financimit ka qenë shumë e ultë dhe shumë më e ultë se kosto e vendeve të rajonit dhe presim që edhe vitin e ardhshëm të ketë një kosto përafërsisht të njëjtë me atë të këtij viti. Ky fakt është i rëndësishëm së veçantë, pasi që për herë të parë u është mundësuar qytetarëve të vendit tonë, që të investojnë në zhvillimin e vendit në këtë formë.

Mbarëvajtja e këtij projekti po ashtu, tregon edhe stabilitetin e sektorit financiar të vendit, si element crucial i zhvillimit.

Të nderuar deputetë, ka më shumë se një arsye që sot mua më jep të drejtën të kërkoj votën pozitive, për këtë projektbuxhet.

Është përfundimi i autostradës nga kufiri i Shqipërisë, fillimi i projektit të ri Prishtinë-Shkup, vazhdimi i punimeve në shumë segmente nacionale, përfundimi i dhjetëra objekteve shkollore, mbulimi i kostos së vendimit të Qeverisë për rritjen e pensioneve, sigurimi i kostos për zhvillimin e reformën në administratë publike, sigurimi i kostos për implementimin e reformave në shëndetësi. Për herë të parë në vitin 2013, pas shumë përpjekjesh, komunat e fitojnë të drejtën që për të hyrën vetjake, të vendosin komunat a dëshirojnë t'i përdorin të hyrat vetjake për investime kapitale, mallra dhe shërbime apo subvencione dhe transfere? Është arritur që të garantohet edhe të ruhet stabiliteti makrofiskal, deficitin primar gjatë periudhës së kaluar ka qenë 1/5%, deficitin i përgjithshëm 1,8% dhe ky projektbuxhet i reflekton prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Buxheti është i bazuar në burime të qëndrueshme, në projektbuxhet është e paraparë edhe e hyrë nga financimi i njëhershëm, mirëpo projektet janë të lidhura të gjitha projektet brenda buxhetit janë të lidhura me të hyrat e rregullta të Buxhetit të Kosovës.

Ne, nuk mund të paragjykojmë përfundimin e proceseve të caktuara, që janë në zhvillim, që kanë të bëjnë me privatizimin e një pjese të aksioneve të ndërmarrjeve publike dhe varësisht nga finalizimi i këtij procesi, bilanci bankar do të jetë i ndryshueshëm. Nëse kemi finalizimin e këtij projekti, sipas planifikimeve që ne nuk dëshirojmë të paragjykojmë as vlerën e kompanisë në treg, as përfundimin e këtij procesi, atëherë bilanci bankar do të jetë në nivel më të lartë.

Po që se ky proces, për çfarëdo arsye nuk finalizohet, burimet për financimin e buxhetit, burimet e të hyrave janë më se të mjaftueshme për financimin e të gjitha projekteve që janë pjesë e buxhetit. Dallimi do të jetë në nivelin e bilancit bankar, do të jetë bilanc bankar më i ulët apo më i lartë, gjithsesi do të jetë bilanc bankar i mjaftueshëm për ruajtjen e likuiditetit.

Dhe, një burim tjetër që është i paraparë për financimin e projekteve është edhe rreth 80 milionë euro, që priten edhe në vitin e ardhshëm të jenë nga emetimi i letrave me vlerë.

Unë duke mos dashur ta zgjas më tepër, dëshiroj t'i falënderoj të gjitha grupet parlamentare, të cilat kanë ndarë kohë që të bisedojmë projektbuxhetin, para se të diskutohet në lexim të parë në Kuvend. Ne me kujdesin maksimal do t'i përcjellim të gjitha diskutimet e deputetëve, i mirëpresim të gjitha propozimet, të gjitha alternativat, pse jo edhe kritikën qëllimmirë dhe jam i sigurt, që gjatë punës në komisionet e Kuvendit, ky buxhet dhe ky draft, i cili sot po diskutohet në këtë Kuvend, do të ketë përmirësime dhe në leximin e dytë do të ketë edhe kualitet më të mirë se sa është sot. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Fjalën e ka, sipas Rregullores, kryetarja e Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, zonja Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: I nderuar nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Projektligjin për Buxhetin për vitin 2013, më 7 nëntor dhe ka vlerësuar se projektligji është përgatitur teknikisht mirë dhe është brenda afateve të cilat i parasheh korniza ligjore.

Pjesa tekstuale e projektligjit është përgatitur shumë më mirë krahasuar me vitin e kaluar, sepse krijon bazë për një efikasitet më të madh në menaxhimin e mjeteve buxhetore. Në pjesën tabelare mund të vërehen të hyrat dhe njëkohësisht mund të vërehet edhe rrjedhja e shpenzimeve të cilat janë të parapara. Projektbuxheti është harmonizuar me Fondin Monetar Ndërkombëtar, është bazuar në analizat makroekonomike të cilat janë pjesë e këtij dokumenti dhe në planin që ka Qeveria për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Vërehet se planifikimi është bazuar në një vlerësim të kujdesshëm të ndikimeve të cilat mund të vijnë për shkak të krizës e cila është dominonte në vendet e Evropës, por edhe në vende të rajonit. Projektbuxheti është hartuar edhe në harmoni me objektivat të cilat i ka Qeveria për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe për përmirësim të mirëqenies sociale për të gjithë qytetarët.

Kështu që Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka miratuar në parim Projektligjin për buxhetin për vitin 2013 dhe ka rekomanduar që buxheti të miratohet edhe në seancë plenare që t'i krijohet mundësia Komisionit që të bëjë plotësim- ndryshimet e duhura të këtij projektligji.

Në projektligj vërehet se të hyrat e përgjithshme janë parashikuar të jenë 1 miliard e 425 milionë, që siç e theksoi edhe ministri parashihet një rritje prej 3%, kurse pjesëmarrja e të hyrave në bruto-produktin vendor është 26.2%. 66% e të hyrave janë paraparë të sigurohen nga dogana, 21% nga bruto të hyrat tatimore në vend, 15% nga të hyrat jo tatimore dhe vetjake.

Ndërsa, të dalat e përgjithshme janë parashikuar të jenë 1 miliard e 586 milionë, që ka një rritje prej 4% të këtyre shpenzimeve, kështu që 27,4% të shpenzimeve janë planifikuar që të jenë për paga dhe mëdijtje, 14% për mallra dhe shërbime, kurse 18,9% për subvencione dhe transfere, kurse 39,1% për shpenzime kapitale.

Në kuadër të nivelit të planifikimit të shpenzimeve edhe më tutje vërehet se vazhdon trendi i lartë i shpenzimeve kapitale që është karakteristikë për vitet e fundit, ku janë të parapara 620 milionë euro për këtë vit. Duhet vlerësuar investimet në përmirësimin e infrastrukturës, sepse janë bazë e zhvillimit ekonomik dhe e krijimit të një ambienti më të favorshëm për investime, qofshin ato të brendshme dhe të jashtme, si dhe reflektojnë në përmirësimin e jetës së qytetarëve. Unë dua t'i përmend disa nga investimet kapitale të cilat janë bërë në disa sektorë. Po marr shembull, në Ministrinë e Infrastrukturës janë paraparë mjete prej 299 milionë e 987 mijë euro për investime kapitale, që janë 31 milionë e 739 mijë euro më shumë se sa këtë vit. Përpos dy projekteve madhore të autostradës janë paraparë mjete edhe për mirëmbajtje të rrugëve, për ndërtim të urave, rehabilitim të rrugëve, ndërtim të rrugëve të reja, ku në këtë projekt përfitojnë një numër i madh i komunave.

41 milionë janë parashikuar mjete për rehabilitimin e sistemit të ujit dhe të kanalizimeve, për rregullimin e mjedisit dhe planifikimit hapësinor. Për shëndetësi janë paraparë mjete për investime 13 milionë e 300 mijë euro, që do të thotë që ka afërsisht 1 milion euro më shumë se sa në vitin 2012. Për përmirësimin e infrastrukturës shëndetësore të kujdesit shëndetësor dytësor, tretësor, janë përkrahur programet për zhvillimin e sistemit të informimit shëndetësor dhe është përkrahur programi për shëndetin e nënës dhe fëmijës.

Ministria e Arsimit edhe më tutje vazhdon me ndërtimin e shkollave, ku janë ndarë 22 milionë e 650 mijë euro, kurse Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për investimet të cilat i ka paraparë për ngritjen e aktiviteteve që kanë të bëjnë me rininë, me kulturën dhe me ruajtjen e trashëgimisë kulturore janë ndarë mjete prej 11 milionë euro. Kurse, për përmirësimin e infrastrukturës në bujqësi janë ndarë 8 milionë e 869 mijë euro, kurse janë ndarë edhe 9 milionë e 400 mijë euro për mbështetje të fermerëve me qëllim të rritjes së prodhimit vendor.

Në këtë projektbuxhet shohim se ka rritje të pjesës që ka të bëjë me pagat dhe mëdijtjet, të cilat nuk dua t'i theksoj sepse i theksoi ministri. Po ashtu, ka rritje edhe te pjesa e shpenzimeve për shkak të reformave, të cilat janë bërë në shëndetësi dhe për shkak të rritjes së shërbimeve diplomatike, po ka rritje edhe tek pjesa e subvencionet. Dua të theksoj se komunat e Kosovës me këtë projektbuxhet përfitojnë nga buxheti shtetëror 375 milionë euro, që shënon një rritje prej... eurove, krahasuar me buxhetin e vitit 2012. Komunat kanë planifikuar që 52.7% apo 198 milionë e 205 mijë euro t'i shpenzojnë për paga e mëdijtje çka do të thotë se pjesën më të madhe të mjeteve e kanë planifikuar për paga dhe mëdijtje, 9,7% për mallra dhe shërbime, 2% për subvencione, kurse 33% komunat nga buxheti i tyre kanë paraparë të shpenzojnë për shpenzime kapitale. Prishtina është komuna që ka përfituar më së shumti nga Buxheti i Kosovës, për të cilin janë ndarë 63 milionë e 371 mijë euro që ka një rritje prej 2 milionë eurove, në krahasim me vitin aktual, mandej komuna e dytë që përfiton më së shumti nga ky projektbuxhet është

komuna e Prizrenit, që përfiton 33 milionë e 423 mijë euro apo 1 milion e 828 mijë euro më shumë se sa në këtë vit.

Pjesë e buxhetit të përgjithshëm është edhe buxheti i 28 institucioneve të pavarura, të cilat kanë të planifikuar 5 mijë e 958 të punësuar dhe kanë një buxhet prej 91 milionë e 803 mijë e 924 euro. E theksoj këtë, sepse Komisioni për Buxhet dhe Financa, në vazhdimësi është në vështirësi në përcaktimin e pagave dhe mëditjeve të bordeve ekzistuese, mbikëqyrëse, ekzekutive, këshillëdhënëse dhe pagave të stafit të këtyre institucioneve, në mungesë të bazës ligjore që përcakton pagat e funksionarëve të lartë publik.

Është shqetësuese se si nuk po gjendet mundësia që të miratohet ligji i cili përcakton pagat e funksionarëve të lartë publik dhe e rregullon se çfarë do të jetë stafi i këtyre institucioneve. Në mungesë të këtij ligji ua kemi dhënë mundësinë institucioneve të pavarura që duke mos qenë të kënaqura me pagat të cilat i kanë, të ankohen te faktori ndërkombëtar dhe ne vazhdimisht të marrim vërejtje edhe nga Komisioni Evropian edhe nga faktorët tjerë relevantë, ndërkombëtarë, të cilët e monitorojnë vendin tonë.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka pranuar kërkesa nga të gjitha këto institucione, të cilat do t'i shqyrtojë me kujdesin më të madh në mënyrë që të ruhet pavarësia financiare e këtyre institucioneve, sepse ka një keqkuptim të madh nga ana e këtyre institucioneve sa i përket pavarësisë financiare, sepse pavarësi financiare nuk do të thotë që të kesh sa të duash mjete dhe të shpenzosh si të duash mjete, por të kesh mjete sipas planeve dhe projekteve të përgatitura paraprakisht dhe me prioritete të përcaktohen mjetet dhe ne gjatë shfrytëzimit të mjeteve të bëhet shfrytëzimi i mjeteve ashtu siç e parashohin dispozitat ligjore.

Të nderuar deputetë, në komision ka pasur debat konstruktiv, deputetët kanë vlerësuar buxhetin, por edhe kanë shprehur vërejtjet e tyre, vërejtje këto që do të shqyrtohen në komision gjatë fazës së shqyrtimit të buxhetit, ashtu që vërejtjet që kanë arsyeshmëri të gjendet mundësia që të përfshihen në buxhet. Është kërkuar që për disa të dhëna tek pjesët tabelare të jepen sqarime në formën e shkruar, është shprehur shqetësimi se edhe më tutje po vazhdojmë me situatën e trashëguar që na bën të varur shumë nga importi dhe importi sipas deputetëve është ai që po ndikon në të hyrat buxhetore, gjë që reflekton edhe në nivelin e zhvillimit ekonomik të vendit tonë.

Ka pasur vërejtje tek Agjencia e Statistikave të Kosovës, sepse nuk po i jep informatat apo nuk po krijon mundësi që të pajisë me të dhëna, të cilat janë mjaftë të rëndësishme me rastin e planifikimit të buxhetit dhe është kërkuar sqarim nga ministri i Financave, që ka qenë i pranishëm në mbledhjet e Komisionit që të japë informata më të sakta rreth rritjes së pagave për 25 milionë euro. Po ashtu, ka pasur vërejtje edhe se rritja ekonomike që po vjen...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Edhe një minutë deputetes.

SAFETE HADËRGJONAJ: Desha të theksoj që ka pasur edhe vërejtje, sepse rritja ekonomike nuk po reflekton, këto investimet publike që po bëhen nuk po reflektojnë me efekte multiplikuese që reflektojnë në zhvillimin ekonomik.

Të nderuar deputetë, në fund dua të them se projektbuxheti që na është ofruar e ruan qëndrueshmërinë fiskale në sajë të një planifikimi të matur që u janë bërë shpenzimeve për vitin 2013, në raport me të hyrat e parashikuara, është bërë një shpërndarje efikase e tyre nëpër kategori të caktuara që mundëson realizimin e projekteve të rëndësishme kapitale tashmë të iniciuara dhe që cilësohen si shumë të rëndësishme për një ambient dhe siguron një ambient të favorshëm për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.

Të nderuar deputetë, Komisioni për Buxhet dhe Financa, me shumicë votash e ka miratuar buxhetin, Projektligjin për buxhetin për vitin 2013. Ju rekomandoj që ta miratoni projektbuxhetin dhe të na jepni mundësitë që duke i marrë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit ! Radha është e shëfave të grupeve parlamentare ose përfaqësuesve. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zonja Krasniqi e ka fjalën.

HASIME KRASNIQI: Faleminderit , zoti nënkryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë dhe kolege deputetë,

Projektligji i Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2013, është shqyrtuar dhe analizuar nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, si projektligj me rëndësi të veçantë për shtetin e Kosovës, i cili është përgatitur mirë në aspektin teknik dhe përmbajtësor ku ofron të dhëna të detajuara në pjesën tabelare si dhe pjesën tekstuale të projektbuxhetit sipas të cilës është rregulluar mënyra e ndarjes dhe e menaxhimit të mjeteve.

Me këtë projektbuxhet në bazë të parashikimeve makroekonomike, grumbullimi i të hyrave buxhetore gjatë vitit 2013 është paraparë të jetë 1miliard e 423 milionë, që domethënë, me një rritje prej 7% ku prej tyre 915 milionë do të jenë bruto të hyrat nga tatimet e mbledhura në doganë, 301 milionë euro do të jenë bruto të hyrat tatimore. Po ashtu parashihet që rikthimet tatimore për vitin 2013, arrijnë vlerën prej 35 milionë euro. Ndërsa, të hyrat vetjake dhe jo tatimore arrijnë shumën prej 208 milionë euro dhe 33 milionë euro nga dividendat dhe grantet.

Në nivelin qendror janë paraparë të arkëtohen 1 miliard e 360 milionë euro, ndërsa në nivelin komunal janë planifikuar të arkëtohen 63 milionë euro. Edhe në parashikimet e buxhetit për vitin 2013, struktura e të hyrave dominohet nga arkëtimet e doganave dhe tatimet, ndërsa sa i përket kontribuuesit kryesor në rritjen e të hyrave të përgjithshme vetjake është kategoria e të hyrave vetjake qendrore që mbështet me të hyrat shtesë nga liberalizimi i frekuencave të Telefonisë Mobile për inkuadrimin e teknologjive më të reja në këtë fushë.

Shpenzimet e përgjithshme buxhetore për vitin 2013, përfshirë edhe shpenzimet e AKP-së dhe rikthimin e kredisë nga KEK-u, janë në vlerë prej 1 miliard e 586 milionë euro apo rreth 4% më të larta se shpenzimet e planifikuara me rishikimin e buxhetit për vitin 2012, e cila rritje vjen si rezultat i rritjes së vazhdueshme të investimeve në infrastrukturën rrugore ku gjatë vitit 2013 pritet të bëhet finalizimi i projektit kapital të autostradës, si dhe fillimi i projektit tjetër kapital, ndërtimit të autostradës Prishtinë – Shkup. Nga ky projektbuxhet i planifikuar mund të themi se Qeveria e Republikës së Kosovës vazhdon me realizimin e projekteve madhore në interes të vendit, me ndërtimin e autostradave të njëpasnjëshme duke mos lënë anash edhe ndërtimin e rrugëve rajonale dhe komunale, investimet në infrastrukturën arsimore dhe sportive, mbështetjen e sektorit të bujqësisë, mbështetjen e reformave në sektorin e shëndetësisë, si dhe investimet në të gjithë sektorët e tjerë që drejtpërdrejt ndikojnë në përmirësimin e kushteve socio-ekonomike për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Po ashtu, edhe shpenzimet për paga dhe mëditje për vitin 2013, parashihet një ngritje prej 6%, që domethënë se kjo Qeveri vazhdon me ngritjen e pagave nëpër sektorë të ndryshëm me qëllim të përmirësimit të kushteve për një jetë më të mirë për të gjithë qytetarët. Te kategoria transfere sociale kemi një ngritje rreth 9.2% si rezultat i ngritjes së pensioneve për pensionistët kontribut-dhënës, pensionet bazë, si dhe pensionet e aftësive të kufizuara dhe kjo ngritje vjen si rezultat i vendimit të Qeverisë për rritjen prej 40% për pensionistët.

Ky projektbuxhet është dëshmia më e mirë se Qeveria e Republikës së Kosovës është në shërbim të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe interesave të tyre. Është një rezultat i punës dhe përpjekjeve të institucioneve të vendit për të hartuar një buxhet i cili garanton zhvillim ekonomik dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mirëqenies së qytetarëve të vendit tonë. Edhe përkundër vështirësive ekonomike nëpër të cilat po kalon jo vetëm Kosova dhe vendet e rajonit, por edhe vendet e tjera të zhvilluara të Evropës, me këtë projektbuxhet të planifikuar nga Ministria e Financave, Qeveria e Republikës së Kosovës, me politikat e saj shtet-formuese vazhdon ta ruajë qëndrueshmërinë makrofiskale dhe stabilitetin makrofiskal duke ofruar mbulesë të plotë buxhetore për të gjitha projektet kapitale dhe për të gjitha shërbimet publike që janë në dobi të qytetarëve tanë.

Dhe, për fund duke pasur parasysh se prioritet janë interesat e qytetarëve të Republikës së Kosovës, grupi ynë parlamentar do të jetë pro këtij projektbuxheti dhe kontributin tonë do ta japim në Komisionin Funkcional. Ju Faleminderit !

(Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Petar Miletij.)

KRYESUESI: Hvala! U ime poslaničke grupe LDK, Naser Osmani.

NASER OSMANI: I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, vlerëson se ky buxhet që i është propozuar Kuvendit të Republikës së Kosovës, vulos varfërinë në Kosovë.

Ky buxhet i mbyl shpresat e qytetarëve të Kosovës për jetë më të mirë, ky buxhet i falimenton bizneset vendore dhe e qon ekonominë e Kosovës edhe më tej në kolaps. Ky nuk është buxhet i zhvillimit pasi nuk mbështetet në asnjë objektivë zhvillimore. Kjo është e pritshme pasi që ky dokument nuk siguron qëndrueshmëri buxhetore, sepse kjo Qeveri nuk ka plan zhvillimor. Plani i Bullgarisë u pa që ishte jashtë kontekstit ekonomik në Kosovë dhe u injorua nga vetë përpiluesit e tij. Parashikimet për rritje ekonomike kanë rënë nga 8% në 4.5%, ndërsa zvogëlimi i papunësisë i paraparë prej 8 deri në 10% mbetet thjesht një mashtrim i opinionit.

Nuk mund të prodhojë zhvillim ekonomik ky buxhet kur 60% e investimeve kapitale shkojnë për infrastrukturë, krahasuar me vetëm 4,6% në arsim, 2,7% në shëndetësi dhe 2,2% në zhvillimin ekonomik. Në një vend me rreth 1/3 e popullsisë në moshën 18 vjeçare, vetëm 1.6% e buxhetit shpenzohen për mbështetjen e rinisë, kulturës dhe sporteve. Me rreth gjysmën e popullsisë në zonat rurale të varur kryesisht nga bujqësia vetëm 1.8% e investimeve kapitale shkojnë për bujqësi. Kjo Qeveri tani ka pranuar këtë fakt dhe nuk po bën asgjë për të ndryshuar situatën, përkundrazi sivjet ka rritur tatimin në biznesin e vogël nga 5 në 9% dhe ka rritur çmimin e rrymës për 9%. Ne vlerësojmë se projektbuxheti i vitit 2013 ka plot probleme strukturore. Deficiti buxhetor pritet të jetë 3,1% e GDP-së që është mbi nivelin e lejuar me normë evropiane. Për të tretin vit me radhë buxheti përfshin të hyrat e njëhershme prej 326 milionëve, që përbën pothuajse 1/3 e buxhetit të jetë fiktiv.

Investimet kapitale prej 621 milionë mbesin pothuajse në të njëjtin nivel me vitin e kaluar. Prej tyre 35% shkojnë vetëm për një kontratë Bechtel Enkën, pa përfshirë shpronësimin për 30 milionë euro. Rreth 30 milionë euro të tjera janë ndarë për Autostradën Prishtinë - Shkup, ndërsa projektet e tjera në rrugë figurojnë tash e tre vjet në buxhet dhe janë të papërfunduara. Harrohen krejtësisht shpenzimet për funksionalizimin dhe mirëmbajtjen e objekteve dhe infrastrukturës së ndërtuar.

Të nderuar deputetë, ky projektbuxhet ka plot paradokse që e bëjnë këtë buxhet jostabil, nuk jepet asnjë vlerësim se si do të kalohet nga mbledhja e të hyrave në kufi që është 64% e të hyrave, në mbledhjen e të hyrave brenda ekonomisë. Kapacitetet e Administratës Tatimore të Kosovës vazhdojnë të jenë të kufizuara për të bërë këtë ndryshim. Dhe, kjo po iu kushton bizneseve pasi që TVSH-ja për mallra mblidhet ende pa u shitur malli, nga 915 milionë euro që mblidhen në kufi, rreth 430 milionë euro apo 47% TVSH-ja që duhet të mblidhet pasi të shitet malli. Kjo nënkupton se bizneset në Kosovë duhet të qarkullojnë rreth 430 milionë kesh pa asnjë nevojë. Në vend që ato mjete të investohen në biznes, pra bizneset po e paguajnë koston e paaftësisë së Qeverisë për të mbledhur TVSH-në, pasi që malli të shitet.

Rritja e deficitit tregtar nga viti në vit po i vë në pikëpyetje të gjitha skenarët për rritje ekonomike. Ekonomia e Kosovës po shndërrohet në një ekonomi konsumuese e varur nga importet, të cilat paguajnë kryesisht nga remitencat e bashkatdhetarëve tanë. Sfidë sa

i përket të hyrave në kufi mbetet funksionalizimi i pikave doganore 1 dhe 31 dhe zvogëlimi i kontrabandës në të gjitha pikat kalimtare kufitare. Me këtë buxhet bizneset nuk mund të presin ndonjë gjë konkrete sa i përket lehtësirave fiskale, reformat fiskale e filluar në vitin 2011 që përfshinte përshkallëzimin e TVSH-së, lirim nga taksat doganore për lëndët e para dhe ambalazhet, lirim nga TVSH-ja për importet me mjetet kapitale Teks Holiday apo lirim të përkohshëm nga tatimi në fitim për korporata dhe masa të tjera lehtësuese për bizneset tani mbeten vetëm shpresë.

Të nderuar deputetë, për shkak të inflacionit pozitiv nga viti në vit, ky buxhet e bën të qartë se vlera reale e pagave do të shënojë rënie reale në vitin 2013. Rritja e buxhetit për paga prej 25 milionë nuk vjen vetëm për shkak të reformës në Administratën Publike, por vjen si rezultat i punësimit të militantëve partiakë të PDK-së në institucionet qeverisëse dhe agjenci të ndryshme, gjoja se të pavarura.

Rritja e buxhetit për mallra dhe shërbime me 21 milionë euro, është më e vogël se rritja e inflacionit të këtij viti dhe vitit të kaluar. Si rezultat investimet kapitale do të dështojnë në funksionalizime dhe të mirëmbahen. Me buxhetin e përgjithshëm prej 225 milionë euro mallra dhe shërbime qytetarët e Kosovës duhet ta dinë se nuk do të marrin shërbime të mira dhe cilësore. Pra, ky buxhet vulos varfërinë në Kosovë, subvencionet dhe ndihmat sociale që marrin familjet e varfra do të zvogëlohen me terma real.

Me vetëm 1,6 euro në ditë apo rreth 45 euro në muaj fëmijët nga këto familje do të mbesin të varfra dhe në të ardhmen. Ata nuk mund të ushqehen dhe arsimohen si duhet. Investimet kapitale në vitin 2013 janë vetëm 1,1% më të larta se vitin e kaluar. Këto investime po bëhen pa asnjë kriter që definon efektin e tyre ekonomik apo normën e kthimit, përveç investimeve në infrastrukturën rrugore. Investimet në bujqësi prej 8,8 milionë dhe subvencione 9,4 milionë, përbëjnë vetëm 1,4% e buxhetit të tërësishëm. Ky buxhet sërish mbetet më i ulëti në rajon. Me rreth 60% e popullsisë në Kosovë në zonat rurale, buxheti për bujqësi do të duhej të ishte së paku 100 milionë euro, mungojnë investimet në sistemin e ujitjes që do të zvogëlonte shpenzimet e bujqësisë dhe do të rriste produktivitetin.

Investimet kapitale në zhvillim ekonomik kanë rënë nga 4,3 milionë, sa ishin në vitin 2012, në 2,5 milionë në vitin 2013 dhe atë në vetëm 240 mijë euro projekte të reja. Nuk ka asnjë orientim pragmatik për tërheqjen e investitorëve, mjetet shpenzohen kryesisht në udhëtime zyrtare, në nxjerrjen e broshurave, aktiviteteve për tryeza dhe reklama. I gjithë fokusi i investimeve mbetet në infrastrukturën rrugore. Ndërtimi i rrugëve nuk po përcillet me efekte multiplikuese ekonomike në vend dhe nuk po e zvogëlon koston e bizneseve. Firmat vendore që kanë investuar miliona euro me pajisje pothuajse tani janë fare pa punë. Buxheti nuk parasheh fare investime në funksionalizimin e tyre, ky buxhet nuk adreson problemin e furnizimit me ujë të pijshëm për rreth 25% të banorëve, që nuk janë të kyçur në rrjetin e ujësjellësit.

Investimet në trajtimin e mbeturinave dhe ujërave të zeza, mungojnë. Ujërat e ndotura po e dëmtojnë bujqësinë për shkak të ndotjes së lumenjve, po ndikojnë në shëndetin e

qytetarëve dhe po e largojnë Kosovën nga standardet ambientaliste të Bashkimit Evropian... *(Ndërprerje nga regjia)*

(Drejtimin e seancës e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.)

KRYETARI: E kreve? Edhe sa kohë do ta kryesh? I ke edhe dy minuta.

NASER OSMANI: Buxheti për Shëndetësi pritet të mbetet në nivelin e deritashëm prej 6,7% të buxhetit të përgjithshëm. Miliona euro po derdhen jashtë Kosovës për shërimë, sepse zhvillimi i shëndetësisë me këtë buxhet është edhe më tutje i pamundshëm.

Më duhet ta shkurttoj për shkak të kohës. I nderuar kryetar i Kuvendit, të nderuar deputetë, LDK-ja nuk mund ta mbështesë këtë buxhet pasi që është në dëm të qytetarëve dhe bizneseve. LDK-ja kërkon që të rishikohet shpërndarja e investimeve kapitale, sidomos në arsim dhe infrastrukturë rrugore dhe të shpërndahen drejt nëpër komunat bazuar në formulat për shpërndarjen e granteve nëpër komuna. LDK-ja kërkon që shpenzimet në arsim të arrijnë së paku në 15% të buxhetit total të vendit, kjo do të mundësonte ndërtimin e infrastrukturës së mjaftueshme, pajisjen e shkollave dhe funksionalizimin e tyre të plotë. LDK-ja kërkon që shpenzimet në shëndetësi të rishikohen për të bërë të mundur furnizimin e rregullt të institucioneve shëndetësore me barna, LDK-ja kërkon ndarjen e fondeve për krijimin e kuadrove të reja shëndetësore dhe pajisjen e klinikave me teknologji moderne. LDK-ja kërkon që të dizajnohet një program i tërë për ngritjen e kapaciteteve në Administratën Tatimore të Kosovës, në mënyrë që të mundësohet kalimi i mbledhjes në kufi të tatimeve në brendi dhe për luftimin e evazionit fiskal. LDK kërkon që të rishikohen edhe njëherë burimet e të hyrave të menjëhershme, ato të hyra që nuk janë aspak të sigurt, LDK-ja vlerëson se nuk ka bazë ligjore për privatizimin e PTK-së, pasi Ligji i buxhetit për vitin 2011 nuk është më në fuqi, përfshirë edhe nenin 4...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Në emër të “Vetëvendosjes”, fjalën e ka kryetari i Grupit, Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit , kryetar!

Mendoj që nga fjala që e dëgjuam këtu e ministrit edhe mënyra, tonaliteti i të folurit të ministrit, mund të jetë i vërtetë për dy skenarë të ndryshëm, kujtoj unë. I pari mund të jetë ai që ministri është lodhur nga puna që e ka pasur në hartimin e këtij buxheti, për shkak se natyrisht që është punë goxha e mundimshme, por e dyta mund të jetë që në fakt as ministri nuk i beson ato që i thotë. Pra, as ministri nuk është optimist për këtë buxhet që po e paraqet për shkak se e paraqiti thua ti do të na thoshte që mos e votoni se nuk është buxhet i mirë, edhe vërtet nuk është buxhet i mirë, po unë pajtohem me ministrin në këtë të dytën.

Për shkak se buxheti i vitit 2013 nuk ka kurrfarë dallimi thelbësor me atë të vitit 2012, por as edhe me vitin 2011, 2010, 2009 e kështu me radhë, por është i njëjti buxhet i cili

vetëm po na përsëritet me një ndryshim të vogël të numrave, të cilën e bëjnë zyrtarët e Ministrisë në Excel.

E njëjta logjikë e të buxhetuarit dhe të njëjtë sektorë ekonomikë vazhdojnë ta marrin pjesën më të madhe të parasë publike, pa kurrfarë planifikimi apo indikacioni që këto do të ndikojnë në zhvillimin e ekonomisë dhe rritjen e mirëqenies së qytetarëve. Në njërën anë pra kemi deklarime të shumta të zyrtarëve të Qeverisë se kemi përmirësime të dukshme në ekonominë e vendit, rritje në përqindje të ndryshme, si dhe në logjikën qeverisëse përmes publikimeve të planeve strategjike, zhvillimore të cilat herë përpilohen në Banjsko, herë diku brenda në Kosovë, ndërkohë që në anën tjetër e kemi buxhetin i cili na përsëritet prej viti në vit. Pra, kjo do të thotë që ose buxheti nuk po reflekton realitetin e ndryshuar, që po thonë qeveritarët se ka ndryshuar, ose realiteti nuk është baza mbi të cilën ndërtohen deklaratimet e pushtetarëve. Edhe unë mendoj që vërtet kjo e dyta është shumë më e vërtetë se sa e para. Kjo logjikë është e mbrapshtë dhe është dëshmuar të jetë e tillë në secilin vit të përmendur më lart. Qeveria e Kosovës vazhdimisht krekoset se ka rritje të buxhetit si në të hyra ashtu edhe në shpenzime, ndërkohë që jeta e qytetarit vazhdon degradimin e ekonomia e Kosovës vazhdon lëngimin.

Edhe ky buxhet sikur të tjerët para tij, në pjesën e të hyrave vazhdon të varet nga doganat, pra nga malli i importuar, shumë kjo që planifikohet të përbëjë diku 75% të të hyrave të përgjithshme të buxhetit. Pra, edhe ky buxhet sikur të tjerët, shpenzon pjesën më të madhe të investimeve kapitale në një projekt të vetëm kapital që është autostrada. Edhe ky buxhet bilancin e tij përfundimtar e bazon në planifikimin e privatizimit të PTK-së, privatizim ky që tash është planifikuar të jetë kusht edhe për fillimin e një autostrade të re, atë që do ta lidhte Prishtinën me Shkupin.

Ministri këtu e tha që ne nuk paragjykojmë se si do të rrjedhë procesi i privatizimit të PTK-së, që do të nënkuptonte sipas fjalës së ministrit që këta nuk i paragjykojnë asçmimin, mirëpo këtu e kanë vendosur për herë të tretë tashmë 300 milionëshin si e hyrë e njëhershme në buxhetin e Kosovës, që nënkupton që këta planifikojnë ta shesin PTK-në për 300 milionë. Edhe unë po i them ministrit, natyrisht që nuk pritet nga Qeveria, asnjë Qeveri që të paragjykojë, mirëpo pritet domosdoshmërisht nga Qeveria që të planifikojë e problemi me këtë buxhet nuk është se nuk kanë paragjykuar, problemi me këtë buxhet është se nuk kanë planifikuar.

Pra, ky është buxhet i cili nuk ka fare koncept të zhvillimit. Ky është një buxhet i asfaltit dhe betonit e jo buxhet i investimeve në sektorët prodhues. Zhvillimi ekonomik i Kosovës, duhet ta dimë të gjithë, vjen nga investimet në prodhim, nga hapja e vendeve të punës së bujqësi, në energji dhe në industri. Rritja ekonomike dhe mirëqenia e qytetarëve varen nga investimet në arsim dhe shëndetësi, në rritjen e kapaciteteve prodhuese që shtojnë vlerë dhe nga rritja e kualifikimit dhe frytdhëshmërisë së fuqisë punëtore. Ky buxhet nuk e bën as për së afërmi këtë. Ky buxhet është në funksion të interesave afatshkurtër dhe pushtetit e jo në funksion të interesit afatgjatë për zhvillim, për shkak se kjo Qeveri, ose nuk e di ose nuk do fare t'ia dijë se çka është zhvillimi.

Por, kjo Qeveri nuk e di dhe nuk do fare t'ia dijë as çka është planifikimi. Secili buxhet që sillet në Kuvend është në shpërputhje flagrante me kornizën afatmesme të shpenzimeve. Të njëjtin problem e ka edhe buxheti aktual, pra ky që propozohet të jetë buxheti i vitit 2013. Në ekonomi për secilin vend është i domosdoshëm planifikimi strategjik afatgjatë. Korniza afatmesme e shpenzimeve pastaj do ta reflektonte këtë plan strategjik në objektivat afatmesme e buxheti i detajizon hapat afatshkurtër të zbatimit të këtyre të dyjave, pra të ecjes në binarët tashmë të planifikuar dhe analizuar mirë. Por, ky projektbuxhet për vitin 2013 e thellon mungesën e aftësisë elementare për planifikim.

Në nenin 14 të Ligjit për Buxhetin dëshmohet fuqishëm tendenca e Qeverisë që gjatë ekzekutimit të buxhetit të manipulojë me alokimet buxhetore sipas nevojave ditore. Pra, jo vetëm që nuk ka plan afatgjatë strategjik, jo vetëm që korniza afatmesme ndryshon sipas buxhetit vjetor, por kemi edhe buxhetin vjetor që lejohet të ndryshohet karshi nevojave ad hoc të politikës ditore. Kjo e bën pastaj gjithë procesin e përpilimit edhe të votimit të buxhetit në Kuvend plotësisht jorelevant.

Po ashtu te neni 5, stimulohen shpenzimet joefikase nëpër agjencitë shpenzuese për shkak se aty shpërfaqet edhe një herë tendenca e Qeverisë që të manipulohet me alokimet, por edhe njëfarë mënyre që organizatat buxhetore të cilat nuk i shpenzojnë natyrisht mjetet e tyre, nuk kanë të drejtë t'i bartin në vitin pasardhës. Dhe, kjo pastaj obligon këto organizata buxhetore që në fund të vitit të shpenzojnë në mënyrë sa më joracionale vetëm e vetëm për t'i shpenzuar ato paratë të cilat tashmë i kanë të buxhetuara.

Tash po hyjmë në detaje të buxhetit në pjesë të caktuara të cilat dua t'i sjell këtu para jush sot. Te pozicioni i pagave, vërehet se për vitet në vijim rritjen e parashikuara janë në disa raste, madje edhe më të ulëta se norma e inflacionit. Pra, ky fakt është kundërthënës me argumentimin e Qeverisë për rritjen e pagave në fund të vitit 2011, kur pretendohet se kjo rritje do të përkthehet në rritje të fuqishme të produktivitetit të zyrtarëve publik.

Si mund të shpjegohet fakti se në vend të rritjes të produktivitetit që do të mundësonte kryerjen e punëve në sektorin publik më me pak të punësuar, Qeveria parasheh rritje të punësimit edhe për 900 nëpunës të rinj. Pra jo vetëm që nuk rriten pagat për ta përcjellë inflacionin, por edhe rritja e pagave është në masë të madhe e ndikuar nga rritja e punësimit dhe jo e pagave në të vërtetë.

Tek alokimet e mjeteve të dedikuara për paga dhe mëditje për agjencitë shpenzuese, vërehet një dalim i madh në shpërndarjen e pagave për zyrtarë publik. Dallimet në disa raste dalin shumë të fuqishme dhe të pashpjegueshme. Kjo vlen sidomos për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ku mesatarisht mjetet e ndara për një të punësuar, janë deri në trefishin e disa ministrive. Kjo pasohet me një fakt tjetër i cili ka të bëjë me diferencën shumë të madhe mes pagave të zyrtarëve të Ministrisë së Drejtësisë, ta zëmë ose asaj të Mjedisit, Planifikimit Hapësinor, Ministrisë së Punës, Mirëqenie Sociale dhe tjera, në njërin anë dhe Policisë së Kosovës, në anën tjetër. Përkundër faktit se niveli i edukimit anon dukshëm, do të duhej të anonte dukshëm në favor të zyrtarëve në ministrinë e përmendura, dallimi në paga është për 25 deri 33%, në favor të Policisë së Kosovës. Pra,

planifikime të tilla buxhetore janë atraktive vetëm për ato shtete të cilat planifikojnë të vendosin policinë në shërbim të objektivave afat ngushta të politikës ditore.

Një rast tjetër i pashpjegueshëm, në rast se nuk paraqet ndonjë problem, gabim prej fillestarësh është edhe ai i Ministrisë së Administrimit Publik ku për secilin nga 7 punëtorët e Departamentit për Menaxhimin e Reformës së Administratës Publike, janë planifikuar paga mujore prej hiç më pak se 120 mijë eurove.

Te shëndetësia në vazhdimësi është cekur se shëndetësia paraqet një nga prioritetet e Qeverisë së vendit, ndërsa në tri vjetët në vijim, Qeveria parasheh një rritje të alokimeve për shëndetësinë që është jo vetëm dukshëm më e vogël se rritja e parashikuar e prodhimit të brendshëm bruto, por madje edhe më e vogël se vet norma e inflacionit. Kjo përkthehet në rënie të vazhdueshme të shpenzimeve për shëndetësi si përqindje e buxhetit, por edhe e prodhimit të brendshëm bruto.

Shqetësuese është edhe interesimi për investime kapitale në shëndetësi ku për gjitha vitet për të gjitha spitalet rajonale dhe për Qendrën Klinike Universitare, janë paraparë investimet simbolike që janë më pak se 0,3% e prodhimit të brendshëm bruto. T'i shtojmë kësaj që edhe këto alokime të pakta nuk janë bërë në bazë të nevojave të qendrave spitalore, por si shuma fikse prej 600 mijë euro për spitale më të mëdha dhe 250 mijë euro për spitalet e vogla.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në vazhdimësi ka proklamuar synimin e Qeverisë për mbështetje të fuqishme për fermerët e Kosovës, që sigurojnë mbijetesën e gjysmës së popullatës së vendit, përkthyer në numra, kjo mbështetje e fuqishme nuk e kalon 0,33% të prodhimit të brendshëm bruto të Kosovës. Kjo duhet t'i përsëritet Qeverisë sa herë që e cekin bujqësinë si një nga prioritetet e tyre.

Nga totali i shpenzimeve të dedikuara për investime kapitale, 40% janë alokuar për ndërtim të autostradës, kurse vetëm 2,9 milionë ose më pak se 0,5% janë dedikuar për ndërtime të reja të rrugëve. Në pjesën e mbetur të shpenzimeve kapitale në shumicën e rasteve, nuk parashihen projekte që mund të kenë ndonjë ndikim në zhvillimin ekonomik të vendit e as për ngritjen e mirëqenies së qytetarëve. Kështu nga totali i projekteve kapitale, 24 prej tyre janë për blerje të veturave, 34 projekte janë për memoriale buste e varreza, kurse hiq më pak se 92 projekte parashihen vetëm për mirëmbajtje. Shumica absolute e projekteve kapitale që do të ekzekutohen gjatë vitit, radhiten si projekte të vazhduara nga viti 2012, përkatësisht nëse e marrim vetëm rastin e ndërtimit të rrugëve të reja, i kemi vetëm 9 projekte të cilat janë planifikuar si projekte për vitin 2013, ndërkohë që nga 33 gjithsej, 24 janë të cilat barten nga viti i kaluar, pra e kemi një dhe kjo është pastaj e shpërndarë në tërë pjesën tjetër të buxhetit.

Po e shoh se gati po më përfundon koha, vetëm desha ta ngris edhe një çështje. Te tabela numër 1, pra e kemi një shpërputhje mes asaj që e tha ministri dhe asaj që ministri tha se pritet që ngritja e importeve në këtë vit të jetë më e ulët se viteve tjera dhe do të jetë një ngritje prej 5.8%, nëse e kuptova mirë, por këtu i kemi pastaj planifikimi që...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Edhe një minutë.

VISAR YMERI... pra kemi një shpërputhje ndërmjet asaj se çka deklaroi ministri për rritjen e importeve dhe të hyrat nga dogana se, nëse rriten importet, atëherë duhet të rriteshin në mënyrën e njëjtë të hyrat nga doganat, për shkak se secili import do të duhej të kalonte kah doganat dhe të marrin pastaj të ardhurat që vijnë nga ajo. Po ashtu është diskutuar disa herë interesimi i kësaj Qeverie për të investuar në ekonominë e vendit dhe nëse e shihni buxhetin, e shihni se investimet kapitale nuk kanë fare të bëjnë me ndërtimin e kapaciteteve prodhuese. Për shembull, për t'i përmendim vetëm disa, 1 milion e 735 mijë janë planifikuar të investohen në "Trepçë" në tri projekte kapitale. Të gjitha këto janë të bartura nga viti 2012, pra për vitin 2013, Qeveria nuk e ka ndarë asnjë cent për "Trepçën".

Po ashtu te Departamenti i Industrisë dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, pra me këtë emër kaq të madh, Departamenti i Industrisë, e kemi vetëm një projekt kapital 100 000 euro për mbështetjen e kapaciteteve turistike. Pra, Departamenti i Industrisë bën vetëm mbështetje kapaciteteve turistike. Natyrisht që Lëvizja Vetëvendosje këtë buxhet nuk do ta votojë për shkak të gjitha këtyre që i përmenda edhe për shkak të shumë të tjerave që nuk na....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Në emër të AAK-së, kryetari i Grupit, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti kryeministër,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Para se të bëhem gati të flas për buxhetin, e kam bërë njëfarë analize, është hera e gjashtë që unë flas në Kuvend të Kosovës për Buxhet të Kosovës, për gjashtë buxhete të ndryshme kam folur. Edhe ajo që është tepër interesante për t'u përmendur është një trend i cili nuk po mund të ndalet dhe përkundër faktit se e di që ministri aktual e ka trashëguar trendin, ka pasur mundësi sipas të gjitha gjasave ta provojë ta ndryshojë këtë trend.

Shpeshherë ka mospërputhje ndërmjet politikave që deklarohen edhe që janë publike dhe asaj që shkruhet në tabelat e buxhetit. Do të thotë ka shpërputhje dhe kur ka shpërputhje mes deklaratave publike dhe asaj që shkruhet në letër, atëherë është goxha problem edhe për të bërë debat konstruktiv.

Një prej problemeve të mëdha që shihet në këtë buxhet, janë projektet e bartura. U tha nga parafolësit këtu, nëse i shihni kolonat e projekteve, e shihni se te projektet e reja në shumicën e rasteve figuron një zero, ndërsa te totali dalin projektet e bartura. Kjo bartje e projekteve, me siguri se do të jetë temë e debatit kur të bisedojmë për raportin e shpenzimeve buxhetore për vitin 2012, që duhet të silllet i detajuar deri mars dhe kur do ta marrim sipas të gjitha gjasave, ose faktikisht me ligj duhet ta marrim raportin për

shpenzimet kapitale për të gjitha projektet veç e veç në janar të vitit në të cilin po hyjmë dhe atëherë, me siguri do ta kemi të qartë se çka po ndodh, a nuk janë hapur tenderët, a nuk janë kryer punët, apo çka ka ndodhur që një numër kaq i madh i projekteve bartet prej vitit 2012 në vitin 2013 dhe njëfarë forme gati e pamundëson të kemi edhe projekte të reja, do të thotë ka shumë pyetje në këtë temë të bartjes së projekteve. A janë shpenzuar mjetet, a nuk janë shpenzuar, a kanë mbetur në gjysmë? Dhe këtu nuk po flas për projekte të cilat e kemi të qartë se nuk mund të kryhen për një vit, shembull ta marrim, autostrada. Aty është e qartë se mjetet bartën për shkak se është projekt më i madh, mirëpo te projektet tjera kjo bartje është jashtëzakonisht problematike.

Një element tjetër jashtëzakonisht i rëndësishëm për buxhetet e Kosovës në vitet e fundit, është përsëritja e projekteve edhe kjo ka të bëjë me vlerën e parasë së investuar dhe kjo përsëritje e projekteve është goxha e shpeshtë.

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Ka rrugë që ndërtohen tri herë, ndërtohen, shkatërrohen, ndërtohen shkatërrohen. Dhe tani pa dashur të lëshohem në detaje të tjera, ma merr mendja se çdo njeri i cili vetëm pak e ka përcjellë gjendjen me rrugë dhe me buxhet, mund ta kuptojë se pse duhet të ndërtohen nga tri herë rrugë brenda një mandati qeverisës, është shumë problematike.

Çështje tjetër që ka të bëjë me shpërputhjen është mes asaj që deklarohet për rritje ekonomike dhe rritjes së buxhetit, e sidomos kur e kemi parasysh që buxhetet e viteve të fundit marrin edhe hua, domethënë shteti merr hua, hua publike. Shembull ta marrim letrat me vlerë janë hua me sa e di unë ministër, ai mund të quhet thjeshtë hua për shkak se shteti jep letra, merr mjete dhe ato mjete i merr me interes, përndryshe askush nuk ka llogari t' i japë shtetit të holla ose vlerë monetare për letër, nëse nuk e merr interesin. Do të kemi edhe hua, domethënë të rritet huaja, buxheti rritet nga pak dhe në të njëjtën kohë të gjitha këto bashkë nuk korrespondojnë me ato që thuhet për rritje ekonomike.

Kemi problem me evazion fiskal. Disa herë këtu në këtë foltore e kam përmendur çështjen e arkave fiskale, dilni në rrugë Komisioni për Buxhet dhe Financa mund ta kryejë këtë punë dhe e shihni që dyqanet dhe bizneset të cilat janë ngjitur me njëri-tjetrën, disa kanë arka fiskale, disa nuk kanë. Kjo është një element tjetër i trendit që i dënon ata që e respektojnë ligjin dhe i favorizon ata që nuk e respektojnë ligjin.

Projektet e reja ju thashë që janë jashtëzakonisht në numër të vogël, janë josinjifikante. Kemi 440 milionë përafërsisht mjete të cilat shpenzohen për paga dhe mëditje dhe raporti në mes totalit të buxhetit dhe pagave dhe mëditjeve, nuk po ndryshon. Edhe një pyetje reale do të ishte - pse duhet Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore të na tregojë se ky raport duhet të ndryshojë? Domethënë, një Qeveri e cila synon zhvillim afatgjatë, duhet ta dijë vetë, nuk ka nevojë t' i thotë një institucion ndërkombëtar se ky raport duhet të ndryshojë.

Kemi 204 milionë euro për mallra dhe shërbime dhe diku pak më pak se 600 milionë euro për shpenzime kapitale, pjesa më e madhe e cilave prapë shkon në autostradë. Pa dashur të ndalem te autostrada e dimë ne se si ka ndodhur kjo, e dimë cila është vlera, e dimë sa

paguajnë tatim këta që shfrytëzojnë mjetet dhe punojnë këtu, mirëpo kjo prapë do të jetë temë e diskutimit kur të diskutojmë për raportin e shpenzimeve, ma merr mendja diku në fillim të prillit.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e ka një temë tjetër, ne mendojmë se ndërtimi i rrugëve është në rregull, të gjitha rrugë janë të rëndësishme, të gjitha autostrada janë të rëndësishme, prapë pa folur për vlerën e cila shpenzohet për këto rrugë. Ne mendojmë se edhe rruga për Shkup është e rëndësishme, mirëpo ne mendojmë se një rajon i tërë po vazhdon edhe sipas kornizës afatmesme të shpenzimeve dhe në shpërputhje me atë që tha ministri, po vazhdon të mbetet i diskriminuar në aspektin e infrastrukturës të re rrugore dhe ky është rajoni i Dukagjinit. Rruga e cila ka shkuar deri në Gjurgjicë, nuk vazhdohet. Ministri tha se vazhdohet, mirëpo në tabelat e buxhetit nuk parashihet asnjë cent për asnjë lopatë më tepër rrugë e cila do të qonte deri në Klinë edhe deri në Pejë edhe t' i lidhë më shumë se $\frac{1}{4}$ e Kosovës e cila sot është vetmja pjesë e Kosovës e cila i bën më shumë se 70 kilometra tani më në rrugë të dorës të tretë për t' u lidhur me kryeqytetin. Edhe një herë po ju them me zhvillimin e rrugëve në Kosovë, një pjesë e madhe, më shumë se $\frac{1}{4}$ e gjithë popullsisë të Kosovës, e cila jep shumë më tepër buxhetit të Kosovës sesa që ka banorë për shkak të zhvillimit ekonomik edhe të potencialit të vet, ka mbetur e palidhur me kryeqytetin me rrugë. Asnjë qytet në Kosovë nuk i bën 70 kilometra, përpos Gjakovës, Deçanit dhe deri diku pjesë të ndryshme të Pejës.

Po flasim për një rajon jashtëzakonisht të madh, po flasim për Klinë, Istog, Pejë, Gjakovë, Deçan, Junik për shkak se Rahoveci veç është lidhur tash, e cila pjesë ka mbetur e palidhur. Mendojmë se Qeveria e Kosovës ka mundësi bashkë me Komisionin për Buxhet dhe Financa, të gjejë mjete që rruga prej Gjurgjicës, të paktën deri në Klinë të vazhdohet, të vazhdohen më 2013 dhe më 2014 të përfundohet. Kjo nuk do të thotë assesi se rrugët tjera nuk janë të rëndësishme, kjo nuk do të thotë assesi se nuk është e rëndësishme që ndërtohet rruga për Ferizaj dhe për Shkup, absolutisht duhet të ndërtohet, mirëpo ky buxhet i Kosovës, edhe kësioj çfarë është, ka mundësi të gjejë mjete për ta vazhduar ndërtimin e 21 kilometrave deri, të paktën deri në Klinë dhe pastaj të vazhdojë edhe deri në Pejë.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e rezervon të drejtën të votojë kundër buxhetin në lexim të dytë. Arsyeja pse sot e votojmë në lexim të parë, është ekzakt për shkak se nëse këto ndryshime do të ndodhin, nëse nuk do të kemi zero shëndetësi, nëse nuk do të kemi zero rrugën prej Gjurgjicës për Pejë, nuk do ta votojmë këtë buxhet. Sikur ta votofshim kundër sot, me siguri se do të vazhdofshim për të ndërtuar kundër, do të thotë është e qartë. Aleanca kërkon që Qeveria e Kosovës, me Komisionin për Buxhet dhe Financa, t'i gjejë mjetet për ndërtimin e rrugës drejt Pejës, vazhdimin e ndërtimit, nëse kjo nuk ndodh, me siguri se në lexim të dytë do të jemi kundër këtij buxheti. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re, fjalën e ka kryetarja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuar kryetar!
Përsëritet për kryeministrin dhe Kabinetin qeveritar

Duke marrë parasysh se sot në këtë seancë plenare diskutohet Ligji apo Projektligji më i rëndësishëm i shtetit, atëherë unë do të jap mendimin e Koalicionit për Kosovë të Re.

Nëse shikojmë të dhënët dhe dëshmitë aktuale në Kosovë, në tërësi duhet të bëhet një menaxhim i kujdesshëm i parasë publike, taksave të qytetarëve për arsye të shumta si dhe kriza e vazhdueshme, e cila ka prekur tregjet financiare globale dhe kriza e cila është akoma në vendet e eurozonës. Projektbuxheti 2013 mund të themi se është projektbuxhet i mundësive, ku rritja ekonomike arrihet nga investimet kapitale dhe nga një pjesë e investimeve private. Ky dokument është projektuar bashkë në bashkëpunim me Fondin Monetar Ndërkombëtar duke e ruajtur qëndrueshmërinë makrofiskale për shtetin e Kosovës. Mbi këtë projektim parashihet niveli i përgjithshëm i grumbullimit të të hyrave buxhetore përgjatë vitit 2013 është paraparë të jetë 1,423 milionë.

Të hyrat nga tatimet e mbledhura në dogana, janë paraparë të jetë 915 milionë euro ku këtu edhe dje gjatë diskutimit me ministrin e Financave, duhet të ndërrohet strategjia për arsye se Kosova pritet të jetë shumë shpejt pjesë e BE-së. Ndërsa të hyrat nga ATK-ja në këtë vit parashihen të jenë 301 milionë euro. Këtu duhet të kemi strategji dhe staf profesional për mbledhjen e tatimeve në mënyrë lineare dhe të gjitha bizneset të jenë tatimpagues. Arkat fiskale, do të ishte një ide apo një sugjerim për Qeverinë t'ju jepen falas bizneseve, ndoshta është mundësia më mirë të gjitha bizneset të jenë në sistem dhe arka e shtetit të jetë më e madhe, deidentat 30 milionë, grandet 3 milionë. Në nivel komunal parashihen të arkëtohen 63 milionë euro. Prapë kemi subvencion për KEK-un, ndërmarrje publike e vdekur që jeton në bazë subvencioneve dhe shfrytëzon lukset e veta për stafin e vet.

Shpenzimet kapitale 620 milionë, pjesë e madhe e dedikuar në autostradën Morinë - Merdar dhe në ndërtimin e disa shkollave dhe disa rrugëve. Nëse e shohim në total këtë projektbuxhet, në vazhdimësi paraqet si pagesë e projekteve të Qeverisë – PKD, LDK. Mund të themi se deri në vitin 2014, me përjashtim të disa projekteve të reja që janë në Gjakovë, Deçan, Junik, Celinë, në këtë vit, atëherë mund të themi se tek në vitin 2014 do të ketë një planifikim të ri të projektbuxhetit. Në tërësi, ne nuk mund të themi se kemi rritje të dëshirueshme ekonomike për qytetarët në bazë të projektimit që kemi. Mund të themi se parashihet rritje 4,5%, mirëpo kërkesat janë edhe më të mëdha ndërsa Fondi Monetar parasheh një rritje ekonomike 3,6%. Mbetet për të punuar akoma si Qeveri dhe si deputet të këtij Kuvendi të Kosovës për një zhvillim ekonomik të shtetit.

Koalicioni për Kosovë të Re, e përkrah Projektbuxhetin 2013, sepse këto janë taksat e qytetarëve dhe të mirat nga këto taksa, duhet t'iu kthehen prapë qytetarëve dhe të mirat nga këto taksa, duhet t'iu kthehen prapë qytetarëve të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të SLS-së, a e kërkon fjalën dikush? E ka fjalën Jelena Bontiq.

JELENA BONTIĆ: Hvala predsedniče!
Uvaženi članovi Vlade,
Poštovane kolegice i kolege,

Samostalna liberalna stranka, detaljno je razmatrala predlog budžeta za 2013. godinu, i smatra da predlog budžeta daje mogućnost za razvoj da je realan i da je uravnotežen. Takođe, Međunarodni Monetarni Fond je predlog budžeta ocenio pozitivno i pohvalio makro-ekonomske i finansijske politike Kosova.

Najveći problem ovog budžeta je u tome što je on nedovoljan za sve potrebe koje se pred njega stavljaju i pored ogromnih napora za njegovo povećavanje na 1,58 milijardi eura. On proizilazi iz nivoa ekonomskog razvoja Kosova na kojem se ono danas nalazi. Činjenica de je najveći deo budžeta u iznosu od 40% kapitalna ulaganja, govori o razvojnom karakteru ovog budžeta i želja da se stvore osnovni preduslovi za ekonomski rast, a to je poboljšanje infrastrukture. Naravno da postoje i osnovane kritike na ovaj predlog budžeta. Svi ćemo se složiti da je uglavnom u poljoprivredu nedovoljno za njen ozbiljni razvoj, ali se ovde ne radi o ignorisanju te potrebe, već o činjenici da se radi o ograničenim sredstvima. Takođe, postojanje infrastrukture je neophodno za razvoj svih drugih privrednih grana pa je tako i osnov za razvoj poljoprivrede.

Ne trebam takođe zaboraviti ni činjenicu da su brojni infrastrukturnih objekti već započeti i da je u predlogu budžeta predviđeno logično i neophodno finansiranje njihovog nastavka izgradnje ili završetka. Mislim da je predlog budžeta napravljen korektno, da se iz njega mogu videti opredeljenja Vlade i da se prilično transparentno vidi trošenje novca. U predlogu budžeta za 2013. godinu, takođe se može videti i predstojeće reforme penzijskog sistema i budžetske implikacije koje ona sa sobom nosi.

Smatramo da ima prostora da se predlog budžeta dodatno poboljša i u tom smislu imamo nekoliko primedbi. Najpre, želim da isteknem loš trend, da se opštinama koje imaju visok stepen sopstvenih sredstava, umanjuju vladini grantovi. Na ovaj način, dobro vođenje opštini bivaju čak i kažnjene jer im se uskraćuje sredstva koje dobijaju od centralnih vlasti na uštrb sopstvenih prihoda. Ovo je posebno uočljivo kod pojedinih opština sa srpskom većinom kod kojih je trend sopstvenih prihoda i najveći.

Političko opredeljenje moje stranke je da se proces decentralizacije i razvoj lokalnih sredina, preduslov za razvoj demokratskog i naprednog kosovskog društva. U tom smislu, proces prenoše nadležnosti sa centralnih na opštinske nivoe, gledamo kao na nezavršen i prioritetan posao. Nezavršetak tog posla, vidi se i u ovom predlogu budžeta. Problem drastično otežava i činjenica da i ovaj predlog budžeta, obeležava problem kao i u prethodnom budžetu da u kapitalnim investicijama, kao ministarstvo, kao što su Ministarstvo zdravlja, infrastrukture ili Ministarstvo omladine i sporta, nema budžetskih linija za kapitalna ulaganja u mestima gde je naseljena srpska zajednica.

S druge strane, i pored preporuke Evropske komisije da se budžet Ministarstva za zajednice i povratak uveća, on je ostao na istom nivou a zbog povećanja ukupnog budžeta, u relativnom smislu čak i pao. Tako se šalje loš signal i srpskoj zajednici a preporuke Evropske komisije su ignorisane. Doneti zakoni o selu Velika Hoča i Istorijskom centru Prizrena nemaju budžetske implikacije na ovaj budžet, odnosno nemaju jasno definisanje budžetske linije. Iz predloga budžeta se ne vidi kolika sredstva su određena za ovu namenu.

Samostalna liberalna stranke svesna je činjenice da će podelom ograničenih sredstava iz budžeta koji usvajamo biti puno nezadovoljni. Jedini način da se ta nezadovoljstva kontrolišu leži u pravednosti i striktno poštovanje principa. Mi zato mislimo da je predlog koji je pred nama dobar i da ga treba usvojiti a primedbe koje postoje, razmotriti do drugog čitanja. Hvala!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, e do dikush fjalën? Fjalën e ka fjalën deputetja Duda Balje.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Poštovani predsedniče,
Zameniku premijera,
Ministri, i poštovane kolege.

Budžet koji stoji pred nama, je budžete realnosti i mogućnosti. Finansijski iznosi koji su stavljeni na raspolaganju deljeni su po sistemu prioriteta za narednu godinu u našoj državi. Danas nam se dešava prvo čitanje budžeta, što znači da imamo mogućnosti da utičemo na manjkavosti ovog dokumenta, tako ćemo mi preko parlamentarne grupe “6+”, dati doprinos kako za opšte interes tako i za interes infrastrukturnog razvoja mesta gde žive naše zajednice kao što je opština Prizren, Dragaš, Peć. Naravno i to da lokacija sredstva po opštinama bude pravednija, najveći primer Priština i Prizrena. Priština sa 63 miliona eura ima gotovo duplo veći budžet od Prizrena sa nešto većim budžetom od 33 miliona.

Razlika između ove dve opštine u broju stanovnika i broj drugih pokazatelja, nije toliko velika za tako veliku razliku u budžetu. To naravno direktno utiče na mogućnosti realizacije infrastrukturnih projekata u Bošnjачkoj zajednici. Radićemo na tome da se do drugog čitanja budžeta, izvedu konkretne korekcije ovog finansijskog dokumenta koji će dovesti do dovršetka započetih projekata kao što su put Prizren, Pousko Jablanica, asfaltiranja puta u selu Retime, izgradnja vodovodnog sistema u donjem Ljubinju, radovi u Ljubiždi i Mušnikovu, Rečanu, Nebregošti, Drajićima, Grnčaru i svim drugim selima koji nisu obuhvaćeni budžetom Opštine Prizren, od velikog su značaja za nas.

Takođe se nadamo da će Vlada ovim budžetom ispuniti obećanje dato posle prirodne katastrofe u selu Restelici, na sanaciji štete koja je nastala. Parlamentarna Grupa “6+” podržaće Nacrt budžeta i svoj doprinos daće kroz rad u funkcionalnoj komisiji.

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, kryetar!

Dëshiroj t’i falënderoj të gjithë diskutuesit e grupeve parlamentare dhe po lidhem te një moment. Unë jam i sigurt që të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës, dëgjojnë mirë edhe unë nuk kam dashur të bërtas të shkaktoj ndotje akustike, por më bëri përshtypje se Visarit i ka bërë përshtypje tonaliteti jem, ai me të vërtetë bërtiti më shumë, ndoshta ka hëngër bukë dhe i shkonte zëri, por për t’ ia qëlluar, nuk ia qëlloi hiq dhe nuk ia qëllon kurrë.

E para ai kur flet me shifra është mirë të jetë preciz, ne kuptojmë për ndonjë përqindje të vogël të mos ia qëlluj, por mos me ia qëlluar 10% është goxha shumë.

E dyta, nuk është mirë në asnjë dokument, as nuk shkruan, as nuk e ka parë as nuk ekziston që procesi i privatizimit të aksionit të operatorit “Vala”, është i ndërlidhur me fillimin e punimeve të autostradës Prishtinë – Shkup. Unë e kuptoj që njerëzit janë kundër ndërtimit të autostradave, kanë projekte tjera, kanë koncept tjetër të zhvillimit ekonomik, kanë prioritete tjera, por autostradat janë nevojë për Kosovën. Këtë e ka dëshmuar dhe po e dëshmon edhe autostrada e kombit ku e ka rritur shkëmbimin tregtar në mes të dy vendeve tona për më shumë se 140%. Është nevojë imanente me qëllim të zhvillimit ekonomik, me qëllim të përkrahjes së sektorit privat edhe autostrada tjetër Prishtinë - Shkup dhe rrugë tjera. Nuk është asfalt rritja e pagave, nuk është asfalt ndërtimi i shkollave, nuk është asfalt rritja e pensioneve, nuk është asfalt rritja e buxhetit për 21% për shëndetësinë.

U përmend këtu se nëse hyjmë në analiza të ndonjë organizate buxhetore, është fillim amatoresk, fillim amatoresk i atyre që kurrë nuk kanë punuar në financa publike dhe nuk i dinë financat publike. Te Ministria e Administratës Publike duhet ditur se është referoma e administratës publike, është një fond i ndarë për implementimin e këtyre reformave dhe ai fond si kontigjencë i ndarë për implementimin e këtyre reformave nuk pjesëtohet me shtatë veta.

Për çfarë rruge janë financat publike në Kosovë, unë besoj që me një fjali që po e lexoj në komunikatën e fundit të Fondit Monetar Ndërkombëtar, ku thotë se politikat makroekonomike dhe financiare janë gjerësisht në rrugën e duhur. Por çka i intereson këtu disave se çka thotë Fondi Monetar Ndërkombëtar, apo çka thotë raporti i Bankës Botërore. Atyre nuk u intereson çka thonë edhe institucionet tjera më të fuqishme dhe për çështje tjera, por është e drejtë e tyre.

U përmenden politikat fiskale. Në raportin e fundit të Bankës Botërore, Kosova sa i përket pagesës së taksave, rangohet e 44-ta. Ngarkesa e ekonomisë së Kosovës me tatime, është 27% e GDP-së, që është më e ulëta në rajon edhe më gjerë. Nuk rritet varfëria në Kosovë duke u rritur pagat, këtu me veti i kam shënimet kur në vitin 2007, masa e pagave ka qenë 209 milionë, ndërsa sivjet mbërrin në 410 milionë. Brenda katër vjetëve Kosova edhe të gjithë ata që realizojnë paga përmes Buxhetit të Kosovës, janë një ngritje prej 100%, të mos flas për investimet kapitale. Nga 155 milionë në vitin 2007, ne mbërrimë në 600 e sa milionë, llogariteni çfarë rritje në përqindje është kjo. Nuk falimentojnë bizneset me këtë buxhet. Të gjithë përfituesit, të gjithë ekzekutuesit e projekteve kanë mundësi që t'i marrin paratë e tyre në kohë për projektet, të cilat i përfundojnë. Kur flasim për buxhetin e shëndetësisë dhe të arsimit, duhet të flasim si sektorë, se buxheti i shëndetësisë dhe arsimit nuk është veç në Ministrinë e Shëndetësisë buxheti i shëndetësisë, por është edhe në shëndetësinë primare, e njëjtë është edhe për arsimin.

Deficiti buxhetor: Kosova viteve të fundit ka pasur deficit buxhetor të përgjithshëm rreth 1,8% dhe deficiti buxhetor në Kosovë dallon prej vendeve tjera, se është deficit më

shumë se 100% i mbuluar. Bartja prej vitit 2012 në vitin 2013 pritet të jetë mbi 200 milionë euro.

Nuk është projekt, ne nuk paguajmë para për “Bechtel&Enka”. Ne paguajmë para për ndërtimin e autostradës së kombit, ne paguajmë para për ndërtimin e projekteve. Unë i kuptoj që njerëzit kanë votuar, kanë qenë kundër rritjes së pagave, kundër autostradës, tash kundër autostradës tjetër, thonë “është buxhet i varfërisë”. Kjo nuk qëndron.

Politikat fiskale: Do t’i përmendi shkurt vetëm disa veprime të fundit që kanë të bëjnë me politikat fiskale që kanë ndodhur në vitet e fundit; ulja e normës së interesit, të cilën e aplikon administrata tatimore, ndryshimi i mënyrës së pagesës të akcizës, derisa në kalim është paguar 2-3 muaj më parë, tash paguhet në momentin kur mallrat vijnë në Kosovë; zvogëlimi i numrit të dokumenteve të nevojshme për import dhe eksport, nga 9 në 3; ndryshimi dhe plotësimi i Kodit të Doganës dhe akcizës; ulja e kundërvajtjeve doganore nga 5 000 në 500; lirimi nga TVSH-ja i të gjitha medieve të shkruara dhe elektronike; lirimi i bartësve për arsimin e lartë prej TVSH-së; lirimi i shërbimeve spitalore, aprovimi i Projektligjit në Qeveri për lirim nga dogana të të gjitha lëndëve të para dhe pajisjeve. Të gjitha këto janë në favor të zhvillimit ekonomik të vendit.

Unë, edhe një herë, duke i falënderuar deputetët për diskutime, besoj se kësaj radhe kam bërë titur pak më shumë, e nëse ka nevojë bërtas edhe më shumë, por nuk e shoh të arsyeshme se me çfarë tonaliteti flet njeriu. Kjo nuk besoj që çon fare peshë. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, ministër Mujota!

MINISTRI FEHMI MUJOTA: Faleminderit, i nderuari kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit të Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që shkurtimisht të përpiqem ta prezantoj buxhetin e paraparë për Ministrinë e Infrastrukturës për projektet që kanë përfunduar, për projektet që janë në realizim e sipër dhe për projektet që janë parashikuar për vitin 2013.

Buxheti i Ministrisë së Infrastrukturës përgjithësisht është 299 milionë e 487 mijë euro, dhe kur flas për këtë buxhet flas për buxhetin e investimeve kapitale, ndërsa buxheti i tërësishëm është 310 milionë euro, që nënkupton pagat dhe mëditjet, mallrat dhe shërbimet, mirëmbajtjen e rrugëve, shpenzimet komunale, subvencionet dhe transferet.

Të nderuar deputetë,

Buxheti për vitin 2013, në totalin e projekteve kapitale, pa përfshirjen e autostradës që po ndërtohet dhe të autostradës që planifikohet të fillojë, është 54 milionë e 521 mijë euro. Prej tyre, obligime të bartura për vitin 2013 janë 27 milionë e 450 mijë euro, projekte të reja do të jenë 25 milionë e 163 mijë euro dhe do të jetë paraparë edhe buxheti për autostradën Prishtinë-Shkup prej 29 milionë e 357 mijë euro.

Pra, për autostradat përgjithësisht janë paraparë 246 milionë e 557 mijë euro, ndërsa 52 milionë e 930 mijë euro janë pjesa tjetër për investimet kapitale për vitin 2013.

Dhe, unë, përgjithësisht, dua të ju njoftoj se investimet janë të orientuara aty ku ka nevojë për qytetarët e Republikës së Kosovës, me përfshirje të tërësishme të të gjithë territorit të Republikës së Kosovës dhe pa dallime etnike dhe dallime tjera.

Më lejoni të ju njoftoj se aktualisht investohet në 70 projekte të tjera, përveç autostradës, përveç Rrugës së Kombit, dhe për vitin 2013 janë 13 projekte të reja, që nënkupton se në vitin 2013 do të hyjmë në investime në 83 projekte anëmbanë Kosovës.

Kur bëhet fjalë për projektet e bashkëfinancimit, ju kisha lutur të gjithëve që ta keni vëmendjen, sepse në këto projekte janë të përfshira të gjitha komunat që ka pasur mundësi të përfshihen me buxhetin e vitit 2012, dhe do të ketë parashikim për vitin 2013, që besojmë se do të ketë një përfshirje të gjerë të të gjithëve.

Nuk qëndron fakti se ka investime vetëm në disa rajone dhe një rajon i tërë është lënë pas dore, siç e përmendi zoti Gjini, pak më herët. Dua ta bind edhe zotin Gjini, por edhe për publikun, se investimet që tani po përfundojnë në rrugën Prishtinë-Pejë, deri te lidhja në autostradë, është një fat i mirë që të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës do të mund ta shfrytëzojnë këtë rrugë, ndërsa investimet tjera në rajonin e Pejës, përkatësisht në rajonin të cilit iu referua zoti Gjini, mund të them se ka investime dhe ato mund t'i numëroj me emra dhe fakte.

Për vitin 2012, të nderuar deputetë, në rajonin e Prishtinës ka pasur 10 projekte që janë investuar nga Ministria e Infrastrukturës, për rajonin e Mitrovicës ka pasur 2 projekte, për rajonin e Pejës ka pasur 6 projekte, për rajonin e Gjilanit 4 projekte, për rajonin e Prizrenit 3 projekte dhe për rajonin e Ferizajt 2 projekte.

Ndërsa për buxhetin e vitit 2013, në investimet që janë paraparë nga projektet e reja, unë dua të jua përmend vetëm disa prej tyre: ndërtimi i rrugës transitore në Shtime; ndërtimi i rrugës Mushtishtë-Budakovë-Jezerc; ndërtimi i rrugës në hyrje të qytetit të Pejës nga Prishtina; ndërtimi i rrugës Pejë-Tërstenik; ndërtimi i rrugës Llukë e Epërme-Deçan; ndërtimi i rrugës Kodrali-Deçan, ndërtimi i rrugës Junik-Gjeravicë; ndërtimi i rrugës lagjja "Agim Ramadani" në Junik; ndërtimi i rrethit Qendra në Gjakovë dhe ndërtimi i rrugës Fortesë-Celinë.

Kur kësaj ai shtojmë projektet që i kanë përfshirë të gjitha rajonet e Kosovës dhe të gjitha nacionalitetet, atëherë më lejoni që unë të përmendi vetëm disa nga rrugët që janë aktualisht duke u ndërtuar: asfaltimi i rrugës Kosavë-Pllajnik në Dragash; rekonstruimi i rrugës Junik-Voksh; asfaltimi i rrugës Açarevë-Siqevë; asfaltimi i rrugës Lagjja e Re-Fustenik; asfaltimi i rrugës në fshatin Dugajevë; asfaltimi i rrugës në rrethinën e ulët të Rahovecit; asfaltimi i rrugës Mamushë-Tetinë; asfaltimi i rrugës Magjistrallja-Grejkovc; asfaltimi i rrugës "Brigada 123"-Suharekë; asfaltimi i rrugës Slivovë-Vërnjak; asfaltimi i rrugës "Zona Industriale" dhe asfaltimi i rrugës "Epopeja e Jezercit" në Ferizaj.

Këto janë disa prej projekteve, të cilat po zhvillohen aktualisht, dhe projektet të cilat janë paraparë për vitin 2013 dëshmojnë se investimet janë orientuar aty ku ka nevojë për qytetarët e vendit, aty ka prioritete dhe mbi të gjitha aty ku mundësojnë edhe kapacitetet buxhetore.

Dua të ju informoj dhe për faktin tjetër se investimet që po ndodhin në Kosovë në infrastrukturë janë jashtëzakonisht të dobishme dhe kanë sjellë një progres të madh, një reformim të madh në të gjitha pjesët e vendit dhe tani për tani në të gjitha diskutimet ndërkombëtare Kosova e zë një vend jo pak të rëndësishëm në përparimin që ka bërë në këtë drejtim. Ndërsa jemi shumë të vetëdijshëm se ka shumë nevojë për investime të reja dhe të gjitha projektet të cilat ju jeni përpjekur t'i prezantoni tani dhe vërejtjet që i keni dhënë për investime të shtuara, e dëshmojnë edhe një fakt, se me gjithë angazhimet se investimet kapitale janë orientuar plotësisht në rrugë, kërkesat janë akoma të larta, kërkesat janë shumë të mëdha. Madje, mund të them se gati me shumicën e deputetëve që jeni të pranishëm kam pasur rast të bisedoj për projekte të caktuar, në lokalitete të caktuara.

Unë besoj shumë se investimet që do të bëjnë kuvendet komunale nëpërmjet planifikimeve të tyre do të mund të arrijnë t'i mbulojnë tanimë lidhjet ndërmjet fshatrave dhe lidhjet ndërmjet lagjeve në fshatra, ndërsa investimet tona do të orientohen kryesisht në investime nacionale.

Unë dua të jua përmend edhe faktin tjetër që po të ishte mundësia për një buxhet shtesë, do të kërkoja sigurisht 10 deri 15 milionë buxhet për rehabilitimin e të gjitha rrugëve magjistrale në Kosovë, të cilat nuk janë në gjendje të kënaqshme.

Prandaj, duke e parë buxhetin aktual që e kemi para vetes për nevojat e qytetarëve, jemi të bindur se kemi bërë atë që ka qenë e mundur dhe ajo që është më e mira për këtë moment, duke marrë në konsideratë çdo diskutim, çdo vërejtje dhe çdo sugjerim për përmirësimin në kuptimin cilësor të buxhetit të parashikuar. Faleminderit!

KRYETARI: Replikë, Daut Haradinaj e ka fjalën.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetar!

Unë desha vetëm t'ia kujtoj ministrit që në planifikimin buxhetor për magjistralen Prishtinë-Pejë keni paraparë vetëm 6 milionë euro, e ato janë vetëm për mirëmbajtje. Ndërsa ju po na flitni këtu për disa rrugë të fshatrave, Kodrali dhe Llugë, të cilat nuk e kalojnë shumën 80 mijë euro, dhe kjo nuk është e drejtë. Në të njëjtën kohë, ju keni deklaruar publikisht se do të gjenden fonde tjera për rregullimin e rrugës magjistrale, ose e autostradës Prishtinë-Hani i Elezit, ndërsa në parashikimet buxhetore ju keni ndarë 29 milionë dhe ky është buxhet fillestar. Pse e tjetërsuat? A hoqët dorë prej magjistrates Prishtinë-Pejë, e cila e përfshin një regjion të caktuar dhe i lidh po ashtu Malin e Zi dhe Kosovën, apo këto janë politika qeveritare të reja? Nuk po hyjmë tash, për shembull, te zvogëlimi i buxhetit për Policinë, meqë nëse e shohim tabelën financiare dhe unë kisha pasur dëshirë vetëm të jua lexoj 2-3 gjëra shumë të vogla, ju i keni minus 4 milionë e 73

mijë e 416 euro në buxhetin për Policinë. Çka nënkupton kjo, a mos është siguria stabile dhe nuk kemi nevojë më të suportojmë në Polici?

Vetëm për operacionet speciale ju keni zvogëlim për 6 milionë e 9 mijë e 40 euro. Domethënë, në vend që të shtohet buxheti për Policinë për njësitë operative, ju ia hiqni buxhetin. Për operacionet dhe shërbimet administrative po ashtu e keni zvogëluar. Vetëm 264 mijë euro keni paraparë për operacione. Këto janë defekte serioze, të cilat ju ministër duheni t'i shihni me kujdes.

KRYETARI: Replikë, një minutë.

MINISTRI FEHMI MUJOTA: Faleminderit, kryetar!

I nderuari deputet Haradinaj,

Qeveria nuk i ka ndryshuar prioritetet. Zgjerimi dhe kompletimi i rrugës nga Prishtina në drejtim të Pejës deri tek kycja në autostradë jemi të bindur se do të finalizohet brenda këtij viti.

Ndërsa zgjerimi i rrugës më tutje në drejtim të Pejës, që është magjistrale, po ashtu kyçe, natyrisht se e kërkon një buxhet tjetër shtesë, e kërkon edhe një studim fizibiliteti të ri nga pika ku lidhet autostrada deri në Klinë dhe natyrisht që investimet në vitin 2013 do të jenë të orientuara në rrugën Prishtinë-Mitrovicë, që kapin shumë rreth 14 milionë e gjysmë, dhe besojmë shumë se t; gjithë jemi të pajtimit që të ketë një zgjerim të rrugës Prishtinë-Mitrovicë, duke mos i harruar prioritetet të tjera.

Ndërsa rruga Prishtinë-Ferizaj, nuk bëhet fjalë për magjistrallen ekzistuese prej 30 milionë euro, por për autostradën e re që mendojmë ta nisim. Ndërsa magjistrallja Prishtinë-Ferizaj këtë vit nuk e ka asnjë cent të parashikuar për investime.

KRYETARI: Visar Ymeri, replikë.

VISAR YMERY: Faleminderit, kryetar!

Për t'ia shpjeguar ministrit: Po, unë e pata tonin e lartë për shkak se besoj çka them. Unë thashë që ministri e pati tonin e ulët për shkak se nuk beson çfarë thotë. Pra, ky nuk na tregoi a beson apo vërtet ka qenë i lodhur.

Nuk e pata asnjë sferë të kristaltë përpara, e as ministri nuk e pati. Pra, nuk po tentojmë t'ia qëllojmë. Unë u bazova në shifrat që i ka dorëzuar ministri si tabela buxhetore.

Ndoshta këta janë munduar t'ia qëllojnë e s'kanë mundur. Nuk e di. Por, kryesorja, unë fola për këto, pra nuk mundohesha t'ia qëlluj, e as të parashikoj se çka do të sjellë e ardhmja.

Dua pasur parasysh një gjë, e mua po më duket që ministri paska dëgjuar me vëmendje, dhe ky fakt po më gëzon. Unë thashë që ky është buxhet i asfaltit dhe betonit, dhe ministri e dëshmoi duke thënë se nuk është veç asfalt, por ka edhe shkolla. Po, pra - beton! Këtë po e them.

Ndërkohë, për sa u përket investimeve në sferat tjera, u dëshmuar qartë që me gjithë rritjen ekonomike, pra rritjen e bruto-produktit vendor, investimet si përqindje në këta sektorë që i përmenda janë në rënie si përqindje e bruto-produktit vendor, kur ishte dashur të jenë në ngritje.

Pra, ministri po e përmend disa herë që ky na qenka shumë i aftë për financat publike, e kështu me radhë. Ndoshta edhe është ashtu, nuk e di. Ato dokumente që po i dorëzon dhe mënyra si po flet nuk e dëshmojnë një gjë të tillë, por ndoshta ky vërtet është shumë i aftë, se unë nuk e njoh personalisht që ta vlerësoj një gjë të tillë, por ne do të bazohemi në numra që i sjell kjo ministri.

E nëse shikohet buxheti me vëmendje, me një kalkulator shumë të thjeshtë, e shoh se çfarë gabimesh elementare ka, madje edhe llogaritje në aritmetikë ka bërë këtë radhë kjo ministri.

Për atë se a jemi kundër ndërtimit të autostradave apo jo, ne e kemi thënë disa herë mënyrën se si duhet të ndërtohen ato autostrada dhe cilat do të duhej të ishin fazat përgatitore të ndërtimit të autostradës. Po me të njëjtën gjuhë t'ia kthej ministrit, atëherë nëse ne jemi kundër ndërtimit të autostradave, kjo Qeveri është kundër investimeve në industri; kjo Qeveri është kundër investimeve në bujqësi; kjo Qeveri e la "Trepçën" pa asnjë fond; kjo Qeveri nuk investon në shëndetësi; nuk investon në arsim; kjo Qeveri nuk investon në politika të mirëfillta...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ministri, kundër-replikë një minutë.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit kryetar!

E thashë edhe po e ritheksoj: pagat edhe rritja e pagave nuk janë asfalt, pensionet edhe rritja e pensioneve nuk janë asfalt; rritja e buxhetit për shëndetësi për 21% nuk është asfalt; buxheti për bujqësi, duke përfshirë fondet prej buxhetit, kreditë dhe grandet që janë aprovuar në këtë Kuvend, vitin e ardhshëm e arrijnë diku mbi 30 milionë. Ka rritje edhe për sektorin e bujqësisë. Të gjithë ne pajtohemi që ky nuk është buxhet i nevojave, por është buxhet i mundësive. Ndërsa sa i përket përgatitjes së buxhetit, unë dëshiroj t'i falënderoj qindra njerëz, ndoshta edhe mijëra njerëz në Kosovë që janë pjesë e përgatitjes së tij. Ky buxhet nuk është i përgatitur veç prej ministrit të Financave. Unë sot po e prezantoj dhe ndihem mirë me draftin, i cili është sot duke u diskutuar. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën, para se të shkojmë në pauzë, e ka deputetja Hykmete Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Ky projektbuxhet, u tha edhe më herët, nuk dallon aspak nga buxheti i viteve 2011 dhe vitit 2012.

Buxheti i vitit 2013 i kësaj Qeverie rritet në terma të inflacionit, çka do të thotë se të hyrat rriten për 2,8%. Këtu dua ta korrigjoj kolegen time nga Komisioni i Partisë Demokratike, e cila tha se të hyrat rriten për 7%, e në fakt rriten 2,8%, rriten për 39 milionë, e kjo në raport me 1 miliard e 384 milionë na jep vetëm 2,8%. Ndërsa e kemi një inflacion të paraparë prej 3%, shpenzimet rriten pak më tepër, për 4%.

Qeveria me këtë buxhet ka treguar edhe një herë se nuk ka plan zhvillimor, nuk ka objektiva makro-ekonomike, nuk ka qëllim, nuk ka strategji për përmirësimin e jetës së qytetarëve të Kosovës, e ç'është më kryesorja nuk ka prioritet.

Buxhetit thjesht i mungojnë elementet zhvillimore, nuk mbështetet në kornizën afatmesme të shpenzimeve dhe nuk e merr parasysh planin e famshëm të Banjskos.

Prapë, edhe në këtë buxhet kemi pjesëmarrje shumë të madhe të investimeve vetëm në një rrugë. Buxheti bazohet në presupozimin e vetëm se prapë çdo gjë që do të konsumojmë do të importojmë, që do të thotë se Qeveria do t'i mbledhë mbi 60% të të hyrave nga importi.

Buxheti ka shumë probleme strukturore.

E para, deficitit buxhetor i paraparë është 3,1%, mbi nivelin e lejuar. Rreth $\frac{1}{4}$ e të hyrave të këtij buxheti janë të hyra të njëhershme, që e bëjnë buxhetin të jetë fiktiv. 915 milionë na vijnë nga Doganat, që do të thotë se vendi prapë do të vazhdojë të varet nga importi.

Investimet kapitale janë rritur për 1,1%, dhe 35%, nëse përfshijmë këtu edhe koston e shpronësimeve 40% do të thotë shkon për "Bechtel&Enka".

Edhe për vitin që vjen, prioritet kryesor i kësaj Qeverie është qëndrueshmëria fiskale e buxhetit, e që nuk është qëllim i keq, se në fakt vetë kjo Qeveri e ka sjellë shtetin në këtë formë, që gjithmonë të jetë buzë të falimentimit. Por, po i shpëton falimentimit falë rritjes së borxhit publik dhe falë rritjes së shitjes së aseteve publike.

Ky buxhet nuk reflekton ndonjë strategji se si do të ulët evazioni fiskal dhe si do të kalojmë nga mbledhja e të hyrave në kufij, në mbledhjen brenda vendit.

Ky buxhet në vete përmban shumë paradokse. Në faqen 2 të pjesës tekstuale thuhet se do të kemi rënie të eksportit të shërbimeve 16%. Po në këtë faqe thuhet se pritet të ketë rënie të investimeve të huaja. Në faqen 3 thuhet se parashihet që eksporti i mallrave të shënojë një rënie prej 20%. Në faqen 5 thuhet se inflacioni do të jetë 3%, dhe krejt në fund vijmë në përfundim se do të kemi një rritje prej 3,9%. Thua se gjithë këta indikatorë do të ndryshojnë vetëm me kalimin në vitin tjetër.

U tha edhe më herët se 60% e buxhetit shkon në infrastrukturë, e kur themi në infrastrukturë këtu e kemi fjalën për rrugë. Bile për një rrugë të vetme. Vetëm 4,6% në arsim, vetëm 2,7% në shëndetësi dhe vetëm 2,2% në zhvillim ekonomik. Që varfëria po thellohet, këtë e dëshmon 18% e shpenzimeve që shkojnë për mirëqenie sociale.

Përveç shpenzimeve në infrastrukturë, asistencë sociale e gllabëron pjesën më të madhe të buxhetit, gjë që tregon se ky buxhet është buxhet i menaxhimit të varfërisë.

Të nderuar deputetë,

Të hyrat buxhetore: Kur 60% e të hyrave buxhetore të një shteti mblidhen në kufij, kjo tregon që Administrata Tatimore e Kosovës ka kapacitete të kufizuara; kjo tregon që Qeveria e Kosovës nuk ka ndonjë strategji për luftimin e evazionit fiskal; kjo tregon që Qeveria e Kosovës nuk ka strategji se si të kalojë nga mbledhja e të hyrave në kufij në mbledhjen e të hyrave brenda vendit.

Nga 915 milionë, sa mblidhen në kufij, rreth 430 milionë mblidhen në emër të TVSH-së. A e dini çka do të thotë kjo? Kjo do të thotë se bizneset tona paguajnë 430 milionë në ditën kur e fillojnë aktivitetin e tyre biznesor. Ata i paguajnë shtetit në emër të TVSH-së në kufij 16% për importin e lëndës së parë, gjysmëprodukteve apo produkteve të gatshme. Kur kësaj i shtojmë edhe 14% interes nga bankat, se bizneset tona kryesisht operojnë me kredi të marra nga bankat komerciale, atëherë shtrohet pyetja: Çfarë marzhe të fitimit duhet të kenë bizneset në Kosovë që të mbijetojnë? Ky ambient i biznesit është i pamundshëm. Ky ambient i biznesit po bën që 40% e mallrave dhe aktiviteteve biznesore, të mos i deklarojnë fare bizneset tona, kështu që vlerësimet janë se evazoni fiskal në Kosovë është diku 400 milionë.

Dhe, Qeveria e Kosovës në këtë projektbuxhet nuk e ka shfaqur asnjë strategji se si ta luftojë evazionin fiskal. Po ta kishte një strategji të tillë, do të parashihej në rritjen e të hyrave. A e dini sa është diferenca e të hyrave prej vitit 2013 në vitin 2014? Është vetëm 3 milionë. Pavarësisht sa do të rritet buxheti, të hyrat prej vitit 2013 në vitin 2014 parashihen të jenë 3 milionë.

Deficiti tregtar për vitin 2011 ka qenë 2,2 milionë. Vlerësimet për këtë vit janë që deficiti do të thellohet tutje. Rritja e deficitit i vë në pikëpyetje të gjithë skenarët për rritje ekonomike të kësaj Qeverie.

Në fakt, ekonomia e Kosovës po shndërrohet në një ekonomi konsumuese, që varet komplet prej mallrave të importit, e që po i financon diaspora jonë.

Me këtë buxhet, bizneset nuk mund të presin asgjë konkrete sa u përket lehtësirave fiskale.

Ministri i përmendi të gjitha lehtësirat kozmetike që janë bërë, por ato në fakt nuk e kanë pasur ndonjë efekt.

Të nderuar deputetë,

Kur i shohim shpenzimet, rrjedh ajo çka shohim. Shpenzimet për paga na janë rritur për 25 milionë. Ministri e ka theksuar edhe më herët, edhe në komision, se këto 25 milionë nuk shkojnë në rritje të pagave. Shkojnë në rritjen e punësimit, në Administratën Publike.

Ne e kemi para vetes një reformë në Administratën Publike. Shtrohet pyetja: A reformohet Administrata Publike duke punësuar më tepër njerëz në të? Përgjigjja është jo. Ne e kemi një administratë shumë të madhe, e kemi një Qeveri të stërmadhe, për koston e të cilës po paguajnë qytetarët e Kosovës dhe po paguajnë bizneset e Kosovës.

Shpenzimet për mallra dhe shërbime janë rritur për 21 milionë. Kjo është e vërtetë. Por, këto nuk mjaftojnë për funksionalizimin e shpenzimeve kapitale, në fakt këto as që janë të ndara për shpenzimet kapitale dhe për mirëmbajtjen e tyre. Këto janë rritur vetëm për ta rritur luksin e Qeverisë.

Përderisa në këtë krizë ekonomike e gjithë bota është kthyer kah kursimi, Qeveria jonë është kthye kah konsumi.

Shpenzimet për subvencione dhe transfere rriten për 17 milionë. Më në fund, Qeveria vendosi t'i rrisë pensionet pas një viti prej kur u pati premtuar pensionistëve. Mirëpo, prapë një person që është në skemën në asistencë sociale do të mbijetojë dhe vetëm 1,6 euro: për arsim, për ushqim, për shëndetësi, për banim - për të gjitha.

Subvencionet për ndërmarrjet publike mbeten pothuaj në të njëjtin nivel. Prapë kemi 31 milionë, që shkojnë, jo për investime kapitale, shkojnë për ta menaxhuar joefikasitetin dhe paaftësinë e këtyre ndërmarrjeve.

Shpenzimet kapitale: I kemi këtu 40% që i merr "Bechtel&Enka". Do të thotë 217 milionë nuk mbeten në Kosovë, ato shkojnë për "Bechtel&Enka".

Janë 30 milionë, që Qeveria ka planifikuar t'i ndajë për autostradën Prishtinë-Shkup. Me këtë autostradë, PDK-ja e ka filluar fushatën elektorale. Do të thotë, kjo është Qeveri e autostradë pas autostrade, siç u tha edhe më herët.

Mirëpo, qytetarët e Pejës dhe ata të Mitrovicës po pyesin se çfarë po ndodh me rrugët rajonale? Prej vitit 2007 kanë filluar rrugët Pejë-Prishtinë dhe Pejë-Mitrovicë. Çfarë po ndodh me to? Planifikimet vitin e kaluar për rrugën autostradë për buxhetin e vitit 2013, për rrugën Pejë-Prishtinë, kanë qenë që të ndahen 18 milionë. Tash i kemi vetëm 6 milionë.

Ne kemi me dhjetëra shkolla që figurojnë në buxhet tani e 4 vjet. Vetëm kësaj Qeverie i ndodh që një shkollë t'i marrë 4 vjet për t'u ndërtuar. Ne kemi shkolla që janë të ndërtuara, e nuk ka nxënës për to; kemi shkolla të tjera që janë të ndërtuara, ka nxënës, mirëpo nuk ka personel dhe inventar për t'i funksionalizuar ato, sepse ndërtohen pa plan dhe pa strategji.

Te buxheti për bujqësi, u tha se pikërisht qasja e kësaj Qeverie me buxhet kaq simbolik që i jepet këtij sektori për 60% të popullsisë që jeton në zonat rurale, e tregon më së miri faktin pse Kosova ka deficit tregtar 2,2 miliardë euro. Do të thotë ne eksportojmë 300 milionë, kurse importojmë 2,5 miliardë.

Zhvillimi ekonomik: Për zhvillimin ekonomik në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë investimet kapitale kanë rënë nga 4,3 milionë në 2,5 milionë.

Dhe, prej këtyre investimeve i kemi vetëm 350 mijë investime të reja. Me këtë shumë të vogël të investimeve kapitale, Ministria është kujdesur që të ndajë 200 mijë euro për vetura dhe 400 mijë euro për renovimin e objektit të Ministrisë. Pa tjetër që ata duhet...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, edhe 2 minuta.

HYKMETE BAJRAMI: Qeveria e autostradave e ka anashkaluar komplet infrastrukturën hekurudhore.

Qeveria ka ndarë për ndërmarrjen publike “Treinkos” vetëm 0,16% të investimeve kapitale dhe për ndërmarrje publike “Infrakos” vetëm 0,3% të investimeve kapitale.

Ministri i Infrastrukturës e tha më herët se për ta vazhduar rrugën Pejë-Prishtinë duhet studim i fizibilitetit. Ne nuk kemi pasur studim fizibiliteti për autostradën Prishtinë-Shkup, e do të ishte mirë që ta sjellë atë, sepse tha se para se të ndajë buxhet duhet studim i fizibilitetit. E unë mendoj që fizibiliteti për rrugën Pejë-Prishtinë është i qartë. Vetëm le ta numërojë numrin e veturave dhe të udhëtarëve që e frekuentojnë atë rrugë, do ta shohë se cili është studimi i fizibilitetit dhe cila është arsyeshmëria ekonomike e kësaj rruge.

Investimet në furnizim me ujë: Rreth 25% e popullsisë së Kosovë janë jashtë rrjetit të furnizimit me ujë. A e dini sa ka ndarë Qeveria e Kosovës për këtë qëllim? Plot 2,5 milionë euro për ta zgjidhur këtë problem!

Mandej u tha se investimet në shëndetësi janë të vogla. Ne e kemi një qasje tjetër. Kësaj Qeverie sot nuk i kemi thënë që do ta votojmë buxhetin, e pastaj besoj që i merrni parasysh ndryshimet tona. Ne sot i themi “jo” Buxhetit të Kosovës, këtij projektbuxheti, e nëse i merrni parasysh vërejtjet tona, atëherë mund të vijë deri te një konsiderim i ndryshimit të votës.

Dhe, rekomandimet janë këto:

Të rishikohet shpërndarja e investimeve kapitale nëpër institucione dhe sektorë. Shpenzimet kapitale në arsim të rriten për 15%. Rritja e pagave të punëtorëve të arsimit nuk ka sjellë kurrfarë beneficioni.

Ministri i Arsimit tash e dy vjet me radhë detyrohet ta ulë kriterin për Maturën shtetërore. Ku është efekti i rritjes...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Ministër, 2 minuta.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, kryetar!

E falënderoj deputeten për diskutimin,

Po e pranoj: Qeveria është Qeveri e autostradave, është Qeveri e ndërtimit të shkollave, është Qeveri e rritjes së pagave, është Qeveri e rritjes së pensioneve, është Qeveri e rritjes së buxhetit për shëndetësi dhe implementimit të reformave në sektorin e shëndetësisë, është Qeveri e cila ka bërë investime dhe do të vazhdojë të bëjë në gjithë këta sektorë. Mirëpo, kur dëgjohet se rritja e pagave për arsimtarët nuk ka pasur kurrfarë efekti, është vështirë të komentohet kjo dhe janë gjëra që nuk shkojnë njëra me tjetrën. Dhe të thuhet se është mirë që është ruajtur qëndrueshmëria makro-fiskale, e në anën tjetër të thuhet se deficitit është i pakontrolluar, i pambuluar - këto janë gjëra që profesionalisht nuk shkojnë me njëra-tjetrën.

Dhe, po e përfundoj, sa i përket borxhit publik, Kosova e ka borxhin publik më të ulët në regjion dhe në Evropë, dhe është mirë që është kështu, dhe është mirë që Kosova edhe në të ardhmen të vazhdojë kujdesshëm sa i përket borxhit publik, sepse kriza në eurozonë në një mënyrë është edhe krizë e borxheve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Replikë, deputetja Hykmete Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, ministër!

Unë nuk pres që ju të pajtoheni me mua se përndryshe nesër nuk do të ishit ministër.

Sa i përket qëndrueshmërisë buxhetore, e thash shumë mirë - po e rritni borxhin publik dhe po i shitni asetet publike për të bërë qëndrueshmëri buxhetore.

Edhe është e vërtetë që Kosova e ka borxhin publik shumë të vogël, por shtrohet pyetja se për çka merrni ju borxhe publike? Për t'i mbuluar shpenzimet rrjedhëse. Kjo nuk ndodh në asnjë vend në botë.

Dhe, nuk jemi kundër që e keni ngritur pagat e arsimtarëve, por cili është kualiteti i arsimit në raport me vitin 2010? Pse jeni detyruar që t'i ulni kriteret e provimit të Maturës edhe në vitin 2011, edhe në vitin 2012? Mandej, jeni kujdesur që atyre me t'u shpallni afat shtesë nëpër fakultete, që t'i akomodoni. Ju lutem shumë, gjendja në arsim është alarmante. Nuk e di nëse e dini apo jo.

KRYETARI: Një minutë, ministër urdhëro!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Unë e mbroj buxhetin, sepse i besoj projektbuxhetit, ndërsa nëse jam ministër a nuk jam ministër, është punë shumë e vogël. Punë e madhe mos qofsha ministër! Mirëpo, unë e vlerësoj punën dhe kontributin e gjeneratave në arsim. E kuptoj që ka vend për përmirësim, por atë që është arritur deri tash e vlerësoj shumë, e nuk mund ta devalvosh punën e 26 mijë njerëzve që punojnë në sektorin e arsimit.

Borxhi publik nuk merret për financimin e shpenzimeve rrjedhëse. Buxheti i Kosovës funksionon në atë mënyrë që të hyrat grumbullohen në llogarinë e vetme në Thesar prej të gjitha burimeve, pavarësisht prej Doganave a prej borxhit publik, apo prej të hyrave të

njerëzve, vijmë në llogarinë e vetme të Thesarit dhe shpërndahen për financimin e të gjitha projekteve dhe të të gjitha kategorive të shpenzimeve që janë pjesë e tabelave të buxhetit.

KRYETARI: Faleminderit! Bëjmë pauzë deri në orën 14:30.

* * *

(Vazhdimi i mbledhjes plenare, pas pauzës)

KRYETARI: E vazhdojmë debatin. Fjalën e ka deputeti Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë do të ndalem pak te buxheti i Ministrisë të Punëve të Brendshme, përkatësisht i Policisë së Kosovës, ose te projektbuxheti, dhe po ashtu pa e përjashtuar edhe buxhetin që është paraparë për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, përkatësisht Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Shihet që buxheti total i Ministrisë së Punëve të Brendshme, krahasuar me vitin 2012, ka pasur një rritje prej 2,4 milionë euro.

Pra, në vitin 2012 kanë qenë 97,6 milionë euro, kurse në vitin 2013 e kalon shifrën 100 milionë euro.

Megjithatë, nëse e shohim buxhetin e Policisë së Kosovës, shihet një zvogëlim në këtë rast për 4,07 milionë euro.

Pra, në vitin 2012 kanë qenë 78,3 milionë, kurse në vitin 2013 janë 74,3 milionë, që i bie diku një diferencë mbi 4 milionë euro.

Pra, e dimë që buxheti i Policisë së Kosovës e luan një rol esencial në përmbushjen e detyrave të përgjithshme të saj, posaçërisht për luftimin e krimit të organizuar, programet për mbrojtjen e dëshmitarëve, hetimin e kriminelëve, hetimin e krimeve kibernetike, e të tjerë e tjera, për çka nevojiten mjete të konsiderueshme financiare.

Parandalimi dhe luftimi i krimit të organizuar është një prioritet që përsëritet në të gjitha dokumentet strategjike të Policisë së Kosovës, por edhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme, të hartuara e të miratuara deri më tani siç janë:

Plani i Zhvillimit Strategjik i Policisë së Kosovës për vitet 2011-2015, Strategjia dhe Plani i Veprimit për Policinë, e udhëhequr nga inteligjenca, Strategjia për Policinë e Komunitetit dhe strategjitë e tjera të ngjashme.

Nëse i shohim me kujdes këto prioritete dhe detyra me të cilat është ngarkuar Policia e Kosovës dhe e krahasojmë një buxhet të ofruar kësisoj, me të vërtetë është i pamundur plotësimi dhe realizimi i detyrave dhe obligimeve që asaj i parashtrohen.

Gjithashtu, në raportin e fizibilitetit të Komisionit Evropian, parandalimi dhe luftimi i krimit të organizuar është një ndër sfidat më të mëdha që i paraqiten Republikës së Kosovës.

Nëse pas gjithë këtyre që u thanë më lart, ende ne dëgjim zëra se në Kosovë ka vullnet politik për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, korrupsionit dhe krimeve në përgjithësi, atëherë kjo e demonstroi të kundërtën.

Ndarja e një buxheti të tillë për Policinë e Kosovës nuk reflekton vullnet politik, nuk reflekton vullnet për përmbushjen e detyrave që dalin në rrugën e integriteteve evropiane.

Vetëm dy shembuj, duke mos dashur të futemi në detaje të tjera, sepse ato janë edhe më të dhimbshme se këto, ndoshta edhe më drastike.

Shembulli i parë është buxheti për operacione speciale, siç e thanë parafolësit më herët, kolegë deputetë, i cili në vend që të rritej, nuk është zvogëluar, por është asgjësuar. Pra, është eliminuar fare, është suspenduar për shkak se nga 6,6 milionë, sa kanë qenë më herët, janë hequr 6,09 milionë deri më tani, dhe ka ngjatur vetëm 526 mijë euro në këtë buxhet.

Dhe, nën dy, nëse e shohim, në shtyllën e hetimeve që është bartëse thuhet kryesore e arritjeve të objektivave të cekura më lart, e shohim që ka një rënie të buxhetit për 1,28 milion euro, që i bie se kjo është në kundërshtim me atë çfarë u tha më lart, e sidomos në kundërshtim me Planin për Zhvillim Strategjik të Policisë së Kosovës për vitet 2011-2015. Pra, në vend që rriteshin e të fokusohen në rritjen e kapaciteteve, e sidomos në hetime, atëherë pikërisht në hetime bëhet, ta them kushtimisht, një lloj sabotimi në trajtimin e saj financiar. Dhe, po ashtu në operacione speciale pothuaj se është suspenduar fare buxheti për Policinë e Kosovës.

Nëse këto gjëra shikohen me kujdes, definitivisht shtrohet pyetja: Kujt po i pengon një zhvillim dhe një ngritje e kualitetit të hetimeve dhe operacioneve speciale në Policinë e Kosovës, sepse këtu lëndohet seriozisht kualiteti i operacioneve speciale, e sidomos i hetimeve në Policinë e Kosovës.

Kujt po i pengon zhvillimi dhe fuqizimi i kapaciteteve të Policisë së Kosovës, në përgjithësi? Një rritje prej 2,5 milionë, krahasuar me vitin paraprak, shihet vetëm në shtyllën e shërbimeve mbështetëse. Përbrenda kësaj shtylle ka disa linja buxhetore, siç janë ato për ngritjen dhe avancimin e teknologjisë informative dhe telekomunikimit, dhe ne duhet të insistojmë që Policia e Kosovës të ketë përkrahje edhe në këtë fushë, por kjo rritje në këtë shtyllë, në vend që të orientohej në pjesën më të madhe, te këto dy pika shohim prapë shpenzime që duhet të racionalizohen më shumë dhe të rishikohen dhe ato janë blerja e mobileve në zyrë, ndërtimet dhe renovimet e parkingjeve, ndërtimet dhe renovimet e stacioneve, ku përfshihen edhe telefonat mobilë të personelit të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Përfundimisht, mendoj se projektbuxheti për Policinë e Kosovës në këtë formë siç është i prezantuar duhet të jetë i papranueshëm.

Më lejoni të jua parashtroj në pika të shkurtra vetëm një renditje tabelare, në përputhje me atë që është paraparë.

Departamenti pra, apo shërbimet administrative, kanë pësuar rritje prej 468 mijë euro mirë, operacionet pra - njësia e operacioneve, Departamenti për Operacione, nuk ka pësuar as rritje, as zbritje. Operacionet speciale kanë pësuar suspendim, e quaj kështu, për shkak se nga 6,6 milionë në vitin paraprak, janë hequr 6,09 milionë, pra i bie suspendim i financimit të operacioneve speciale. Dhe, nga kjo pak a shumë mund të hetohet se cili do të jetë efekti në vitin vijues.

Dhe, në anën tjetër, po ashtu theksoj për hetimet, në vend që të rriteshin investimet, është bërë një zbritje prej 1,2 milion euro. Për Departamentin e Shërbimit të Mbështetjes është rritur ndoshta për shkak të asaj çfarë pamë ditëve të fundit dhe në lajmet e fundit, kanë nevojë më tepër shërbime të mbështetjes, por sidoqoftë për 2,5 milionë është rritur, e është zvogëluar një nga shtyllat më delikate të zhvillimit të Policisë, është zvogëluar buxheti për trajnimet, e ne e dimë se sa të nevojshme janë trajnimet për Policinë e Kosovës gjithmonë, e sidomos tani.

Për Policinë Kufitare është paraparë një rritje ta quaj modeste; për Drejtorinë për Mbrojtjen e Dëshmitarëve as rritje, as zbritje; për menaxhmentin as rritje, as zbritje; kurse totali i bie diku 4 milionë e 703 mijë euro që Policia e Kosovës do të ketë më pak në vitin vijues.

Në të njëjtën kohë, në të njëjtin projektbuxhet të Kosovës sa i përket Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës, respektivisht Forcës së Sigurisë së Kosovës, është paraparë buxheti prej 36 milionë eurove.

Nëse duhet t'i besojmë që është vullnet edhe i Qeverisë së Kosovës që Forca e Sigurisë së Kosovës t'i arrijë kapacitetet e plota profesionale, t'i arrijë synimet për t'u bërë ushtri e Kosovës, atëherë dijeni: me 36 milionë, Forca e Sigurisë së Kosovës nuk bëhet ushtri e Kosovës, aq më tepër që kjo shumë parashihet, jo të rritet në vitet e ardhshme, përkatësisht në vitet 2014 dhe 2015, për shkak se në ato vite, sipas këtij tabelari, parashihet që kjo shumë jo thjesht të rritet, por edhe të zbritet në një masë të konsiderueshme, që i bie sikur edhe të rritet plus-minus, aq sa është rritur dhe zvogëluar prej vitit 2012 deri në vitin 2014, atëherë kjo është një garanci, jo për ta bërë FSK-në ushtri, por një garanci për ta mirëmbajtur këtë gjendje, e cila nuk do të doja të besoja asnjëherë që është gjendje e kënaqshme e mirëmbajtjes, për shkak se ky buxhet për Forcën e Sigurisë së Kosovës është thjesht jo buxhet zhvillimor, por është thjesht madje as për mirëmbajtjen e statusit dhe të nivelit që e ka. Pra, është një buxhet thjesht i mbijetesës, buxhet i cili ndoshta nuk do ta garantojë as këtë mbijetesë, të cilën e pretendon Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës, respektivisht Qeveria e Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit! Time Kadriaj e ka fjalën, pastaj Ismet Beqiri.

TIME KADRIAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Buxheti i vitit 2013 është një buxhet i cili nuk jep rritje ekonomike ashtu siç kanë premtuar zyrtarët e institucioneve të Kosovës, nuk e adreson çështjen e papunësisë dhe të varfërisë në Kosovë, si dhe nuk ka ndikim të madh në situatën makro-ekonomike.

Rritja ekonomike, edhe pse ishte paraparë të jetë mbi 5%, tani deklarohet se do të jetë 3,5% deri në 3,9%, gjë që tregon se ky nivel i rritjes ekonomike nuk ka arritur ta përmirësojë nivelin e punësimit dhe ta zbusë nivelin e varfërisë në Kosovë.

Ne me të drejtë kemi pritur që Qeveria në draftbuxhetin e buxhetit të vitit 2013 t'i paraqesë disa politika më të qarta lidhur me rritjen, në mënyrë që ato ta kenë ndikimin e vet në këto shpërpjesëtime makro-ekonomike.

Punësimi, një prej problematikave në Kosovë nuk adresohet në projektbuxhet. Nuk ka një analizë të saktë lidhur me atë se sa kemi të punësuar, cila është norma e saktë e papunësisë dhe çfarë politikash kemi në drejtim të përmirësimit të kësaj situate.

Buxheti më i madh prapë është ndarë për infrastrukturën rrugore, e pjesa më e madhe e mjeteve destinohet për autostradë.

Në kornizën afatmesme, ministri ka thënë se do të fillojë ndërtimin e autostradës Prishtinë-Shkup, dhe se kjo do të financohet nga mjetet shtesë - burime alternative, e tash shuma për këtë autostradë është paraparë nga Buxheti i Kosovës.

Për magjistralen Prishtinë-Pejë tash nuk janë ndarë mjete dhe siç po shihet, punimet do të përfundojnë aty ku janë tash. Për këtë magjistrale janë ndarë mjete veç për rehabilitimin e rrugës. Meqenëse ky është veç projektbuxhet, kërkojmë që të shqyrtohet mundësia dhe të ndahet buxhet për ndërtimin e kësaj magjistraleje.

Buxheti i vitit 2013 nuk ka dallim thelbësor me atë të vitit 2012. Me investime kapitale nuk shihet se ka projekte të reja, veç kemi bartje të projekteve të pareaizuara nga viti 2012.

Njëqind herë gjatë këtij viti e kemi debatuar gjendjen e rëndë në shëndetësi, menaxhimin jo të mirë. Nuk ka transparencë as llogaridhënie. Qendrat spitalore përballen me mungesë të barërave dhe materiale tjera shpenzuese. Pacientët me muaj mbeten pa insulinë, e të mos flasim për citostatikë-barëra që kanë kosto, e që pacientët detyrohen t'i blejnë, me gjithë vështirësitë financiare.

Klinikat në sezonin dimëror nuk kanë ngrohje, ndërtohen objekte dhe ato objekte nuk janë funksionale, aparaturat nuk funksionojnë për shkak se mjekët nuk dinë t'i përdorin, angazhojnë ekspertë për trajnim të stafit për funksionalizim të radioterapisë, e prapë pacientët janë të detyruar të gjejnë zgjedhje në sektorin privat, apo në qendrat spitalore jashtë Kosovës.

Në shëndetësi një konkurs për zgjedhjen e drejtorëve është bërë maratonë, e cila ende po vazhdon. Dhe, a është ky buxhet për shëndetësi buxhet që do të ndikojë në zgjidhjen e të gjitha këtyre problemeve dhe vërtet Qeveria a e ka prioritet shëndetësinë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Ismet Beqiri e ka fjalën, edhe për diskutimin edhe atë që pate ta thuash.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryetar!

Jo, sinjerisht desha të them se me 7-8 vetë deputetë të pozitës, ne mund të shkojmë në shtëpi, e pak pa u krye mbledhja të vijmë në seancë, veç për votim. Nuk është korrekte të fillojë seanca 20 veta, aq më shumë të gjithë pothuajse të opozitës. Prandaj, po e shpreh shqetësimin, ne po flasim për buxhetin..

KRYETARI: Rregullorja e parasheh vetëm ata që janë të interesuar të vijnë të debatojnë, nuk është e obligueshme.

ISMET BEQIRI: Ok-ej, për interesimin po shihet, por nuk ma dhatë fjalën në fillim, se sigurisht po të kishim dalë jashtë sigurisht do të ishte ndërprerë seanca dhe do të kishin ardhur, por sidoqoftë s'ma dhatë fjalën. Faleminderit!

Sa i përket buxhetit, unë do të ndalem vetëm në dy segmente, të cilat tregojnë dallime që kanë të bëjnë me investimet në komuna, investimet kapitale.

Nga të gjitha analizat që janë bërë në fushën e arsimit dhe të infrastrukturës është vërejtur se ka dallime të mëdha ndërmjet komunave dhe në shpërndarjen e këtyre investimeve.

Kryesisht këto dallime janë bërë në baza politike dhe partiake, varësisht se cila parti politike qeveris në cilën komunë.

Këto po jua ilustroj me fakte konkrete. Gjatë periudhës 3-vjeçare, po e marrim 2010-2013, në komunat që udhëhiqen nga PDK-ja është investuar mesatarisht dy herë më shumë në arsim për kokë banori, se në komunat që udhëhiqen nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

Për shembull, në vitin 2012 është investuar 11 euro për kokë banori në komunat që udhëhiqen nga Partia Demokratike, ndërsa vetëm 6 euro për kokë banori në komunat që udhëhiqen nga LDK-ja, dhe 7 euro për kokë banori në komunat që udhëhiqen nga AAK-ja. Këto dallime kanë dalë në pah prejse kjo Qeveri është në pushtet.

Si rrjedhim, në disa komuna të vogla, që dominohen nga zonat rurale dhe që udhëhiqen nga Partia Demokratike e Kosovës, shumë shkolla të ndërtuara në 3 vjetët e fundit kanë mbetur të zbrazëta për mungesë të nxënësve të mjaftueshëm.

Në ndërkohë, po e marrim Prishtinën, kryeqytetin, me gjithë investimet e mëdha, ka shumë shkolla që kanë nga 50 nxënës nëpër klasë, pavarësisht investimeve nga Komuna.

Pse ndodh kjo? Këto dallime po u sqaroj, për arsyen e thjeshtë se Ministria e Arsimit me rastin e licencimit të shkollave nuk u lejon shkollave, përkatësisht Komunës që ta rrisë numrin e arsimtarëve dhe këta detyrohen t'i grumbullojnë nxënësit, ashtu siç i grumbullojnë me numër jashtëzakonisht të madh nëpër paralele.

Këto dallime bëhen edhe më të mëdha nëse analizohen këto investime nëpër komuna, veç e veç, duke shikuar për kokë banori.

Po e marrim edhe këtë draftbuxhet për vitin 2013. Këtë që e them, do ta them shumë qartë, por për të mos u keqkuptuar. Çdo pjesë e Kosovës ka nevojë për arsim, ka nevojë për infrastrukturë, e këtë nuk e mohojmë. Por, në një komunë, ku investohet 20 herë më shumë se në kryeqytet, siç është për shembull Skenderaj, ku numri i nxënësve dhe presioni për të regjistruar në shkolla nuk është i tillë çfarë është në Prishtinë, kjo flet vetë.

Brenda kësaj periudhe, po e zëmë, në këtë komunë, për kokë banori është investuar 230 euro në arsim, ndërsaq në komunën e Prishtinës, në kryeqytet, 12 euro. Dhe, unë po e them këtë vetëm në bazë të shifrave për kokë banori. Shikoni çfarë investimesh! E përmenda këtë komunë, pastaj në Shtime 85 euro për kokë banori, 97 euro në Malishevë, 64 euro në Kaçanik, po edhe Glogoci 19 euro. Glogoci vetëm 19, që nuk dallon shumë besoj prej Skenderajt, por edhe atje “faleminderit” i kanë nja 7 euro më shumë se komuna e Prishtinës.

Në Prishtinë janë ndërtuar shumë shkolla, por për arsyet që i thashë më sipër përsëri pengesë është fakti që Ministria e Arsimit, edhe pse arsimi primar është i garantuar në bazë të Ligjit mbi arsimin komunal, do të ishte dashur që komunat ta bëjnë, por kjo nuk ka mundësi të ndodhë, sepse nuk lejohet zgjerimi, përkatësisht marrja e më shumë njerëzve në punë, në mënyrë që të plotësohen nevojat për këta nxënës.

Nëse në një komunë ka nevojë të ndërtohet një shkollë, atëherë fondet duhet të barten në komunë dhe ajo të merret edhe me ndërtimin e saj, edhe me financimin e vetë shkollës, përkatësisht arsimtarëve të nevojshëm për punësim.

Nëse shikojmë te investimet në infrastrukturën rrugore ndërmjet komunave, dallimet janë edhe më të mëdha se sa ato që i thashë për arsimin.

Shikoni dallimet ndërmjet komunave që udhëhiqen nga LDK-ja dhe atyre që udhëhiqen nga PDK-ja. Janë aq të thella sa vërtet është e habitshme.

Në vitin 2010 janë investuar vetëm 12 euro për kokë banori në komunat që udhëhiqen nga Lidhja Demokratike e Kosovës, krahasuar me 36 euro në komunat që udhëhiqen nga Partia Demokratike e Kosovës.

E njëjtë gjë, i njëjti dallim i madh parashihet të jetë edhe në vitin 2013. Parashihen 17 euro për kokë banori, krahasuar me 6 euro PDK-LDK, meqenëse fatkeqësisht kështu po shikohet buxheti, që nuk është dashur të jetë ashtu. Por, kjo po vërehet në bazë të asaj që është paraparë në këtë projektbuxhet.

Dallimet janë shumë të mëdha. Kemi komunë ku për këto tre vjet janë investuar 531 euro për kokë banori në infrastrukturë, krahasuar me 14 euro në komunën e Prishtinës, për shembull.

U tha më herët nga një koleg këtu që Komuna e Prishtinës e ka buxhetin më të lartë, por kjo nuk varet nga ajo se po i jep Qeveria. Mos harroni, 21 milionë euro janë planifikuar në Komunën e Prishtinës. U përmend edhe Prizreni, u tha pse paska më pak kur dallon pak nga numri i banorëve, por mos harroni se 6 milionë euro i kanë paraparë për të hyra vetjake, ndërkaq Prishtina i ka 21 milionë euro. Prandaj, jo që ka pasur dëshirë në këtë rast Qeveria t'i japë më shumë, por fakti që Komuna inkason më shumë e rrit normalisht edhe buxhetin.

Ajo që do të dëshironim është që vërtet në këtë shpërndarje të këtyre mjeteve të mos ketë dallime të tilla. Mos harroni se te pjesa që është e rezervuar dhe pjesa ku mund të bëhen më së shumti spekulime ose manipulime në bartjen e parasë në nivelin qendror, është pjesa që ka të bëjë me bashkëfinancimin dhe bashkëfinancimi me "Ipën".

Po ashtu, shikojini grantet! Disa nga ministritë e ndryshme diku investojnë shumë. Keni komuna, po i përmendi të LDK-së, në të cilat nuk ndahet asnjë cent për investime. Përpos pjesës nga bashkëfinancimi, merreni shikojeni tabelarin, asnjë cent nuk ndahet. Unë po flas në bazë të asaj që e kemi shikuar. Do të dëshironim kjo të mos ndodhë, sepse buxheti nuk do të duhej të ishte buxhet i shpërndarë në baza partiake, por për të gjitha nevojat e të gjitha komunave dhe të qytetarëve tanë. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro ministër, veç shkurt!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, kryetar!

E përgëzoj dhe e falënderoj zotin Beqiri për diskutimin.

Mirëpo, buxheti nuk është i shpërndarë dhe nuk është i ndarë në bazë të asaj se kush i qeveris komunat. Edhe kur të flasim për vitin 2010, atëherë ka ekzistuar në Qeveri koalicioni PDK-LDK. Mirëpo, se nuk është duke u trajtuar keq Komuna e Prishtinës në raport me komunat tjera, më lejoni t'i them disa fakte:

Vetëm projekti i kogjenerimit, që është negociuar si projekt nga Ministria e Financës, është nënshkruar nga Ministria e Financave, është sjellë në Kuvend dhe është aprovuar, e ka vlerën rreth 24 milionë euro. 24 milionë euro përfitojnë qytetarët e Prishtinës. Unë nuk e kam shqetësim se këto fonde janë shumë, por kam shqetësim se Kosova ka mundësi të kufizuara dhe nuk ka mundësi t'i plotësojë të gjitha nevojat.

Përveç projektit të kogjenerimit, që është rreth 25 milionë euro, është Fabrika e Ujit, e cila e zgjidh problemin e furnizimit me ujë në Prishtinë dhe në regjion 32 milionë euro. Vetëm këto dy projekte bëjnë 57 milionë euro. E nëse i shtohet vetëm edhe një projekt, që është rreth-rrrotullimi te stacioni i autobusëve, që është në Prishtinë, në komunën e Prishtinës, me 13 milionë euro, bëjnë 70 milionë euro. E ne nuk kemi nxituar dhe nuk jemi duke nxituar, që nëse i marrim për bazë regjistrimet e fundit të popullsisë, Prishtina nuk del që ka qenë e diskriminuar me buxhet, por realisht del që ka qenë përfituese jashtë

asaj që i takon. Por, ne nuk do të nxitojmë as në të ardhmen. Do ta trajtojmë këtë çështje me shumë kujdes, sepse nuk dëshirojmë që qytetarët e Prishtinës t'i lëmë pa fonde të mjaftueshme. Dhe, të dhënat tregojnë se Komuna e Prishtinës nuk ka vuajtur për mungesë të mjeteve. Ka vuajtur për mungesë të kapaciteteve për ta ekzekutuar buxhetin, e nëse e shikojmë historikisht, del që Komuna e Prishtinës në vitin 2011 i ka pasur rreth 17 milionë euro, të cilat ka pasur mundësi t'i shfrytëzojë. Janë të hyra vetjake të Komunës, por realisht nuk i ka shfrytëzuar, prandaj janë bartur.

Ka projekte në gjithë territorin e Kosovës, edhe në komunën e Podujevës, edhe në komunat ku udhëheq LDK-ja, edhe AAK-ja, edhe PDK-ja, edhe të gjitha të tjerat. Krahassimi i investimeve për kokë të banori, nëse e marrim që autostrada kalon nëpër Suharekë, dhe e pjesëtojmë atë investim për kokë të banorëve të Suharekës, del që banorët e Suharekës kanë përfituar shumë, e të tjerët janë diskriminuar. Por, janë projekte të caktuara, për të cilat realisht ka nevojë të investohet. Është fatbardhësi që ka kaluar koha e rezervave dhe është investuar në Skenderaj. Është mirë që është investuar, por sigurisht se mbetet regjioni më i pazhvilluar dhe me nevojat më të mëdha në gjithë Republikën e Kosovës, ku ende pjesa më e madhe dërmuese e qytetarëve të kësaj komune nuk e kanë të siguruar as ujin e pijes. Faleminderit!

KRYETARI: Replikë, deputeti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryetar!

Së pari po i përmendi projektet, për dy të parat nuk janë paratë e Qeverisë. Dihet të kujt janë. Mos harroni, Fabrika e Ujit, këta qytetarë e dinë, nuk duhet t'u thuhet juve 'faleminderit'. Edhe për koogjenerim, edhe për Fabrikën e Ujit dihet prej nga janë ato para. Ne i kemi miratuar këtu dhe nuk ka kuptim të mos thuhet e vërteta. E para kjo.

E dyta, projekti rreth rrotullimit, zoti ministër, prej 13 milionësh është që sa kohë. Ne po flasim, e nuk përmenda unë 2008, unë thashë prej 2010 e këtej. Për 2010 e këndej fola, e jo prej 2008, se e di që kemi qenë në koalicion, por po i përmendi tash projektet 13 milionë euro, që është tash e 5 vjet dhe ende fatkeqësisht nuk është kryer si duhet. Por, është projekt që lidh. Nëse ju tash vazhdoni kështu t'i përmendni që prej Prishtinës po bëhet magjistranja për Mitrovicë dhe magjistranja për Pejë, këto nuk qëndrojnë kështu.

Këto dy projekte që i përmendët mos thoni, se këto nuk janë para. Dihet se ne këtu i kemi ratifikuar, sepse janë donacione dhe jua u dimë për nder.

Po ashtu, Komuna e Prishtinës, dhe nuk duhet bërë ashtu asnjë komunë, së pari ta bëjë asfaltin e pastaj ta shpallë tenderin, siç ka ndodhur në shumë komuna, për të cilat ka shumë dosje edhe shumë hetime, por që është punë e organeve të hetuesisë. Po të ndodhte kjo në Prishtinë, të njëjtën gjë duhet bërë. Keni ju me dhjetëra e dhjetëra raste që paratë shpenzohen, zoti ministër, jepen ato pa u kryer edhe punët, ose kryhen punët - shpallen tenderët. Këto i dini, por është për organet e hetuesisë, e nuk është për këtu. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Lumnije Morina e ka fjalën.

LUMNIJE MORINA: Faleminderit!

I nderuari kryetar i Kuvendit,

I nderuari kryeministër, ministra, të nderuar kolegë dhe kolege deputetë,

Projektligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës, i cili sot na është ofruar për shqyrtim shihet se është hartuar me profesionalizëm dhe me përkushtim, me një parashikim dhe planifikim realisht objektiv dhe progresiv.

Qeveria e Republikës së Kosovës me Projektbuxhetin e këtij viti tregon në mënyrë të qartë dhe të dukshme angazhimin dhe përkushtimin e saj për ndërtimin e një Kosove evropiane.

Tregon përkushtimin e saj për një qeverisje të mirë, efikase, për rritjen e investimeve kapitale, për rritjen e mirëqenies sociale, për atë që lejojnë mundësitë buxhetore për disa kategori të shoqërisë në gjendje të rëndë ekonomiko sociale, siç janë pensionistët.

Dhënia e premtimit nga Qeveria për rritje të pagave për punëtorët e arsimit, të shëndetësisë, të shërbyesve civilë, të kategorive të dala prej luftës e të tjera, si dhe dhënia e premtimit për ndërtimin e autostradës së kombit Vërmicë-Merdar, sot është një realitet. Ky realitet i mbajtjes së premtimeve vërehet edhe në Projektbuxhetin e vitit 2013.

Ndërtimi i autostradës Prishtinë-Ferizaj-Shkup nuk është më premtim. Tani më i kemi të planifikuara mjetet për ndërtimin e Rrugës VI, edhe pse disa ekspertë për çështje ekonomike realizimin e projektit të autostradës Prishtinë-Ferizaj-Shkup e kanë quajtur ëndërr të Ekzekutivit.

Punën e bërë me përkushtim dhe vendosmëri për menaxhimin e mirë të buxhetit të shtetit të Republikës së Kosovës e ka vlerësuar edhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, si dhe Banka Botërore, duke u dakorduar plotësisht me idenë e ndërtimit të autostradës Prishtinë-Ferizaj-Shkup.

Për realizimin e interesave të qytetarëve të komunave të Kosovës që nga 2007, Qeveria e Republikës së Kosovës është kujdesur që Buxheti i Republikës së Kosovës të ndahet dhe të shfrytëzohet për një administratë me shërbime efikase për krijimin e kushteve më të mira dhe hapësirë të mjaftueshme për nxënës e studentë, për përmirësim të sistemit të ujësjellësit e të kanalizimit, të rrugëve, për krijimin dhe ruajtjen e hapësirave të gjelbëruara e të tjera, investime të cilat më parë qytetari i Republikës së Kosovës nuk i kishte përjetuar.

Edhe me projektbuxhetin e vitit 2013 vazhdon përkushtimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës nëpërmjet investimeve në të gjitha fushat, atë që lejojnë mundësitë buxhetore që e vet ta trajtojë qytetarin në mënyrë të dinjitetshme.

Gjithashtu, është e vendosur dhe e përkushtuar për trajtim të dinjitetshëm të të gjitha komunave të Republikës së Kosovës. Komunave u mbetet të dinë të menaxhojnë me buxhetin, e të mos ndodhë që t'u mbetet pa u shpenzuar ai në fund të vitit.

Të nderuar deputetë të Republikës së Kosovës,
Vendimi ynë për miratimin e këtij Projektbuxheti do të jetë vendim realisht objektiv, progresiv dhe në përputhje me interesin e të gjithë qytetarëve të vendit dhe për të ardhmen më të mirë të tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka Albana Fetoshi.

ALBANA FETOSHI: Faleminderit, kryetar!
Fillimisht unë do të isha ndalur te të hyrat vetjake për disa komuna.

Nëse i shohim të hyrat vetjake të komunave, e shohim se komunat si Leposaviqi, Zubin-Potoku, Zveçani e Parteshi realizojnë një shumë të vogël të të hyrave vetjake.

Leposaviqi ka të hyra vetjake në shumën prej 15 milionë eurove, ndërsa të njëjtën shumë e realizon edhe komuna e Zubin-Potokut, ndërkaq komuna e Zveçanit realizon të hyra vetjake në shumën prej vetëm 10 milionë eurove. Kjo shumë kaq e vogël po vazhdon tani e sa vite, ndërkohë që Qeveria e Kosovës po shihet që nuk e ka bërë asnjë përpjekje për ta ndryshuar këtë gjendje.

Nëse e shikojmë Raportin e Auditorit të Përgjithshëm sa u përket këtyre komunave, për shembull, komuna e Leposaviqit nuk i ka dorëzuar fare pasqyrat vjetore financiare për vitin 2011.

E njëjta situatë është edhe me Zubin-Potokun. Pra, përveç që nuk realizojnë sa duhet të hyra vetjake, edhe për mjetet që ndan Qeveria mungon llogaridhënia dhe përgjegjësia. Shtrohet pyetja: A e ka humbur kontrollin Qeveria e Kosovës mbi këto komuna, përderisa ato po sillen sikur kjo Qeveri të mos ekzistonte? Apo edhe më keq? Mos ndoshta komunat e reja që kanë dalë nga procesi i decentralizimit janë krijuar me qëllim që të mos japin llogari në institucionet përkatëse qendrore.

Nëse e shikojmë neni 4 të buxhetit, i cili thotë se deri në themelimin e komunës së re ndarjet buxhetore mund të shpenzohen vetëm nga komunat ekzistuese, ndërkohë që në tabelën 4.1, me gjithë faktin që ka një kontradiktë logjike brenda këtij neni, është edhe antikushtetuese, sepse nuk ka mundësi të ndajë mjete buxhetore për një zyrë administrative, që po quhet Zyra Administrative për Komunën Veriore, sepse komuna e veriut realisht nuk ekziston.

Gjithashtu është shqetësuese edhe mënyra e planifikimit në nivelin komunal. Shumica e komunave, si Drenasi, Fushë-Kosova, Besiana, Kastrioti, Graçanica, Malisheva, Deçani, Klina, Zubin-Potoku e tjera nuk mund ta planifikojnë rrjedhën e të hyrave vetjake për vitet në vijim. Ato thjesht i përsëritin shumatat e planifikuara për vitin 2013 me një shtesë fikse për vitet në vazhdim.

Përderisa Komuna e Gjilanit nuk mund fare t'i listojë projektet kapitale, komunat tjera e bëjnë këtë në disa faqe me radhë. Ndërsa disa prej tyre nuk përtojnë ta radhitin si projekt kapital edhe blerjen e shportave të mbeturinave, të biçikletave për rojat e pyllit etj. Mbase

ata e dinë se si këto projekte do të kontribuojnë në rritjen e prodhimit të brendshme bruto të Kosovës.

Ndërkaq në kategorinë e pagave dhe të mëditjeve për të punësuarit në nivel lokal shihet një anomali, të cilën aparati qendror e ka krijuar falë tendencës për kontrollim intensiv të pushtetit lokal, duke vendosur limite të dyfishta që kufizojnë si mjetet buxhetore të parapara për paga dhe mëditje, ashtu edhe numrin maksimal të të punësuarve, por duke mos mbajtur një lidhje të logjikshme ndërmjet këtyre dy limiteve, është krijuar një diskrepancë e madhe në nivelin e pagave të zyrtarëve në rrafshin lokal.

Gjithashtu, përderisa kemi komuna si Mamusha, Juniku apo Hani i Elezit, të cilat nisur nga këto limite mund të paguajnë paga mesatare që kalojnë edhe 400 euro, disa komuna, si Shtërpca apo Skenderaj, mbeten në nivel edhe nën 360 euro pagë mujore. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Xhevdet Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, i nderuari zoti kryetar!

Ministra dhe kolegë deputetë,

Do të bëj përpjekje që ta rrumbullakoj për 3-4 minuta, të mos zgjatem dhe të mos përmendi përqindje. Nuk dua të përmendi sa duhet të ketë rritje, hyrje, se të gjitha i kemi në buxhet dhe jemi të furnizuar me mjaft shënime.

Por, do të kisha thënë se Kosova edhe në këtë vit po hyn pa një strategji të zhvillimit ekonomik. Kjo strategji, e cila do të kishte nevojë ta ketë Kosova për arsye se të planifikimit më të mirë dhe hartimit të projekteve më të mira për një zhvillim më të shpejtë ekonomik, për një rritje më të madhe ekonomike, për një zbutje më të madhe të papunësisë dhe të zvogëlimit të saj, për shërbime më të mira cilësore, edhe në shëndetësi, edhe në arsim, dhe kudo qoftë.

Unë do të ndalem edhe te disa projekte që mungojnë, sidomos në Ministrinë e Bujqësisë, ku besoj që duhet të investohet më shumë.

Arsyeja është se edhe pse ka rritje për çdo vit, edhe subvencione, unë besoj që është e vetmja fushë që mund të ketë rritje të numrit më të madh të papunëve dhe mund të zvogëlohet për çdo vit numri i papunëve në këtë sektor. Është një problem tjetër, për arsye se importojmë shumë produkte bujqësore, të cilat mund të prodhohen në vend, në Kosovë, dhe të bëhen hapje të reja të vendeve të punës, por edhe të zvogëlohen importet nga jashtë.

Diçka tjetër që do të theksoj është problemi te Ministria e Komuniteteve dhe e Kthimit dhe te disa dikastere që merren me mbrojtjen e komuniteteve që janë pranë kryeministrit, siç është Këshill Konsultativ pranë kryetares së Shtetit. Unë besoj që këto investime duhet të menaxhohen më mirë dhe të shfrytëzohen që nga këto të përfitojnë të gjitha komunitetet njëjtë, të mos përfitojë dikush më tepër e dikush më pak. Dhe shpresoj që komunitetet që kanë nevojë të përfitojnë më tepër, gjë që deri më tani nuk ka ndodhur,

prandaj shpresoj që me një menaxhim më të mirë mund të bëhet që komunitetet që kanë shfrytëzuar më pak dhe që kanë nevojë më shumë të menaxhohet ai buxhet edhe nga Ministria për Komunitete, edhe nga Zyra e Kryeministrit, meqë është një ndarje jo aq e madhe për komunitete, gjithashtu edhe nga Zyra e Presidentit.

Do të ndalem edhe te vazhdimi i rrugës për Pejë, që e përmendi shefi i Grupit të Aleancës. Unë besoj që është një lëshim teknik rehabilitimi i rrugës për Pejë. Ndoshta ministri do ta rregullojë - do të thotë se do të jetë zgjatje deri në Klinë, dhe të vazhdojë autostrada. Pasi e ka marrë epitelin “Qeveri e autostradave”, le të vazhdojë deri në Klinë.

E sa i përket stabilitetit të fizibilitetit, askush më mirë se sa unë dhe zoti Gjini nuk e di atë rrugë, sepse paradite dhe pasdite jemi në atë rrugë dhe garantojmë që plotësohen kushtet e fizibilitetit dhe se ka nevojë që të vazhdohet ajo autostradë, se jo vetëm që vijmë nga ai rajon, por është një rajon që do një zhvillim më të hovshëm dhe më të shpejtë ekonomik.

Në parim, Aleanca tha se Projektligjin do ta mbështetim me këto vërejtje që do t’i japim, kështu që unë do të përfundoj, duke shpresuar se ky projekt do të kalojë.

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Imri Ahmeti e ka fjalën. Nuk qenka, prandaj e humbi rendin. Deputetja Afërdita Berisha Shaqiri e ka fjalën.

AFËRDITA BERISHA-SHAQIRI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryetar,

I nderuar kryeministër,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Kosova është një importues i madh i produkteve bujqësore, edhe pse kemi tokë të mirë dhe klimë të favorshme për kultivimin e këtyre produkteve, edhe pse kemi njerëz që tërë jetën e tyre merren me bujqësi.

Buxheti i vitit 2013, i ndarë nga Qeveria e Kosovës për Ministrinë e Bujqësisë, është i pamjaftueshëm.

Investimet kapitale prej 8,8 milionë euro dhe subvencionet 9,4 milionë janë të pamjaftueshme. Edhe pse shihet një rritje në krahasim me vitin e kaluar, gjendja në këtë sektor përsëri nuk është e dëshiruar, sepse ky buxhet sërish mbetet më i ulëti në rajon. Maqedonia ndanë 150 milionë, kurse Serbia 3,7% të buxhetit.

Duke marrë parasysh se rreth 60% e popullsisë së Kosovës jeton në zonat rurale, buxheti për bujqësi do të duhej të ishte së paku 100 milionë euro e buxhetit të tërësishëm.

Nga 8,8 milionë euro projekte kapitale për vitin 2013, vetëm 335 mijë euro janë projekte të reja.

Kjo qasje e Qeverisë ndaj bujqësisë tregon më së miri pse Kosova ka deficit të lartë tregtar prej 2,2 miliardë euro.

Lidhja Demokratike e Kosovës vlerëson se bujqve kosovarë u nevojitet një përkrahje tjetër më e madhe, në mënyrë që ata të bëhen konkurrues me bujqit në rajon. Të ketë forma stimuluese për bizneset dhe bujqit që merren me këtë degë, në mënyrë që t'u zvogëlohen shpenzimet dhe t'u rritet aftësia e tyre konkurruese.

Sistemet e ujitjes kanë mbetur nga koha e socializmit, janë vjetruar dhe janë pa mirëmbajtje adekuate. Aty-këtu ka investime në ndonjë sistem, gjë që është e pamjaftueshme.

Pastaj, çmimi i pesticideve dhe i plehrave është tepër i lartë dhe këto impute bujqësore nga aspekti i pagesës së taksave dhe Doganës trajtohen njësoj si çdo mall tjetër.

Duhet menduar më shumë dhe më seriozisht për këtë sektor, sepse tokat dikur pjellore janë kthyer në zona banimi, ku në vend të zarzavateve, po mbijnë shtëpi dhe ndërtesa.

Për më tepër, për një gjendje jo të mirë për bujqit kosovarë po konfirmohet në tre sezonet e fundit, kur me mijëra tonë patate u hodhën në lumenj dhe me rrush që nuk vilet fare nga vreshtat.

Mendojmë se Qeveria në të ardhmen duhet seriozisht të mendojë për zhvillimin e këtij sektori, sepse është i vetmi sektor ku ne mund të jemi konkurrues. Është sektor, i cili mund të gjenerojë vende të reja pune dhe ta zvogëlojë deficitin tregtar.

40% e shpenzimeve buxhetore që shkojnë për investime kapitale i dedikohen kryesisht projektit të autostradës.

Ky projektbuxhet, me pjesëmarrje të madhe të investimeve vetëm në një rrugë, bazohet në presupozimin se qytetarët e Kosovës do të vazhdojnë të konsumojnë mallra nga importi.

Këto fakte tregojnë se kjo Qeveri nuk është aspak optimiste se politikat e saj do ta nxitin sadopak prodhimin vendor.

Ekonomia e Kosovës po shndërrohet në një ekonomi konsumuese, e varur nga importet.

Në përgjithësi, Kosova ka bërë përparim të kufizuar në fushën e bujqësisë. Prandaj, meqenëse mendojmë se është një sektor i cili gjeneron vende të reja të punës, duhet të jetë një prioritet dhe mjetet të cilat i ndahen këtij sektori, të jenë, nëse jo sa rajoni, bile t'i afrohen atij. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit i nderuar kryetar!

I nderuar kryeministër,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Një miliard e 586 milionë është Buxheti i vitit 2013 i Republikës së Kosovës, i harmonizuar në tërësi me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Aprovimi i këtij buxheti do të bënte të mundur vazhdimin e shumë projekteve me rëndësi të veçantë për ekonominë e vendit tonë.

Në vitin 2007, atëherë kur PDK-ja ishte në opozitë, buxheti ishte 776 milionë. Prej se Partia Demokratike e Kosovës është në pozitë, prej vitit 2008 e deri më sot, buxheti është rritur dhe është dyfishuar.

Të nderuar kolegë deputetë,
Kur e kemi shqyrtuar buxhetin e viteve paraprake, 2011 dhe 2012, disa kolegë këtu dhe disa ekspertë, me shumë ‘eksitim’ proklamoni se do të bankrotojmë. Bile e ftonin popullin që të blejnë gjëra elementare ushqimore se shteti do të bankrotojë, se Kosova nuk ka kapacitete për të ndërtuar autostrada, rrugë të reja, shkolla të reja dhe njëkohësisht edhe t’i rrisë pagat për mësimmshënësit, për familjet e dëshmorëve, për invalidët e luftës, për Policinë, për zjarrfikësit, për FSK-në, për shërbyesit civilë dhe të tjerët.

Sot të gjithë pagat po i marrin me rritje, autostradën do ta përurojmë brenda dy javësh dhe shumë projekte të tjera u përfunduan, e shumë të tjera janë në zhvillim e sipër dhe lëre që nuk bankrotuam, por e dyfishuam buxhetin e Shtetit.

Në vitin 2013, dhe në vitet në vijim, ekonomia e Kosovës do të vazhdojë me rritjen e saj pozitive. Pritet që në vitin 2013, norma e rritjes ekonomike të jetë ndër më të lartat në regjion, rreth 4%.

Sigurisht se të gjithë do të dëshironim më shumë, por edhe kjo është mirë për kohën nëpër të cilën po kalon ekonomia botërore. Ata të cilët dështuan në programimet e tyre se Kosova do të bankrotojë, tani e kanë gjetur një pretekst tjetër për ta kundërshtuar buxhetin e vitit 2013. Duke mos qenë fare parimorë dhe duke dëshmuar një mentalitet të prapambetur e izolues, ata u ankuan se investimet po shkojnë në Skenderaj, se gjoja shpërndarja e buxhetit nuk është e drejtë, kurse unë ju them se buxheti i shtetit tonë asnjëherë nuk ka qenë i shpërndarë më mirë, asnjëherë nuk ka qenë më zhvillimor dhe më gjithëpërfshirës.

Për ta argumentuar këtë po e lexoj vetëm një pjesë të projekteve në arsim nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

“Parashihet ndërtimi i shkollave të mesme në Podujevë, në Suharekë, Rahovec, Pejë, Lipjan, Vushtrri, Prizren, Suharekë, Mitrovicë, Gjakovë, Viti, Dragash, Prishtinë, Fushë-Kosovë, Istog, Randobravë, Kaçanik, Gjilan, Shtime, Mitrovicë, Deçan, Rahovec, Lipjan, Mitrovicë, Prishtinë, Prishtinë”. Kjo është shpërndarë në mënyrë vërtet gjithëpërfshirëse dhe në gjithë Kosovën.

Të kthehemi pak në retrospektivë. Si e shpërndanë buxheti këta që sot po ankohen? Sa kilometra autostradë ndërtuan? Asnjë. Sa kilometra rrugë ndërtuan nga Prishtina në drejtim të Ferizajt, apo në drejtim të Mitrovicës, apo të Pejës? Asnjë. Sa janë sot?

Deri në vitin 2007, në kuadër të 7 projekteve të buxheteve, të cilat kaluan, e ndërtuan një rrugë të dobët në fshatin Rezallë, e as që u shqetësuan se fëmijët në komunën e Skenderajt po mërdhijnë në shkollat kontejnerë, edhe pse e dinin se në komunën e Skenderajt u dogjën 23 shkolla, kurse të tjerat u shkatërruan dhe u demoluan dhe u përdorën si kazerma për ushtrinë dhe policinë serbe. Këta lejuan që deri në vitin 2007, 8 nga këto shkolla të punojnë në kontejnerë.

Me këtë Projektbuxhet parashihet ndërtimi i gjimnazit “Hamëz Jashari”, ku në të cilin deri më tani tri paralele mbajnë mësim në podrum. Gjithashtu, kërkoj që në këtë Projektbuxhet të përfshihen investimet edhe në shkollat e fshatit Qirez, fshatrat Ticë e Makermal. Në shkollën e fshatit Ticë shpesh dalin edhe gjarpinjtë të cilët e rrezikojnë jetën e nxënësve, zoti Ismet, dhe e pengojnë punën edukativo-arsimore, duke rrezikuar edhe jetën e tyre, ndërsa po ankoheni se po investohet në arsim, ose në infrastrukturë. Nuk ka shkolla në Kosovë të zbrazëta e pa nxënës, por ka shkolla të cilat punojnë me dy e tri ndërrime, në kushte shumë të vështira.

Shqetësimet për ndarjen e buxhetit në baza politike nuk qëndrojnë. Me gjithë investimet e deritashme, të cilat i ka bërë Qeveria e Kosovës, dhe e cila ka bërë shumë në përmirësimin e infrastrukturës, kërkoj që të vazhdohet me projekte vëllimore në infrastrukturën arsimore. Gjithsesi, shqetësimet për ndarje të buxhetit në baza politike nuk qëndrojnë, sepse faktet flasin ndryshe. T’i krahasojmë komunat ku Partia Demokratike e ka pushtetin dhe komunat ku Partia Demokratike nuk ka e ka pushtetin. Në Skenderaj janë paraparë 2 milionë e 654 mijë euro, ndërsa në komunën e Podujevës 5 milionë e 742 mijë euro; në Drenas 2 milionë e 424 mijë euro, në Suharekë 4 milionë e 660 mijë euro; në Prizren nga investimet kapitale në komuna janë paraparë 14 milionë, ndërsa në Prishtinë 31 milionë, në Mitrovicë 3 milionë e 743 mijë euro, në Gjakovë 5 milionë e 911 mijë euro; në Kaçanik 1 milion e 93 mijë euro, ndërsa në Fushë-Kosovë 2 milionë e 343 mijë euro.

Në asnjë rrethanë nuk kanë shprehur gatishmëri për krahasime ndërmjet qyteteve të Kosovës apo lokaliteteve, sepse të gjithë janë qytetarë të Kosovës dhe kanë të drejtë t’i gëzojnë frytet e lirisë dhe të buxhetit të shtetit të tyre. Të gjithë ata që sot janë duke u ankuar në shpërndarjen e buxhetit janë të njëjtit që kur kanë qenë në pushtet kanë bërë diskriminim në baza regjionale dhe politike.

Kjo rritje e buxhetit dëshmon për një ekonomi stabile dhe menaxhim të mirë të Qeverisë me paratë publike, duke e ditur se afro 60% e buxhetit është orientuar në investimet kapitale. Është mënyra më e mirë që qytetarit t’i kthehen taksat nëpërmjet investimeve kapitale. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuari kryetar i Kuvendit të Kosovës!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Mendoj se projekti i buxhetit për vitin e ardhshëm arrin ta ruajë stabilitetin fiskal dhe t'i riparojmë marrëdhëniet me Fondin Monetar Ndërkombëtar, gjë që pa dyshim është një arritje. Mirëpo, në prapavijë të këtij buxheti ka probleme serioze në sfondin makroekonomik, ka probleme serioze lidhur me financimin dhe menaxhimin e deficitit buxhetor, nuk shihen politika të qëndrueshme afatmesme të prioriteteve sektoriale dhe të prioriteteve lidhur me politikat e Qeverisë, marrja e vendimeve për investimet kapitale të rëndësishme mbetet e improvizuar.

Analiza makroekonomike, që e shoqëron projektin e buxhetit për vitin 2013, e cila do të duhej të ishte një bazë e formësimit të politikave buxhetore, paraqet në deskricion të strukturuar jo mirë për një model që qëndrueshëm makro-ekonomik dhe fiskal dhe me keqardhje mund të them se këtu e kemi një analizë më të dobët sesa në vitet e kaluara. E kemi pritur një avancim të cilësisë. Në këtë drejtim, mendoj se rritja ekonomike është modeste për nevojat e Kosovës dhe duhet të analizohet seriozisht. Ne nuk e kemi një analizë serioze, se pse ne nuk e arrijmë rritjen ekonomike. Nuk mjafton arsyetimi me krizën e jashtme, sepse ka vende të cilat janë edhe më të ekspozuara në marrëdhëniet ekonomike dhe financiare me botën e jashtme dhe arrijnë një rritje shumë më të mirë ekonomike. Prandaj, ky argument nuk është tërësisht i qëndrueshëm, ndonëse nuk mund të mohohet efekti. Prandaj, rritja ekonomike rreth 3,9%, pra më pak se 5% e planifikuar, shumë më pak se vizioni 8% i bankës, ka mbetur pa përgjigje dhe pa analizën e shkaqeve.

Analiza cilësore e shkaqeve lidhur me pengesat e një rritjeje më të madhe ekonomike në Kosovë e përbën hapin e parë me të cilin nëpërmjet politikave buxhetore ne duhet deri diku t'i korrigjojmë defektet e asaj rritjeje. Ne e dimë se pa një rritje ekonomike 7 deri në 8%, nuk mund të riparohet konfiguracioni tejet problematik i Kosovës.

Në këtë drejtim, mendoj se problemi të rritja ekonomike pse deficiti tregtar është thelluar. Ne kemi rënie të eksportit 20%, planifikojmë rritjen e tij për 18%, domethënë eksporti i Kosovës në vitin 2013 nuk do të jetë as sa eksporti në vitin 2011. Kështu që problemi tjetër ka të bëjë me investimet e sektorit privat, që stagnojnë, investimet e jashtme po bien. Prandaj, kjo është dashur të analizohet. Pse ne e kemi një nivel kaq të vogël të investimeve në sektorin privat? Sado që ne kemi dëgjuar se e kemi përmirësuar mjedisin për biznes me ata indikatorë që duan biznes, por kjo si duket është vetëm gjë kozmetike, sepse ky përmirësim i mjedisit biznesor nuk ka sjellë investime të sektorit privat dhe ka ndikuar në një rritje më të vogël ekonomike.

Në këtë drejtim, analiza makroekonomike është jo e qëndrueshme. Platforma makroekonomike e Kosovës qëndron në tri shtylla, në vend se në katra. Çdo analizë makroekonomike, që nuk e ka të studiuar mirë rritjen ekonomike, që nuk e ka të studiuar mirë inflacionin, që nuk e ka të studiuar të studiuar mirë bilancin e pagesave me botën e jashtme dhe punësimin, ajo nuk është analizë konsistente makroekonomike. Prandaj, ne jemi në tri shtylla, e platforma në tri shtylla është e luhatshme. Ne duhet ta kemi shtyllën e katërt, punësimi mungon. Nuk kemi tregues për punësimin në tërë analizën

makroekonomike. Prandaj, unë nuk kisha dashur që me të vërtetë një dokument i tillë të vijë në Kuvend pa një analizë të punësimit, sepse e gjithë ajo që bëjmë ne këtu është që t'i rritim mundësitë për punësim dhe ta përmirësojmë jetën e qytetarëve.

Rritja e shpenzimeve të buxhetit e ka shënuar një progres të rëndësishëm, është e shpejtë dhe tash kemi arritur në nivel kur kemi arritur që ta kemi një buxhet, mund të them të mirë, por ky buxhet që e përbën gati 30% të GDP-së, kërkon qeverisje shumë cilësore makroekonomike, kërkon një aftësi të institucioneve dhe agjencive buxhetore, që këto mjete t'i shndërrojnë në projekte dhe në aktivitete buxhetore, të cilat e përmirësojnë jetën e qytetarëve. Kapacitetet absorbuese, qeverisjet makroekonomike, ende në shumë pika, në shumë ministri dhe në shumë agjenci buxhetore nuk janë të mira, sepse gjithë kjo rritje e konsumit buxhetor nuk po shprehet në ngritjen e cilësisë së qytetarëve, gjë që flet edhe problemi se perceptimet mbi cilësinë apo kënaqshmërinë e opinionit me mënyrën e qeverisjes po shkojnë duke rënë, kanë ardhur në pikën kritike. Përcillni hulumtimet e NDP-së, dhe do ta shihni aty. Edhe po t'i pyetni bizneset, meqë unë kam biseduar ndoshta me 30 biznese në kohën e fundit. Ata janë në gjendje shumë të rëndë, në gjendje dëshpëruese. Unë u sugjeroj ministrave që shkojnë dhe të bisedojnë me bizneset, në mënyrë të sqartë dhe të shohin se çfarë disponimi është në bizneset në Kosovë. Ndonëse është për t'u pritur, siç tha edhe ministri, që edhe këtë vit do të ruhet stabiliteti makrofiskal, e kjo është ajo për të cilën kujdeset edhe ministri, dhe unë e përgëzoj që po e ruan stabilitetin fiskal, por ruajtja e stabilitetit fiskal për një kohë të gjatë, pa stabilitetin makroekonomik nuk është e mundur dhe është vetëm çështje kohe kur na vijnë problemet.

Deficiti i përgjithshëm i buxhetit ka shënuar rritje prej 78 milionë euro, në viti 2011, në 180 milionë, në vitin 2013. Ky deficit do të mbulohet me financimin e jashtëm, shitjen e letrave me vlerë dhe të ardhurat nga privatizimi. Kostoja e financimit të këtij deficiti, e dakorduar me Fondin Monetar Ndërkombëtar, është tejet e lartë dhe destimuluese për rritjen ekonomike, e këtu është edhe një nga përgjigjet pse nuk kemi rritje më të madhe ekonomike. Për arsye se ne po tërheqim 426 milionë të bilancit bankar, merrni pastaj edhe mjetet e privatizimit, merrni edhe fondin e pensioneve, e të gjitha nuk plasohen për t'u investuar në Kosovë. Kjo ndikon që 25 deri 30% të GDP-së ne i kemi tërhequr nga qarkullimi. Do të ishte fenomen i paparë ekonomik, sikur ne të kishim rritje më të madhe ekonomike, kur i merr paratë prej bizneseve, prej qytetarëve, i tërheq dhe natyrisht kjo ndikon në mënyrë destimulative në rritje ekonomike. Kjo është një abece e makroekonomisë. Prandaj, ne e bëjmë me dije tash e katër vjet se këtu gjendet zgjidhja. Nuk mund ne t'i bëjmë turshi mjetet financiare të Kosovës, e të themi se kemi rritje ekonomike dhe do ta zgjidhim çështjen e punësimit.

Më vjen keq që duhet ta përsëris gati në çdo diskutim këtë. Prezantimi i prioriteteve sipas sektorëve dhe ministrive, është po ashtu shumë i mangët. Nuk ka një pasqyrë që mund të ndihmojë që të shihen këto prioritete. Korniza afatmesme e shpenzimeve sivjet nuk është duke diskutuar në Kuvend dhe si duket rëndësia e këtij dokumenti po vjen duke u devaluuar. Në tekstin sqarues e kemi vetëm një mënyrë përshkruese. Ceken disa nga projektet kryesore, por jo edhe efektet e tyre, jo edhe arsyeja e tyre. Pse bash ato projekte?

Sot para jush po e cek vetëm problemin e financimit të kërkimeve shkencore. Ne e kemi një ligj relativisht të mirë të arsimit të lartë, kemi ligj për kërkime shkencore. Në krejt buxhetin jam munduar ta gjej atë që e obligon ligji, që të krijohet një fond modest për t'i mbështetur projektet kërkimore të institucioneve publike dhe të institucioneve private arsimore. Nuk e kam gjetur. Sigurisht është diku brenda, por nuk e kam gjetur. Kjo e tregon trajtimin e shkencës te ne. Ne nuk investojmë në shkencë as 0,1% të GDP-së, e kërkojmë të kemi zhvillim modern. Mendoj se kjo duhet të tejkalohet. Nuk mund të ecim më tutje kështu. Prandaj, unë propozoj konkretisht që së paku bile sivjet, 3 deri në 5 milionë euro t'i zvogëlojmë mallrat dhe shërbimet dhe t'i krijojmë kapacitetet për kërkime në institucionet tona akademike.

Shqetësuese është mënyra e marrjes së vendimeve për financimin e projekteve të mëdha kapitale. Në buxhetin e sivjetmë propozohet që të ndahen afro 30 milionë për autostradën Prishtinë - Shkup, pa e ditur koston e tërësishme, pa e pasur studimin e përfunduar të fizibilitetit. Unë kam lexuar se ai pritet të përfundohet në janar më duket, ministër. A është kështu? Studimi i fizibilitetit për rrugën Prishtinë-Shkup? Ju lutem! Domethënë në janar, domethënë dy muaj pasi ta aprovojmë buxhetin.

Kjo mund të them se nuk është praktikë e mirë dhe kjo duhet të tejkalohet. Qeveria duhet t'i tejkaloj këto metoda, ose Kuvendi duhet ta detyrojë që t'i tejkalojë këto metoda, për arsye se financimi i rrugës Prishtinë-Shkup, ndonëse mund të jetë i rëndësishëm, nuk është urgjent. Ajo që është urgjente tash është efektuimi i Rrugës së Kombit...

(Ndërprerje nga regjia)

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetar i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Zotëri Ali Sadriu e ka fjalën.

ALI SADRIU: Përshëndetje, zoti kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Unë jam përpjekur t'ia bëj një analizë një segmenti të veçantë Ligjit të buxhetit. Në veçanti jam ndalur te rialokimet, përkatësisht pozicionet e paspecifikuara, ashtu siç parashihej edhe në Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi. Qeveria e ka dorëzuar në Kuvend buxhetin dhe për këtë e falënderojmë që me kohë na e ka sjellë projeksionin mbi të cilin ne mund të bisedojmë.

Bazuar në të dhënat e prezantuara në këtë projektbuxhet, shihet se shpenzimet e përgjithshme buxhetore për vitin 2013 e kanë një rritje të konsiderueshme deri në 4%, më të larta se shpenzimet e vitit 2012, të aprovuara me rishikimin e buxhetit të vitit 2012.

Ajo që unë desha të theksoj është se me gjithë të arriturat në projeksionet buxhetore, prapëseprapë i kemi disa çështje për të cilat kërkohet sqarim, e kjo ka të bëjë me transferim dhe rialokimin e fondeve brenda vitit, e veçanërisht në kategoritë e shpenzimeve kapitale.

Në Ligjin e menaxhimit të financave publike, në nenin 14, pika 1, 2 dhe 3, rregullohet çështja e rialokimeve buxhetore. Pra, i kemi tri momente ku Ministria e Financave e udhëheq korin, ta quaj kor në qarkoret buxhetore, dhe si finale e merr pëlqimin e Ministrisë për ndarjet buxhetore. Faza e parë është ky projektion që tani po e pretendojmë ta bëjmë ligj. Faza e dytë është rishikimi në mes vitit, kur rikonstruohet buxheti. Dhe faza e tretë, pra është neni 14, pika 1, 2 dhe 3. Sipas këtij neni të Ligjit mbi menaxhimin e financave publike, ministri i Financave, në harmoni me autoritetin që jep ky ligj, me gjendjen e konstatuar se mjetet nuk janë konsumuar në mënyrë racionale në periudhat e caktuara dhe me rrezikun që ato të mbeten të pashfrytëzuara, e me pëlqimin e organizatës buxhetore, e merr të drejtën të bëjë rialokim deri në 15% të shumës së investimit kapital. Nëse ajo shumë e tejkalon këtë përqindje dhe shkon deri në 25%, atëherë për këtë vendos Qeveria. Nëse ndodh që projektioni kërkon rialokim më të madh se 25%, atëherë këtë nuk mund ta bëjë as ministri, e as Qeveria, por për këtë duhet të vendosë Kuvendi.

Në projektionin e buxhetit, në ligjin e buxhetit, që po pretendojmë ta bëjmë ligj të buxhetit, janë dy pika, të cilat ministrit dhe Qeverisë i japin kompetenca shtesë në formën e rialokimit të mjeteve. Të përkujtojmë se mjetet mund të alokohen vetëm në projektionet kapitale të listës në tabelën nr. 3.2 për projektet kapitale, të paraqitura në tabelën 3.2. Ministri mund, nëse i ofrohet arsyetimi se vlera e projektit është më e madhe nga organizata buxhetore, ta bëjë atë. Mirëpo, po ashtu në nenin 7.2 të Ligjit të buxhetit, jo më vonë se 30 ditë pas lëshimit të ndarjeve buxhetore të plota për vitin fiskal 2013, Qeveria i dorëzon për informim në Kuvend tabelat që i tregojnë ndryshimet e bëra në tabelat 3.2 dhe 4.2, të bashkangjitura, duke kërkuar nga organizatat buxhetore për t'i përmbushur obligimet e pakryera financiare nga viti paraprak, që lidhen me projektet kapitale shumëvjeçare, ndryshimet në tabelën 3.2 dhe 4.2. Por, e theksoj për informim, çka nënkupton se nuk kërkohet aprovimi i Kuvendit. Ju lutem, përcillenit me vëmendje, derisa mbi shumën e vlerës së kapitalit mbi 25%, Qeveria nuk ka autoritet të bëjë rialokim.

Neni 7 i Ligjit të buxhetit bie ndesh me këto elemente me Ligjin mbi menaxhimin e financave publike. Pastaj, e kemi edhe nenin 13, pika 2, ku ndër tjera thuhet: “Kur organizata buxhetore ka nën shpenzim në përputhje me planin e rrjedhës së parave të dorëzuara në Thesar, ministri mund gjatë tremujorit të fund vitit, me aprovimin paraprak nga Qeveria, t'i autorizojë shkurtime buxhetore dhe të njëjtat t'i rialokojë në pozicionet që i shohin të arsyeshme. Kjo shumë nuk mund ta tejkalojë 5%-shin.”. Kështu shkruan në nenin 13 pika 2.

Ju lutem, të kemi parasysh se në shumën e tërë buxhetit 5%-shi është jo më pak se 79 milionë euro. Prandaj, nëse i shikojmë këto dy dispozita të projektionit të buxhetit, ka interferim të kompetencave të Qeverisë në Kuvend, në raport me Kuvendin, nëse të njëjtat nuk vijnë për miratim në Kuvend. Prandaj, ju preferoj që gjatë shqyrtimit nëpër komisione, gjithsesi buxheti të vijë, ose këto rialokime të vijnë në Kuvend, të pozicionohen në buxhet, në Ligjin e Buxhetit, se do të merren obligime që të vijë dhe të ratifikohet në Kuvend dhe tek atëherë është e vlefshme. Përndryshe, çdo kontestim i tij mund të sjellë pasoja në mosaprovimin e këtij ligji dhe mosaprovimi i Ligjit të buxhetit në fund të vitit sjell edhe probleme tjera.

Unë përpos përvojës që kam rreth buxhetit, kam konsultuar shumë juristë dhe po ashtu ata të njëjtit e ndajnë këtë mendim, se ky është interferim i përgjegjësive të Qeverisë në raport me Kuvendin.

Një çështje tjetër që po ashtu unë e kam vërejtur e kemi te memorandumet e bashkë investimit, që bëhen edhe me pushtetin qendror dhe aty të metat i kam vërejtur që do të duhet edhe njëherë ato memorandume të bashkëpunimit të shikohen në raport me të hyrat vetjake se si po trajtohen ato.

Zoti ministër, ju e dini atë që ne gjatë shqyrtimit vërejtëm se ka organizatë, ku edhe nga 8 mijë euro i marrin rroga, duke iu falënderuar asaj se kanë të hyra vetjake dhe kanë nxjerrë rregullore shtesë, brendapërbrenda institucionit. Unë mendoj se duhet të jetë fushë e këtij viti, që ju ta rregulloni këtë çështje.

Një çështje tjetër e të hyrave vetjake është një përgjegjësi dhe një problem që është sfidë, sepse i kemi edhe institucionet e pavarura, të cilat ju drejtpërdrejt nuk i menaxhoni. Po ashtu, nga analizat që e kemi bërë, kemi vërejtur se edhe atje ka devijim në këtë raport.

Një çështje tjetër e memorandumeve ka të bëjë edhe në raport me komunat. Ministria e Infrastrukturës na dorëzoi, gjegjësisht na prezantoi tabelën e bashkëfinancimeve, e cila sipas tabelës kap shumën prej 10 milionëve. Por, ju lutem, pozicionin e parë e keni investimet në bazë të Memorandumit të Mirëkuptimit, gjegjësisht të bashkëfinancimit, e keni pozicionin të paspecifikuar, 5,18 milionë, domethënë pesë milionë e njëqindetëdhjetë e sa mijë euro, që është më shumë se gjysma e asaj të paspecifikuar, që ne nuk e dimë në cilat komuna do të shkojnë.

Prandaj, shpresoj që në leximin e dytë do ta specifikoni dhe do të dihet se ku shkojnë ato mjete. Nëse mbetet kështu, unë mendoj se po bëjmë një veprim bllanko, që mund të sjellë pozicione jo të këndshme. Ne kemi pasur rast...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Edhe një minutë zotit Sadriu.

...si pasojë e saj ne kemi menaxhim, unë mund ta marr rastin konkret, te Ministria e Arsimit. Çdo herë i keni prezantuar shpenzimet për blerjen e teksteve shkollore I - IX, në shumën 2,93, realisht kanë shkuar 7 milionë e 500 mijë, këtë vit nuk e dimë sa, prapë e keni paraparë 2 milionë e diçka. Pse këto nuk planifikohen në shumën, që realisht i shpenzojnë ata, por e çoni Ministrinë që ajo të hyjë në obligime pa mjete të siguruar.

Dhe, unë mendoj se në start këto çështje duhet rregulluar paksa më ndryshe dhe unë shpresoj se këto do t'i kemi, përndryshe brenda këtyre mund të gjenden, po them, këso elementesh që vijnë në terrene të papërshtatshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Të metat e buxhetit të vitit 2013 vërehen edhe tek institucionet e drejtësisë. Pra, e kam fjalën për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Gjykatën Kushtetuese, Prokurorinë e Shtetit, Institutin Gjyqësor të Kosovës, Komisionin për Ndihmë Juridike Falas. Pra, nuk ka ndonjë dallim me atë të vitit 2012, por as viteve të mëparshme.

Ndarja buxhetore që u është bërë këtyre institucioneve në njëfarë mënyre minon efikasitetin e punës së gjyqësorit, por edhe e përforcon argumentin që kjo Qeveri nuk e ka në interes të saj forcimin, pavarësimin e gjyqësorit, por po punon për të kundërtën.

Reformimi i sistemit të drejtësisë, për të cilën për çdo ditë po zotohet ministri i Drejtësisë, nuk mund të bëhet asnjëherë me këtë ndarje buxhetore, por sigurisht që jo edhe këtë Qeveri.

Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar një varg ligjesh sa i përket sistemit të drejtësisë dhe kjo nënkupton funksionalizim të këtyre institucioneve, pra shtimin e numrit të punëtorëve të administratës, shtimin e numrit të gjyqtarëve, prokurorëve, trajnimit e tyre, si dhe shpenzimet tjera që hyjnë në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, si dhe shpenzimet kapitale.

Marrim shembull, Institutin Gjyqësor të Kosovës, i cili ka një rol shumë të rëndësishëm, përveç që vitin e kaluar, sikurse edhe institucioneve tjera, iu kanë bërë shkurtime arbitrare buxhetore, i është ndarë buxhet i pamjaftueshëm për vitin 2013, iu janë ndarë 686 mijë e 789 euro më pak se sa ka qenë kërkesa e tyre buxhetore. Mirëpo, me këtë buxhet që iu është ndarë, pra vetëm 517 mijë euro, ky Institut nuk do të mund të bëjë përgatitjen e kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë të rinj, as trajnimet e specializuara dhe të vazhdueshme për gjyqtarë dhe prokurorë, as trajnimet për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive, në implementimin e projektit të Qendrës për Burime Ligjore, por as ndërtimin e objektit të Institutit Gjyqësor të Kosovës, pasi që ky institut akoma qëndron në objekt me qira dhe jo vetëm kaq.

Sot gjyqësori ballafaqohet me probleme të shumta, me kushte të vështira të punës, me hapësira të pamjaftueshme të zyrave, mungesa e sallave të gjykimit. Pra, shumica e gjyqtarëve mbajnë gjykimet në zyrat e tyre, kanë mungesë të pajisjeve për punë, kompjuterë, fotokopje dhe pajisje tjera.

Në strukturën buxhetore të Republikës së Kosovës të vitit 2013, ndarja buxhetore për sektorin e drejtësisë përfshin një shumë prej 28 milionë euro. Kjo shumë në mënyrë nominale paraqet shumën prej 1,97% të totalit buxhetor për vitin 2013. Ndarja buxhetore për institucionet e drejtësisë është ndarë në këto shuma.

- Për Komisionin për Ndihmë Juridike falas, 292 mijë e 345 euro,
- Institutin Gjyqësor, 517 mijë,
- Gjykatën Kushtetuese, 1 milion e 566 mijë e 741,
- Prokurorinë e Shtetit, 5 milionë e 795 mijë e 534,
- Dhe Këshillin Gjyqësor, 19 milionë e 910 mijë e 467

Në krahasim me degën e Ekzekutivit, që përfshin një shumë prej më se 60% të buxhetit, kjo ndarje paraqet një denigrim që i bëhet degës së gjyqësorit. Në anën tjetër investimet për Pallatin e Drejtësisë, që kapin shumën prej 25 milionë euro, në gjendjen momentale në të cilën gjendet sistemi gjyqësor, paraqet një komoditet tejet luksoz, sepse siç edhe thashë më herët, sot sistemi gjyqësor gjendet në një kaos.

Kushtet subjektive të gjyqtarëve dhe prokurorëve janë të mjerueshme dhe në vend se të ngrihet niveli dhe cilësia e punës së tyre, përmes përmirësimit të kushteve subjektive të punës, sigurisë së tyre personale dhe familjare, ruajtjen e dinjitetit të tyre në shoqëri, sot investohen milionat në pamjet kozmetike të ndërtesave, që do të reflektonin vetëm nga pamja një seriozitet, por jo edhe faktik.

Problemi tjetër që e ka sot sektori i drejtësisë, është numri i madh i lëndëve të pazgjidhura. Andaj, në vend se të investohet në rritjen e kapaciteteve profesionale në sistemin e gjyqësisë, sot investohet në fasadat e ndërtesave.

Vendet e rajonit në buxhetet e tyre kanë një ndarje buxhetore prej një mesatareje prej 4-5% të pjesëmarrjes së këtyre ndarjeve buxhetore në buxhetin e përgjithshëm shtetëror. Kështu që ministri i Drejtësisë apo kryeministri, le të mos na thonë më se janë të përkushtuar për shtetin ligjor e të tjera si këto. Qeveritë që janë të përkushtuara për sundimin e shtetit ligjor e reflektojnë atë, së pari në buxhetet vjetore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Emilija Rexhepi.

EMILIJÀ REDZEPI: Zahvaljujem, predsedavajući!

Uvaženi predstavnici Vlade,

Kolege poslanici,

U globalnom interesu svih građana naše države jeste da se podrži nacrt budžeta za 2013.godinu. Što se tiče položaja bošnjačke zajednice i argumentovano tvrdim da su za ove dve godine uložene više od 2 miliona finansijskih sredstava. Tiču se infrastrukturnih projekata, kapitalne investicije, vodovodna mreža, električna mreža, kanalizacije i tako dalje. Ono što je bitno za Prizrensku opštinu i za poboljšanje socioekonomskog statusa svih naših građana, jeste ovo povećanje budžeta za našu opštinu, zato što i po popisu stanovništva, Prizren je, Prizrenska opština zauzima drugo mesto.

Mi bošnjaci, odnosno poslanici u Parlamentu Kosova, podržavamo nacrt budžeta, s tim što imamo neke prioritete, odnosno neke predloge, koje ćemo dostaviti Komisiji za buxhet i financije, a tiču se izgradnja vodovoda u našim najjačim selima po broju stanovnika, to je izgradnja vodovoda u Gornjem Ljubinju, izgradnja vodovoda u Donjem Ljubinju. A ono što je jako bitno jeste da se rekonstruiše, odnosno doda aneks osnovne škole u Mitrovačkom kraju, osnovna škola „Bedri Džinaj“, gde se izvodi nastava na bosanskom jeziku. Znamo da je USAID finansirao izgradnju te škole, odnosno četiri dodatne učionice u nastavi na bosanskom jeziku, ali zbog opstanka naše nastave od prioritete važnosti u konsultaciji sa ministrom za Finansije obećano nam je da će toga biti za 2013. godinu. Zahvaljujem se!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Kabinet Qeveritar,

Zoti ministër, ju falënderoj për prezantimin që e bëtë të projektit, po ashtu edhe për angazhimet në një përgatitje të tillë, e cila nuk është aspak e lehtë, duke pasur parasysh ato sfida në të cilat vendi ynë ndodhet tani, ku kemi një agjendë goxha të ngjeshur zhvillimore të vendit dhe po ashtu, një agjendë goxha të ngjeshur në aspektin e zbatimit të atyre që quhen obligime ndaj BE-së ose agjendës evropiane. Sido që të jetë, buxheti nuk ka ndonjë ndryshim esencial, ka rritje e cila kryesisht është në linjat të cilat kanë qenë vitin e kaluar, por që mund të konsiderohet se është një konsistencë në projektet zhvillimore, në përputhje me agjendën e Qeverisë.

Ka diçka që unë dëshiroj të shtoj sot e që mendoj se mund të përmirësohet gjatë punës së komisionit, eventualisht mund të merret parasysh për periudhën vijuese, derisa buxheti përfundimisht ta merr dritën e gjelbër të Kuvendit.

Rregullatorët dhe agjencitë, siç e dini janë disa mekanizma të cilat i përgjigjen Kuvendit dhe shpeshherë buxheti i tyre nuk është trajtuar në mënyrën më të mirë dhe shpeshherë po ashtu, janë marrë për bazë vetëm ato që quhen paga, mëditje dhe disa shpenzime të cilat mund të kontrollohen në forma të ndryshme nga Kuvendi ose nga institucione tjera. Por, në fakt, nuk duhet të harrohet asnjëherë që buxheti i këtyre mekanizmave duhet të trajtohet në përputhje me objektivat zhvillimore ose me direktivat e BE-së që shpeshherë pasqyrohen edhe në Raportin e Progresit. Kemi pasur nja dy-tri raste të cilat dëshmohet se ne duhet të kemi kujdes që të krijojmë ose t'u japim fonde dhe pavarësi të duhur këtyre institucioneve, në mënyrë që ato të kenë mundësi të zhvillojnë sektorët e tyre.

Po ashtu, në buxhetin që ka të bëjë me zhvillimin ekonomik, ose me vetë Ministrinë përkatëse, në disa pika u fokusova, aty ku unë mendoj se është dashur të ketë më shumë përkujdes. Te eficientia e energjisë elektrike, ne e dimë që kemi sfida në të ardhmen, për ta stabilizuar këtë sektor të energjisë dhe mendoj, që duhet një asistencë pak më e madhe e Qeverisë, duke pasur parasysh që ka edhe një gatishmëri të fondeve ndërkombëtare për eficienten e energjisë, mendoj që është dashur të kishim pak më shumë kujdes në fondet në këtë drejtim.

Dhe po ashtu, ju e dini që këto ditë ne e kemi në Kuvend Ligjin për zonat ekonomike, në ndërkohë që tek ne veç paraprakisht paragjykohet ky ligj, për shkak se nuk është paraparë fond në vitin vijues, por ndoshta kjo do të shihet e të trajtohet edhe gjatë punës së komisionit.

Te infrastruktura, ministri nuk është këtu, unë dëshiroj të theksoj diçka që jam i obliguar nga disa kolegë deputetë dhe nga disa institucione, vitin e kaluar e kemi kërkuar që të jetë një projekt, të paktën, për një rrugë që lidh një rajon të tërë duke përfshirë edhe Preshevën e Bujanocin. Në ndërkohë që sot nuk ka asnjë linjë buxhetore dhe nuk kemi asnjë rezultat, ne e dimë që nuk do të mund të bëhen përnjëherë të gjitha rrugët. Po ashtu, e dimë që disa rrugë kanë kosto më të mëdha, po meqenëse ky mandat i Qeverisë është

identifikuar me rrugët, me projektet e rrugëve më të mëdha, që kemi pasur ndonjëherë në histori, të paktën duhet të përmbyllet kjo fazë edhe me projekte të tjera vijuese. Ne duhet ta dimë, duhet t'i kishim nja dy-tri variante, ajo që ne kërkonim tash një studim me nja dy-tri versione, të na thuhej që kjo rrugë mund të bëhet në këtë vit, ose nuk ka të holla për këtë rrugë, po mund të ketë një format tjetër të një rruge ose një zgjerim rruge e tjerë, po në fakt, ne nuk kemi asnjë linjë, bile edhe ajo linjë buxhetore, që ka qenë në kuadër të kësaj Ministrie, që është thënë në kuadër të asaj linje, mund të bëhet një studim i tillë, as ajo linjë nuk ekziston.

Një çështje tjetër, që dëshiroj ta spikat është çështja e investimeve në sport. Shikoni, e kemi pasur një periudhë paraprake, i kemi pasur Lojërat Olimpike dhe kemi pasur një debat madje, edhe këtu brenda nesh ka pasur të tillë, që me krenari kanë folur për disa rezultate sportive.

Vetëm shikoni, vitet paraprake dhe këto investimet në sport. Është një linjë lineare, përherë përsëriten disa investime ose disa planifikime për do fusha sporti, asnjëherë nuk janë kryer. Kemi 7 milionë e 300, prej tyre 4 milionë janë nga IPA, nga fondet e Komisionit Evropian. Duhet të mendohet thjesht, nuk janë të bollshme, por duhet të mendohen këto investime, që bëhen në sport në kuptimin që t'ju jepet bile financim organizatave sportive që ato ta zhvillojnë sportin.

Pra, është mirë që investimeve në infrastrukturë t'ju jepet mundësi edhe investimeve private dhe tjera, ndërsa një pjesë që kanë të bëjnë me zhvillimin drejtpërdrejt të kualitetit në sport, meqenëse Lojërat Olimpike do të vijnë shumë shpejtë dhe lojërat tjera ndërkombëtare.

Një çështje tjetër, te ambienti dhe që ka të bëjë po ashtu, me një projekt, të cilin e kemi biseduar edhe herën e kaluar. Ka shumë çështje që neve na duhen investime edhe në ambient. Ne i dimë kufizimet, të cilat janë, po një prej tyre është investimet në lumin Mirusha, që është një projekt i një rajoni, nuk mund të themi që është veç e një qyteti, 300 mijë euro janë të pamjaftueshme për ta përfunduar atë projekt, kur dihet, që pasi të përfundojë kjo fazë e këtij lumi, duhet të përfundojë një kolektor i madh i ujërave të zeza, sepse vetëm e kemi hequr problemin e erës në qytetin e Gjilanit dhe ka rrezik të bartet kjo në fshatrat përreth dhe na duhet të vazhdohet. Pra kërkoj, zoti ministër, që kjo të trajtohet bashkë me komisionin. Unë do t'i propozoj edhe Komisionit për Buxhet dhe Financa, në mënyrë që vitin që vjen ky projekt të përmbyllet krejtësisht.

Dhe, derisa jemi te ambienti, e kam evidencuar edhe një diçka që mendoj se duhet, nuk kushton dhe nuk ndikon fare në ambient, te materialet e rrezikshme. Ne kemi pasur në Kosovë para disa vitesh një rast të tillë dhe nuk kemi pasur një vend ku t'i lëmë disa materiale, të cilat janë konfiskuar në doganë.

Mendoj, që në një linjë tjetër, ku 150 mijë euro mund të jenë për vetura, mendoj se do të mund të shfrytëzoheshin edhe për aq mjete, nuk po paragjykoj tash se veturat nuk duhen në Ministri, të investohen për një objekt, i cili kishte mundur të jetë për këto materiale të rrezikshme edhe një objekt i munguar në Kosovë.

Dhe një çështje tjetër, po ashtu te emergjencat, është një buxhet që është i lejuar mjaft i mirë. Te emergjencat, ju e dini që secilën herë e më shumë po përballemi me to. Kostoja është shumë e lartë e investimeve e shpenzimeve që i bëjmë në emergjencë, për shkak se automjetet, ose mjetet të cilat janë, janë kryesisht donacion, janë të vjetruara dhe mendoj që duhet pasur një strategji të re, se si të përballemi me emergjencat. Ndoshta, nëse s'ka mjete për të blerë të reja, ndoshta më mirë do të ishte të kontraktohen kompani, të cilat huazojnë mjete, që janë të përsosura dhe ndoshta, kostoja do të ishte shumë më e lirë, se sa të bliheshin ose të shfrytëzoheshin këto me një kosto shumë më të lartë.

Dhe, për ta përfunduar, ndoshta kjo që thash unë që duhet të shikohen edhe ato çështje që janë në Raport të Progresit, ndoshta shembulli tipik pozitiv këtu është që në Ministri të Punës janë paraparë 100 mijë euro për teknologji informative dhe me këtë po përmbillet një vërejtje, që është përsëritur disa herë në Raport të Progresit se ende nuk ka pasur një data-bazë në sistemin e punës, që do ta shfrytëzonin institucionet komunale, qendrore dhe Inspektorati i Punës dhe mendoj, që vetëm me këtë buxhet në Ministrinë e Punës është mbyllur një linjë ose një vijë e kuqe, e cila ka qenë e përmendur në Raportin e Progresit. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Lutfi Haziri e ka fjalën.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar dhe kryesues i Kuvendit!

Zonja zëvendëskryeministre,

Ministra të nderuar,

Unë do ta filloj fjalën time në buxhet, me atë që është substanciale dhe dëshiroj vëmendjen e kryetarëve të grupeve parlamentare, sepse një vit buxhetor edhe një ditë buxhetore, si sot, është dita më e rëndësishme që ka Kuvendi i një Republike, i një shteti. Vendimi më i rëndësishëm, pas emërimit të Qeverisë, për një Parlament është vendimi për buxhet.

Në raportin e fundit të studimit të fizibilitetit thuhet që Kuvendi i Republikës së Kosovës apo Kuvendi i Kosovës duhet të ketë autonomi buxhetore.

Të nderuar kolegë, as Qeveria as ju nuk e keni përmendur autonominë buxhetore të këtij Kuvendi, i cili duhet të jetë i pavarur në planifikim, në realizim të mjeteve dhe në ushtrimin e detyrave, sepse dy probleme kryesore që i dalin Kuvendit, është mungesa e buxhetit.

1. Detyra e parë është mbikëqyrja e ekzekutivit, rritja e kapaciteteve për mbikëqyrjen e ekzekutivit, që është mungesë e buxhetit, dhe
2. Zhvillimi i politikave legjislativ apo ligjvënës, që është mungesë e buxhetit e që lidhet me shumëçka në këtë rrafsh.

Unë kërkoj që ministri deri në leximin e dytë ta konsultojë Kuvendin, organet e Kuvendit, Komisionin Evropian, kryetarët e komisioneve parlamentare dhe në fund shefat e grupeve parlamentare, në mënyrë që autonomia buxhetore e Kuvendit të garantohet.

Edhe më tutje, organet e Kuvendit marrin para më shumë se vetë Kuvendi. Nuk e kam fjalën, pse ata po marrin, le të marrin sa të duan, sepse nëse themi RTK-ja e ka buxhetin më të madh se sa ne, Kuvendi, në rregull, por RTK-ja para një jave ka thënë që në vitin 2015, ne do ta mbyllim programin, sepse jemi me program analog dhe nuk do të jemi në përputhje me teknologjinë informative, përderisa për Zenunin, kolegun tim të dashur, është shqetësuese data-baza e Ministrisë së Punës, për shembull, që është prioritet numër 5 ose 6, në raport me RTK-n dhe në raport me Kuvendin.

Pra, kur flasim për nevojën e Kosovës që ta balancojë buxhetin me projektet e BE-së, duhet konstatuar se 64 milionë euro janë konfirmuar nga Komisioni Evropian, për Kosovën për këtë vit buxhetor. Dhe, është viti i parë që janë përputhur programet e IPA-s me projektet e Qeverisë. Për herë të parë nuk kemi letra të nënshkuara prej ministrave, që nuk janë adaptuar në buxhet. Unë e di që ministri i Financave ka pasur problem, se letrat që janë nënshkruar nuk janë përcjell në Qeveri dhe kanë mbetur të parealizuara. 64 milionë euro vijnë si pjesë e programit të IPA-s 1, sepse IPA-2 do të fillon prej vitit 2015 dhe merr 21 miliardë euro për Ballkanin Perëndimor.

Ky vit buxhetor duhet të jetë paralel planifikues për Qeverinë, sepse 21 miliardë jepen për shtetet e Ballkanit Perëndimor e që Qeveria jonë nuk ka programe as t'i realizojë këto 64 milionë që sot i ka, sepse prej kësaj shume janë paratë e Ministrisë apo të Pallatit të Drejtësisë.

Tek Administrata Publike kemi numrin në rritje të punëtorëve, jo si pjesë e transferit të kompetencave dhe të detyrave kushtetuese, por si pjesë e militantizmit dhe nepotizmit që është bërë dukuri në vendin tonë.

Ministria nuk ka edhe me këto mjete planifikim buxhetor të qëndrueshëm. Ka rritje, ministri Jaghillar, ka rritje, por jo mjete të sigurta që reformën si njërin prej kushteve për ta quar përpara.

Ministria e dytë që unë e kam gjetur, është Ministria e Pushtetit Lokal, që ka minus 1 milion euro buxhet, e që rishikimi funksional i procesit të decentralizimit si obligim, edhe pse i vonuar vitin e ardhshëm do të vijë në shprehje, kërkon mjete buxhetore.

Pra, duke kërkuar nga ministri, në fakt mungesa e kryeministrit po na hendikepon, që të garantoj autonominë buxhetore të këtij Kuvendi, që ne t'i kryejmë detyrat tona, sepse jemi bërë organi më i përfolur publik. Organi më i lakuar dhe më i diskredituar sot për sot në Kosovë është Kuvendi i Kosovës, i cili nuk ka mjet të vetin, deputetët nuk kanë buxhet. Deputetët nuk kanë zyra, deputetët nuk kanë mbështetje dhe deputetët më së paku kanë qasje në buxhet, janë më të përfolurit në publik, sepse u shit pazari duke e bartur temën tek Kuvendi.

Atëherë ushtrojeni detyrën tuaj dhe kërkon autonominë buxhetore, sepse është kërkesë, që është mbështetur nga Komisioni Evropian, i cili duhet të garantojë.

Nën 2, ne duhet ta rritim rolin tonë edhe në programet e IPA-s, edhe pse janë programe ekzekutive. Ne duhet të shohim a janë investimet me prioritet? A janë sipas prioritetit dhe a janë sipas nevojave që Kosova ka nevojë sot që 64 milionë sot e miliardat, që priten të vijnë në 5 vjetët e ardhshme, të jenë në përputhje me kërkesat e vendit, sepse veç një hise do të shkojë, tash a autostrada Prishtinë-Nish, a kalon nëpër Merdar a nëpër apo Prapashtricë, është çështje që komisioni do t'ja marrë paratë e programit të Serbisë dhe të Kosovës dhe do t'i qojë në autostradë edhe ato mjete veç janë pazar i kryer.

Pjesa e fundit ka të bëjë me Anamoravën, ku unë jam deputet dhe ku unë e kam bazën. Zoti ministër, 7 komuna i ka Anamorava, 5 janë tradicionale, dy Vetëvendosja thotë, janë komunat e luftës, unë i kam themeluar, janë politike, janë bërë kompromise të dhembshme, por 7 komuna i marrin 35 milionë euro. Është një rajon, është një krahinë e Kosovës, e cila i merr 35 milionë euro bashkë, që krahasohet me një komunë. Kur ua merr krejt investimet e ministrive me një komunë të mesme në Kosovë, jo me një të madhe në Kosovë. Mendojmë dhe besojmë që gjashtë rekomandimet që ka dhënë Grupi i ekspertëve të LDK-së duhet të përfshihen në leximin e dytë, sepse ndihmon që të bësh ndarje e drejtë, jodiskriminuese dhe t'i trajtosh njerëzit barabartë, sepse buxheti është i tyre, grumbullohet nga ata dhe duhet t'u kthehet në mënyrën e vet.

Gjilani me 6 komuna në Anamoravë, sot të hyrat në krahasim me Pejën, nuk po e marr një komunë të Drenicës, sepse u bë pak trendi ta krahasosh me Skenderajn ose me Drenasin dhe dua ta marr Pejën. Peja merr buxhet më shumë se Gjilani, të hyra komunale ka njëherë më pak se Gjilani. Gjilani i ka 3,8 milionë euro, Peja i ka 2 milionë euro të hyra komunale, ndërsa investimet i ka dyfishuar 100%. Nuk po kërkoj t'i zvogëlohet as Pejës, as Skenderajt, as askujt buxhetin, po kërkoj që t'i rritet Gjilanit, Kamenicës, Vitisë, Artanës, Kllokotit edhe Kamenicës, buxhetin, sepse, nuk është rritje, është rënie. Është rënie dhe diskriminim. Imagjinoni një komunë si Gjilani, e cila e ka një rrugë ta ndërtojë - 400 mijë euro për një vjet. Gjysma e mjeteve kanë për t'u bartur prej këtij viti.

Unë e falënderoj ministrin publikisht, që në rishikim buxhetor e ka bërë prioritet. Për një komunë, që është e gjashta me numër të banorëve në Kosovë, i merr 500 mijë euro në infrastrukturë për një vit. Unë nuk e di çka lypin dhjetë deputetë të asaj komune sot këtu, pesë prej të cilëve janë të PDK-së, kur Qeveria vetë ua jep 420 mijë euro për infrastrukturë. Dhe, dalim ne, shesim patriotizëm qysh të doni. Patriotizëm më të madh po shihet, sa që buxheti të bëhet i drejtë, jo diskriminues. Bëjeni buxhetin e drejtë, ndaje drejt, kudo që i bie të shkojnë le të shkojnë.

Njëra prej standardeve kryesore, meqë kam filluar më seriozisht të merrem me këtë problem dhe t'i besoj procesit të integriteteve, është barazia në buxhet, jo barazia në ligj dhe në Kushtetutë. Barazia më e madhe gjinore, fisnore, krahinore, komunale, grupore politike është kur buxheti ndahet drejt. Kur ndahet buxheti drejtë, atëherë jemi të barabartë. Ky buxhet nuk është i ndarë drejt. Pranojeni, është buxhet për vete, për parti dhe nuk ka kurrfarë problemi, sepse është normale, partia që udhëheq ndanë pak kah vetja, por të ndash krejt kah vetja e t'i shkelësh të tjerët nuk bën, sepse është diskriminim. Mos lejoni të vuajë një krahinë e Kosovës në diskriminim për shkak të sloganeve, që nuk qëndrojnë. Dhe, realisht nuk qëndrojnë, as për një arsye të vetme. Faleminderit! Unë

kërkoj dhe besoj, që ministri gjashtë rekomandimet e LDK-së ka për t' i shqyrtuar, ka për t' i analizuar, e në leximin e dytë ka për t' i arsyetuar. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Siç e di edhe zoti Lutfi që shumicën e atyre komunave që i përmendi, i udhëheq PDK-ja prapë, po besoj që kryetarët e komunave i kanë dërguar projektet dhe i kanë miratuar, ose jo.

Fjalën e ka zonja Alma Lama.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Pajtohem plotësisht me deputetin Haziri në lidhje me pabarazinë e shpërndarjes së investimeve, por unë dua t' ju kujtoj edhe një aspekt tjetër të kësaj pabarazie.

Në buxhetin që kemi përpara vetes janë parashikuar që në komuna të ndryshme të ketë 34 përmendore, të cilat do të ndërtohen për personalitete të ndryshme.

Në asnjë nga këto nuk është parashikuar, që një përmendore t' i kushtohet gruas dhe rolit të saj në luftë. Ky do të duhej të ishte një investim, në nivelin qendror faktikisht, sepse kontributi i gruas në luftë është shumë i madh dhe brazat të cilët po rriten, fëmijët tanë do të duhej që të rriteshin me ndjenjën e mirënjohjes dhe respektit për sakrificën e tyre në luftë.

Do të duhej të ishte një përmendore dhe unë kërkoj këtu publikisht nga ministri dhe nga Qeveria, që të ndajë buxhet në lidhje me këtë çështje, në Prishtinë, në të cilën do të ishin shkruar emrat e të gjitha vajzave dhe grave, të cilat dhanë jetën në luftë, në luftën e fundit, sepse natyrisht kontributi i gruas është shumë më i madh sesa ai në luftën e fundit. Kjo përmendore, do të duhej të ishte pjesë e agjendës së të gjitha vizitave zyrtare që bëjnë personalitete të ndryshme nga bota, këtu në Prishtinë.

Në këtë mënyrë, do të mund të vendosnim një gur sado të vogël në shenjë respekti dhe mirënjohjeje, për këtë kontribut, i cili mendoj se ka qenë shumë i madh, madje më i madh se sa ai i burrave, të cilët, e kam thënë edhe njëherë tjetër këtu në Kuvendin e Kosovës, se ka qenë shumë më e lehtë të marrësh një pushkë dhe të dalësh në mal, se sa të ruash fëmijët në kohën e një pushtimi shumë të egër, t' i ushqesh ata në kohën e një varfërie shumë të madhe dhe të një izolimi të madh. Kontributi i grave në luftë është i jashtëzakonshëm dhe ju të gjithë këtu e dini shumë mirë këtë çështje, kështu që është momenti i fundit që ne të shprehim mirënjohje për këtë.

Unë, natyrisht që këtë kërkesë timen publike, do ta kthej në amendament dhe shpresoj dhe besoj, që edhe Grupi i Grave Deputete do të më mbështes tërësisht në këtë nismë dhe besoj, që edhe Qeveria nuk ka asnjë lloj arsyeje apo justifikimi, që të ndajë buxhet për një përmendore në mesin e 34 përmendoreve të tjera. Më duket se ka pak devalvim vlerash këtu, sepse ndërtohen përmendore gjithandej dhe ka edhe diskriminim me baza gjinore. Shpresoj që të merret seriozisht kjo kërkesë, sepse është momenti i fundit. Po tregohemi shumë mosmirënjohës për gjysmën e popullatës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Dibra e ka fjalën.

VALBONA DIBRA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji i buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2013, vlerësoj se është i përgatitur në mënyrë profesionale dhe reale.

Buxheti i paraparë për vitin 2013 është 1 miliard e 591 milionë euro dhe i shpërndarë në mënyrë të drejtë dhe racionale, duke pasur parasysh se ky është buxhet i mundësive dhe jo i nevojave që ka Kosova. Gjithnjë duke u bazuar në buxhetin e planifikuar për vitin 2013, mendoj se nuk duhet të ketë investime të koncentruara vetëm nëpër qytete të mëdha, zhvillimi dhe investimet duhet të jenë në të gjitha zonat e Kosovës.

Kosova duhet zhvilluar në tërësi e jo në qytete të shëtisin nëpër pllaka të mermerit e qytezat dhe fshatrat të jenë të mbytura në baltë. Kjo qeveri ka menduar dhe mendon për të gjithë qytetarët e Kosovës, pavarësisht zonave, ku ata jetojnë. Kjo vërteton në investimet që i ka bërë në këto pesë vitet e fundit dhe investimet dhe investimet që do t'i bëjë në të ardhmen, të parapara në kornizën afatmesme 2013 - 2015.

Unë me të vërtet ndjehem keq kur gjatë këtij debati dëgjoj zëra kritik për investimet në disa rajone, siç është Drenica, duhet t'i gëzohemi secilit investim, kudo që ndodh në Kosovë. Nuk e dini apo ndoshta keni harruar, se ky rajon ka qenë ndër më të pazhvilluarit në Kosovë, me mungesë kronike të investimeve, rajon i vuajtur ndër shekuj, i shkatërruar dhe i djegur deri në themel. Mu në atë vend, jo shumë vite më parë, kombit iu dha vula patriotike, iu ngrit edhe një herë dinjiteti i përkulur i Kosovës.

Ajo luftë, ato vuajtje, që më vonë e përfshin fatkeqësisht krejt Kosovën, ishin vendimtare, që ne sot të ulemi këtu dhe të diskutojmë për këtë buxhet. Për ata që po ankohen për ndarje joproporcionale të buxhetit, më duhet t'ua rikujtoj, të nderuar deputetë, se komunës e Prishtinës gjatë vitit 2011 i ka mbetur të pashfrytëzuara mbi 17 milionë euro, shumë kjo e konsiderueshme duke marrë parasysh nevojat e mëdha që ka kryeqyteti jonë. Sikur këto mjete të ishin investuar, kjo do të ndikonte në një jetë më dinjitoze të qytetarit të kryeqytetit.

Ndërsa, Skenderaj, meqenëse u përmend shumë këtu, mjetet për investime kapitale për vitin 2011 i ka shpenzuar 94%. Prandaj, mendoj se problemi nuk është te ndarja buxhetore, problemi është pikërisht te menaxhimi i tij. Për hir të informimit të qytetarëve, të nderuar deputetë, unë kam bërë një analizë të shpenzimeve, për investime kapitale nga viti 2005 deri në vitin 2011, për disa komuna.

Nga viti 2005 deri në vitin 2011, komunës së Prishtinës nga Buxheti i Kosovës i janë ndarë mbi 184 milionë euro, vetëm për investime kapitale, ku nga ky buxhet janë shpenzuar 115 milionë apo shprehur në përqindje 62%. Këtu shihet mos efikasiteti i shfrytëzimit të mjeteve, sidomos në kategorinë, ku më së shumti përfitojnë qytetarët.

Komuna e Prizrenit, nga gjithsej 63 milionë euro buxhet për investime kapitale, ka shpenzuar 56 milionë, apo 88% kuptohet për periudhën e njëjtë 2005-2011, ndërsa komuna e Skenderajt nga gjithsej 12 milionë euro buxhet për investime kapitale, ka shpenzuar mbi 11 milionë, apo 89%.

Komuna e Skenderajt nga kjo analizë del të jetë më e suksesshme në menaxhimin e buxhetit, sidomos në investimet kapitale, ndërsa komuna e Prishtinës ka dalë më e pasuksesshme në menaxhimin e mjeteve për investime kapitale.

Andaj, unë mendoj se është më mirë të mendojmë se si të shfrytëzohen mjetet e parasë së buxhetit dhe jo të ankohemi për ndarje joproporcionale. Unë, të nderuar kolegë deputetë, do ta votoj këtë projektbuxhet dhe ju ftoj edhe ju që ta votoni. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, zoti Beqiri.

ISMET BEQIRI: Sigurisht është e drejtë e koleges deputete ta thotë mendimin e saj, por jo ta thotë si e tha në kuptimin që ju të tjerët mos u merrni me komunat tjera e unë po merrem qysh u mor me Prishtinën. Të hyrat që po i përmend, ose më mirë të thuhet parat që po i përmend, kryesisht janë të hyra vetjake të cilat më mirë është të shpenzohen nëse munden, por nëse nuk munden, më mirë është barten që është një e drejtë e komunës në vitin vijues se sa për t'i harxhuar ose për t'i keqpërdorur qysh ka ndodhur në shumë komuna. Mos më trego se keni dhjetëra raste nëpër komunat e PDK-së që pa procedura janë harxhuar paratë dhe këto janë procese hetimore që janë duke u zhvilluar, e thashë edhe më herët, mos të lavdërohen me atë që e kanë shpenzuar mjetet, sepse e thashë dihet si i kanë shfrytëzuar.

Ju keni raste që rruga është asfaltuar pa u shpall tenderi, keni raste, janë organet e hetuesisë duke u marr me këtë. Prandaj, po e përsëris, më mirë paratë të kursehen e mos të shkelen procedurat se sa të bëhen ashtu siç ka ndodhur në disa komuna. Dhe s'është e vërtetë që askush nuk e konteston nevojën të investohet në komuna të ndryshme edhe në Skenderaj, edhe çdo komunë tjetër. Ne veç kemi thënë që do të duhej trajtuar kryeqyteti ashtu siç e meriton edhe kjo ia ka nisur të na tregoj buxhetin 180 milionë euro u janë dhënë Prishtinës, mos të fol shifra që s'qëndrojnë kësisoj. Prishtina prej mbas luftës nëse llogaritet ka pasur edhe shumë më shumë buxhet, aq ka pasur veç nga të hyrat vetjake nëse e shikojmë për dhjetë vjet. Prandaj, nuk është mirë se s'ka filluar fushata. Unë e përmenda si fakt se ky është kryeqytet. Këtu dëshirojnë njerëzit të jetojnë, të punojnë, por duhet edhe të kontribuojë dhe Prishtina nuk është më shumë e imja se e zonjës deputete.

Por, kështu nuk qëndron kjo që po e thotë dhe mos të tenton të sulmojë se ne të tjerët nuk dëshirojmë komunave tjera t'u japim para, dëshirojmë, por kryeqyteti mendojmë se meriton të ketë edhe fabrikë për përpunim të ujërave të zeza, edhe fabrikë të ujit siç e tha ministri më herët...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Kundër-replikë, zonja Dibra.

VALBONA DIBRA: Faleminderit, kryesues!

Unë dua t'ia rikujtoj kolegut deputet se të dhënat, të cilat i mora për krahasim janë në sistemin e rebalancit në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave.

E kam marrë periudhën pikërisht 2005-2011 këto janë të dhëna të argumentuara, nuk i kam marrë prej veti dhe nuk është mirë të paragjykoni dhe t'i gënjeni qytetarët. Sepse, mbi 17 milionë në vitin 2011 kanë mbetur të pashpensuara në komunën e Prishtinës kur Prishtina ka nevojë për shumë investime. Nuk jam duke spekuluar me këto shuma. E përmendët edhe Skenderajn, fatmirësisht jam në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe i shoh të gjitha raportet e auditorit që vijnë. Raporti i auditorit për komunën e Skenderajt është opinion i pakualifikuar dhe nuk vë në pah parregullsia, të cilat ju i përmendët.

Prandaj, të lutem unë flas gjithëherë me argumente. I merr 184 milionë, janë në këtë periudhë kohore 2005-2011, nuk e atribuova, nuk e bëra ndarjen a janë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit! I nderuar kryesues!

Po shihet një pasion shumë i madh i lokalizmit, si duket zgjedhjet po afrohen edhe shumica e deputetëve këtu po kanë një pasion për të treguar origjinën e vet se nga vijnë dhe po harrojnë se në momentin që bëhen deputetë të Parlamentit të Kosovës, janë përfaqësues të popullit të Kosovës dhe duhet përfaqësojnë unitetin e qytetarëve të Kosovës dhe në këtë rast sipas interesave politike. Mirëpo, ideja e ndarjes së buxhetit ka disa probleme realisht që ekzistojnë dhe këto probleme duhet të anulohen si rezultat i një qasje më të hapur dhe si rezultat i një mendimi më të mirë në aspektin e planifikimit dhe shpenzimit të buxhetit.

Sa i përket buxhetit, problematikat shihen në qoftë se e merrni dhe shihni buxhetin, përveç elementeve që i përmendën kolegët paraprakisht, ka shumë probleme tjera siç mund të jenë: buxhetet e ministrive, të cilat kanë projekte realizuese nëpër komuna. Unë nuk po mund ta kuptoj pse projekte për infrastrukturë rrugore lokale që është kompetencë ekskluzive e komunave, projekte sa i përket ujësjellësit, mbeturinave, kanalizimit që janë kompetencë ekskluzive lokale, realizohen nga ministri të ndryshme. Nga ajo që kam parë unë në buxhet pesë ministri, së bashku me komunën, merren me një fushë të caktuar. Supozojmë, Ministria e Mjedisit ka projekte në infrastrukturën rrugore, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka projekte në infrastrukturën rrugore që janë kompetencë ekskluzive e komunave, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ka projekte me infrastrukturë rrugore apo projekte bile, bile edhe projekte në trotuar nëpër komuna të caktuara. Dhe, ministrinë tjera, të cilat realisht nuk ka logjikë, kur t'i shtohet kësaj edhe Ministria e Infrastrukturës, që realizon projekte infrastrukturë rrugore në nivel komunal, kompetencë ekskluzive e komunave dhe Ministria e Arsimit që merret me shkolla dhe ndërtim edhe të çerdheve nëpër komuna, pse atëherë ekzistojnë komunat, pse duhet të bëhet ky disbalancim?

Nga ajo që kam parë unë në analizën e buxhetit rezulton se kemi shpërndarje sipas apetiteve politike të ministrave. Nëse e marrim edhe i shohim projektet që realizohen nga ministritë e linjës nëpër komuna, mesatarja e buxhetit të ministrive, përveç Ministrisë së Arsimit dhe Ministrisë së Infrastrukturës që realizojnë projekte nëpër komuna, sillet nga 7 deri 10 milionë euro buxhet për ministritë tjera. Po flas për Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, po flas për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale e cila s'do të duhej të kishte të bënte me shtrimin e trotuarit nëpër komuna. Çka ka lidhje Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale me këtë punë?

Kjo tregon një qasje e cila ka dy elemente kryesore, elementi i parë është përdorimi për qëllime politike dhe të kënaqjes së apetiteve edhe financiare edhe politike të ministrave të caktuar dhe e dyta është dhënia e mundësisë më të madhe për abuzim nëpërmjet kësaj rishpërndarje. Mendoj se është një problem juridik dhe konceptual në Buxhetin e Republikës së Kosovës, i cili është propozuar që të them të drejtën nuk është vetëm në këtë buxhet, por edhe në buxhetet paraprake ka qenë. Kjo ndarje e tillë e cila nuk ka logjikë institucionale. Pse do të duhej të merreshin ministri të veçanta me projekte nëpër komuna kur komunat i kanë kapacitetet dhe kanë obligimet kushtetuese dhe ligjore. Merreni dhe shiheni Kushtetutën e Republikës së Kosovës e cila thotë: “njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Kosovë është komuna”. Dhe komunat qeverisin sipas Ligjit për vetëqeverisjen lokale. Nëse e marrim dhe e shihni Ligjin për vetëqeverisjen lokale thotë: “komunat kanë burime të tyre financiare, kanë të hyrat vetjake, kanë grande speciale, grande të veçanta” dhe kaq dhe komunat menaxhojnë me jetën publike dhe administrative në territorin e komunës. Pse duhet Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale të shtrojë rrugë? Pse? Pse duhet Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal të shtrojë trotuare? Ku është logjika? Apo duhet shpërndarë këto për interesa të caktuara.

Prandaj, mendoj se kjo rrugë e ndërtimit të buxhetit dhe shfrytëzimi i tij me qëllime të përfitimit të individëve është shumë e dëmshme për buxhetin e Kosovës dhe rrezikon realisht që të shndërrohet në një shembull shumë të dëmshëm për të ardhmen e buxhetit dhe për të ardhmen e qëndrueshmërisë ekonomike, sepse duke u zhvilluar këto aktivitete ekonomike në nivel të ministrive ndodh edhe një problem tjetër. Bizneset e vogla dhe të mesme, të cilat operojnë në nivel komunal, nuk mund të jenë konkurrese dhe nuk mund t'i marrin këto punë, të cilat tenderohen nga niveli qendror i qeverisjes dhe rezultat i tenderimit nga niveli qendror i qeverisjes komunat nuk kanë mundësi të kenë qasje në menaxhim të këtyre projekteve kapitale. Dhe, si rezultat as bizneset në nivel lokal nuk po kanë mundësi të kenë qasje në këto, sepse normalisht një biznes në Shtime, supozoj, nuk mund të jetë konkurrues me një biznes super të madh në Prishtinë. Mirëpo, në qoftë se tenderi do të shpallej në Shtime, normalisht që edhe bizneset konkurrese do të ishin më mirë në Shtime, sepse do të kishin rrethanat krahasuese më të mira.

Prandaj, mendoj se duhet të ketë një qasje më të mirë në aspektin e barazisë dhe në aspektin e respektimit të vetëqeverisjes lokale, sepse këtu thyhet një element kryesor që është elementi i parimit subsidiaritetit që njihet me Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale, e cila është e inkorporuar edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe po ashtu, Ligjin për vetëqeverisjen lokale dhe një sërë ligjesh tjera. Prandaj, duhet të kemi parasysh se ky buxhet, përveç problemeve tjera që u përmendën këtu, ka edhe problemin

sa i përket parimit të subsidiaritetit të njohur me Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale dhe i cili po rrezikon qëndrueshmërinë e komunave dhe po rrezikon realisht mundësinë e zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme sidomos në komunat e vogla pa marrë parasysh se kush në ato komuna të vogla qeverisë, a është PDK, a është LDK apo cila është.

E rëndësishme është që të ketë qasje sistemore. Sistemi duhet t'i rregullojë këto punë dhe sistemi është i infektuar deri në atë masë sa nuk po garanton që të kemi qeverisje të qëndrueshme lokale. Kjo mungesë e vetëqeverisjes së qëndrueshme lokale po bëhet qëllimisht për përfitime politike dhe për përfitime ekonomike dhe financiare në mënyrë të padrejtë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Rashiq e ka fjalën.

NENAD RAŠIĆ: Hvala gospodine predsedavajući!

Svarno je bitno da naglasim. Projekat ako gledam budet malo bolje verovatno bih primetio to. Projekat takozvani, održivo zapošljavanje (punësim i qëndrueshëm apo surver employment), je onaj koji finansira na osnovu zahteva opština. I to je projekat, ja jedini koji znam, koji investira ceo iznos koji je predviđen za projekte, na osnovu predloga opština 50% tog iznosa ide u ruke radnika, odnosno ljudi koji dolaze sa biroa rada.

Znači, Ministarstvo na osnovu zahteva opština finansira te projekte i nikako drugačije. To u budžetu ne postoji, Ministarstvo za rad. Postoji takozvana Projekat održivog zapošljavanja ili Punë Publike, javni radoni, što je usmereno na ovaj način saradnje sa opštinama, na osnovu njihovog zahteva finansiranje projekta koji oni traže. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, zoti Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

I nderuar nënkryetar,

Unë e kam buxhetin përpara edhe ndër projektet e shumta që këtu i shoh unë që janë kompetencë ekskluzive e nivelit lokal të vetëqeverisjes, më rezulton që Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, shtron edhe trotuare dhe nuk merret me punën dhe mirëqenien sociale dhe punësimin e njerëzve në Kosovë, por merret me shtrimin e trotuareve, që do të duhej të ishte kompetencë ekskluzive e nivelit lokal të vetëqeverisjes. Dhe, si rezultat i kësaj unë shoh edhe plot projekte tjera, të cilat realisht nuk do të duhej të ishin në nivelin qendror të qeverisjes dhe të cilat realisht po dëmtojnë dhe po pamundësojnë që komunat të jenë më të afta dhe komunat, sidomos komunat e vogla po flas të kenë mundësi që të ngritin kapacitetet e tyre dhe të kenë mundësi që të zhvillojnë ndërmarrje të vogla dhe të mesme dhe të kenë mundësi që të rrisin kapacitetet e ndërmarrësisë, sepse si rezultat i kësaj qasje kemi ndarje ose distribuim të buxhetit sipas interesave politike të individëve që mund të jenë ministra. Dhe, kjo është e dëmshme për të ardhmen dhe kjo është e dëmshme për qëndrueshmërinë e vetëqeverisjes lokale dhe kjo nuk ndikon pozitivisht në aspektin e qeverisjes. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E u kryer, nuk ka kundër-replikë. Ai pati kundër-replikë në diskutimin e vet. Fjalën e ka zoti Kasolli.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit!

I nderuar kryesues dhe të nderuar deputetë,

Më lejoni që këtë diskutim ta filloj me një konstatim grotesk që dëgjuam në seancën e paradites nga ministri i Financave zoti Hamza në replikë me kolegun Ymeri.

Ministri i Financave tha se ky nuk është buxhet i nevojave, por buxhet i mundësive. Absurde. Sipas kësaj logjike i bie thotë: “pasi Qeveria nuk ka mundësi ta zhvillojë Kosovën dhe t’i plotësojë nevojat e qytetarëve të Kosovës, atëherë qytetarët duhet t’i reduktojnë nevojat”. Pra, kjo i bie që qytetarët nuk duhet të kenë nevojë për shërbime kualitative shëndetësore, për arsim cilësor, për mirëqenie sociale ekonomike, për zhvillim të mirëfilltë ekonomik, për punësim, sepse Qeveria nuk ka mundësi nëpërmjet këtij projektbuxheti t’i plotësojë këto nevoja, atëherë ju duhet t’i reduktoni këto nevoja dhe s’duhet t’i kërkonit që t’i realizoni. Send më absurd nuk kam dëgjuar nga një ministër i Financave. Dhe kjo logjikë siç duket po reflektohet edhe në Projektligjin për buxhetin për vitin 2013, të cilin po e diskutojmë sot edhe që dëshmon edhe njëherë për mungesën e vizionit të kësaj Qeverie për disa nga sferat qenësore të kësaj shoqërie me theks të veçantë sferën e arsimit.

Për më tepër ky projektbuxhet në mënyrën se si është konceptuar dhe sajuar jo vetëm që vazhdon të jetë buxhet i mos zhvillimit ekonomik, por si i tillë ai e ruan këtë gjendje të pashpresë edhe për vitet në vijim. Prandaj, ky injorim i sferës së arsimit si një nevojë qenësore padyshim se ka kosto të madhe politike, ekonomike dhe sociale, sidomos, kur dihet se për Kosovën arsimi është prioritet madhor. Me gati $\frac{1}{4}$ e popullatës të përfshirë në arsimin formal dhe më shumë se 40% e saj të papunësi e ardhmja e Kosovës është një garë në mes të arsimit dhe katastrofës, garë të cilën Kosova duhet ta fitojë me çdo kusht dhe me çdo çmim, mirëpo fatkeqësisht si shihet me këto politika të kësaj Qeverie dhe me këtë ndarje buxhetore për këtë sferë, kjo garë jo vetëm që nuk do të fitohet, por katastrofa do të thellohet edhe më tej. Në këtë kontekst projektbuxheti për vitin 2013, përpos që është i mbarsur me këto deficite duke mos ofruar vizion makro zhvillimor, po ashtu në pjesën më të madhe është jo transparent dhe konfuz dhe madje i shkruar edhe vende-vende në mënyrë sharlatane.

Fillimisht, shumica e projekteve kapitale që figurojnë në këtë projektbuxhet janë shpenzime të transferuara nga viti i kaluar edhe në këtë vit. Prandaj, shtrohet pyetja: a është fjala për projekte shumëvjeçare, projekte të parealizuara për mënyrë fondesh që mbarten nga viti në vit apo për manipulim perfid për të maskuar dështimin? Kështu, po të analizohet me vëmendje pjesa për kufijtë e fortë buxhetore e cila përfshin Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, aty thuhet se kësaj Ministrie i janë ndarë 44 milionë e 679 mijë euro nga të cilat rreth 22 milionë përfshijnë shpenzimet kapitale. Mirëpo, mënyra si janë ndarë mjetet për këto shpenzime kapitale mbetet mjaftë e errët. Bie fjala, sa u përket shpenzimeve në këtë sferë për vitin 2013, kodi numër 13 084 thotë se 50 mijë euro janë ndarë për ndërtimin dhe zgjerimin e infrastrukturës. Shtrohet pyetja se ku do të bëhet ky investim, në cilën shkollë, në cilin qytet apo mos vallë Ministria e Arsimit është

transformuar në Ministri të Infrastrukturës dhe këtë ne nuk e dimë pasi se siç shihet tulla dhe betoni janë i vetmi interes i kësaj Qeverie.

Kështu seria e kësaj dukurie të konfuzionit sa i përket shpërndarjes së mjeteve buxhetore vazhdon në pjesën më të madhe të tabelës që përfshin shpenzimet kapitale. Bie fjala Kodi 11 mijë e 206 thotë: “projektet kapitale në vazhdim përfshijnë 200 mijë euro”, por nuk specifikohet se për çfarë projektsh është fjala apo kodi 13 083 ku thuhet: “ndërtimi i shkollës fillore i cili përfshin shumën 700 mijë euro” mirëpo, nuk ceket qyteti se ku është duke u ndërtuar kjo shkollë fillore, lokacioni, lagjja etj. Përgjithësisht ky maskim i projekteve sipas të gjitha gjasave është bërë me qëllim për të arsyetuar ndonjë tender të ardhshëm korruptiv që zyrtarët e kësaj qeverie u duhet të shpërndajnë për “kamarillën” e tyre oligarkike.

Kjo gjendje e mjerueshme sipas këtij draft buxheti nuk mbetet më i mirë as sa i përket Universitetit të Prishtinës. Në këtë sens vlen të veçohet mungesa e buxhetit të mirëfilltë për zhvillimin e veprimtarisë shkencore, investim ky i cili konsiderohet bazik për zhvillimin e resurseve humane. Kryesisht si shpenzime kapitale të reja përmenden vetëm 300 mijë euro, kurse të gjitha të tjerat janë bartje nga vitet e kaluara. Të mos flasim për Universitetin e Prizrenit, ku nuk parashihet asnjë investim i ri, por kemi vetëm bartje të shpenzimeve të vitit të kaluar të atyre 1 milion eurove që mbarten nga viti në vit.

Prandaj, që të tejkalohet kjo gjendje e mjerueshme ku është katandisur sfera e arsimit, shkencës dhe teknologjisë në shoqërinë tonë Lëvizja “Vetëvendosje” konsideron se Republika e Kosovës ka nevojë për një projektbuxhet radikalisht të ndryshëm nga ky që na servohet sot në Kuvendin e Kosovës. Nuk ka dyshim se ky buxhet tjetër duhet të derivohet nga një filozofi tjetër dhe program alternativ qeverisës. Puna kërkimore shkencore në Kosovë vazhdon të jetë marginale dhe kryesisht e motivuar nga nisma individuale, por pa mbështetje sistimore. Madje, edhe pse programi kombëtar i shkencës 2010-2015 i aprovuar nga Kuvendi i Kosovës i përcakton të gjitha veprimet dhe alokimet buxhetore për nxitjen e zhvillimit të veprimtarisë kërkimore shkencore, por në praktikë bëhen veprime tjera, ndërsa mjetet buxhetore të alokuara janë shumë të vogla nga ato që parashihen.

Është e ditur se shumë nga reformat në arsimin e Kosovës dhe në veprimtarinë kërkimore-shkencore të shumtën kanë dështuar për shkak të shpërputhjes në mes planeve të veprimit dhe zotimeve financiare. Kosova ka dy dokumente të rëndësishme strategjike për zhvillimin e arsimit dhe të veprimtarisë kërkimore- shkencore me aktivitete të përcaktuara që shoqërohen dhe me kalkulime të kostos. Këto janë plani i zhvillimit të arsimit 2011-2016 dhe programi kombëtar i shkencës. Por, duke marrë parasysh faktin se mjetet buxhetore për ... dhe programin kombëtar të shkencës thuajse se nuk alokohen fare, na del se shpenzimet e përgjithshme për arsim kapin shumën prej 3,86% të bruto produktit kombëtar. Pra, në Lëvizja Vetëvendosje, në koherencë me programin e saj alternativ qeverisës konsideron që buxheti i konsoliduar i Kosovës për arsim dhe shkencë duhet të ndajë një shumë prej 5% të bruto prodhimit kombëtar. Vetëm në këtë mënyrë Kosova mund të dalë nga rruga qorre ku e ka futur arsimin kjo Qeveri dhe këto politika të mbrapshta buxhetore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri Hamza e ka kërkuar fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Unë fillimisht e falënderoj deputetin për diskutimin, por besoj se deputeti e din ose të paktën duhet ta dijë se buxheti duhet të jetë një dokument i balancuar. Edhe besoj që deputeti e din apo të paktën duhet ta dijë që nuk ka asnjë vend në botë që nuk ka më shumë nevoja se që ka mundësi, edhe vendet më të zhvilluara.

Edhe po e thjeshtësoj këtë, edhe ju zoti deputet keni më shumë nevoja për t'u zhvilluar edhe si familje, por s'ki mundësi, s'ki para të mjaftueshme. Unë e kuptoj që tentove për ta luajtur rolin e avokatit, nuk ka kurrgjë të keqe, por luajte keq se zoti Ymeri është i zoti me i dal zot fjalës së vet, diskutimit të vetë dhe të kisha këshilluar që kur të flasësh për buxhetin të bazohesh edhe në praktikën e vendeve tjera se asnjë sektor nuk dëgjova sot që nuk pat kërkesa për më shumë mjete. Por, pyetja është si të sigurohen këto mjete? Nuk mundesh me e mohuar faktin që Kosova është në mesin e vendeve të rralla, e vetmja në regjion që katër vjetet e fundit ka pas rritje edhe në pjesën e të hyrave edhe në pjesën e shpenzimeve. Ka një dyfishim të buxhetit. Unë prapë po e theksoj, është bërë shumë, është arrit shumë, vlerësohet edhe nga tjerët, edhe nga institucionet shumë kredibile si Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, mirëpo nevojat e Kosovës janë edhe më të mëdha. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Svirca e ka fjalën. A! Replikë? Mirë, mirë! zoti Kasolli replikë.

AFRIM KASOLLI: Fillimisht, ministër ato që i keni brenda jush mos i projektini te dikush tjetër se...

KRYESUESI: Në fakt, kundër-replikë e ke.

AFRIM KASOLLI: Po, kundër replikë. Nuk mora rolin ta mbrojë avokatin e djallit, por thjesht për të diskualifikuar një logjikë anakronike kur ju nëse nuk mund t'i plotësoni nevojat e kësaj shoqërie atëherë sipas kësaj logjike ju kërkon që qytetarët e Kosovës t'i reduktojnë ato nevoja në përputhje me mundësitë e juaja.

Pra, nëse ju jeni të paaftë dhe nuk keni mundësi ta zhvilloni Kosovën mos kërkon nga qytetarët e Kosovës të mësohen të jetojnë me fukarallëk, me moszhvillim edhe me mosinvestim. Kështu që kjo qasje anakronike është e dëmshme për zhvillimin e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Svirca e ka fjalën. Deputetit Svirca fjalën, ju lutem!

JETON SVIRCA: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Ne e kemi marrë draft buxhetin, të cilin e kemi shqyrtuar me kujdes të veçantë. Sigurisht që për këtë planifikim të ndarjes së buxhetit kemi pajtime tona, por edhe mospajtimet tona.

Unë propozoj që, unë përgëzoj pra ministrin edhe ministrat e tjerë për planifikimet, për mbështetje të reformës së administratës publike, për investimet në arsim, në shëndetësi dhe në dikasteret tjera. Kurse, sa i përket infrastrukturës kam propozim që t'ju shtohet buxheti për rehabilitimin e dy rrugëve me interes të veçantë për qytetarët e komunës së Prishtinës dhe të Vushtrrisë dhe për këtë propozim konkret do t'ua adresojë komisionit funksional edhe amendamentin edhe besoj që do të gjejmë mirëkuptim, për arsye se janë shuma jo të mëdha dhe të mbulueshme. Ne e dimë se ka kërkesa të mëdha, por me argumentime mund të ketë edhe lëvizje në linja buxhetore.

Ne si deputetë të rinj të Kuvendit të Kosovës kemi marrë edhe një letër ankesë që në këtë seancë gjatë diskutimit të ngremë zërin në emër të disa organizatave të ndryshme rinore, të cilat kanë të bëjnë me vërejtjen e tyre, por edhe tonën për këtë projektligj, konkretisht për ndarjet buxhetore për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, e cila është 19 milionë e 100 mijë e 525 euro dhe nga totali për vitin 2013 për sektorin e sportit janë paraparë 9 milionë e 304 mijë e 174 euro ose 48,7% e buxhetit të Ministrisë. Për sektorin e kulturës janë paraparë 4 milionë e 882 mijë e 396 euro ose 25.5%, për sektorin e trashëgimisë kulturore janë paraparë 2 milionë e 567 mijë e 941 euro ose 13,5%, për administratën qendrore janë paraparë 1 milion e 53 mijë e 425 euro ose 5,5% dhe për sektorin e rinisë janë paraparë 1 milion e 292 mijë e 589 euro ose 6,7%, prej nga 500 mijë janë investime kapitale dhe 700 mijë subvencione për mbështetje të drejtpërdrejt të programeve dhe projekteve të organizatave rinore që i bie 6,3% e buxhetit total të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Me shpresë se nga viti në vit Departamenti i Rinisë në kuadër të Ministrisë do të ketë rritje, në vitin 2013 ky departament do të ketë rënie për 30 mijë euro krahasuar me vitin 2012. Shqetësimet tona janë se nëse fillohet këtë vit të ketë rënie të buxhetit në Departamentin e Rinisë, këto rënie mund të përcillen dhe vazhdojnë edhe në vitet e ardhshme. Puna jonë çdo herë ka qenë në drejtim të asaj që të rinjtë të kenë mundësinë dhe hapësira të mjaftueshme për të plotësuar nevojat e tyre dhe për të ngritur kapacitete të tyre njerëzore dhe intelektuale. Duke pasur parasysh faktin që numri i donatorëve dhe organizatave ndërkombëtare që mbështesin sektorin e rinisë në Kosovë është në rënie dhe në anën tjetër uljen e buxhetit të institucionit përkatës për rini karshi kërkesave në rritje të rinjve dhe sektorit rinor në përgjithësi, mund të vij në përfundim se ky sektor nuk po ec drejt zhvillimit dhe avancimit, por në kahun e kundërt.

Ne shpresojmë se shqetësimin tonë do ta marrin parasysh Komisioni Funksional edhe në bashkëpunim edhe me ministrin për Financa do të gjejmë hapësirë që t'i mbështesim më shumë këto propozime. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E ka fjalën Hamza Balje.

HAMZA BALJE: Zahvaljujem gospodine predsedniče!
Poštovani gospodo ministri,
Kolege zastupnici,

Danas odlučujemo kako će se trošiti novac poreskih obveznika, novac naših građana, koji očekuju boljitak u ovom periodu ekonomske nestabilnosti u periodu razvoja naše države. Tako i naša zajednica očekuje da će biti i sa njihovim parama.

Šta će se povratno uložiti na prostorima gdje oni žive? Da li će to biti ona stalna retorika - opet ništa, ili će to biti nešto novo, što će zainteresirati i strane investitore da počnu sa ulaganjima na našim prostorima, normalno kada se za to stvori povoljna klima.

Kao prvo fokusiraću se na deo budžeta u kome se govori o ulaganjima u opštini Dragaš. Naime u pogledu tabele, jasno se vidi da je budžet opštine Dragaš podeljen na tri djela. Prva dva djela oko milion eura, idu u korist okolnim selima oko Dragaša naseljenim većinskim albanskim stanovništvom, dok jedan deo manje od 500 hiljada pripada dvema zajednicama, koji žive u gorskom djelu opštine Dragaš, bošnjacima i gorancima. I to ne bi bilo toliko eminento da iz opštinskog budžeta nije izdvojeno samo 18 800 eura za gorski deo opštine Dragaš, dok za Opolje oko 280 hiljada.

Znači, vidan je disbalans budžeta u ovoj opštini a ako uzmemo broj stanovništva, koji živi i radi u ovoj opštini, potpuno je evidentna razlika.

Drugo, ovi projekti su 90% slučajeva infrastrukturni. Znači manjkaju projekti koji su od ekonomskog aspekta, kulturološkog pa ako baš hoćete i od socijalnog karaktera.

Svi znate i čuli ste o katastrofi u Restelici i znamo da je tu Vlada zakazala svojim nezalaganjem i projektima, koji su od životnog značaja za taj deo i taj kraj, i tu predlažem da se na drugom čitanju izvrši korekcija, odredi određena suma novca, koja će biti jako potrebna tim ljudima.

Kao treće, da ne bude da samo kritikijemo Vladu, globalno gledajući, vidi se da je Vlada vodila računa o nekim sverama, kao što su krupni projekti u autoputevima, socijalnoj politici, makrofiskalnoj politici, kao i politici stranih ulaganja. To govorim uopšteno o budžetprojektu, to bi od prilike bilo ono što smo mogli uvideti i koje su prednosti a koje su mane ovog budžeta i normalno očekujemo da će se do drugog čitanja izvršiti korekcija i da će se uzeti u obzir naše sugestije i predlozi. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Urdhëro? Në emër të grupit parlamentar? Po, more! Zoti Gashi e ka një propozim në emër të Grupit Parlamentar. Latif Gashi e ka fjalën.

LATIF GASHI: Faleminderit, kryesues!

Kërkoj që në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike diskutimi të shkurtohet nga 10 minuta në 5 minuta, natyrisht nëse janë të pajtimit edhe grupet tjera parlamentare. Faleminderit!

KRYESUESI: Ok! Pasi është në emër të grupit parlamentar, jam i detyruar t'i pyes edhe të tjerët. Zoti Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit! Jo se i shikova kolegët deputetë se normalisht se na pa u konsultuar nuk, ne kemi demokraci të brendshme. Nuk kemi asgjë kundër, meqenëse mendojmë që në 5 minuta mund ta përmbledh secili prej deputetëve fjalimin. Kjo nuk është ndonjë problem për ne edhe nëse shkurtohet e pranojmë.

KRYESUESI: Zoti Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERY: Jo, kryesues ne jemi kundër këtij propozimi, për shkak se mendojmë që është jo korrekte tash disa prej deputetëve t’ia shkurtojmë fjalën. Pra, nëse ata që folën deri në këtë moment e patën të drejtën për ta shfrytëzuar 10 minutshin edhe këta të tjerët duhet ta kenë të njëjtën të drejtë. Ndoshta edhe dikush edhe nuk e shfrytëzon, ndoshta dikush do ta dorëzojë fjalën e shkruar, por kjo le t’i mbetet përgjegjësi secilit individualisht.

Ne jemi kundër që tash të shkurtohet kjo ose e shkurtojmë në fillim debatit ose nuk e shkurtojmë fare.

KRYESUESI: Nga AAK-ja, fjalën e ka Donika Kada-Bujupi.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Po, edhe ne po konsiderojmë që është konsumuar goxha fort debati edhe që jemi goxha vonë, prandaj për pesë minuta besojmë që mund të thuhet ajo çka ka mbet me u thënë e mos me e përsërit njëri-tjetrin. Prandaj, po e përkrahim me e shkurtuar debatin në pesë minuta. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E ka fjalën Zoti Svirca.

JETON SVIRCA: Edhe Koalicioni për Kosovë të Re mendon se është e arsyeshme që të shkurtohet debati në pesë minuta. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Milosavljeviq e ka fjalën.

SAŠA MILOSAVLJEVIČ: Hvala gospodine presedavajući!
I poslanička grupa Samostalne Liberalne Stranke smatra da treba da se skрати na 5 minuta debata. Hvala!

KRYESUESI: Zoti Kinolli e ka fjalën.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, nënkryetar!
Edhe Grupi Parlamentar “6+” e përkrah propozimin dhe mendon që është e arsyeshme që të shkurtohet në pesë minuta. Faleminderit!

KRYESUESI: Mirë! Atëherë, janë 64 deputetë. Të gjitha grupet përveç “Vetëvendosjes” kanë kërkuar pesë minuta. Nuk e hudhin në votim deputetëve të “Vetëvendosjes” që të mos ju ngelet hatri mund të flasin dhjetë minuta, të tjerët pesë minuta. Mirë, mirë! në rregull! Votimi po dihet është me shumicë pesë minuta e lëmë ashtu dhe... fjalën e ka deputeti Salih Morina.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryesues!
Të nderuar Kabinet qeveritar, ministra,
Të nderuar kolegë...

KRYESUESI: Regjia, pesë minuta është diskutimi.

SALIH MORINA: Të nderuar kolegë deputetë,
Konsideroj që buxheti për vitin 2013 nuk parasheh ndryshime të një politikë bërje ekonomike edhe si rrjedhojë nuk do të prodhojë asnjë efekt ndryshe se çfarë kemi pasur deri më tani. E ajo çfarë kemi pasur deri më tani është papunësia enorme, inflacioni, deficitit tregtar, zhvlerësimi i aseteve publike.

Për nivelin e zhvillimit ekonomik që ka Kosova sot, konsiderojmë që infrastruktura paraqet një faktor limitues në zhvillimin ekonomik. Investimet publike duhet të orientohen në industrinë përpunuese dhe në zhvillimin e ndërmarrësish, kryesisht përmes bizneseve të vogla dhe të mesme ku absorbojnë investime të vogla, krijojnë vende pune, ndikojnë në ngritjen e GDP-së, bruto-produktit të brendshëm, si dhe në ngritjen e standardit jetësor.

Prandaj, strategjia e zhvillimit ekonomik në Kosovë duhet të orientohet në prodhimtari, sepse me mungesën e një strategjie të tillë kapitali privat dhe ai publik është orientuar në degët shërbyese sidomos kapitali privat në hoteleri, turizëm dhe tregti. Edhe me buxhetin e vitit 2013 nuk parashihet përmirësim i deficitit tregtar, ku kontribuues në këto të hyra do të jenë doganat e Kosovës, relacioni në mes të parave të mbledhura në kufi, pra nga doganat e Kosovës me ato të mbledhura nga Administrata Tatimore e Kosovës është dhe do të mbetet në nivelin 75% me 25% në favor të doganave dhe siç shihet të paktën edhe tri vjetet të ardhshme arka e shtetit do të mbijetojë vetëm falë importeve enorme. Prandaj, derisa arka e shtetit mbijeton kësioj vendi do të vazhdojë të ngulfatet nga rritjet e vazhdueshme të hendekut tregtar.

Sipas UNDP sektori privat ka evazion fiskal më të lartë të ngjasuar ndonjëherë në ndonjë shtet të tranzicionit, ku 40% e shitjeve nuk deklarohen për qëllime tatimore, prandaj kemi të bëjmë me një ekonomi informale, evazioniste e cila nuk pritet të përmirësohet deri në vitin 2015. Unë do të diskutoj edhe buxhetin e Ministrisë së Mjedisit që edhe këtë vit vazhdon të jetë i ultë dhe pa prioritet për Qeverinë. Në dukje buxheti për Ministrinë e Mjedisit është i kënaqshëm, pra rreth 41 milionë, kurse vetëm për politikën e kësaj ministrie buxheti është 10 milionë euro. Në këtë draft buxhet për këtë ministri janë dy kode buxhetore që nuk kanë të bëjnë me këtë ministri e ato janë, shpronësimet që kapin shumën e buxhetit në vlerë prej 30 milionë e 41 mijë euro dhe kodi tjetër buxhetor, planifikimi hapësinor ku shuma në vlerë prej 3,7 milionë euro ka të bëjë me rregullimin e komplekseve memoriale.

Këto investime duhet të jenë nën kujdesin e institucioneve përgjegjëse për trashëgiminë kulturore e jo të trajtohen si çështje mjedisore. Pra, kemi të bëjmë me një buxhet që nuk do t'i përmbushë as kërkesat më elementare të qytetarëve të Kosovës sa i përket fushës së mjedisit që kemi të bëjmë me ujën e pijshëm, trajtimin e mbeturinave dhe ujërave të zeza,

si dhe mbrojtjen e ambientit në përgjithësi. Ky buxhet nuk adreson problemin e furnizimit me ujë të pijshëm, ku rreth 25% e banorëve të Kosovës ende nuk janë të kyçur në rrjetin e ujësjellësit. Në projekte të tilla, Ministria e Mjedisit do të investojë vetëm 2,1 milionë euro, që është 0,13% e shpenzimeve buxhetore, ose 0,34% e investimeve kapitale.

Ujërat e zeza dhe mbeturinat e përbëjnë pikën e zezë sa i përket mbrojtjes së ambientit. Është e kotë të investohet në furnizimin me ujë të pijshëm nëse nuk pastrohen ujërat e zeza dhe nëse nuk bëhet trajtimi i mbeturinave. Ujërat e ndotura po e dëmtojnë bujqësinë për shkak të ndotjes së lumenjve, po ndikojnë edhe në shëndetin e qytetarëve dhe po e largojnë Kosovën nga standardet ambientalistike të BE-së.

Buxheti për Ministrinë e Kulturës edhe pse kemi një rritje të vogël të buxhetit në krahasim me vitin 2012, karshi kërkesave që kanë institucionet vartëse të Ministrisë së Kulturës, prapë edhe këtë vit këto institucione do të kenë po të njëjtin buxhet. Për kulturën është projektuar një buxhet në vlerë prej 4.8 milionë euro, për të gjitha kategoritë buxhetore që bie më shumë se 100 mijë euro në krahasim me vitin 2012. Dhe, po t'i shikojmë ndarjet buxhetore nëpër kategori 1 milion euro shkojnë për paga dhe mëdijtje, 100 mijë euro për mallra dhe shërbime, 2 milionë për subvencione dhe 1,2 milion për investime kapitale. Sa i përket ndarjes buxhetore në kategoritë e subvencioneve nga ana e Ministrisë për kulturën është bërë një ndarje shumë e vogël në krahasim me departamentet tjera, sepse ky buxhet përpos politika të brendshme që ka kulturën, departamentin e saj, në këtë buxhet përfitues do të jenë institucionet vartëse të Ministrisë, si: Teatri Kombëtar, Qendra Kinematografike, Galeria e Kosovës, Filarmonia e Kosovës, Ansambli i Këngëve dhe Valleve, si dhe Kosova Filmi.

Këto institucione të rëndësishme edhe për këtë vit do të kenë po të njëjtin buxhet sikurse vitin e kaluar sa i përket kategorisë së subvencioneve. Departamenti i Sportit në dukje ka një buxhet në vlerë prej 7,3 milionë për investimet kapitale, por 4 milionë euro janë buxhet në bashkëfinancim me programin IPA, prej vitit 2012, që kryesisht këto projekte i dedikohen kulturës, rinisë dhe sportit, ndërsa nga kategoria e subvencioneve, sporti ka një buxhet në vlerë prej 1,2 milion dhe kjo do të thotë që federatat e Kosovës gjatë vitit 2013 do të kenë po të njëjtin buxhet. U përmend edhe nga kolegu deputeti Jetoni që rinia...

(Ndërprerje nga regjia)

(Drejtimin e seancës e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.)

KRYETARI: Vazhdojmë. Liburn Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: Faleminderit! Para se të filloj, do të doja që në deklarinimin pak më të hershëm të ministrit të Financave ku thotë se nuk varet fillimi i autostradës nga shitje e PTK-së desha ta përmend nenin 20 të këtij projektbuxheti, tek alokimi për Rrugën VI, ku thotë: “mjetet për ndërtimin e Rrugës VI do të alokohen atëherë kur bilanci bankar do të arrijë nivelin prej 300 milionë euro”.

Dhe, pikërisht kjo pra lidhet edhe me kushtëzimin nga FMN-ja e cila ka kërkuar që 300 milionë euro rezervë të jenë në fond në mënyrë që të mundësohet fillimi i autostradës. Në anën tjetër e kemi 300 milionë euro e Postës, si dhe e kemi shumën prej 326 milionë euro për investimet e menjëhershme në projektbuxhet. Për ato 26 milionë euro e kuptuam që do të vijnë nga shitja e distribucionit. Pra, e kemi shumë të qartë se edhe 300 të tjera kanë të bëjnë me shitjen e Postës. Për sa i përket analizës së këtij projektbuxheti do të doja ta cek një element që e ka hendikepuar analizën tonë në projektbuxhet dhe ky është raporti nëntëmujor i Ministrisë për shpenzimet në buxhet, të cilin na e ka dhënë Ministria pak kohë më parë.

Në këtë raport mungojnë të dhënat nga projektet apo investimet kapitale. Pra, kemi të dhëna të përgjithshme, por mungojnë detalet konkrete qysh ka qenë vitin e kaluar. Pra për çdo projekt të investimeve kapitale ne kemi pasur të dhëna dhe kemi pasur rast të shohim se deri ku ka mbërri situata, pra në bazë të investimeve kapitale. Ne po shohim pra, investime kapitale në projektbuxhetin e sotëm, mund t'i shohim në buxhetin e vitit të kaluar, por nuk mund ta shohim deri ku ka mbërri dhe sa është punuar në të gjitha ato investime kapitale për shkak se në raportin që na e keni dërguar, këto të dhëna nuk figurojnë. Pra, unë do të doja ta di pse janë fshehur këto të dhëna? Pse nuk janë, pse ne nuk e dimë sot si deputetë që jemi se secili projekt i investimit kapital deri në çfarë faze ka mbërri dhe për këtë nëntë mujor sa para janë shpenzuar për atë projekt? E për sa i përket projektbuxhetit, prapë edhe ky projektbuxhet pra e paraqet në fakt politikën e Qeverisë, është politikë, e cila nuk e sheh zhvillimin në bazë të prodhimit, por e cila bazohet tek importi dhe eventualisht kur flasim për ndërtim apo shfrytëzim prodhim përmes shfrytëzimit të mirave materiale drejtpërdrejt nga natyra, kjo bëhet në dëm të natyrës apo në dëm të mjedisit, gjegjësisht edhe në dëm të planifikimit hapësinor, gjë që këtyre fushave nuk u është dhënë fare prioritet me këtë projektbuxhet.

Kur flasim për bujqësinë kam pritur një kërcim kualitativ në buxhet te bujqësia meqenëse në vitet e mëhershme flitej gjithmonë për ngritje të kapaciteteve në mënyrë që këtë vit dhe vitet tjera të kemi rritje të madhe të buxhetit. Në fakt kjo çka pamë sot, çka po shohim sot dhe po diskutojmë këtu në lidhje me buxhetin në bujqësi, është mjaftë zhgënjyese pasi që buxheti aktual dhe mbështetja e ashtuquajtur e fuqishme për fermerët nuk kalon as 0,33% të prodhimit të brendshëm bruto të Kosovës. Vitin që shkoi parashihej rritje e investimeve kapitale në bujqësi për 2 milionë euro e në fakt u rrit vetëm gjysma, por tash po më duhet të shkoj pak më shpejtë, duhet ta kemi të qartë që në fushën e subvencioneve komplet shuma edhe pse është rritur për 1 milionë euro për dallim prej vitit të kaluar sasia, shuma e mjeteve jepet komplet tek pagesat direkte. Vitin e kaluar gjysma e saj është dhënë tek fusha e zhvillimit rural.

Tani zhvillimi rural është injoruar plotësisht, duke pasur parasysh që pagesat direkte sot tek ne jepen vetëm në kesh, nuk jepen në forma tjera, nuk jepen pagesat direkte për bujqit ta zëmë me ushqim apo me plehra, apo me fara, apo me mënyra tjera, por jepen vetëm përmes keshit. Kjo mënyrë që të rriten subvencionet në dëm të investimeve në zhvillimin rural po tregon qartë që Qeveria po ka nevojë që të japë para kesh drejtpërdrejt te qytetarët, gjë që si duket kjo tregon që do të kemi shumë shpejt zgjedhje, pra vitin e ardhshëm.

E për sa i përket fushës së mjedisit vazhdon po ashtu njëjtë edhe avazi i vjetër ku komplet shifra fshihet në masë të shpenzimeve të shumta, që lidhen me shpronësimet.

Sa i përket fushës së mjedisit...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! 5 minuta i ke Liburn. Pak më shpejt dhe nuk ke të drejtë ta paragjykosht shitjen e postës për 300 milionë.

(Ndërhyrje)

Dorëzoje fjalimin, por nuk ke të drejtë të paragjykosht. Edhe një herë po them - shitjen e postës për 300 milionë, meqë devida për 3 vjet mund të jetë 300 milionë.

(Pjesë e diskutimit, e dorëzuar me shkrim, nga deputeti Liburn Aliu)

...Edhe në fushën e mjedisit, vazhdon avazi i vjetër. Fjala mjedis duket si e hidhur për politikën e Qeverisë. Natyrisht, kjo politikë dhe mjedisi i shëndoshë e përjashtojnë njëra-tjetrën. Dhe, kjo shihet qartë në buxhet.

Me përjashtim të rritjes së buxhetit në burimet ujore, në të gjitha fushat tjera kemi rënie, apo ngecje në vend të buxhetit dhe, në anën tjetër, shifra të mëdha të alokimit të buxhetit, pra këtë vit janë 43 867 745, njëjtë si vitin e kaluar, kur ishin 66 870 416. Kjo të bën të mendosh se po investohet në mjedis, dhe kur këtë shifër e “qëron” nga shumat për shpronësimet, mbeten ca milionë të paktë e që nuk mund të ndikojnë pothuajse fare në mjedisin që degradohet çdo vit.

Shpenzime kapitale, pa shpronësimet, këtë vit i kemi 10 870 000, apo 270 mijë euro më tepër se vitin që shkoi. Ndërsa, kur e shikon kornizën afatmesme dhe e krahason atë me investimet kapitale për vitin 2013, duket se kemi 3 milionë më tepër. E në fakt, po të shikohen se ku janë ato rritje, prapë lidhen me shpronësimet.

Në këto shpronësime, zotërinj, hyjnë edhe aso shpronësimesh që lidhen me privatizimin e tokës bujqësore, që i pasurojnë njerëzit brenda natës me buxhetin e shtetit.

E kur flasim për shëndetësinë, buxheti i rritur për 18,2 milionë, pra nga 88,6 milionë në 106,8 milionë, në sy të parë mund të duket shpresëdhënëse. Krahasimi i tij me bruto-prodhimin e brendshëm, që përbën 0,3%, si dhe alokimin e kësaj rritjeje vetëm në mallra e shërbime dhe paga bëhet e qartë se kjo nuk korrespondon me deklaratimet për një reformë në shëndetësi.

Në fakt, reforma në shëndetësi, ashtu e ndarë nga pjesa tjetër, nuk mund dhe të ndodhë pa ndodhur ajo politike, së pari.

Joserioz e bëjnë këtë projektbuxhet edhe shumat fikse prej 600 mijë euro për spitale më të mëdha dhe 250 mijë euro për spitalet e vogla.

Ky projektbuxhet, në fakt, jep edhe një dëshmi për nevojën e ndryshimeve rrënjësore në këtë shoqëri.

(Liburn Aliu, d.v.)

KRYETARI: Vazhdojmë. Imri Ahmeti e ka fjalën. Më fal, më duket se e kapërceva radhën.

IMRI AHMETI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Janë dy arsye që më duhet ta reduktoj diskutimin. E para është se shumë çështje u thanë dhe e dyta shkurtimi i minutazhit tonë për të diskutuar.

E para që do të them për parametrat e përgjithshëm të ndërtimit të pushtetit u referuan nga shumë parafolës të mi, me të cilët normalisht në shumicën e rasteve dakordohem, dhe çështja tjetër është se pati shumë diskutime edhe për një ndarje joproporcionale dhe një ndarje jo të drejtë ndërmjet komunave, që në veçanti u shtjellua nga disa kolegë të Grupit tonë Parlamentar.

Unë i dëgjova disa diskutime këtu, edhe në kuptimin e lokalizmit prej nga vijnë disa deputetë, dhe kjo më bëri përshtypje që të heq dorë nga diskutimi i përgatitur për të folur normalisht edhe prej rajonit prej të cilit vij unë.

E para, ndoshta nuk është në rregull të flasim për politikën lokale buxhetore, por megjithatë edhe buxhetet komunale janë pjesë përbërëse e këtij buxheti.

Çështja shumë e rëndësishme për trevën e Lipjanit është anashkalimi që i është bërë me rastin e heqjes së trasesë së autostradës, e cila sigurisht do të ketë efekte negative për zhvillimin e mëtutjeshëm të kësaj treve.

E dyta, edhe me buxhetin e vitit 2013, kjo Qeveri po e anashkalon trevën e Lipjanit për të investuar në disa resurse, që nuk janë vetëm të komunës së Lipjanit, por janë resurse të nivelit të Kosovës. Mund ta shihni te Ministria e Planifikimit Hapësinor, është paraparë rregullimi i shtratit i gati të gjithë lumenjve të Kosovës. Ndërsa lumi Sitnica vazhdon të kundërmojë nga kanalizimet me vite të tëra dhe vazhdimisht prolongohet si një projekt investiv, që është jashtëzakonisht i nevojshëm, sepse mund të jetë me rrezik edhe për shëndetin, edhe për mundësinë e epidemive të ndryshme.

Është çështja e Parkut Nacional të Blinajës, që e kemi quajtur park nacional. Është një resurs i rrallë, që është i vetmi në Kosovë, dhe Qeveria përsëri absolutisht asnjë cent nuk e ndan. Është i vetmi resurs, në të cilin kultivohen dhe ruhen edhe resurset e botës shtazore.

Çështja tjetër është Shpella e Mermerit, i vetmi resurs që është në nivel vendi dhe më gjerë, për të cilin kjo Qeveri përsëri asnjë cent nuk e jep.

Prandaj, mendoj se vërtet bien në sy disa investime që janë të nevojshme në nivel vendi, pavarësisht lokaliteteve kah vijmë, e kjo bie në sy, deshëm a s'deshëm ta pranojmë, që ndikimet politike e kanë bërë këtë ndarje buxhetore jo të drejtë dhe joproporcionale karshi nevojave që ekzistojnë në terren.

Më lejoni ta them edhe një çështje tjetër. Ka disa vite rresht, ndoshta viti i pestë a i gjashtë, që investohet në një park të biznesit në Drenas. A thua ka Kosova nevojë të ketë edhe ndonjë park tjetër të biznesit? Ndonjë zonë tjetër të biznesit? A ka diku në ndonjë komunë që është ndërtuar ndonjë zonë e biznesit? Mos harroni se në Lipjan është ndërtuar një zonë e biznesit dhe absolutisht kurrë nuk është ndihmuar dhe po vazhdon të mos ndihmohet si një zonë që është mjaft atraktive për investitorët, edhe të brendshëm, edhe të jashtëm.

Unë pa dashur të vazhdoj më tutje, do ta shtroja vetëm edhe një çështje te ministri i Financave, meqenëse është këtu. Unë e di që zakonisht tavanet apo limitet e kategorive buxhetore të organizatave të ndryshme buxhetore jepen dhe përcaktohen nga Ministria e Financave. Por, ka raste, siç është rasti i komunës së Lipjanit, kur janë rritur mallrat dhe shërbimet për 116%. Çka domethënë kjo? Janë rritur subvencionet dhe transferet për 111%, janë rritur shpenzimet komunale për 118%, e kjo ka ndikuar në rënien e investimeve kapitale për 10%.

Mendoj se Ministria këtu është dashur të ketë kujdes, sepse ne patëm diskutues paraprakë dhe poenta jonë është që ta ndërtojmë një buxhet me sa më pak shpenzime në mallra, shërbime e në kategori të tjera, duke e ngritur pozicionin e investimeve kapitale, ndërsa në atë komunë ndodh e kundërta, dhe këtu Ministria besoj në fazën e mëtutjeshme të shqyrtimit të këtij buxheti do të duhej të ketë kujdes edhe me organizatat tjera buxhetore.

Unë kujtoj se në fazën e shqyrtimit të këtij buxheti ka hapësirë dhe mundësi që disa çështje të rirregullohen, përndryshe kështu si është, edhe unë do të mbetem në qëllimin e grupit tonë dhe do të jem kundër këtij projektbuxheti. Faleminderit!

KRYETARI: Replikë, Shaip Muja!

SHAIP MUJA: Jo, e ka përmendur zonën e Drenasit, ku unë kam marrë vota dhe dua t'ia adresoj një vëmendjen deputetit, i cili e përmend parkun industrial në Drenas. Ai është një vlerë, e cila nuk është dedikuar vetëm për Drenasin, mirëpo pozicioni gjeografik i Drenasit është në qendër të Kosovës dhe si i tillë ka qenë i goditur edhe gjatë luftës, ndërsa sot duhet t'i lejohet edhe perspektiva.

Drenasi, meqë e kam parë edhe unë në linjën buxhetore, nuk është i stimuluar mirë, edhe pse ndikon shumë në rritjen e vlerës buxhetore të arkës së shtetit, me resurset që i ka "Ferronikeli" dhe është ndër qytetet më së paku i zhvilluar, në krahasim me komunat e vogla.

Ndërsa sa i përket devijimit të autostradës që u përmend, Lipjani do të kufizohet nga dy autostrada dhe i janë krijuar kushtet zhvillimore jashtëzakonisht të mëdha për komunikim me gjithë territorin për zhvillim, prandaj nuk është mirë të jemi subjektiv, sepse devijimi i autostradës është bërë për shkaqe ekonomike dhe të sigurisë. Faleminderit!

KRYETARI: Një minutë! Imri Ahmeti, kundër-replikë!

IMRI AHMETI: Faleminderit, zotni kryetar!

E para, nuk jam kundër atij parku, nëse më keni kuptuar drejt.

E dyta, do të them: ai është bërë si Ura e Shenjtë, që sa vite e vite financohet për çdo buxhet që është aprovuar këtu edhe më herët, jo vetëm në këtë legjislacion. Janë derdhur miliona.

Pastaj, ai park, ju vetë e quajtit park industrial. Por, shikoni çfarë lloj biznesesh janë vendosur brenda atij parku! Absolutisht nuk kanë të bëjnë me industri hiç.

Dhe, çështja e autostradës. Vendimi i Kuvendit dhe traseja e aprovuar ka qenë, e di këtë mirë edhe ministri i Infrastrukturës, zoti Mujota, t'i bjerë nëpër Shtime e Lipjan.

Pra, nuk është me rëndësi me kë kufizohet Lipjani, E di unë me kënd kufizohet. Por, e rëndësishme është që është anashkaluar një vendim i këtij Kuvendi dhe është vendosur njëanshëm në një pjesë tjetër të Kosovës.

KRYETARI: Jo, jo! Fjalën e ka deputeti Ramë Vata.

RAMË VATA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Kolegë deputetë,

Unë në fillim e përgëzoj ministrin e Financave, zotin Hamza, për përgatitjen e mirë të këtij projektbuxheti, si nga ana përmbajtjesore, po ashtu i argumentuar dhe i përgatitur mirë edhe teknikisht.

Ky buxhet duhet nënkuptuar se është buxhet i mundësive reale, e që është si rezultat i punës së mirë të Qeverisë.

Unë do të përpiqem të them diçka që të tjerët nuk e kanë thënë, edhe pse të gjitha janë shteruar. Pasi edhe ministri i Arsimit erdhi, do të kisha bërë apel që të rritet buxheti për universitetet e reja dhe për Universitetin e Prishtinës, krejt në funksion të ruajtjes së cilësisë, sepse kemi programe të reja që duhet të zhvillohen, dhe nevojitet angazhim i stafit të ri akademik, e të mos dëmtohet cilësia shkakut i kufizimeve buxhetore.

Një gjë që e vërejta dhe që besoj se do ta bëjmë amendamentim, i cili ka mbetur anash, nuk e vërejta kurrkund që ka buxhet për Këshillin Kombëtar të Shkencës, meqë është një këshill shumë me rëndësi dhe që është i themeluar nga ky Kuvend, në vitin 2007. Dhe, për këtë këshill duhet të mendohet, sepse funksionimi i tij e ka një rëndësi shumë të

madhe, pasi do të jetë zbatuesi kryesor i programit kombëtar të shkencës dhe evaluimit të institucionit shkencor në Republikën e Kosovës. Prandaj kërkoj që kjo të rregullohet në projektbuxhet.

Do të isha marrë pak edhe me ndërtimin e shkollave dhe të rrugëve. Ne e dimë që është nevojë e çdo fshati, bile kur kemi shkuar gjatë fushatës - kanë qenë rrugët dhe shkollat. Ne e dimë se në gjithë botën rrugë shtrohen me asfalt, shkollat ndërtohen me beton, e nuk ndërtohen me letra, prandaj nuk është me vend të thuhet “buxhet i asfaltit dhe i betonit”.

Një tjetër çështje që do ta them, për shembull, është komuna e Therandës, prej nga unë vij. Komuna e Therandës asnjëherë nuk ka qenë nën qeverisjen e Partisë Demokratike të Kosovës, ndërsa unë e kam nxjerrë një statistikë. Vetëm në shkolla, prej vitit 2009 deri në vitin 2012, janë investuar diku 9 milionë e 500 mijë euro prej Ministrisë së Arsimit; nga ajo e Infrastrukturës me sa e di unë 6 milionë, e kështu me radhë. Prandaj, nuk ka vend që të thuhet se kjo Qeveri po i diskriminon komunat, por ka punuar në mënyrën më të drejtë të mundshme, në suazat e kufijve që i lejon mundësia e Qeverisë.

Krejt në fund, unë do t’u bëj ftesë të gjithë kolegëve që të punojnë në amendamentimin e kërkesave që do të dalin për çështjet e caktuara. E ndiej obligim prej anës nga vij, sepse u kemi premtuar të gjithë qytetarëve dhe do të kërkoj e do të jem në konsultim edhe me deputetët prej nga vij, e kam për obligim ta kërkoj një rrugë për fshatin Maçitevë, që të gjithë e kanë premtuar dhe kanë thënë se do ta amendamentojnë, por edhe një shkollë për fshatin Vraniq, sepse u kemi premtuar disa herë, por edhe me kolegët këtu jemi dakorduar që ta kërkojmë dhe të mundohemi ta futim në amendamentimin e buxhetit për leximin e dytë. Faleminderit!

KRYETARI: Teuta Haxhiu! Nuk është! Sevdije Lama e ka fjalën.

SEVDIJE LAMA: Faleminderit, kryetar!

Nëse e shohim buxhetin e komunës së Gjakovës, aty shohim se Drejtoria e Bujqësisë i ka vetëm dy prioritetet - ndërtimin e kanaleve për ujitje në territorin e komunës dhe ndërtimin e pendëve në territorin e komunës.

A nuk do të duhej të dilni në mbështetje të prodhuesve bujqësorë, apo në ndërtimin e ndonjë serre, a ku ta di unë?

Nëse shkojmë te Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, aty i shohim këto kode - ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës lokale Orize-Mejë, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës lokale në Moglicë, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës lokale në Smolicë, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës lokale në Skivjan, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës lokale në fshatin Dujakë.

Jo se jemi kundër, ose se nuk kemi nevojë për asfaltimin e rrugëve, por konsideroj se nuk janë studiuar resurset ekonomike të komunës së Gjakovës, nëpërmjet të cilave do të caktoheshin prioritetet për projekte nëpërmjet të cilave krijohet përmirësimi i ambientit biznesor, zhvillimi ekonomik dhe të bëhet përmirësimi i mirëqenies së qytetarëve atje. Andaj, i ftoj zyrtarët përgjegjës të komunës së Gjakovës që t’i ndryshojnë linjat brenda

buxhetit të drejtorive përkatëse të zhvillimit ekonomik dhe në afat të paraparë kohor me ligj t'ia paraqesin këto prioritete Komisionit për Buxhet dhe Financa. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Faleminderit, kryetar!

Diskutimin e kam të gjatë rreth 10 minuta, ose më shumë se 5 minuta, por meqë kam mbetur i vetmi që kam qenë kundër që diskutimi të shkurtohet, ndoshta do ta keni në konsideratë këtë fakt.

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Projektbuxheti i Kosovës për vitin 2013 është projekt i qeverisjes, i cili Buxhetin e Kosovës e bën Buxhet të Kosovës atëherë kur mblidhet ai, kurse jo edhe kur shpenzohet. Pra, Buxheti i Kosovës grumbullohet prej qytetarëve që janë kryesisht konsumatorë të mallrave të importuara, porse nuk u kthehet me gjithë mend atyre dhe sigurisht nuk u kthehet për ta ndryshuar këtë gjendje të mjerueshme.

Tre çereku i këtij buxheti mbushet në kufijtë e Kosovës, duke e bërë Kosovën shtet të thjeshtë dhe të dobët, kurse popullin e saj të varfër e të papunë. Përgjithësisht, buxheti i projektuar për vitin 2013 kryesisht kopjon dhe bart numra nga vitet paraprake, e deri në vitet e ardhshme. Vetë këta numra të përsëritur e garantojnë mosndryshimin dhe stagnimin. Po ashtu, kjo dëshmon që Qeveria ka shpërfillur edhe qytetarët dhe Kuvendin me këtë joseriozitet dhe dembeli. I mbushin shtyllat me numra të kopjuar deri në shifrën e njësheve për t'i hequr qafe disi ata, të cilëve Qeveria duhet t'u japë llogari.

Mungesa e vizionit për zhvillim ekonomik shndërrohet në buxhet të përsëritur, ku ndryshimet e vogla nuk e mbulojnë as inflacionin. Të kopjosh, do të thotë ose je i paditur, ose i papërgjegjshëm.

Në anën tjetër, investimet kapitale me shifra të rrumbullakuara me shumë zero, sërish tregojnë dembeli dhe arbitraritet, e jo planifikim zhvillimor.

Fondi Monetar Ndërkombëtar po përdoret si argument justifikues për këtë projektbuxhet. Mirëpo, Fondi Monetar Ndërkombëtar brengoset vetëm për shifrat përfundimtare, për stabilitetin makrofinanciar, pa e konsideruar strukturën e zhvillimit ekonomik, e as atë se ku orientohen shpenzimet nga Qeveria. Njëjtë po vepron edhe Ministria e Financave, e cila logjikën e FMN-së për shtetet në botë e ka përbrendësuar në Kosovë. FMN-ja sheh shtete të cilat me shpërthimin e krizave të ndryshme mund ta kontaminojnë rrethinën, ndërkaq në anën tjetër kjo ministri me këtë logjikë sheh komuna, rajone dhe harta votuesish.

Përputhja me Fondin Monetar Ndërkombëtar duhet të jetë pasojë, e nuk duhet të jetë qëllim. Vetëm asisoj mundësohet zhvillimi dhe të ketë qasje zhvillimore.

Te Ministria e Punëve të Jashtme, për shembull, e kemi si program akademinë diplomatike me vetëm 328 mijë euro buxhet dhe 4 të punësuar. Po, emri i madh, akademi

diplomatiqe, me buxhet simbolik dhe të njëjtë deri në shifrën e fundit për vitet 2014 e 2015. Kemi përqendrim të ngjarjet inauguruese disi, e jo të punët që duhet kryer dhe institucionet që duhet ndërtuar.

Po ashtu, për shembull, edhe te instituti i politikave sociale kemi emërtime që mbeten pa substancë, sepse financat e pakta të alokuara e tregojnë mungesën e sinqeritetit. Institutit të politikave sociale i ndahen vetëm 150 mijë euro, me gjithsej 15 të punësuar. Ky institut do të duhej t'i bënte politikat sociale, e jo Ministria, sepse instituti i këtillë bën planifikime e parashikime afatgjata që sjellin qëndrueshmëri, për dallim prej Ministrisë që ekzekuton me mendësi afatshkurtër.

Shpërputhjet me kornizën afatmesme të shpenzimeve vijnë për shkak se ky projektbuxhet nuk i përket planifikimit, që e nënkupton planifikimin afatmesëm.

Mirëqenia sociale nuk matet vetëm me kriteret makroekonomike, si bruto-produkti vendor, mesatarja e të ardhurave për frymë, rritja ekonomike apo rritja e rrogës, por nga situata konkrete e secilit qytetar.

Milionat e derdhur në emër të pensioneve të ndryshme dhe ndihmave sociale kanë qenë të nevojshme për t'i futur në treg, por nuk kanë mjaftuar për ta siguruar minimumin jetësor të atyre që kanë nevojë për mbështetje shoqërore.

Nuk ka politikë sociale pa një ide dhe një objektiv të drejtësisë shoqërore dhe nevojave të qytetarëve. Përmirësimi e ka referencën në të kaluarën, pra pak më mirë se shumë keq, se që ishim, por jo edhe sukses, sepse nuk kemi referencë në të ardhmen. Sistemi fiskal dhe sigurimet shoqërore janë mjete për këtë, por nevojitet programi me qëllime e me objektiva. Duhet një ideal, duhet një ide, duhen ca qëllime që do t'i arrish, dhe vetëm mandej i mat sukseset. Me këtë logjikë, kur ke referenca vetëm në të kaluarën, ke përmirësim, duke e përjashtuar kategorinë e suksesit si të tillë.

Pse nuk po thoni asnjëherë - u realizua kapitulli i parë i vizionit ekonomik Banjsko, apo u realizua sektori i tretë i kapitullit të dytë të vizionit ekonomik në Banjsko? Pra, asnjëherë nuk thuhet çka është përmbushur, në krahasim me atë që është planifikuar, por vetëm përmirësime, që janë arnime, janë menaxhim i krizave, sikur EULEX-i në rrafshin politik, po ashtu FMN-ja në rrafshin ekonomik, është përbrendësuar logjika që edhe në brendësi duhet ta menaxhojmë krizën tonë.

Nuk mund ta trajtojmë vendin tonë sikur FMN-ja. Nuk mund ta trajtojmë vendin tonë sikur EULEX-i. Ne duhet të kemi aspirata dhe ambicie më të mëdha.

Në rregull! Nuk kemi mundësi që t'i plotësojmë nevojat, mirëpo pse nuk rriten mundësitë? Nuk ka kreativitet që të rritet ky buxhet. Si të rritet ky buxhet? Kjo është një pyetje që nuk është shtruar asnjëherë seriozisht dhe mendoj se është një problem shumë i madh.

Në anën tjetër, njëmend ndoshta buxheti nuk është i nevojave, por është buxhet i dëshirave. Kjo autostrada për Shkup është më shumë dëshirë, sesa nevojë. Nëse i shikon qytetarët, e kupton shumë mirë se cilat janë nevojat e tyre.

Edhe autostrada e kombit për Tiranë, pjesa në Kosovë, e shkurton rrugën për 1 orë, kurse ajo në Shqipëri e shkurton për 6 orë. Aty është shkurtimi i vërtetë i kohës së udhëtimit, e jo te kjo pjesa tjetër.

Prandaj, po them, është më shumë buxhet i dëshirës se sa i nevojës, ndërkohë që thuhet se është i mundësive. E unë besoj se mundësitë duhet të rriten, sepse ashtu tregohet lidhshmëri në ekonomi.

Politikat sociale e garantojnë një jetë me dinjitet, duke ofruar resurse të nevojshme ekzistuese dhe eliminojnë izolimin e një pjese të shoqërisë. Qëllimi kryesor i politikës sociale është sigurimi dhe garantimi i minimumit jetik për secilin qytetar të shtetit të Kosovës. E unë besoj në atë tezën që pabarazia e brendshme krijon përjashtime të jashtme. Pra, shtresat e caktuara dhe grupet shoqërore përjashtohen për shkak të pabarazisë brenda. Përjashtimi është çështje, është dallim i shkallës me pabarazi.

Dhe, me këtë rast, unë do të kisha përmendur minimumin jetik dhe përmbushjen e standardeve minimale për jetën e secilit qytetar dhe politikat sociale, e mandej të shohim çka po plotësojmë - ushqim dhe ujë të pijshëm, higjienë dhe shëndet, strehim dhe ngrohje, siguri e integritet fizik, arsim dhe rekreacion, punësim dhe mbrojtje e të papunëve. Mirëpo, te mirëqenia sociale i kemi 1,5 milion më pak se në vitin e kaluar. Domethënë, duhet të definohet se çka po duam.

Dhe, tjetra, para 6 javësh, Qeveria tha se po i rrit pensionet 40% e 33%, e cila do të paguhet retroaktivisht 26,45% dhe 11,1% nga janari i këtij viti, e pjesa tjetër në vitin 2013, por çështja është pse retroaktivisht nga janari i këtij viti. Paratë paskan qenë aty! Është e qartë se po kushtëzohet miratimi i ligjit, e kjo është një lojë me pensionistët, sepse kjo ka mund të bëhet shumë më mirë, shumë më ndryshe, shumë më herët.

Dhe, në fund, desha ta pyes ministrin, se nuk e kam të qartë një gjë. I kam shikuar pak numrat. Në vitin 2011 pensioni bazik ka qenë 45 euro. Në vitin 2012...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Po, edhe sa kohë? Jo, një minutë e gjysmë është shumë, një minutë bën. Atëherë, mundësojani për një minutë e gjysmë.

ALBIN KURTI: ...50 euro, në vitin 2013, 60 euro. Tash për vitin 2012 janë paraparë gjithsej 73 milionë e 38 mijë euro, e nëse kësaj ia shtojmë 20%, sepse ky 50 euro për t'u bërë 60 euro duhet shtuar 10 euro, që është 1/5 - 20%, atëherë duhet të jetë 87 milionë e 645 mijë euro, e jo siç po figuron aty, 81 milionë e 337 mijë e 677 euro. Pra, është një diferencë prej 6 milionë e 370 mijë e 923 euro. Nëse këtë e pjesëtojmë tash për 60 euro,

sa do të jetë pensioni, dalin gjithsej 105 132 pensione. Nëse këtë e pjesëtojmë për 12, sa është numri i muajve në vit, atëherë dalin 8 759 pensionistë.

Dhe, ajo çka nuk e kam të qartë, është se qysh këta pensionistë, ose është paraparë që kaq do të jetë numri më i madh i atyre që vdesin se sa i atyre që i bëjnë 65 vjet, ose është çështje e spastrimit të listave. Po me të vërtetë, këtë gjë nuk e kam të qartë prej këtyre shifrave. Faleminderit!

KRYETARI: Mirë, urdhëro ministër! 2 minuta i ke.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, kryetar!

Fillimisht dëshiroj ta falënderoj zotin Kurti, mirëpo buxheti i reflekton prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Se Qeveria është e aftë për t'i rritur të hyrat tregojnë të dhënat, nëse krahasohen prej viteve të kaluara, dhe trendit që është. Gjithashtu, edhe rritja e buxhetit.

Ne mund të kemi dallim në prioritete, e pranoj këtë.

Ndërsa, sa i përket çështjes së fundit, që u ngrit rreth pensioneve, ato janë të kalkuluar ekzakt, përveç se është i kalkuluar numri aktual i atyre që përfitojnë nga pensionet, është llogaritur në bazë të ecurive të deritanishme edhe rritja natyrale e pensionistëve, që do të ketë rritje të numrit të tyre dhe buxheti është më se i mjaftueshëm. Është i shpërndarë nëpër disa kategori: kategoria e pensionistëve kontribut-dhënës, kategoria e pensionistëve të pensioneve bazike, e pensioneve me aftësi të kufizuara, dhe është e shpërndarë nëpër vija. Pra, buxheti është i llogaritur në detaje dhe jam i sigurt që buxheti është më se i mjaftueshëm për dhënien e pensioneve sipas vendimeve të Qeverisë.

KRYETARI: Faleminderit! Një njoftim, besoj se ju intereson. Tani kemi të paraqitur për fjalë kryesisht nga Lidhja Demokratike dhe Partia Demokratike. Nëse keni mundësi, shkurtrojeni pak diskutimet. Fjalën e ka deputeti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Unë desha të ngre çështjen që ne e kemi miratuar një ligj për të burgosurit dhe ai ligj parashihet të hyjë në fuqi, por ndoshta është një mungesë e buxhetit për këtë ligj, që do të thotë se nuk është paraparë për vitin 2013, por mendoj se ligji e parasheh që të burgosurit politikë me këtë ligj të ndihmohen, e sidomos për ata që e kemi një kategori shumë të vjetër dhe kanë nevojë. Për kontributin e tyre që e kanë dhënë, ndoshta as me këtë ligj nuk mund t'u ndihmojmë, as me asnjë buxhet, por megjithatë është e nevojshme ta kemi parasysh këtë kategori.

Prandaj, derisa nuk është këtui, kemi mundësi për amendamentimin e tij dhe të paktën të bëjmë diçka në këtë drejtim.

Kurse, në anën tjetër, në buxhetin e Qeverisë, i ardhur këtui, ka disa rritje, por ato nuk janë të mjaftueshme me raportin, me të cilin ne hyjmë në vitin kalendarik 2013.

Ministria e Bujqësisë është rritur me përqindje 1,8, ndoshta me grande rritet më shumë, por është një përqindje shumë e ulët, kur i kemi parasysh sfidat dhe Raportin e Progresit, që drejtpërdrejt ndikojnë për mjedis dhe në bujqësi.

Ne ende nuk i kemi prioritet bujqësinë e as mjedisin, kurse i kemi dy raporte që vijnë për fizibilitetin që tregojnë se bujqësia dhe mjedisi janë pjesë dhe objektiva kryesore të Bashkimit Evropian për vendet e Evropës, por edhe për vendet për anëtarësim, ose që duhet të anëtarësohen. Derisa ne kërkojmë të anëtarësohemi në këta mekanizma, atëherë duhet t'i kemi edhe prioritetet, të cilat duhet t'i shtrojmë si çështje për zhvillimin e vendit. Mungesa e këtyre domethënës se ne ende nuk jemi në prioritetet e duhura, për të cilat vendi ynë ka nevojë.

Për çështjen e buxhetit për komunat, mendoj se krahasimet e ndryshme që janë bërë deri më tash nuk janë të balancuara, për arsye se Prizreni me Prishtinën janë dy qytete kryesore të Kosovës që dallojnë me numër të banorëve të regjistrimit të popullsisë për 20 000 sish, ndërsa për numrin e përqindjes së buxhetit dallojnë 100%.

Komuna e Prishtinës i ka 190 000 banorë, ndërsa Prizreni 170 000 mijë. Buxheti i Prizrenit është 31 milionë euro, ndërsa buxheti i Prishtinës është 56 milionë. Do të thotë gati 100% është i rritur buxheti dhe mendoj se kjo është një balancë jo e drejtë. Ndoshta Prishtina duhet ta ketë një përqindje për shkak se është kryeqytet Prishtina, por megjithatë Prizrenit duhet t'i rritet buxheti, sepse është vend, qendër dhe kryeqendër historike.

Prandaj, mendoj se ministri duhet ta ketë parasysh buxhetin dhe duhet shohë edhe mundësinë e riorientimit që të ndihmohet qyteti, i cili i ka nevojat më të mëdha të zhvillimit ekonomik.

Mendoj se Ministria e Bujqësisë nuk ka bërë sa duhet në këtë drejtim, ose e ka kaluar në heshtje një pjesë dhe duhet të kërkojë që buxheti i bujqësisë dhe i mjedisit, edhe pse ministri i Mjedisit nuk është këtu, të rritet të paktën edhe për 2%, që do të thotë që këtë buxhet për Ministrinë e Bujqësisë ta kemi me 4%, e po ashtu edhe për Ministrinë e Mjedisit.

Unë mendoj se nëse i rritim këto, të paktën për hapat kohorë dhe zhvillimin e strategjisë që e ka prezantuar Ministria e Bujqësisë, ajo duhet të mbulohet nëpërmjet buxhetit. Ndryshe, ajo strategji do të jetë pjesë e një angazhimi, por jo edhe e një realizimi të plotë të zhvillimit të bujqësisë.

Ka shumë gjëra në buxhet që duhet të cekën, por ato çfarë janë më thelbësore, edhe një herë them se Ministria e Financave dhe ministri që e kemi këtu të pranishëm, duhet të kenë kujdes për kategorinë e të burgosurve politikë. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro! Ministri e ka fjalën, e pastaj Albini, replikë.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, kryetar!

Do të bëj përpjekje që ta jap vetëm një sqarim. Janë dy ligje në fazën finale të përfundimit të tyre, e pritët edhe kompletimi i akteve nënligjore. Puna me ligjin e të burgosurve politikë është më e avancuar dhe pritët që ato akte nënligjore të miratohen në Qeveri dhe siç mund ta vëreni janë të planifikuara mjetet - kostoja e këtyre ligjeve qysh nga viti 2014. Mirëpo, nëse këto ligje dhe akte nënligjore mundësojnë përcaktimin e kostove të këtyre ligjeve dhe aprovohen më herët, për proceset e ardhshme buxhetore është krijuar hapësirë e mjaftueshme për të filluar implementimi dhe kompensimi i këtyre kategorive. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Replikë me ministrin, deputeti Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Faleminderit!

Së pari, kjo rritja, edhe një herë po na kthen në të kaluarën. Vazhdimisht krahasohemi me diçka paraprake, kur ka qenë shumë keq e tash është pak më pak keq, rrjedhimisht na qenka mirë, po nuk është kjo qasja për ambicie të mëdha e aspirata të shtuara, përkundrazi. Dhe nuk është rritja e projektuar e planifikuar, nuk është pra rritje e cila rrjedh nga politika qeverisëse. Më shumë ka disi karakter demografik, se sa që ka rritje të planifikimit qeveritar dhe të vizioneve.

Por, e fundit, është më e rëndësishmja, ministër që 6 milionë e 300 mijë euro janë më pak për rritjen e pensionit bazik, jo për ata kontribut-dhënës. Dhe kjo reflektohet në 8 759 njerëz pensionistë mbi moshën 65-vjeçare, 12 muaj në vit. Pra, ose janë 6 milionë më pak, ose janë 8 759 njerëz tepër, prandaj për këtë ju kisha lutur, sepse nuk e kam të qartë, të më përgjigjeni me përgjigje matematikore, je o letrare.

KRYETARI: Urdhëro ministër, përgjigju!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit!

Zoti Kurti, është kërkuar që të vendoset një disiplinë sa i përket korrigjimit të listave të përfituesve prej Buxhetit të Kosovës, edhe te numri i nxënësve, edhe te numri i pensionistëve, e tash është duke u bërë rregullimi edhe i numrit të invalidëve të luftës, i familjeve të dëshmorëve e çështje tjera.

Ministria e Financave, kur i kemi kërkuar shifrat prej Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, kemi ardhur në përfundim se duhet të ketë një korrigjim të shifrave nga kjo ministri dhe kjo ka ndodhur. Ka pasur planifikime për këtë vit më shumë se sa janë nevojat për shpenzim dhe për vitin e ardhshëm kemi shkuar me shifra reale, dhe fondet e ndara për këtë kategori janë më se të mjaftueshme. Mund të jetë dallimi, dhe është dallimi te numri i cili ka qenë i kalkuluar për vitin 2012 dhe nuk është arritur asnjëherë, sepse deri tash diku realizojnë pensione bazike rreth 108 mijë apo 109 mijë persona në Kosovë dhe e kemi aplikuar rritjen ekonomike. Edhe për vitin e ardhshëm, buxheti është më se i mjaftueshëm për këtë kategori.

Dhe unë jam shumë i sigurt se ky kontroll duhet të vazhdojë edhe në vitin e ardhshëm, edhe te përfituesit e skemave sociale. Dhe, nëse eliminohen...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Sadri Ferati.

SADRI FERATI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Tani veç u tha mjaft, e unë do të jem konkret në disa çështje, që mendoj se ia vlejné dhe janë me interes që të shtrohen.

Pra, unë mund të absorboj dhe mendoj se është e kuptueshme kur ministri e tha se ky është buxhet i mundësive, e jo i nevojave, dhe mund ta kuptojmë si të tillë.

Tani u diskutua mjaft se në kuadër të këtyre mundësive, pra të këtij buxheti, duhet të ketë planifikime të mira, duhet të ketë respektim, implementim, ndarje të drejtë dhe një menaxhim po ashtu të mirë të parasë publike.

Por, për mua, që në fillim të them se është brengosëse ndërprerja ose zvarritja e disa projekteve dhe veç kemi tani paralajmërime për fillimin e shumë projekteve. Kjo është shumë brengosëse, e unë do ta them një rast, e raste të tilla ka shumë, si bie fjala në rrugën Stan-Tërg - Melanicë - Vllahi, 9 kilometra, është vendosur shtresa e parë e asfaltit, por shpresojmë se është një gabim këtu, se thuhet 100 000 euro janë ndarë për këtë vit, por 100 000 euro nuk nënkuptojnë se asaj do t'i vendoset edhe shtresa e dytë, dhe nëse nuk bëhet, ajo do të shkatërrohet. Fatkeqësisht, nëse ndodh kështu, sepse ai regjion i Shalës për të gjitha këto vite, që nga viti 2000, ka përfituar gjithsej në 4 rrugë të asfaltuara, në 27 fshatra, dhe ky është projekti më i madh që ka ndodhur, por po mbetet në gjysmë. Por, nuk po ndodh kjo vetëm me këtë projekt, por kemi një mori rastesh kur nuk përfundojnë projektet e filluara, ndërsa fillojnë projektet e reja, e nuk e di se ku është interesi. Ndoshta do të ishte dashur një analizë e mirë e kësaj.

Ndërsa, çështje dhe problem i veçantë është ky buxhet 1,5 miliard. Sido që ta themi, edhe kur lavdërohem, edhe kur shprehim keqardhje për mospërbushje të kërkesave, shihet se është i vogël. Dhe, shtrohet pyetja: Çka më tutje? Nëse ne mendojmë që edhe më tutje do të ndikojmë me buxhetin në jetën e qytetarëve dhe të perspektivës, duhet të shtrohet pyetja: A do të vazhdojmë edhe vitet tjera me këtë buxhet? Pra, jo! Por, si të rritet buxheti, pastaj do të mund të bisedojmë se si do t'i trajtojmë më tepër kategoritë e ndryshme.

Në rend të parë, edhe këtë vit shoh se, bazuar në të hyrat, sidomos nga Dogana, shihet se nuk ka aspak përpjekje dhe përkushtim që të luftohet informaliteti. Nuk është kjo çështje vetëm e një ministrie, por është çështje e një sistemi, se sikur të kishte një vendosmëri të luftës së informalitetit, unë jam i bindur se në këtë buxhet do të kishin mundur të futen 50, 100 apo edhe më shumë milionë. Dhe, kjo është ajo pjesa kryesore që ishte dashur ta bëjë Qeveria.

Dhe, shtrohet pyetja, pra: Si të shkohet më tutje? Çka nënkupton dhe si do të shkohet më tutje në zhvillim? Duke e marrë parasysh gjendjen reale, sepse ne tash e sa vite e kemi një buxhet po themi të rritur vazhdimisht 1,5 miliardë, kemi 800 milionë nga Konferenca e Donatorëve dhe shihet se cili është impakti, pra cili është produkti që është shndërruar në aspektin e zhvillimit, në aspektin e rritjes së vendeve të punës.

Ne tani kalkulojmë me shifrën 4,5%, e cila kryesisht reflektohet nga kompanitë e mëdha, ato tregtare, shërbyese dhe kompanitë, të cilat e kanë fatin që nga ky buxhet ta fitojnë ndonjë tender, ndërsa qytetarët shumë pak e prekin këtë 4,5% të zhvillimit.

Pastaj, çështja e evazionit fiskal dhe raporti eksport-import, 20 me 80%, e tregon edhe një herë mungesën e perspektivës së mëtejme.

Dhe, një çështje, që ndoshta në mungesë të kohës nuk do të mund ta zhvilloj deri në fund, por unë mendoj se është shumë e rëndësishme, është se ne kemi insistuar edhe sa herë që sikur t'i kishte paraprirë një plan i punës Qeverisë ne sot do ta kishim kuptuar buxhetin shumë më mirë. Aty do të kishim kuptuar se cilat janë ato politika zhvillimore që duhet përkrahur, ndërsa në mungesë të një strategjie të zërthyer, në mungesë të planeve të politikave sektoriale dhe të ministrive veç e veç, ne sot po flasim për një buxhet dhe absolutisht jemi të pasigurt se a do të gjenerojë zhvillim, a do të zvogëlohet importi, a do të ketë mbështetje për biznesin ku de fakto tash për tash punëdhënësi kryesor ka mbetur Qeveria, ndërsa bizneset punojnë me shumë vështirësi. Një dorë e shtrirë sot e shtetit në raport me ndërmarrësit nesër do të ishte kthyer me gjenerim dhe zhvillim. Dhe, sipas këtyre trendëve, të themi 10 deri 15 vjet, nuk do të mund të absorbohet kjo armatë e të papunëve. Do të thotë, një perspektivë e atyre të posadiplomuar, të themi sot, një person i ri që sot futet në konkurrencë për t'u punësuar, teoritikisht nuk i vjen radha para 10 deri 15 vjetësh.

Prandaj, shtrohet pyetja çka duhet të bëhet në këtë drejtim, cilat duhet të jenë ato rrugë, cilat duhet të jenë ato resurse, ato kapacitete dhe ajo strategji që na çon përpara.

Pra, edhe diçka, unë jam për atë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Sala Berisha-Shala e ka fjalën.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje Kabinet qeveritar,

Meqenëse jemi përcaktuar për demokraci si vullnet i shumicës, edhe unë po e shkurtoj diskutimin tim.

Së pari, do ta falënderoj zotin Hamza, i cili e ka bartur peshën kryesore gjatë draftimit të këtij ligji dhe është munduar t'i ketë parasysh balancat ndërmjet mundësive dhe nevojave të vendit dhe ajo që vlen për ta theksuar është sukses i zotit Hamza që vazhdimisht ka qenë në harmoni me Fondin Monetar Ndërkombëtar gjatë diskutimeve të këtij draft-ligji.

Unë dua t'i kthehem një diskutimi që e pati kolegu ynë nga Lidhja Demokratike e Kosovës, zoti Haziri, me të cilin do të pajtohesha me atë që tha sa u përket kushteve të deputetëve, të cilët nuk kanë zyra, nuk kanë buxhet të mjaftueshëm, e që është edhe si kriter i Bashkimit Evropian dhe është shumë e vërtetë, mirëpo unë mendoj që duhet ta ngre këtu prapë një shqetësim se brenda këtij buxheti, ata që janë të thirrur të kujdesen për buxhetin e Kuvendit, e kanë karikuar pak a shumë ruajtjen e buxhetit deri në banalizim, sepse nuk besoj se do ta ndihmonin buxhetin në qoftë se i fshehin ftesat e deputetëve për ngjarje të caktuara jashtë vendit.

Megjithatë, kjo nuk është temë e diskutimit sot.

Ajo që më bëri shumë përshtypje, në paraqitjen e zotit Haziri, i cili iu shmang krahasimeve, të cilat i ka dhënë Grupi i Ekspertëve nga LDK-ja, të krahasimit të buxhetit dhe të shpërndarjes së buxhetit ndërmjet komunave, kryesisht duke bërë krahasimin në komunat e rajonit të Drenicës, sepse kjo për mua ishte një diçka e mirëseardhur, është një dilemë për të vërtetuar se në LDK nuk mendojnë të gjithë njëjtë t'i nxjerrin nga sirtarët elaboratet që kanë qenë më herët, qindravjeçare - një qëndrim selektues dhe diskriminues ndaj rajonit të Drenicës.

Dhe, ka deputetë në Lidhjen Demokratike të Kosovës që e shohin ndryshe zhvillimin e Kosovës, në përgjithësi, jo me metoda selektive, duke i zbatuar elaboratet e Çubriloviqit, e kështu me radhë.

Dhe, duhet ta dinë këta deputetë - kolegë tanë, se nuk është e vërtetë se Qeveria investon më shumë në Drenicë.

Unë dua t'i sjell vetëm dy-tri raste, që nuk i përmendi askush, natyrisht se nuk i dinë. Pikërisht në fshatin nga vjen kryeparlamentari i Republikës së Kosovës, zoti Krasniqi, në fshatin Negroc, shkolla është shkatërruar dhe nxënësit e asaj shkolle e kanë filluar mësimin me dy muaj vonesë, më 1 nëntor.

Po në të njëjtën gjendje, e edhe më të keqe, është shkolla në Arllat, e cila punon në tri ndërrime me kapacitete shumë të kufizuara dhe mua më vjen mirë që e pashë shkollën e Arllatit në projekt që do të jetë në vitin 2013 që të ndërtohet dhe ata nxënës të kenë të drejtë të marrin mësim sikur edhe nxënësit tjerë nëpër shkolla tjera.

Dhe, tjetër? Dua t'ua përkujtoj disa deputetëve se ka përfunduar koha kur duhet të mendohet se fshatari i Begracës, i Vasilevës, i Rezallës apo i Herticës duhet të jetojë me gjysmë opinge dhe të shkelë nëpër baltë, e ata qytetarë që jetojnë nëpër qendra të zhvilluara ta përjetojnë luksin nga taksapaguesit e Kosovës.

Krejt në fund, unë do ta votoj këtë buxhet dhe ju thërras të gjithëve, kolegë deputetë, që ta votojnë buxhetin - Projektbuxhetin që e kemi para nesh, sepse në vazhdimësi ky projektim është kujdesur që Kosova të mos bjerë në kolapse dhe në kriza financiare, siç i kemi shtetet përreth. Faleminderit!

KRYETARI: Replikë! Ismet Beqiri, 2 minuta.

ISMET BEQIRI: Zoti kryetar,

Nëse zonja në fjalë nuk kërkon falje, ne e lëshojmë seancën.

Me elaboratet e Çubriloviqit le të merret ajo. Kjo është fyerje, është idiotizëm të bëhet kësi debati dhe kësi diskutimi. Dhe, me të vërtetë është shqetësuese si nuk kursehen në fjalor. Këtu ka njerëz, shumica, të mos them të gjithë, së pari kanë dinjitet, kanë familje dhe kanë dhënë shumëçka për vendin.

Prandaj, nëse kjo zonjë nuk kërkon falje për këto shprehje shumë të ulëta, ne ia falim kësaj Çubriloviqin - falë i qoftë. Prandaj, unë kërkoj që të kërkojë falje kjo për shprehjen, në të kundërtën ne e lëshojmë seancën.

KRYETARI: Më fal, realisht nuk kam qenë me vëmendje dhe nuk e kam dëgjuar...

(Reagim)

Jo, dua të jem korrekt! Nëse ka thënë ashtu, është mirë ta tërheqësh fjalën, deputete.

(Reagime)

Fjalën e ka deputetja Salë Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar!

Veç është mirë të përcillet me vëmendje ajo çfarë thashë. Mos keqkuptoni! Ajo që nuk ju takon juve, ju lutem mos e merrni. Ju lutem, mos e merrni! Mos keqkuptoni!

Ka përfunduar koha e Çubriloviqit komplet për të gjithë shqiptarët kudo që janë, edhe në Kosovë. Dhe nuk i duhen askujt ato elaborate. Mos keqkuptoni!

Në qoftë se dikush ndihet ashtu, le ta marrë, e bajtët me shëndet, por unë nuk thash as për ju, as për kërkend.

Megjithatë, më vjen mirë që ka deputetë dhe jam shumë e bindur, jo vetëm te Lidhja Demokratike, por te të gjithë deputetët - të grupeve parlamentare, që e mendojnë pak më ndryshe edhe shpërndarjen e buxhetit.

Ju, nëse e keni ndërmend, mos u lidhni prej kësaj fjale. Nuk është e vërtetë që unë kam aluduar në ju. Ka qenë qasje krejt ndryshe e zotit Haziri, nuk ka bërë krahasime. Dhe, kjo është mirë që nuk ka aso qasje. Më keni keqkuptuar, se nuk e kam pas fjalën për ju.

KRYETARI: Urdhëro, Ismet Beqiri e ka fjalën për replikë, një minutë!

ISMET BEQIRI: Zotni kryetar,

Transkripti ekziston dhe do ta shikojmë. Të mos tentojë të na bëjë lojë fjalësh.

Ne jemi të vëmendshëm, e dimë çfarë tha. Dhe, edhe një herë po e them: nëse s'kërkon falje dhe nuk e tërheq fjalën për këta “çubrilloviqat”, ne ecim, e ju vazhdojeni.

KRYETARI: Ju lutem, ajo në një mënyrë edhe e tërhoqi fjalën. Tha “nuk e kam thënë për ju”, prandaj mendoj se është tërheqje e fjalës.

(Reagime)

Uluni, njëherë!

(Ndërprerje e incizimit)

Ju lutem! Ju lutem, uluni një herë, unë e kam një propozim. Ismet, të lutem ti me Ademin, shkoni e dëgjojeni incizimin edhe një herë dhe ejani na tregoni si është incizimi. Le të shkojë edhe deputetja Sala.

(Reagime)

Po, leni këta farë termash, se na mbytët me ta!

(Ndërprerje e incizimit)

Tash i bëjmë 10 minuta pushim.

(Pas pauzës, mbledhja e vazhdoi punën.)

KRYETARI: Deputetë, zini vendet dhe ta verifikojmë praninë.

Pra, po e vazhdojmë punën dhe po e kryejmë debatin. Fjalën e ka deputeti Nijazi Idrizi.

NIJAZI IDRIZI: Faleminderit, i nderuari kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Meqenëse u tha shumëçka lidhur me këtë projektbuxhet, dhe është evidente se ky buxhet po tregon se Kosova po konsolidohet si shtet për faktin se ne kemi të hyra që po shtohen vit për vit, do të thotë që nga viti 2008 kemi të hyra që po rriten. Këto të hyra kanë filluar të bëhen edhe në vend, që është diçka shumë pozitive.

Dëshiroj të tërheq vëmendjen dhe ta jap kontributin tim në disa aspekte që kanë të bëjnë së pari me krizën globale dhe planifikimin e buxhetit tonë.

Mendoj se në kohën e krizës së tashme globale është mirë që sektorët e ndryshëm të ministrive ta bëjnë rishikimin e planeve, të cilat po i prezantojnë si projekte në Buxhetin e Kosovës.

Duhet të caktohen prioritete të reja me qëllim që të matet efikasiteti i investimeve të parasë publike, e cila është jo vetëm nevojë e Kosovës, por është edhe kërkesë e miqve tanë donatorë, si Banka Botërore, USAID-i e të tjera.

Në sektorin e pylltarisë ne e kemi një investim prej 550 mijë eurosh për pyllëzime. Këto pyllëzime deri tash janë bërë me modele të vjetra, të cilat nuk kanë arritur ta japin një rezultat të mirë, për faktin se me matjet që janë bërë dhe që kanë zgjatur për 30 vjet kanë arritur nga këto të zënë vetëm 10% të sipërfaqeve.

Mendoj se Ministria këtë vit është mirë t'i shqyrtojë këto projekte dhe t'i pasurojë, me qëllim që këto pyllëzime t'i bëjë me modele të reja.

Po ashtu, kemi investime edhe në planet menaxhuese afatgjata, të cilat deri tash nuk janë zbatuar. Ne kemi shpenzuar disa milionë euro, por këto plane po vjetrohen, janë plane dhjetëvjeçare, të cilat nuk jemi duke i shfrytëzuar dhe ndoshta do të ishte më me interes që Ministria të organizohet dhe të ndajë buxhet për ta përgatitur kuadrin, i cili do të ishte i zoti që këto plane t'i zbatojë.

Aspekti i dytë, të cilin dëshiroj ta përmend, ka të bëjë me nevojën e një reforme institucionale. Pra, ne kemi nevojë ta bëjmë një reformë institucionale, me qëllim që të arrijmë efikasitet në investimin e parasë publike. Është për t'u vlerësuar planifikimi i kësaj reforme administrative, e cila do ta çojë vendin më mirë dhe këto investime do t'i bëjë më të efektshme.

Do të marrim shembullin se ne e kemi shumë nevojë që Agjencinë Ushqimore të Kosovës ta çojmë te Ministria e Bujqësisë, për faktin se realisht kjo agjenci i takon asaj dhe nuk ka nevojë të mbetet si e pavarur për shkak se ushqimin duhet ta përcjellim në zinxhirin e prodhimit për ta kompletuar ciklin.

Edhe Instituti Bujqësor i Pejës dhe disa institucione tjera kanë nevojë që të jenë më afër institucioneve arsimore e shkencore të Kosovës, sepse vetëm aty e japin kontributin e vet në masë të duhur.

Desha t'u referohem pak a shumë edhe subvencioneve dhe grandeve për të cilat buxheti i sivjetmë planifikon t'i ndajë edhe në industri, por edhe në bujqësi.

Për sa u përket subvencioneve në industri, mendoj se subvencionimi i prodhimit të mineraleve në "Trepçë" duhet të rishikohet për faktin se kemi të bëjmë me resurse të paripërtëritshme, të cilat do të konsumohen dhe të cilat, si gjeneratë, kemi nevojë që ato t'i transformojmë në një vlerë të re, e cila do të jetë si pasuri edhe e brezave që vijnë, për shkak se ne jemi bashkë me brezat që vijnë pronarë të atyre resurseve që janë të paripërtëritshme.

Kam pasur nevojë t'i theksoj edhe disa projekte, të cilat i ka paraparë buxheti, si projektet për ujitje, që janë shumë të mira, të cilat në kohën e kësaj krize globale të ujit do të ishte

mirë të rritej shuma për Ministrinë e Bujqësisë, me qëllim që ajo të planifikojë të përfshijë sa më shumë diga për grumbullim...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Faleminderit që ma dhatë mundësinë që edhe një herë t'u drejtohem kolegëve të mi nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Nuk e kam pasur qëllimin ta fyej askënd dhe nuk është në natyrën time t'i fryj zjarrit të përçarjes.

Ajo kohë, që s'po ia përmendi emrin, ka përfunduar njëherë e përgjithmonë. Dhe, jam e bindur se të gjithë qytetarët e Kosovës, pa dallim partie, feje e etnie, janë të përcaktuar për shtetin e Kosovës. Dhe, në qoftë se rastësisht jam keqkuptuar prej jush, nuk ndihem aspak e përulur dhe e fyer, e të them se ju kërkoj falje, për shkak se ju më keni keqkuptuar. Dhe, herëve tjera, të gjithë bashkërisht duhet të tentojmë ta mirëkuptojmë njëri-tjetrin. Të mos keqkuptojmë, edhe në këso situatash të rëndësishme të mos shkojmë rrugës kah nuk duhet.

Nuk ka qenë qëllimi im ta fyej askënd. Kaq!

KRYETARI: Mirë, faleminderit! Po vazhdojmë. Fjalën e ka deputetja Lirije Kajtazi.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit!

Pas krejt kësaj pauze, jo të dëshirueshme, dëshiroj që ky buxhet i ndarë të mos e humbë diku rrugën, por të shkojë në destinacionin për ku është ndarë. Dhe, kaq, nuk po e zgjas më tepër.

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka Idriz Vehapi.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Bazuar në faktin se Ligji për buxhetin është një nga dokumentet bazike për jetën institucionale politike dhe zhvillimore të një vendi, konsideroj se Qeveria e Republikës së Kosovës kujdesshëm e ka bërë hartimin e këtij draft-ligji edhe për vitin 2013.

Ky dokument është përgatitur mbi bazën e mundësive, të cilat i ka vendi, duke u kujdesur që vendi të ecën sigurt drejt zhvillimit të mëtejshëm ekonomik, në të gjitha fushat.

Me këtë rast, Qeveria, në radhë të parë, është kujdesur që vendi të mos ndikohet shumë nga kriza ekonomike, e cila i ka përfshirë edhe disa vende të euro-zonës që nga viti 2009.

Ky seriozitet sigurisht se ka ndikuar që rritja ekonomike e vendit të ketë trend pozitiv edhe gjatë viteve në vazhdim. Kështu, për vitin 2013, rritja ekonomike pritet të jetë, sipas përlllogaritjeve, 4,5%. Kjo rritje është paraparë të ndihmohet kryesisht nga investimet private, konsumi, si dhe eksporti, në përgjithësi.

Sidomos vlen të theksohet rritja e investimeve private, e kjo pritet të ndodhë si rezultat i angazhimeve të Qeverisë për përmirësimin e ambientit për të bërë biznes, e kjo nëpërmjet ofrimit të lehtësirave procedurale, si dhe lehtësirave të ndryshme tatimore.

Me këtë rast vlen të theksohet fakti se janë bërë lehtësime në një sërë procedurash për regjistrimin e bizneseve, si dhe lehtësimet në procedurat për zhdoganimin e mallrave me rastin e importit, efektet e të cilave pritet të vërehen në plotësi gjatë vitit 2013. Përveç kësaj, vlen të theksohet edhe miratimi i Ligjit për lirimet doganore, i cili pritet të hyjë në fuqi në vitin 2013 nëpërmjet të cilit synohet të përkrahen investime private, duke eliminuar tatimin doganor të imputeve, të cilat përdoren direkt në procesin e prodhimit.

Kjo do të ketë impakt sidomos në sektorin e bujqësisë dhe atë të industrisë përpunuese, fusha këto të cilat ndikojnë në rritjen e zhvillimit ekonomik të vendit.

Nëse analizohen të hyrat buxhetore, të parashikuara për vitin 2013, shihet qartë se Qeveria këtë planifikim e ka bërë në pajtueshmëri me mundësitë dhe nevojat afatgjate të ekonomisë së vendit. Kështu, të hyrat e projektuara për projektbuxhetin e vitit 2013, të shpërndara sipas kategorive, shihet qartë se, përveç deidentës, në të gjitha këto kategori ka rritje krahasuar me vitet paraprake, me gjithë faktin se janë parashikuar lirime të shumta doganore. Kjo do të ndodhë në radhë të parë nga rritja e performansës makroekonomike, si dhe ngritja e efikasitetit të agjencive argëtuese. Ndërkaq, edhe sa u përket shpenzimeve buxhetore për vitin 2013, shihet qartë se është bërë planifikim i mirë dhe që ndërlidhet me nevojat e qytetarëve të vendit. Me këtë rast vlen të theksohen investimet në infrastrukturë në të gjitha fushat, pastaj rritja e buxhetit për sektorin e mjekësisë, atë të bujqësisë e tjerë.

Në përgjithësi, shihet qartë se edhe kategoria e shpenzimeve buxhetore është përgatitur duke marrë për bazë kategorizimin ekonomik të shpenzimeve sipas standardeve ndërkombëtare për statistikën financiare të Qeverisë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Hashim Deshishku e ka fjalën.

HASHIM DESHISHKU: Faleminderit, kryetar!

Unë do të tërhiqem nga fjalimi im, dhe do ta dorëzoj me shkrim. Por, i kam nja katër kërkesa nga qytetarët e Podujevës.

Kërkesa e fundit nga Kuvendi Komunal dërguar Ministrisë është më 17 gusht 2012, për shkollën “Naim Frashëri” në Podujevë, që i ka 1 700 nxënës dhe punon në tri ndërrime. Dhe, këtu është një kërkesë që Ministria të intervenojë për ndërtimin e një shkolle të re, pra për zgjerim. Dhe në fshatin Shajkoc, në shkollën “Hasan Ramadani”, në të cilën janë 280 nxënës, kurse objekti është ndërtuar në vitet e ‘50-ta, e nuk i plotëson kushtet sot për

mësim, dhe në fshatin Siboc, shkolla “Pavarësia”, në të cilën gjithashtu janë 350 nxënës dhe mësojnë në tri ndërrime. Domethënë, nuk është e drejtë që nxënësit të mbahen në tri ndërrime dhe klasa e nëntë nuk ka mundësi ta vijojë mësimin në fshatin Siboc, por në fshatin Gllamnik.

Deputetët që janë nga Llapi e dinë sa është largësia midis Sibocit dhe Gllamnikut, si dhe në fshatin Halabak, edhe aty janë 120 nxënës, dhe kjo shkollë është e ndërtuar në vitet e ‘60-ta, kështu që as ajo nuk i plotëson kushtet për të mbajtur mësim. Faleminderit!

(Diskutim i dorëzuar me shkrim)

I nderuar kryetar i Parlamentit,
I nderuar kryeministër,
Të nderuar deputetë,

Kur është fjala për buxhetin e vitit 2013, në fillim më duhet të them se jam thellësisht i shqetësuar për të ardhmen e ekonomisë së vendit. Po ashtu, jam i befasuar keq për faktin se shpenzimi i parashë publike edhe më tutje vazhdon të bëhet në projekte, që nuk po sjellin zhvillim.

Janë injoruar degët që mund të nxisin zhvillimin e vendit, ndërkaq shuma më e madhe e parashë vazhdon të shpenzohet vetëm në asfalt, përkatësisht në autostrada. Kjo si duket do të vazhdojë edhe gjatë shumë viteve të tjera, meqenëse në mot Qeveria synon ta hapë edhe një front për shpenzimin e parashë së tatimpaguesve.

Por, a po na sjell zhvillim kjo qasje e Qeverisë? A po e rrit numrin e të punësuarve? A po e zvogëlon nivelin e varfërisë? Të gjitha këto e kanë vetëm një përgjigje: JO!

Këtë e tregojnë shifrat. Zhvillimi ekonomik me normë vjetore 4-5% nuk zgjidh asnjë problem të këtij vendi; pastaj shkalla e papunësisë ka vite që mbetet në 44,8%, bashkë edhe me atë të varfërisë.

Kur i kemi parasysh këto shifra, atëherë patjetër se njeriu gjendet para dilemës: kah po shkojnë këto investime, për të cilat Qeveria e Kosovës vazhdon të krenohet.

A e analizon ndonjëherë Qeveria e Kosovës efektin e investimeve të deritashme, para se ta planifikojë buxhetin për vitin pasues? E them me bindje të plotë se të vetmin efekt që e merr parasysh Qeveria është se sa kilometra rrugë do t’i ndërtojë, pa marrë parasysh çmimin e tyre.

Pa dyshim se edhe rrugët janë të nevojshme. Po ashtu, edhe autostradat që lidhin vendin me korridoret ndërkombëtare apo që lehtësojnë qarkullimin e njerëzve dhe të mallrave. Por, pse kjo duhet të bëhet, duke i dëmtuar potencialet tjera zhvillimore.

Këto shqetësime i paraqiti edhe drejtoresha e Bankës Botërore për Evropën Juglindore, Zhan Armitazh. Sipas saj, qëndrueshmëria fiskale do të rrezikohet duke i rritur pagat në

mënyrë të pakontrolluar, si edhe duke shpenzuar paratë e buxhetit për ndërtimin e autostradës Prishtinë-Hani i Elezit.

Por, Qeverisë nuk i bëjnë përshtypje këto sugjerime. Ajo, edhe në mot gati gjysmën e investimeve kapitale do t'i orientojë në infrastrukturë, kurse në autostrada 247 milionë euro, ose 40% të shpenzimeve kapitale.

Mirëpo, a mund të ketë zhvillim ekonomik kur Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në shpenzime kapitale merr pjesë me 0,5%. Madje, edhe këtu, ato pak investime kapitale prej 2,2 milionë eurosh kryesisht shkojnë në një park të biznesit - 1,3 milion euro.

Po ashtu, Ministria e Zhvillimit Ekonomik në investime kapitale merr pjesë me 2,2%, por as kjo nuk ka ndonjë strukturë premtuese të shpenzimeve, meqenëse në tabelat e saj si shpenzues vazhdon të dominojë KEK-u. Kurse bujqësia fare nuk zë vend në mesin e prioritetëve që ka Qeveria, meqenëse ajo në totalin e shpenzimeve merr pjesë me 1,8%, kurse në investime kapitale me 1,9%. Si projekte kryesore këtu janë tregjet dhe qendrat e grumbullimit, si edhe sistemi i ujitjes, të cilat në total marrin 5 milionë euro.

Të gjitha këto zhvillime kanë edhe të përbashkëtat e tjera, që vërtet janë frikësuese:

1. Kjo Qeveri nuk ka menduar fare për projektet e reja, përkatësisht asaj i mungon vizioni, pos kur është në pyetje asfalti. Kjo del qartë, kur merret parasysh se për vitin e ardhshëm ajo nuk e parashihet gati asnjë projekt të ri, por edhe ata që mund të jenë, nuk kanë ndonjë rëndësi të veçantë. Në nivelin qendror, 86% të investimeve kapitale, apo 428 milionë shkojnë për projekte që barten nga viti 2012. Ndërkaq, prej 69 milionë eurove të parapara për projekte të reja, gati 30 milionë i merr autostrada Prishtinë-Hani i Elezit.

2. Edhe në mot do të vazhdojë shpenzimi i paarsyeshëm i parasë nëpër projekte të manifestimeve të ndryshme që nuk kanë dhënë asnjë efekt. Pyes, a ka kush farë vlerësimi se çfarë të mirash solli spoti reklamues për Kosovën në CNN? Ose, cili është efekti konkret i konferencave, të ashtuquajtura me investitorët jashtë vendit? Aty më shumë ka pasur pjesëmarrës nga Kosova se sa investitorë të mundshëm nga jashtë. Ne po shpenzojmë para, ato nuk po vijnë, ndërsa investimet e huaja janë në rënie. Pra, këto konferenca më shumë ishin turizëm, se sa që e kanë arritur ndonjë efekt tjetër.

3. Ndoshta edhe më e rëndësishmja - Burimi i të hyrave për buxhetin do të jenë pikat kufitare. Dogana duhet të sjellë 65% të hyrave të planifikuara. Kjo do të jetë ngarkesa më e madhe që i bëhet biznesit, meqenëse ai duhet të paguajë ende pa e futur mallin në vend. Për shkak se pakoja e lehtësive fiskale nuk po e jep asnjë efekt, likuiditeti i ndërmarrjeve është duke u rrezikuar seriozisht. Madje, ato e kanë vështirë të gëzojnë edhe përkrahje nga bankat, meqenëse çdo ngarkesë e re i sjell ato përballë krizës. Kjo është njëra prej arsyeve pse kreditimi i ndërmarrjeve ka rritje dy herë më të ulët se ai i ekonomive familjare.

Fakt tjetër shqetësues është edhe diskriminimi i qytetarëve të Kosovës që u bëhet nëpërmjet shtrirjes së investimeve dhe shpenzimeve buxhetore. Diskriminimi është i

hetueshëm në të gjitha fushat, si te arsimi, ashtu edhe te shpenzimet kapitale. Paratë shkojnë atje ku e ka pushtetin PDK-ja, ndërkaj nuk duhet harruar se obligimet ndaj shtetit nuk i përmbush vetëm elektorati i saj, por edhe ata të LDK-së, AAK-së etj.

Do t'i jap vetëm disa ilustrime. Investimet në arsim në komunat ku qeveris PDK janë 11 euro për kokë banori, kurse në ato ku qeveris LDK-ja 6 euro, AAK-ja 7 euro. Kjo duket edhe më e qartë kur themi se për kokë banori në Skenderaj janë investuar 230 euro, në Prishtinë 12 euro, në Kamenicë 1 euro, kurse në Novobërdë (Artanë) zero euro. Në Podujevë 28 euro për kokë banori; në Obiliq janë investuar 4 euro për kokë banori, ndërsa ka vite që refuzohet kërkesa e kësaj komune për ndërtimin e dy shkollave nëntëklasëshe.

Struktura e shpenzimeve nuk ndryshon as te investimet në infrastrukturë. Aty ku qeveris PDK-ja janë investuar 11 euro për kokë banori, te LDK-ja 5 euro, kurse te AAK-ja 3 euro. Ndryshime do të ketë në mot, meqenëse investimet në infrastrukturë në komunat që i ka LDK-ja ngrihen vetëm për 1 euro, ose shkojnë në 6 euro për kokë banori, ndërsa te PDK 17 euro, e te AAK-ja 15 euro.

Pra, është e qartë se kjo Qeveri po i diskriminon qytetarët në baza partiake. Përderisa e ka këtë qasje, atëherë nuk duhet të shpresojmë se do të ketë zhvillim dhe mirëqenie sociale njësoj për të gjithë. Faleminderit!

(Hashim Deshishku, d.v.)

KRYETARI: Latif Gashi, replikë.

LATIF GASHI: Faleminderit, kryetar!

Jam dakord plotësisht me kërkesën që e bëri kolegu, vetëm do të ishte më mirë që kërkesën ta bëjë Kuvendi Komunal i Besianës. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, për kundër-replikë, deputeti Hashim Deshishku.

HASHIM DESHISHKU: Informata ime është nga Kuvendi Komunal i Podujevës, që për herë të fundit është bërë më 17 gusht 2012. Kështu e kam informatën, ndoshta nuk është e saktë, por unë e di që është informatë nga udhëheqësit e Kuvendit Komunal në Podujevë.

KRYETARI: Mirë, faleminderit! Fjalën e ka deputetja Blerta Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryetar!

Edhe pse fjalën e kemi kërkuar më herët, por si duket ka ndodhur një defekt në elektronikë dhe të gjithë deputetëve u është fshirë kërkesa për marrjen e fjalës. Dhe, megjithatë, edhe pse këtu u thanë shumë gjëra, unë do të ndaj një pjesë të fjalimit tim, sepse e kemi edhe kohën e kufizuar.

Pra, kam përgatitur më shumë, por do të ndalem te kritika e kolegëve opozitarë, jo për faktin se unë vij nga komuna e Skenderajt, por për faktin se ka qenë komuna që është akuzuar më së tepërmi në ndarjen e buxhetit nga kolegët e partive opozitare.

Dhe, po e them edhe këtu se gjatë dy mandateve që Partia Demokratike e Kosovës nuk ka qenë në pushtet, në këtë komunë nuk është investuar pothuajse në asnjë projekt. Dhe, për kuriozitet, u përmend edhe këtu, po them se gjatë vitit 2000 deri në vitin 2007, në Skenderaj janë investuar vetëm 6 kilometra rrugë lokale, e kjo rrugë, e kam pasur fatin të jetë ndërtuar në fshatin prej nga vij unë, në fshatin Rezallë, dhe do të thotë se është një rrugë që është ndërtuar sa për sy e faqe dhe sa për t'u thënë atyre qytetarëve se kemi bërë diçka dhe e kemi rregulluar infrastrukturën në këtë fshat, e cila nuk i ka përmbushur as standardet minimale të asfaltimit dhe me shumë vështirësi është ndërtuar edhe rruga në lagjen e Jasharajve, do të thotë një kilometër e diçka rrugë, përderisa në regjione tjera janë investuar edhe në zona që nuk kanë pasur fare frekuentim të madh të qytetarëve.

Të nderuar kolegë opozitarë,

Do të thotë i gjithë mllefi që është shprehur ndaj kësaj komune dhe ndaj buxhetit të dedikuar për këtë komunë, ju kujtoj se gjatë kohës që ju keni qenë në pushtet keni treguar një qasje tejet negative ndaj regjioneve të dala nga lufta, siç janë Drenasi dhe Skenderaj. E keni theksuar edhe paraprakisht këtu në seancë se me këtë projektbuxhet Qeveria i paska ndëshkuar komunat që nuk e kanë votuar Lidhjen Demokratike të Kosovës. Sa për informatë, i kam marrë disa të dhëna: në vitin 2007, asnjë fshat i Skenderajt nuk ka pasur rrugë të asfaltuar. E tërë hapësira ndërmjet magjistrales Prishtinë - Pejë e deri te magjistrallja Mitrovicë - Skenderaj - Pejë nuk ka pasur asnjë kilometër asfalt. E vetë qyteti ka qenë i mbytur tërësisht në baltë.

Po ju rikujtoj se komuna e Skenderajt ka dalë nga lufta pothuajse tërësisht e shkatërruar. Këtë e dëshmojnë analizat e bëra, e nuk është se po e them unë, por është fakt se nga lufta kjo komunë ka dalë me 98% të tërë infrastrukturës së shtëpive, shkollave dhe të objekteve fetare tërësisht të shkatërruara.

Kur jemi te ndërtimi i shkollave, që është përmendur këtu, dhe infrastruktura, në përgjithësi, mendoj se këto investime janë evidente edhe në të gjitha komunat e tjera, e jo vetëm në komunën për të cilën është folur vazhdimisht, për shkak se gjatë dy mandateve që Partia Demokratike nuk ka qenë në pushtet, të nderuar kolegë deputetë, më thoni cila shkollë, apo sa shkolla janë ndërtuar në komunën e Drenasit dhe të Skenderajt? Sa rrugë janë ndërtuar në këto dy komuna? A e dini ju se deri në vitin 2008 në Skenderaj nxënësit kanë mësuar në shkolla kontejnerë, u cek më herët edhe nga kolegu Bekim Haxhiu. Pastaj në shkollën fillore "Shaban Jashari" në këtë komunë, derisa Partia Demokratike ka ardhur në pushtet, fëmijët e kanë pasur jetën të rrezikuar nga objekti gërmadhë.

Ky regjion, të nderuar kolegë deputetë, ka qenë i lënë anash edhe i anatemuar edhe në kohën e ish-Jugosllavisë për arsye që tashmë i dimë të gjithë.

Andaj, nuk është mirë që në këtë kohë të ndërtimit të shtetit të dëgjohen zëra se në Drenicë po investohet dhe të matet metër për metër e gram për gram çdo investim në atë zonë. Përkundrazi, unë mendoj se është jashtëzakonisht njerëzore që secili nga ne këtu që jemi t'i gëzohet mirëqenies minimale të atyre qytetarëve, sepse ata vërtet kanë nevojë për investime shtesë dhe kanë shumë kërkesa. Faleminderit!

KRYETARI: Replikë, Ali Sadriu e ka fjalën.

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë mendoj se kjo gjuhë çfarë po përdoret këtu nuk është gjuhë që ia do të ardhmen Kosovës.

Më preku shumë kolegia parafolëse, kur tha se nga partitë tjera, përkatësisht aludoi në LDK-në, e AAK-në, në qeverisjen e tyre nuk është investuar në Drenicë. Unë kam dëgjuar se edhe një ministër, që edhe tash është prapë ministër, në një studio, po të njëjtën gjuhë e ka përdorur në Mitrovicë. Nuk kam dashur t'i kundërvihem, meqenëse unë kam mirënjohje prej kryetarit të komunës të Skenderajt për investimet që i kam bërë atje. Ajo rrugë edhe ato varreza për herë të parë në Skenderaj janë ndërtuar me iniciativën time. Nuk është i vetmi objekt ai, është edhe Kulla e Ahmet Delisë, është edhe kulla tjetër, ka shumë e shumë investime. Prandaj, po them se kam mirënjohje, herën tjetër do ta sjell këtu do të jua tregoj publikisht. Nuk kam dashur të bëj këso krekosje, por desha të tregoj se kjo gjuhë është në rregull.

Unë nuk i takoj asaj pjese, jetoj në Prishtinë mu si kjo. E shfrytëzoj Prishtinën. Prishtina është kryeqendër, është krenaria e të gjithëve. Zonja sot del jashtë kufijve ose cilido që del jashtë kufijve, kur ta pyesin, në njëfarë mënyre ka qejf të jetë nga Prishtina. Është një kryeqendër, është e të gjithëve. Kosova është shumë e vogël për këso ndasish. Është turp i kohës të diskutohet në këtë mënyrë. Faleminderit!

KRYETARI: Latif Gashi, replikë.

LATIF GASHI: Faleminderit, kryetar!

Unë ndiej obligim edhe para qytetarëve të Besianës t'i njoftoj ata, por edhe kolegun që e kam afër këtu, se ky fare nuk e di sa shkolla i ka ndërtuar "Qeveria Thaçi" prej vitit 200 deri më sot dhe fare nuk ka informacione sa shkolla i ka ndërtuar Qeveria më herët. Unë po e njoftoj shkurt: mbi 12 milionë euro "Qeveria Thaçi" nga viti 2008 deri më sot ka investuar veç për shkollat në Llap, kështu që janë diku 10-12 shkolla.

E, jam i bindur që në kohën kur e ka pasur Ministrinë e Arsimit janë meremetuar nja 2-3 shkolla, kështu që kërkesa ka ende, nevojë ka, mirëpo do të ishte mirë të jepen informacione të sakta.

KRYETARI: Blerta Deliu, replikë.

BLERTA DELIU - KODRA: Faleminderit, kryetar!

Unë për korrektësi po e bëj të ditur se nuk bëra asgjë, përveç se solla fakte dhe e kisha obligim moral para atyre qytetarëve për shkak se komuna e Skenderajt, komunë prej nga vij unë ka qenë temë qendrore e kritikave që kanë ardhur këtyre ditëve për ndarjen buxhetore dhe unë po them se është investuar në Drenicë dhe në Skenderaj për shkak se gjatë tetë vjetëve nuk është investuar në atë zonë dhe solla vetëm diçka faktike nga statistikat. Asgjë nuk përmenda tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: Vazhdojmë! Jo, po e marrim vesh tash. Të mos bëhemi tepër lokalistë. Fjalën e ka Anton Quni.

ANTON QUNI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Unë do të përkufizohem në vlerësimin tim në lidhje me buxhetimin e disa institucioneve të sigurisë.

Forca e Sigurisë e Kosovës në vitin 2013 për shërbimet kapitale do të disponojë diku rreth 14 milionë euro. Por këto para janë të parapara për ndërtimin dhe riparimin e disa objekteve pune, depo, objekte sporti, heliodrame, asfaltimin brenda kazermave, rrethojat etj., etj.

Por, viti 2013 është i paraparë për mundësinë e rishqyrtimit të misionit të FSK-së. Ndërrimi i misionit nënkupton: zgjerimin e detyrave dhe të përgjegjësi, ndryshimin e strukturës organizative, ngritjen dhe zhvillimin e njësive të specializuara, trajnime në veprime taktike të njësive, pajisja me armatim dhe automjete taktike, standardizimi, ndërrimi dhe heqja e pajisjeve të amortizuara që janë jo funksionale dhe me siguri të ulët për pjesëtarët e FSK-së. Me buxhetin e paraparë për FSK-në nuk është garantuar rishikimi i misionit të FSK-së.

Edhe nëse rishikohet në rrafshin teorik ajo është e pamundur të realizohet në dimensionin praktik. Për Policinë e Kosovës në total, apo për Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe për Policinë e Kosovës në total janë të parapara diçka mbi 100 milionë euro, por për operacionet janë gjithsej 264 mijë euro, për operacionet speciale 340 mijë euro, për trajnime 150 mijë euro, për Akademinë e Policisë 1 milion e 140 mijë euro, kurse për Drejtorinë për Mbrojtjen e Dëshmitarëve vetëm 240 mijë euro.

Kjo mënyrë e shpërndarjes së financave nuk siguron që në vitin 2013 do të ketë fitim dhe luftim serioz të krimit të organizuar, zbardhje të krimeve ekonomike, vendosje të rendit dhe të ligjit në pjesën veriore të Kosovës, ndërprerje të rrugëve të trafikimit me narkotikë dhe me qenie njerëzore, e shumë e shumë veprime tjera. Mënyra e tillë e menaxhimit të parasë publike i inkurajon individët dhe grupet nga bota kriminale që të ndihen të sigurt në aktivitetet e tyre dhe njëkohësisht i dekurajon qytetarët dhe dëshmitarët potencialë për bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe me organet e drejtësisë.

Për Këshillin e Sigurisë Kombëtare janë paraparë mjete vetëm për paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, që në total janë 334 mijë euro. Këshilli i Sigurisë Kombëtare me komponentët e saj, FSK-në, Policinë e Kosovës, Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, Doganën e Kosovës, Departamentin e Emergjencave etj., e ka për detyrë të bëjë rishikimin strategjik në sektorin e sigurisë. Ky veprim nënkupton identifikimin e rreziqeve që e kërcënojnë rendin kushtetues, sovranitetin dhe integritetin e Republikës së Kosovës, sundimin e rendit dhe të ligjit, jetën dhe pronën e qytetarëve dhe përgjigjen adekuate të institucioneve të sigurisë ndaj situatave të krijuara.

Veprimet gjatë rishikimit strategjik nënkuptojnë analiza, studime, vlerësime, elaborime, paralogaritje, ndërtim i skenarëve, simulim i situatave, ndërtim i alternativave etj. Të gjitha këto veprime janë punë ekipore e të gjithë aktorëve të sigurisë, të cilat e kanë koston financiare. Nga buxheti i paraparë për Këshillin e Sigurisë Kombëtare nuk sigurohet që në vitin 2013 do t'i kemi strategjitë e sigurisë, e cila do të jetë funksionale, reale dhe e zbatueshme për të gjitha situatat kërcënuese. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Ramiz Lladrovci. Ndoshta “del” prej Drenice.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë shumë shkurt po flas, kurse fjalën time do ta dorëzoj me shkrim. Por, megjithatë po flas. Mjetet buxhetore, përkatësisht projektbuxheti të cilin duhet ta aprovojë ky Kuvend është tepër i rëndësishëm për Kosovën që të vazhdojë suksesshëm me financimin publik.

Kuvendi duhet ta aprovojë projektbuxhetin për faktin se paraqet impenjimin e Qeverisë për financimin e projekteve mbi bazën e prioritetëve dhe në funksion të qëndrueshmërisë së financimit publik të zhvillimit ekonomik dhe mirëqenies sociale. Po e ndërpres këtu, sepse shumëçka u tha. Faleminderit!

(Diskutim i dorëzuar me shkrim)

I nderuari kryetar i Parlamentit,

I nderuari kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Mjetet buxhetore, përkatësisht projektbuxheti, të cilin duhet ta aprovojë ky kuvend është tepër i rëndësishëm për Kosovën që të vazhdojë suksesshëm me financimin publik.

Kuvendi duhet ta aprovoj projektbuxhetin për faktin se paraqet impenjimin e Qeverisë për financimin e projekteve mbi bazën e prioritetëve dhe në funksion të qëndrueshmërisë së financimit publik, zhvillimit ekonomik dhe mirëqenies sociale në Kosovë.

Buxheti për vitin e ardhshëm planifikon një rritje ekonomike për rreth 4 për qind. Ky projektbuxhet është hartuar në bashkëpunim me ekspertët e ekonomisë, si dhe mbi bazën e rekomandimeve të përfaqësuesve të FMN-së për një politikë dhe menaxhim të disiplinuar fiskal.

Projektbuxheti për vitin 2013 në dimensionin e të hyrave parashihet të jetë 1,6 miliard euro, ose rreth 100 milionë euro më i lartë se buxheti i vitit 2012.

Ky parashikim bazohet në vlerësimet afatmesme të indikatorëve kryesorë makroekonomikë dhe në vlerësimet e rritjes së performancës së institucioneve përgjegjëse për mbledhjen e të hyrave, siç janë: Doganat dhe Administrata Tatimore e Kosovës, të cilat i përgëzoj për punën dhe rezultatet e arritura.

Buxheti i Kosovës për vitin 2013 planifikon të hyrat e përgjithshme në vlerën prej 1 miliard e 423 milionë euro, ndërsa shpenzimet kapin shifrën prej 1 miliard e 586 milionë eurosh. Deficiti afërsisht prej 172 milionë eurove do të mbulohet nga bartjet e këtij viti.

Pra, është arritur një ngritje e lehtë, e kujdesshme dhe konservative e Buxhetit të Kosovës. Të hyrat e përgjithshme buxhetore janë parashikuar me një ngritje 3% nga baza e vitit paraprak.

Krejt kjo është bërë edhe me sugjerimet respektive të FMN-së. Kjo pasi në vitin që jemi buxheti ka qenë 1 miliardë e 520 milionë, kurse për vitin 2013 ky buxhet pritet të jetë 1 miliardë e 586 milion euro.

Natyrisht se synim kryesor i caktimit të tavanit të epërm të shpenzimeve është që Kosova t'u bëjë ballë turbulencave nëpërmjet një bilanci bankar të qëndrueshëm, "për t'u bërë ballë tronditjeve eventuale në eurozonë, dhe kështu qëllimi i projektbuxhetit mbetet arritja e një niveli adekuat të bilancit bankar".

Mbledhja e të hyrave nga tatimet indirekte në Doganë (TVSH, akcizë dhe doganë) është paraparë që të jetë 915 milionë euro, që krahasuar me vitin 2012 shënon rritje prej 4,6%.

Mbledhja e të hyrave nga tatimet e brendshme është paraparë të jetë 301 milionë euro, që krahasuar me vitin 2012 shënon rritje prej 4,5%.

Mbledhja e të hyrave në shumën prej 1 360 milionë euro është barrë e institucioneve qendrore, ndërsa shuma prej 63 milionë euro është barrë e organeve lokale.

Në dimensionin e të hyrave, projektbuxheti mbështetet në të hyra të sigurta dhe ky projektbuxhet nuk është projektbuxhet deficitar dhe se rritjet e shpenzimeve mbështeten mbi bazën e rritjes së performansës së SHD të Kosovës dhe ATK-së.

Kur jemi te rritja e performansës së institucioneve përgjegjëse për mbledhjen e të hyrave dhe luftën e tyre kundër evazionit fiskal, dua të theksoj se zvogëlimi i mëtejshmë i evazionit fiskal dhe suksesi ndaj tij do jetë i mundur vetëm me angazhimin e të gjitha institucioneve relevante në Kosovë.

Qeveria duhet të sigurojë me ngulm ndihmë nga institucionet ndërkombëtare që ta ruajë unitetin e sistemit të saj doganor dhe të mbledhë dogana në pjesën veriore të Kosovës. Kjo e drejtë është e sanksionuar me të gjitha dokumentet relevante rreth statusit politik të Kosovës.

Atje Kosova humb miliona euro. Ndërsa përbrenda theksi duhet të vihet në luftimin e evazionit fiskal në formë të mashtrimit, në vend të targetimit të obliguesve tatimorë dhe kompanive kosovare, të cilat janë duke u munduar që t'i binden ligjit.

Në dimensionin e shpenzimeve buxhetore, projektbuxheti në pjesën më të madhe të tij është produkt i projeksioneve dhe politikave të filluara në vitet e mëparshme (një ngritje prej 4,0%, në krahasim me shpenzimet e vitit 2012).

Kjo ngritje vjen si rezultat i rritjes së të dy kategorive të shpenzimeve, si atyre rrjedhëse, po ashtu edhe të atyre kapitale. Në këtë kuadër, shpenzimet rrjedhëse gjatë vitit 2013 pritet të rriten për rreth 7%, ndërsa shpenzimet kapitale do të rriten me 1,1%, në krahasim me vitin 2012.

Ngritja e shpenzimeve kapitale reflekton kryesisht implementimin e projektit të autostradës, projekt ky i cili shkakton presione fiskale për Kosovën, por që pa dyshim do të jetë në funksion të zhvillimit ekonomik dhe integrujes të Kosovës.

Në kuadër të buxhetit 2013 është parashikuar edhe autostrada Prishtinë-Shkup, duke arritur të ndahet një shumë e mjetëve për këtë projekt.

Ky projekt, sipas projeksionit buxhetor dhe në pajtueshmëri me FMN-në, do të fillojë vetëm nëse do të ketë një nivel të kënaqshëm të bilancit bankar në shumën e paraparë 300 milionë euro, kurse zhvillimi i kësaj autostradës do të shtrihet deri në vitin 2016.

Shpenzimet publike të Kosovës nga viti në vit janë rritur, sepse janë rritur funksionet shtetërore të Kosovës, përkatësisht nevojat publike të saj.

Shpenzimeve publike të parapara me projektbuxhet janë indikator presioni mbi institucionet përgjegjëse që të gjejnë burime për financimin e shpenzimeve.

Mirëpo, nga analizimi i përmbajtjes së këtyre shpenzimeve del se ato janë paraparë mbi bazën e kriterit të nevojës dhe kriterit të dobisë së financimit të një shpenzimi publik.

Në fund, mendoj se Projektbuxheti i Qeverisë duhet aprovuar, sepse:

- a) do të jetë në funksion të zhvillimit ekonomik të Kosovës, duke bërë të mundur që nëpërmjet shpenzimeve kapitale të ndikohet në rritje ekonomike;
- b) do të jetë në funksion të stabilitetit financiar - duke bërë të mundur një financim publik të qëndrueshëm të shpenzimeve shtetërore, dhe
- c) do të jetë në funksion të zhvillimit social, duke bërë të mundur financimin e nevojave sociale të shtresave të caktuara të popullsisë për aq sa mjetet buxhetore në dispozicion e mundësojnë këtë.

(Ramiz Lladrovci, d.v.)

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Teuta Haxhiu, shpresojmë sa më shkurt.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!
Të nderuar, kolegë deputetë,

Unë do t'i bjer shumë shkurt, por do të ndalem te Ministria e Bujqësisë, duke e ditur që vazhdimisht edhe vetë ministri e ka përmendur që kjo ministri e ka prioritet bujqësinë, por bujqësia nuk mund të zhvillohet në qoftë se nuk mendohet në sistemin e ujitjes, në qoftë se nuk ndahet një kod i veçantë, në qoftë se nuk është ndarë asnjë cent në këtë drejtim.

Unë po flas pak për komunën e Gjakovës, e cila ka pasur të ndara në këtë vit dy penda, në fakt të miratuara edhe nga ministria dhe e ka marrë edhe njoftimin pikërisht nga ajo për të filluar puna qysh në qershor, por ato janë tërhequr më vonë dhe tani në këtë projektbuxhet nuk është ndarë asnjë cent për sistemin e ujitjes. Unë nuk e nuk di se si do të zhvillohet bujqësia, në qoftë se nuk ndahen mjete për sistemin e ujitjes. Duke pasur parasysh që specifikacionin e komunës së Gjakovës dhe disponimin e saj me katër lumenj dhe me një tokë shumë cilësore, unë besoj dhe shpresoj që gjatë rishikimit të projektbuxhetit do të kihet parasysh ky fakt.

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Bahri Thaçi.

BAHRI THAÇI: Faleminderit zoti kryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Kur diskutojmë për Buxhetin e Kosovës për vitin 2013 konsideroj se është e nevojshme të diskutojmë me qëllimin më të mirë, të finalizohet ky dokument ashtu si duhet dhe në të mirën e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Ndoshta është krijuar njëfarë përshtypje që ne si opozitë apriori ta kundërshtojmë çdo dokument që vjen nga Qeveria, por në këtë rast kemi të bëjmë me buxhetin e vendit dhe komentet tona nuk duhet kuptuar si kundërshtim, por si këshillë dhe sugjerim për ta realizuar një shpërndarje sa më të drejtë, për të cilin qëllim ne si deputetë duhet ta japim sot kontributin tonë.

Pa hyrë shumë në detaje të shifrave, vërehet se ky buxhet është vazhdimësi e praktikave të viteve të kaluara, një buxhet i cili më shumë adreson prioritetet politike të partive në pushtet se sa prioritetet kyçe shtetërore, të cilat i duhen vendit tonë. Një buxhet i bazuar në parime të të hyrave të pasigurta, një buxhet që parasheh rritjen e deficitit buxhetor dhe futjen e vendit në borxhe të panevojshme, të cilat do të mbeten obligim për qeveritë e ardhshme.

Është shumë e dhimbshme që sektori i shëndetësisë dhe politikat sociale prapë mbeten të neglizhuara. Sa i përket shëndetësisë, unë jam i sigurt që edhe gjysma e këtij buxheti po të ndahej për nevoja shëndetësore, nuk do t'i plotësonte nevojat shëndetësore në Kosovë, në përgjithësi.

Besoj që të gjithë këtu pajtohem me një konstatim se gjendja në këtë sektor është jashtëzakonisht e rëndë. Duke u nisur prej këtij konstatimi dhe duke marrë në shqyrtim buxhetin e paraparë për këtë sektor, vërejmë se nuk i është bërë kurrfarë prioriteti.

Totali i shpenzimeve kapitale të parapara në këtë buxhet në shëndetësinë terciare është 6,1 milionë euro. Gjithashtu me këtë buxhet janë paraparë edhe shifrat për buxhetin e viteve 2014 dhe 2015. Shifrat pothuajse janë të njëjta e kjo qytetarit i jep të kuptojë që kjo Qeveri edhe në periudhën afatmesme as që do ta ketë ndërmend të ndryshojë diçka në këtë sektor.

Për shpenzimet kapitale, për krejt këtë sektor në nivel të vendit shifra është 13,3 milionë euro. Kjo është afërsisht e barabartë me 1 ose 1,5 kilometra autostradë, që tash jemi duke e ndërtuar.

Nuk do të duhej t'i përdorë ato autostrada si njësi matëse në këtë rast, por një diçka e tillë na është imponuar.

Sikur të vendosnim të ndërtonim 1 ose 2 kilometra asfalt më pak për vitin 2013 dhe këtë shumë ta alokonim në prioritetet kapitale në shëndetësi, jam i bindur që të gjithë qytetarët do të ishin më të kënaqur dhe kualiteti i shërbimeve shëndetësore do të rritej.

Unë kam menduar që në këtë buxhet do të projektohet një shumë e mjeteve diku prej 600 mijë eurove për Ngrohtoren e qytetit. Ne të gjithë e dimë se në Qendrën Klinike Universitare, si donacion është dhënë një ngrohtore, e cila ekziston aty dhe vetëm në mungesë e naftës nuk funksionon. Mendoj se nuk është e drejtë, nuk është e mirë që ngrohjen e të sëmurëve, ngrohjen e fëmijëve të porsalindur ta lëmë në mëshirën e Ngrohtores së qytetit. Unë mendoj që të amendamentohet një amendament, i cili parasheh që së paku 600 mijë euro t'i japim për Ngrohtoren e qytetit. Mendoj që është shumë e njerëzishme që këto mjete të ndahen dhe jam i sigurt që të gjithë deputetët që janë këtu, por edhe të gjithë qytetarët, po të pyeten, jam i sigurt se do ta aprovonin një gjë të tillë. E kam fjalën për Ngrohtoren e Qendrës Klinike Universitare, në qoftë se nuk isha i qartë.

Gjatë këtyre tre vjetëve na është përmendur që rritja ekonomike në Kosovë ka qenë më e larta në rajon, se e ka kaluar shifrën 5%, e kështu me radhë. Kjo rritje nuk është reflektuar asesi në zvogëlimin e varfërisë dhe në gjendjen e rëndë të shtresave sociale. Edhe më tutje, niveli i varfërisë mbetet mbi 34%, prej të cilëve 12% janë në varfëri të skajshme ekstreme, me vetëm 90 centë në ditë.

Meqenëse po flasim për varfërinë dhe gjendjen e rëndë sociale, me këtë buxhet nuk është paraparë asnjë përkrahje shtesë për këto shtresa. Jam duke folur për familje, të cilat marrin asistencë sociale. Buxheti për familjet me asistencë sociale përkundrazi është zvogëluar në krahasim me vitin e kaluar.

Janë diku 35 mijë familje në asistencë sociale, që mbijetojnë me 45 deri 65 euro në muaj. Numri i tyre nuk është duke u zvogëluar, por përkundrazi, sepse numri i këtyre familjeve mund të zvogëlohet vetëm me një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe me një punësim adekuat, duke punësuar nga një anëtar të familjes që është i aftë për punë.

Se nganjëherë kjo Qeveri nuk është...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Sa i përket shëndetësisë, unë pajtohem me ty, por është çështje se edhe mjetet që ndahen si shfrytëzohen. Fjalën e ka deputeti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë dhe kolege deputetë,

Siç e dini, formimi im nuk është nga ekonomia, e as vokacioni im. Megjithatë, nga angazhimet e mëhershme që kam pasur më është dashur të shfletoj edhe të studioj autorë nga ekonomia socialiste, edhe nga ekonomia kapitaliste, për t'i përballur ata dhe për t'i përdorur në punën time, të cilën e kam pasur për të fiaskuar për shtetin e së kaluarën të dhunës dhe gjithë atë formim, me të cilin isha shkukurëzuar kohë të gjatë dhe nuk e kam përdorur deri në analizën e buxhetit.

U mundova për një fjalë rasti këtu dhe ta shfrytëzoj gjithë dijen në përgatitjen time, por meqenëse tash e shoh se është ezauruar shumë koha dhe ka qenë një ditë e bezdisshme pak, edhe ngacmuese nga pak, edhe e pakëndshme ndonjëherë, kam respekt për të gjithë të pranishmit këtu edhe fjalën time do ta dorëzoj me shkrim te Sekretaria. Faleminderit!

(P.S.: Diskutimi i deputetit nuk ka arritur në Njësinë për Trankriptim dhe Lekturë.)

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Sali Asllanaj.

SALI ASLLANAJ: Faleminderit, kryetar!

Edhe unë do të përpiqem të jem racional, sepse vërtet ndoshta jemi bërë monoton me këtë stërzgjatje të këtij debati, por më lejoni të konstatoj që kam disa vërejtje në projektbuxhetin e propozuar, e ato kanë të bëjnë me një deficit të paralajmëruar, të parashikuar dhe me disa të ardhura të njëhershme, që për mendimin tim do të duhej të eliminoheshin në të ardhmen nga Buxheti i Kosovës.

Kryetari pati vërejtje që të mos prejudiojmë se po shitet posta. Por, objektivisht prej aeroplani shihet që ideja aty është. Kishim dashur që vërtet të mos jetë prejudikuese, se edhe kryetari i Kuvendit ka thënë ashtu. Unë mendoj që vërtet një prejudikim ka ndodhur.

Tjetër? E kam thënë edhe në Komisionin për Buxhet dhe Financa, edhe këtu po e them. Do të ishte fat i madh nëse një pjesë e mjeteve ndahen prapë për bujqësi. Konsideroj që kjo do të kishte ndikuar shumë mirë në pasqyrat sociale në Kosovë, sepse me 30 milionë euro eventuale do të gëzonin shumë familje nga subvencionet në bujqësi.

Dhe, diçka konkrete. Projekti i autostradës për Ferizaj-Shkup, mendoj që është i parakohshëm objektivisht nëse ka një logjikë pak ekonomike, atëherë vazhdojeni rrugën e modelit të njëjtë si deri te QMI-ja. Le të vazhdojë për Ferizaj, me 30 milionë do të ndërtohet. Për Shkup të shohim, ta ndërtojmë në një gjendje më të mirë ekonomike.

Konsideroj që bujqësia vërtet do të duhej ta ketë një prioritet. Kam pritur prej Qeverisë suaj që, pas 2 vjet janë bërë përparime në infrastrukturën rrugore, në infrastrukturën shkollore, ta ndërrojmë pak strategjinë e zhvillimit në aspektin tjetër. Nuk ka ndodhur. Është një vijë unisone e një strategjie.

Konsideroj që ka vend dhe hapësira të ndryshme, të cilat gjendjen sociale në Kosovë do ta bënim më të mirë.

E kam edhe një vërejtje tjetër në lëmin e shëndetësisë, për të cilën foli para folësi im, zoti Thaçi. Mendoj që investimet në shëndetësi janë edhe ato që i bëjmë edhe në ambient, nëse i menaxhojmë ujërat e zeza si duhet, edhe ato janë investime në shëndetësi. Nëse krijojmë kushte për ujë higjienik që ta përdorin familjet tona, edhe ato janë investime në shëndetësi. Këto janë sfida, të cilat i kemi lënë për momentin pas dore, por kisha dashur që në të ardhmen të mendojmë që realisht të bëjmë investime sa më të mëdha në këto lëmi, në mënyrë që sëmundjet ngjitëse, të cilat në shumë vende të Evropës janë harruar, kanë dalë nga harta e tyre, te ne ende ekzistojnë. Do të ishte kontribuar që standardi i popullatës sonë të jetë në nivel më të lartë, shëndet shumë më i mirë dhe me këtë refleksion në zhvillimin ekonomik të Kosovës.

U përpoqa sa më shkurt, prandaj ishte vështirë të thuhet krejt gjërat. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Autostradën e bëjmë deri në Han të Elezit, e jo deri në Shkup, se i përzihemi dikujt atje. Fjalën e ka deputetja Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë dhe ju kolege deputete,

U fol shumë sot dhe do të mundohem që të mos përsëris, edhe pse nuk do të duhej të lodhem kaq shumë, sepse në vendet tjera shkojnë 2 e 3 ditë derisa të shqyrtohet buxheti, por ne zakonisht i marrim gjërat pak më për ngut dhe ata që po flasin të parët po lodhen për të na dëgjuar ne të tjerëve.

Po megjithatë unë dua t'i ngre dy shqetësime për komunën e Skenderajt. Në këtë rast, do të kërkoj nga Ministria e Bujqësisë që të ketë parasysh dhe t'i shtojë mjetet buxhetore për sektorin e bujqësisë, duke pasur parasysh se Skenderaj është e vetmja zonë ose i vetmi vend në Kosovë, i cili nuk e ka as edhe një ar tokë nën sistemin e ujitjes. Prandaj, bujqit në atë anë me shumë mund e sakrificë arrijnë që të sigurojnë diçka nga bujqësia dhe është një pjesë total rurale.

Shqetësimi im i dytë për komunën e Skenderajt është ndarja e kufijve buxhetorë për planifikimin e të hyrave vetjake, duke pasur parasysh që ky planifikim ose kjo vendosje e këtyre kufijve është bërë në bazë të dy vjetëve të fundit, kur Skenderaj ka pasur të hyra vetjake thjesht mbi procesin e koncesioneve dhe këto nuk janë të hyra të rregullta, por janë të hyra të jashtëzakonshme. Dhe kur e kemi parasysh numrin e madh të papunësisë në Skenderaj dhe rritjen e varfërisë, konsideroj që nuk do të ketë mundësi që Skenderaj t'i sigurojë këto të hyra vetjake, siç janë paraparë në projektbuxhet.

Dua që të mos u mbetem borxh kolegëve nga LDK-ja dhe t'ia konfirmoj koleges sime Blerta Deliu ato çka i tha për investimet. Unë dua t'i falënderoj LDK-në dhe qeveritë prej vitit 2000 deri në vitin 2007 që në Skenderaj, përveç rrugës prej 6 kilometra që e kanë shtruar dhe renovimit ose restaurimit të kullës së Ahmet Delisë, ka ndërtuar edhe dy shkolla, njëra është në Likoc, shkolla "Fehmi Rama", dhe shkolla tjetër "Ahmet Delia" në Skenderaj. Kështu që për 7 vjet, në komunën e Skenderajt, "ju lumtë", keni investuar vetëm 2 shkolla, 6 kilometra rrugë dhe keni bërë restaurimin e një kulle.

KRYETARI: Replikë, deputeti Ali Sadriu.

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë edhe më herët thashë se vërtet po ndihem keq nga ky disponim i disa kolegëve këtu.

Thashë se janë investuar një mori projektesh në mandatin tim në Skenderaj dhe unë kam mirënjohje prej kryetarit të Kuvendit të Komunës së Skenderajt, dhe unë do të jua sjellë nesër për ta parë. Prandaj, turpërohuni zotërinj, se të thuhet se nuk ka pasur investime, e keni diskredituar... Në çfarë pozitash po mendoni? Po mendoni se vetëm Drenica paska luftuar? Vetëm Drenica i paska kontribuar kësaj çështjeje? E unë po ju them edhe si individ, edhe si familje, në të gjitha etapat kam qenë viktimë edhe krenohem për atë. Ka edhe shumë e shumë të tjerë. E dimë se nuk ka mal pa derra. T'i këqyrim derrat tanë, brenda vetes çdonjëri. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Haki Demolli e ka fjalën.

(Reagim nga salla)

HAKI DEMOLLI: Faleminderit, kryetar! A janë krijuar kushtet, kryetar? Jam duke pritur.

I nderuari kryetar,

Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë mjaft të lodhur,

Do të mundohem të flas paksa më shkurt. Mirëpo, fillimisht do t'i theksoja shpenzimet për paga dhe mëditje.

Sipas projektbuxhetit të vitit 2013, është planifikuar që 435 milionë euro, apo 27,5% të tij do të shpenzohen për paga dhe mëditje. Kur krahasohet kjo përqindje me ato të vendeve të regjionit, atëherë shihet se është më e lartë, sepse në Shqipëri shpenzimet për paga marrin pjesë me 16,95% në buxhetin vjetor. Në Maqedoni me 14,55 të buxhetit, kurse në Serbi me 23,22% të buxhetit. Shuma prej 435 milionë eurove, e paraparë për paga dhe mëditje për vitin 2013, është për 25 milionë euro më e lartë se sa ajo e vitit 2012. Mirëpo, kjo rritje nuk është pasojë e rritjes së pagave, por është pasojë e rritjes së punësimit të vazhdueshëm dhe të pakontrolluar në sektorin publik, me çka Qeveria është shndërruar në punëdhënësin më të madh në Kosovë, që po i punëson militantët e vet partiakë pa kurrfarë kriteresh, duke e keqpërdorur pushtetin për manipulime politike, pa marrë fare në konsideratë konkurrencën lojale në tregun e punës dhe kriteret e përvojat profesionale të punëkërkesve kosovarë.

Në këtë mënyrë, ky buxhet është stërngarkuar me paga dhe mëditje për të punësuar në vija partiake dhe kështu shndërrohet në një mekanizëm për zgjedhjen e problemeve sociale dhe për shpërblimin apo kompensimin e militantëve për kontributin e dhënë.

Me këtë rast duhet konstatuar se me gjithë premtimet e kota të Qeverisë se do t'ua rrisë pagat të punësuarve në sektorin publik, realisht, duke pasur parasysh shkallën e lartë të inflacionit nga viti në vit në Kosovë, vlera reale e pagave të këtij sektori po shënon rënie të vazhdueshme.

Por, derisa me këtë projektbuxhet planifikohen fonde dhe stimulohet punësimi në sektorin publik, i njëjti nuk i kushton kujdesin e duhur njërit prej sektorëve më të rëndësishëm të ekonomisë kosovare. Fjala është për degën e bujqësisë, për të cilën për vitin 2012 janë ndarë 8,4 milionë euro për subvencione dhe 7,8 milionë euro për shpenzime kapitale. Ndërsa, sipas projektbuxhetit të vitit 2013 planifikohen 9,4 milionë euro subvencione dhe 8,8 milionë euro investime kapitale, prej të cilave vetëm 335 mijë euro për projekte të reja në bujqësi.

Shuma prej 18,2 milionëve paraqet vetëm 1,4% të buxhetit, që është përqindja më e ulët në regjion, e duke pasur parasysh strukturën e popullatës së Kosovës, shumica e së cilës jeton në zonat rurale, sipas ekspertëve përkatës, do të duhej të shumëfishohej për së paku edhe pesë herë dhe në atë mënyrë do të krijoheshin kushtet për një zhvillim solid të bujqësisë kosovare.

Investimet më të mëdha në bujqësinë kosovare sesa ato që janë planifikuar me këtë projektbuxhet duhet bërë edhe për faktin se në Kosovë afro 143 mijë ekonomi familjare, respektivisht afro 170 mijë persona janë të involvuar drejtpërdrejt në sektorin e bujqësisë.

Trajtimi i këtillë joserioz apo lënia pas dore e bujqësisë gjatë planifikimit të buxhetit, siç është duke vepruar Qeveria që po e sponsoron këtë draftligj, ka bërë që për nevojat e konsumit të gjerë kosovar të importohen produkte bujqësore në vlerë deri në 400 milionë euro në vit, e që paraqet afro 20% të importit total.

Pra, në këtë mënyrë, për shkak të politikave të gabuara në planifikimin e investimeve, në vend se të stimulohet kosovari për të prodhuar atë që di dhe mund më së miri, konkretisht pemët dhe perimet, ai detyrohet t'i nxjerrë eurot jashtë vendit për të blerë pemë, perime dhe produkte të tjera bujqësore.

Kjo Qeveri nuk e ka lënë pas dore vetëm bujqësinë, por edhe arsimin kosovar, i cili është duke u ballafaquar me probleme të shumta, si mungesë e objekteve shkollore, e inventarit dhe kushteve tjera elementare, që drejtpërdrejt ndikojnë në kualitetin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Konkretisht, sipas këtij buxheti, për arsimin kosovar, në emër të investimeve kapitale janë planifikuar 22,6 milionë euro, që janë 3,64% e investimeve...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Ganimete Musliu, replikë.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, kryetar.

Edhe një herë dua ta shfrytëzoj të drejtën time për kundër-replikë, çdoherë kur unë e kërkoj dhe dua t'i tregoj edhe një herë të nderuarit koleg nga LDK-ja që pajtohem plotësisht se ka marrë mirënjohje dhe unë dua ta falënderoj që për 8 vjet në Skenderaj ka bërë 6 kilometra rrugë, 2 shkolla dhe restaurimin e një kulle.

(Ndërprerje e incizimit)

KRYETARI: Urdhëro, Latif Gashi, replikë.

LATIF GASHI: Faleminderit, kryetar!

Unë e falënderoj zotin Demolli, veçse e kisha lutur shumë që ta ushtrojë ndikimin e vet te pushteti lokal në Prishtinë, edhe në Besianë, se ka diskriminim total të kuadrove të subjekteve tjera politike. Avancohen vetëm strukturat e LDK-së. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, zoti Demolli e ke fjalën, kundër-replikë.

HAKI DEMOLLI: Unë t do t'i kisha thënë vetëm dy fjalë. Kjo që e theksoi kolegu deputet Gashi, bash nuk ka lidhje kurrgjë me diskutimin tim.

KRYETARI: Mirë! Latif Gashi, kundër-replikë.

LATIF GASHI: Unë e kisha lutur zotin Demolli ta korrigjojë veten dhe ta lexojë procesverbalin çfarë ka thënë në fillim. Unë kurrgjë më shumë nuk thash, vetëm kërkoja nga ai që ta ushtrojë ndikimin e tij, ngase ka diskriminim të kuadrove tjera, të subjekteve tjera politike. Edhe një herë po ia them.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti, nënkryetari Xhavit Haliti.

XHAVIT HALITI: Të nderuara zonja deputete,

Zotërinj deputetë,

Kabinet qeveritar,

Së pari dua ta falënderoj Qeverinë, që e ka përgatitur dhe e ka sjellë me kohë projektin e buxhetit dhe që na ka dhënë kohë dhe hapësirë edhe ne, që të kemi mundësi të diskutojmë dhe ta shqyrtojmë dhe të bëjmë amendamentimin e këtij buxheti deri në miratimin e dytë.

Unë i kam dëgjuar me vëmendje diskutimet dhe për mua është krejtësisht normale, që secili nga zona që vjen të llobojë, sepse i dhemb më shumë për regjionin dhe obligimet që i kanë marrë nga votuesit e vet, aty ku janë votuar.

Ashtu siç është e drejtë, edhe ajo që të tjerët thonë, Kosova është një zonë dhe duhet të mendojmë të gjithë për Kosovën, por, sidoqoftë, secili jemi në njëfarë mënyre avokat i atyre që na kanë zgjedhur, i atyre që na kanë votuar, në radhë të parë.

Unë dola që ta lus ministrin e Financave dhe Qeverinë që ta ketë parasysh një projekt, për të cilin ne nuk diskutuam shumë, projektin e turizmit malor në Kosovë. Sot në Evropë

është në trend turizmi malor, i cili i sjell të hyra edhe buxhetit të shtetit, por edhe banorëve, të cilët mund të ndërtojnë objekte, të cilat u krijojnë kushte dhe lehtësira atyre që duan të pushojnë në ajrin e pastër dhe në klimën e përshtatshme, veçanërisht kur e kemi parasysh ngrohjen globale.

Unë nuk po them që të investohen sot qindra miliona, por po them që të kihet parasysh të bëhen projekte të mundshme dhe në të ardhmen të shohim se sa mund të investojmë për ndërtimin e infrastrukturës, e cila mund të jetë ndihmesë e madhe për turizmin malor dhe për investimet private në këtë lloj turizmi me përfitime të mëdha. S'po dua ta krahasoj as me Austrinë, as me Zvicrën, të cilat dihet se çfarë të ardhurash kanë nga turizmi malor, por e kemi këtë mundësi.

Çështje e dytë është që ne e kemi një sistem shumë të keq, ose më mirë të themi ne nuk kemi ujë. Rezervat e ujit janë shumë të vogla. Dhe, dua ta kemi parasysh që sot vdesin 1,5 milion banorë në botë për shkak se përdorin ujëra të papastrë. Në Kosovë, një pjesë e madhe e qytetarëve pinë vetëm ujë të klorizuar, pa kaluar nëpër procesin e pastrimit dhe ka sish, një pjesë shumë e madhe, akoma më keq, që pinë ujë nga pusët dhe ujë të paklorizuar.

Ta kemi parasysh, që mundësisht të ju sigurojmë, të mos flasim fjalë të mëdha, të gjithë banorëve të Kosovës që të pinë ujë të pastër dhe ujë të përpunuar.

Ashtu siç do ta mbështetja Qeverinë për ndërtimin e shkollave dhe ofrimin e shërbimeve në spitale, do të kërkoja që të vazhdojë, pa marrë parasysh kush e ka filluar, projektin për ngrohjen e Prishtinës, që pati filluar nga Termoelektrana e Obiliqit dhe ta heqim ngarkesën që e ka sot "Termokosi", siç po e quajnë Ngrohtoren e Prishtinës. Uroj që ta votojmë këtë projekt-buxhet. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Fadil Demaku, i fundit i paraqitur për sot.

FADIL DEMAKU: Faleminderit, kryetar!

E di që ka humbur durimi moti këtu, por sikur të gjithë deputetët tjerë, që po janë insistues për t'i thënë gjërat të cilat i kanë përgatitur, ashtu dua edhe unë. Të falënderoj që më ke ruajtur të fundit sot edhe të fjalimet jashtë rendit të ditës, edhe këtu.

Gjatë diskutimeve u fol shumë, e sidomos u fol për Skenderajn nga të gjithë taborët. Unë do të ndalem pak te komuna e Drenasit, se po të shikohet projekt-buxheti dhe nga të gjitha projektet që kanë paraparë ministrinë aty, po më duket se kanë harruar që edhe aty është pushteti i PDK-së.

Unë do të isha ndalur konkretisht në 4-5 projekte, që mendoj se janë tepër të rëndësishme dhe janë emergjente që të ndërhyhet.

Së pari, te projekti i Ministrisë së Arsimit, shkolla fillore e Arllatit, të cilën e përmendi kolegja deputete, Sala Berisha-Shala. Është shumë e vërtetë që është në gjendje jashtëzakonisht të rëndë dhe aty për më tepër se një muaj është vonuar procesi mësimor

për shkak të gjendjes së keqe të shkollës. Këtu dua ta bëj një përmirësim, sepse ministria nuk e ka futur në projektet për vitin 2013, por e ka futur në vlerësim për vitin 2014.

Dhe, këtu, gjithashtu Komuna e Drenasit e ka ndarë një shumë të mjeteve dhe bashkëfinancimi duhet të bëhet nga ministria bashkë me komunën, që sa më shpejt të mundësohet që në vitin 2013, nxënësit e asaj shkolle, që janë në numër rreth 500, ta kenë shkollën e tyre.

Një projekt tepër i rëndësishëm, të cilin duhet ta ketë parasysh Ministria e Arsimit, nuk po flas për fshatra më të largëta, por pikërisht në qendër të Drenasit, për shkollën fillore “Rasim Kiçina”, e cila i ka rreth 600 nxënës. Rreth 40% e shkollës është bërë rregullimi i saj në një bashkë-projekt me USAID-in dhe Komunën e Drenasit, por 60% e saj është në gjendje jashtëzakonisht të keqe. Nuk e ka vështirë kurrkush të shkojë e ta shohë shkollën pikërisht në qendër të Drenasit.

Te Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor do të kisha qenë shumë kureshtar ta di, përderisa komuna e Drenasit e dimë që e ka “Ferronikelin”, si njërin nga ndotësit më të mëdhenj dhe e dimë çfarë dëmsh të mëdha u shkakton të gjithë banorëve, është theksuar disa herë këtu nga shumë deputetë kolegë, por në ato projekte të cilat janë bërë, ndalemi të rregullimi i lumenjve. Për rregullimin e shtratit të lumit “Drenica”, kjo ministri ka paraparë vetëm 50 mijë euro. Po ta krahasosh me komunat e tjera, pavarësisht ku është në pushtet, LDK, PDK, AAK, apo diku tjetër, ajo shumë është jashtëzakonisht e vogël dhe pakrahasimisht me nevojat dhe kisha pasur dëshirë ta di mbi cilat kritere është bërë kjo.

Te Ministria e Infrastrukturës, zoti ministër është këtu, sinjerisht uroj që të mos jesh ndikuar nga barsoletat për asfaltin në Drenicë, sepse gjendja është jo shumë e mirë atje.

Unë do t’i përmend vetëm dy rrugë. Rruga Drenas-Baicë, ministër, që ka 5 kilometra, është rrugë e cila e lidh qytetin me 4 fshatra tjera, me numër rreth 10 mijë banorë. Ajo rrugë tash pothuajse është bërë e pakalueshme për këtë sezon. Dhe, absolutisht nuk është menduar asnjë investim për atje.

Në të njëjtën gjendje e kemi rrugën Drenas-Çikatovë e Vjetër, e cila i lidh po ashtu katër fshatra dhe aty janë më tepër se 10 mijë banorë. Edhe ajo është në gjendje katastrofale. Dhe, do të duhej të parashikohej që gjatë punës në komisione dhe deri në leximin e dytë këto çështje duhet të rregullohen.

Edhe një çështje tjetër. Rregullimi i rrugës Prishtinë-Pejë, zoti ministër, ju e dini që mbikalimet dhe nënkalimet që janë bërë, sidomos në zonën e Komoranit, për to absolutisht nuk janë pyetur qytetarët, as bizneset. Dhe, aty ka pasur një diskriminim, të gjithë e dimë, me zhvendosjen nga kryqi dhe bllokimi i tyre.

Përveç që është bërë dëmtimi i tyre, devijimi i rrugës, nga mjetet e rënda, krejtësisht është dëmtuar infrastruktura në qendër të Komoranit. Unë e di që ministria ka premtuar që do

të investojë për rregullimin e infrastrukturës në qendër të Komoranit, por në buxhet nuk është paraparë kurrkund.

Do të sugjeroja dhe ju kisha lutur që të tri ministritë t'i parashohin këto çështje. Nuk janë çështje të vogla, por janë jashtëzakonisht të mëdha. Unë bashkërisht me ministrin kisha pasur dëshirë të shkojmë e t'i vizitojmë pikërisht ato dy rrugë dhe të bindemi të gjithë bashkë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën përfundimtare e ka ministri, zoti Bedri Hamza.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryetar!

Dëshiroj t'i falënderoj të gjithë deputetët për diskutimet e tyre.

Me vëmendjen dhe kujdesin maksimal kam bërë përpjekje që t'i përcjell të gjitha këto diskutime dhe stafi i Ministrisë së Financave i ka evidencuar diskutimet e deputetëve, kërkesat, normalisht edhe kritikën, dhe premtoj e shpresoj që sot ky buxhet të aprovohet.

Gjatë punës në komisione ne do të punojmë maksimalisht, që gjithçka që është e mundur, brenda mundësive reale buxhetore, këto diskutime, këto kërkesa dhe këto propozime të akomodohen.

Unë edhe një herë ju falënderoj shumë për diskutimin tuaj shumë korrekt, përmbajtjesor, profesional, kontribuues për këtë dokument sot shumë të rëndësishëm dhe i jap vetes të drejtë që edhe një herë të ju lus që të njëjtin ta votoni. Faleminderit!

(Ndërprerje e shkurtër nga regjia)

KRYETARI: Konsideroj që diskutimet për këtë çështje janë harxhuar. Dhe, kemi ardhur në fund, te votimi në parim i Projektligjit për buxhetin e vitit 2013.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 62 vota për, 31 kundër dhe një abstenim, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013.

Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

Mirupafshim në seancën e nesërme!

E përgatiti:

Njësia për Transkriptim dhe Lekturë